

# Indeksi i Reformës së Transparencës Komunale **2015**



British Embassy  
Pristina

Ky raport është përgatitur në kuadër të projektit "Indeksi i Reformës së Transparencës Komunale", i përkrahur financiarisht nga Ambasada Britanike në Prishtinë. Përmbajtja (ose të gjeturat dhe rekomandimet) e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi e autorëve dhe EC Ma Ndryshe dhe jo domosdoshmërisht paraqesin pikëpamjet e donatorit.

Botues: EC Ma Ndryshe

Redaktor: Agron Bajrami

Bartës i hulumtimit: Fisnik Minci

Autorët e kapitujve të komunave: Albert Krasniqi, Bekim Kupina, Dren Pozhegu dhe Fisnik Minci

Hulumtuesit: Albulena Nrecaj, Dardan Hoti, Elmedina Baxhaku dhe Vullnet Sanaja

Përkthyesit në anglisht: Arif Kastrati, CITS Translation dhe Iliriana Kaçaniku

Dizajn dhe faqesje: Bubrrecat

Fotografitë: Agron Beqiri, Alban Dragoshi, Arba Hatashi, Berat Hoxha, Brad Arlington, Erëlehtë Zymberi, Hipi Zhdripi-Gimi, Mick Morton, Shkëlzen Rexha [Wikimedia Commons]

Rr. Saraçët 5, 20000/Prizren

Bulevardi Nënë Tereza, H 30 B1 Nr. 5, 10000/Prishtinë

[www.ecmandryshe.org](http://www.ecmandryshe.org)

[info@ecmandryshe.org](mailto:info@ecmandryshe.org)

038-224-967

029-222-771

EC Ma Ndryshe

Përkrahur nga Ambasada Britanike në Prishtinë

Prill 2016

# Përmbajtja

---

**4**

Hyrje

---

**14**

Komuna e Ferizajit

---

**36**

Komuna e Gjakovës

---

**60**

Komuna e Gjilanit

---

**84**

Komuna e Mitrovicës

---

**108**

Komuna e Pejës

---

**130**

Komuna e Prishtinës

---

**154**

Komuna e Prizrenit

---

**180**

Referencat

---

**192**

EC Ma Ndryshe

# Hyrje

Autor: Agon Bajrami



Hyrje	6
Indeksi i Reformës së Transparencës Komunale	7
Metodologjia	8
Notimi	10
Përmbledhja ekzekutive	10

## Hyrje

Demokracia konsiderohet gjerësisht si sistemi superior politik, që ofron përfaqësimin më të drejtë, më të mirë dhe më efektiv të shumicës së qytetarëve në institucionet e qeverisjes. Në bazën e saj është e drejta e secilit për të zgjedhur dhe për të qenë i zgjedhur, pa asnjë presion dhe ndërhyrje. Kështu, demokracia moderne siguron qeverisjen e shumicës, me mekanizma që mbrojnë edhe të drejtat e pakicës.

Por, demokracia nuk ka të bëjë vetëm me sigurimin e zgjedhjeve të lira dhe të drejta; ajo është shumë më tepër se kaq: kuptimi modern i demokracisë ka të bëjë jo vetëm me të drejtën për të zgjedhë lirshëm, por edhe me llogaridhënien e të zgjedhurit i cili merr mandatin nga zgjedhësi.

Që kjo llogaridhënie të realizohet, sistemi demokratik ka të parapara disa mekanizma të ndryshëm, prej rregullave zgjedhore deri te sundimi i ligjit, që janë vendosur për të parandaluar shmangien nga mandati i pushtetit, apo zhytjen në korrupsion.

Megjithatë, vetëm këta mekanizma shpesh herë nuk mjaftojnë që synimi të arrihet, andaj dhe është shfaqur nocioni i transparencës së shtetit/pushtetit, si mjet për të ngritur llogaridhënien në një shoqëri demokratike.

Kështu, transparenca e institucioneve të shtetit ka rëndësi qendrore në procesin demokratik. Ajo është mjeti përmes të cilit publiku ka qasje në punën e zyrtarëve të lartë, dhe ofron një mundësi për ndërtimin e llogaridhënies efektive.

Në Kosovë, sigurimi i transparencës së institucioneve ka qenë vazhdimisht një prej sfidave më të mëdha në ndërtimin e demokracisë funksionale. Të gjitha nivelet e pushtetit, prej atij lokal/komunal deri të ai qendror, por edhe institucionet e pavarura kombëtare sikur edhe një numër mekanizmash ndërkombëtar me mandat ekzekutiv në vend, janë dëshmuar të dobëta në ofrimin e transparencës për publikun. Në fillim, madje, mungesa e transparencës ka qenë aq e theksuar, sa që zhvillimi i takimeve prapa dyerve të mbyllura ka qenë rregull, dhe jo përjashtim.

Viteve të fundit, megjithatë, ka një presion më të madh ndaj institucioneve të shtetit që të ofrojnë transparencë më të madhe në punën e tyre, e cila bëhet në emër të publikut dhe me mjetet e publikut. Shoqëria civile kosovare dhe mediat, por edhe një pjesë e bashkësisë ndërkombëtare, por edhe qytetarë individual, kërkojnë çdo herë e më shumë informata për punën e qeverisë, shpenzimin e buxhetit, realizimin e premtimeve parazgjedhore dhe projekteve të ndryshme, vendim-marrjen institucionale, dhe të gjitha proceset që kanë të bëjnë me ofrimin e shërbimeve dhe qeverisjen në emër të qytetarit.

## Indeksi i Reformës së Transparencës Komunale

Në kuadër të kësaj përpjekjeje për të siguruar transparencë sa më të madhe është realizuar edhe ky Indeks i Reformës së Transparencës Komunale, synimi i të cilit është të evidentojë nivelin e transparencës në pushtetin lokal, hapat e ndërmarra për të shtuar transparencën aty ku është e nevojshme, si dhe vlerësimin e hapave tashmë të ndërmarrë në përmirësimin e transparencës nga ana e autoriteteve komunale.

Zhvillimi i Indeksit të Reformës së Transparencës Komunale ka qenë një proces, në të cilin kanë qenë të përfshirë akterë të ndryshëm, me ç'rast janë hulumtuar problemet që kanë të bëjnë me transparencën në nivel lokal e qendror. Indikatorët janë zhvilluar duke synuar që të adresojnë problemet më të mëdha dhe të vendosin numra apo vlerësime për këto probleme. Raportet vendore dhe ndërkombëtare, të cilat adresojnë çështjen e transparencës së qeverisjes kanë qenë burimet kryesore për të identifikuar çështjet më problematike dhe për të dizajnuar indikatorët. Ndër raportet më të rëndësishme janë ato të Transparency International (Spanjë, Meksikë, SHBA), EC Ma Ndryshe, Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Departamentit për Komunitete dhe Qeveri Lokale të Mbretërisë së Bashkuar, Institutit Demokratik të Kosovës, ndërsa më pak të rëndësishme kanë qenë raportet e Open Government Partnership, OSBE Misioni në Kosovë, Iniciativës për Progres, dhe institucione e organizata tjera. Gjatë zhvillimit të Indeksit ka pas kontakte edhe me kryetarët e disa komunave, që po ashtu kanë qenë pjesëmarrës në hartimin e tij.

Ky Indeks është mekanizëm përmes të cilit synohet të maten indikatorët relevantë që dëshmojnë nivelin e transparencës së institucioneve të pushtetit lokal në Kosovë. Në këtë indeks, që është i pari i këtij lloji, janë përfshirë shtatë komuna të Kosovës, që njëherësh njihen edhe si qendra rajonale të vendit: Prishtina, Mitrovica, Peja, Prizreni, Ferizaj, Gjilani dhe Gjakova.

Është e qartë se një pamje e plotë e nivelit të transparencës në pushtetet komunale të Kosovës është e arritshme vetëm përmes monitorimit dhe analizës së të dhënave nga të gjitha komunat e vendit. Megjithatë, marrë parasysh se shtatë komunat në fjalë përveç se janë qendra rajonale, janë edhe komunat më të populluara në Kosovë, pasqyra e fituar nga monitorimi i tyre është një tregues shumë i mirë për nivelin e transparencës në pushtete lokale në gjithë vendin.

Projektin “Indeksi i Reformës së Transparencës Komunale” EC Ma Ndryshe ka nisur që ta zbatoj nga maji i vitit 2015, falë përkrahjes së Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë. Projekti ka shtrirje në komunat e mëdha të Kosovës - Prishtinë, Prizren, Pejë, Mitrovicë, Gjilan, Ferizaj dhe Gjakovë, sikurse edhe në Suharekë, Rahovec, Malishevë, Dragash, Mamushë dhe Shtërpçë. Ky Indeks ka për qëllim që ti asistoj komunat në identifikimin e mangësive kryesore sa i përket transparencës sikurse edhe të ofroj udhëzime për adresimin dhe tejkalimin e tyre. Indeksi i Transparencës paraqet edhe një përpjekje të strukturuar për të mbështetur komunat e Kosovës në përmbushjen e standardeve të qeverisjes së mirë, të përcaktuara me reformën e qeverisjes lokale dhe agjendën evropiane të Kosovës.




Metoda e përdorur për monitorimin, analizën dhe vlerësimin e transparencës mbështetet në indikatorë objektivë, të njëjtë për të gjitha komunat.

Në këtë mënyrë, Indeksi ofron një mundësi për vet administratat komunale të vërejnë dhe adresojnë mangësitë në transparencën e tyre, ndërsa ndihmon edhe qytetarët dhe publikun e gjerë të këtyre komunave që aktivisht kërkojnë ngritjen e transparencës së pushtetit lokal.

Shpesh herë, sytë e opinionit kombëtar janë të kthyer në tërësi nga Qeveria qendrore. Projektet e mëdha kombëtare, proceset e rëndësishme politike dhe investimet kapitale ekonomike e buxhetore zakonisht zënë vendin qendror në raportimet e mediave dhe aktivizmin e shoqërisë civile.

Por, një pjesë e madhe e vendim-marrjes dhe ekzekutimit që ndikon tek kualiteti i jetës së qytetarit varet më shumë nga autoritetet lokale se sa nga qeveria qendrore, ndërsa në shumë raste bashkëpunimi i të dy niveleve të pushtetit është i domosdoshëm për arritjen e rezultateve në të mirën e qytetarit. Në shumicën e rasteve, kur flitet për shërbimet publike, projektet infrastrukturore apo investimet ekonomike, përgjegjësia është e përbashkët – te pushteti qendror dhe pushteti lokal, njëkohësisht.

Andaj, përderisa mbetet jashtëzakonisht e rëndësishme që të monitorohet transparenca e institucioneve qendrore të pushtetit dhe shtetit, jo më pak me rëndësi është edhe transparenca në nivelin komunal, ku shpesh herë efektet e qeverisjes ndjehen më drejtpërdrejtë në jetën e përditshme të qytetarëve.



## Metodologjia

EC Ma Ndryshe, para hartimit të Indeksit të Reformës së Transparencës Komunale, ka zhvilluar hulumtim rreth problemeve që ndërlidhen me transparencën në Komuna të Kosovës si dhe transparencën e qeverisjes në përgjithësi. Gjatë këtij hulumtimi është vërejtur se hartuesit e raporteve të transparencës komunale në Kosovë nuk kanë arritur të dizajnojnë ndonjë metodologji që do të rezultonte me të gjetura dhe rekomandime të kualitetit të lartë, për shkak se raportet e transparencës komunale kanë qenë raporte vlerësuese të zbatimit të kriterëve minimale ligjore. Bazuar në këtë hulumtim, EC Ma Ndryshe ka dizajnuar 13 grupe indikatorësh/faktorësh, me një morri nën-indikatorësh, të cilat kanë rëndësi të veçantë në vlerësimin e transparencës së komunave. Për më tepër, EC Ma Ndryshe ka përpiluar edhe pyetjet dhe ka dhënë shembuj se çfarë nënkuptojnë këto fusha. Në këtë mënyrë fokusi i hulumtimit ka qenë në çështje të njëjta si dhe vlerësimet për secilën komunë janë bazuar në kritere të njëjta.

Indikatorët/faktorët të cilat janë monitoruar dhe mbi të cilat është shkruar raporti janë:

Kryetari, Drejtorët dhe Anëtarët e Kuvendit



- Organizimi dhe funksionimi
- Puna e organeve politikë-bërëse dhe vendim-marrëse
- Luftimi i sjelljeve të pahijshme dhe keqpërdorimeve
- Integrimi Evropian
- Kontabiliteti dhe buxheti
- Kontratat e prokurimit publik, furnizimit dhe granteve
- Të punësuarit në administratën publike dhe organizatat/institucionet publike
- Pasuria kapitale dhe jokapitale
- Informimi dhe shërbimi i qytetarëve
- Bashkëpunimi me shoqërinë civile
- Planifikimi urban
- Monitorimi i projekteve urbanistike

Nga gjysma e vitit deri në fund të vitit 2015, EC Ma Ndryshe ka angazhuar monitorues në 7 komuna. Ata kanë marrë pjesë në monitorimin direkt të zhvillimeve në kuadër të pushtetit lokal, duke i përcjellë takimet e organeve vendimmarrëse, sikurse edhe diskutimet e ndryshme publike. Në të njëjtën kohë kanë vëzhguar në mënyrë të rregullt publikimin e njoftimeve, raporteve, rregulloreve e dokumenteve tjera statutore në ueb faqen zyrtare të Komunës, por edhe portalet ndihmëse të krijuara nga vet komunat. Informatat relevante nga monitoruesit janë grumbulluar edhe përmes qasjes në dokumente publike, por edhe në kontakt dhe intervista të drejtpërdrejta me zyrtarët komunal, përfaqësuesit e partive opozitare, aktivistët e shoqërisë civile dhe gazetarët lokal. Kësisoj këto të dhëna i kanë shërbyer autorëve të raporteve për përpilimin e draftit të parë.

Autorët e raporteve kanë përpiluar draft raportet bazuar në të gjeturat e monitorimit vjetor, por edhe referencat e institucioneve publike dhe organizatave tjera të shoqërisë civile. Ata kanë marrë për bazë aspektin normativ dhe veprimet në praktikë të zbatuara nga komunat për transparencën në indikatorë të ndryshëm. Gjithashtu janë analizuar përmbajtjet e raporteve të komunave dhe cilësia e të dhënave të pasqyruara në to. Janë marrë parasysh qasjet statike apo dinamike të zyrtarëve përgjegjës, sikurse edhe vështirësitë reale me të cilat ballafaqohen komunat, por janë vlerësuar edhe praktikatat e mira që janë zbatuar nga pushtetet lokale për t'i tejkuluar sfidat reale, në përpjekje për të qenë transparent kundruall publikut.

Më pastaj draft raportet janë rishikuar nga një ekip i analistëve të EC Ma Ndryshe.

Me qëllim të sigurimit për kredibilitetin e informatave të paraqitura si dhe që analiza e paraqitur të jetë e saktë dhe e qëndrueshme janë organizuar Fokus Grupet, në 7 komunat, me ç'rast draft raporti për komunën përkatëse është diskutuar me përfaqësuesit nga qeveria komunale, këshilltarët opozitarë, MAPL-i, shoqëria civile dhe gazetarët.

Pas vërejtjeve e komenteve të pasqyruara në Fokus Grupe, autorët janë siguruar për saktësinë e informatave përmes hulumtimit sekondar dhe me intervistat gjysmë të strukturuar me akterët e caktuar. Në të njëjtën kohë brenda afatit të caktuar kohor janë kërkuar edhe komentet përfundimtare nga vet Komuna, në lidhje me përmbajtjen e draft raportit.

Pas kompletimit të këtij cikli, autorët kanë finalizuar përmbajtjen e raporteve. Pas rishikimit nga ekipi i analistëve të EC Ma Ndryshe, raportet para publikimit janë edituar nga një redaktor.



## Notimi

EC Ma Ndryshe në vitin e parë të monitorimit dhe përpilimit të Indeksit të Reformës së Transparencës Komunale është përcaktuar që mos të vendos një notim të përgjithshëm për komunën, por ka aplikuar vetëm notimin për secilin indikatorë. Notimi është bërë duke u bazuar në mundësinë për qasje në informata, përdorimin e informatave, mundësinë për komunikim të dyanshëm, dhe sa janë të plota informatat. EC Ma Ndryshe ka rezervuar të drejtën për vendosjen e notës përfundimtare.

Për notën/vlerësimin, autori ka paraqitur në formë narrative edhe arsyen për vendimin e tillë, duke qartësuar ngjarjet të cilat ndikojnë në një vlerësim të tillë.

EC Ma Ndryshe synon që indikatorët, pesha e tyre dhe metoda e notimit të jenë relevant për një kohë të gjatë dhe të zbatueshme në vende të ndryshme, kështu që krahasimi të jetë i mundshëm për vende të ndryshme dhe periudha të ndryshme kohore. Rrjedhimisht, ky indeks mund të aplikohet për qeveri lokale edhe jashtë Kosovës dhe të jetë i krahasueshëm.

## Përmbledhja ekzekutive

Indeksi i Reformës së Transparencës Komunale që prezantohet në këtë raport jep rezultatet për shtatë komunat e monitoruara: Prishtinën, Mitrovicën, Pejën, Prizrenin, Ferizajn, Gjilanin dhe Gjakovën.

Rezultatet, të cilat janë prezantuar edhe përmes raportimit por edhe në formë tabele, japin vlerësimin e nivelit të transparencës komunale për 13 indikatorë të veçantë. Siç mund të vërehet, në shumicën e komunave trendi është për një transparencë më të madhe në disa indikatorë, dhe transparencë shumë më të ulët në disa tjerë.

Për shembull, niveli i transparencës në publikimin e informative rreth të zgjedhurve dhe të emëruarve politikë në pushtetin komunal, prej kryetarit të komunës dhe drejtorëve deri tek anëtarët e Kuvendeve Komunale (që është indikator i parë), tendenca është për një nivel “neutral” të transparencës, që nënkupton se është regjistruar një përpjekje mesatare për të qenë transparent.

Në bazë të vlerësimit të bërë në Indeks, del se pesë komuna kanë nota negative në indikatorin për luftimin e sjelljeve të pahijshme dhe keqpërdorimeve, derisa Peja ka marrë notë neutrale, e vetëm Gjakova ka vlerësim pozitiv.

Notë pozitive kanë marrë të gjitha komunat, përveç komunës së Prizrenit, te indikatorin 11, që ka të bëjë me bashkëpunimin e organeve komunale me shoqërinë civile.

Ndërsa, kur analizohet indikatorin 9 – që ka të bëjë me informimin e publikut me menaxhimin e pasurisë publike nga ana e pushtetit komunal – rezultatet janë dëshpëruese, meqë të gjitha komunat e monitoruara dalin me rezultat negative, që tregon mungesë pothuaj të plotë të transparencës në këtë segment.

Po ashtu, ka indikatorë ku disa komuna qëndrojnë më mirë se disa tjera; për shembull, te indikatorin 12, planifikimi urban, komuna e Prishtinës është vlerësuar me notë pozitive dhe ajo e Pejës me notë neutrale për transparencë, derisa pesë komunat tjera kanë marrë nota negative te ky indikator.

Marrë në tërësi, sikur që mund të vërehet edhe nga tabelat e notimit që janë pjesë e këtij raporti, disa komuna kanë një performancë shumë më pozitive se disa tjera. Për shembull, komuna e Gjakovës ka notë pozitive në 8 nga 13 indikatorët, me vetëm dy nota negative dhe tre neutrale. Në anën e kundërt qëndron komuna e Prizrenit, e cila ka 11 vlerësime negative, 2 neutrale ndërsa në asnjërin nga indikatorët e transparencës nuk ka shënuar notë pozitive.

Sa i përket indikatorëve të veçantë, përveç menaxhimit të pasurisë publike që tashmë u përmend, të gjitha komunat (përveç Gjakovës) kanë performancë të dobët në indikatorin 5 që ka të bëjë me procesin e integrimi evropiane.

Në mesin e shtatë komunave të monitoruara ka edhe të tilla që kanë aplikuar praktika të mira. Derisa një pjesë e komunave janë ankuar se kanë telashe teknike me ueb faqen zyrtare, për shkak të sistemit të centralizuar, Komuna e Gjakovës dhe ajo e Prishtinës kanë ndërmarrë veprime konkrete në këtë drejtim, duke krijuar portale shpesh, që janë më lehtë të navigueshme dhe ku mund të ngarkohen më shumë informata, apo të dhëna të madhësive më të mëdha. Ndërkaq Komuna e Gjilanit ka themeluar Regjistrin e Procedurave Administrative ku publikohen të gjitha informatat mbi procedurat që qytetarët marrin nga Komuna, ku për secilën procedurë është detajuar baza ligjore, informacioni dhe dokumentet e duhura për të aplikuar, tarifën dhe pagesat për aplikim si dhe koha e përcaktuar për kthimin e përgjigjes.

Marrë në përgjithësi, ky Indeks i Reformës së Transparencës Komunale evidenton një mungesë të transparencës në segmente shumë të rëndësishme të pushtetit lokal, ndërsa të pakta janë fushat ku mund të konstatohet një përmirësim sistematik, që përfshinë të gjitha komunat.

Sigurisht, vazhdimi i monitorimit do të mund të japë informata më të mira rreth tempos së ndryshimeve në performancën e komunave, dhe Indeksi i ardhshëm i Reformës së Transparencës Komunale për këto shtatë komuna ka gjasa të japë një pamje edhe më të qartë rreth arsyeve të mungesës së transparencës në fusha të caktuara. Por, një trend i dukshëm tashmë është i qartë edhe nga këto shtatë raporte, që bashkërisht japin një pamje më të gjerë për nivelin e transparencës në pushtetin lokal të Kosovës, si dhe pikat ku progresi do të mund të sillte rezultate më të mira, dhe më shpejtë.

# Shenjat për navigim

---



---

Grupimi i indikatorëve/faktorëve

---



Indikator/faktor

---

Notimi për indikator/faktor

# Komuna e Fe

Autor: Bekim Kupina






# Ferizajit

I. Organizimi, përbërja, kompetencat, dokumentacioni dhe funksionimi _____	16
1. Kryetari, Drejtorët dhe Anëtarët e Kuvendit _____	16
2. Organizimi dhe funksionimi _____	17
3. Puna e organeve politike-bërëse dhe vendim-marrëse _____	18
4. Luftimi i sjelljeve të pahijshme dhe keqpërdorimeve _____	20
5. Integrimi Evropian _____	21
II. Menaxhimi ekonomik dhe financiar _____	21
6. Kontabiliteti dhe buxheti _____	21
7. Kontratat e prokurimit publik, furnizimit dhe granteve _____	22
III. Menaxhimi i resurseve njerëzore dhe resurseve tjera _____	23
8. Të punësuarit në administratën publike dhe organizatat/ institucionet publike _____	23
9. Pasuria kapitale dhe jokatitale _____	24
IV. Marrëdhëniet me qytetarët dhe shoqërinë _____	25
10. Informimi dhe shërbimi i qytetarëve _____	25
11. Bashkëpunimi me shoqërinë civile _____	26
V. Planifikimi dhe zhvillimi urban _____	27
12. Planifikimi urban _____	27
13. Monitorimi i projekteve urbanistike _____	28
VI. Notimi _____	30





# I. Organizimi, përbërja, kompetencat, dokumentacioni dhe funksionimi

## 1. Kryetari, Drejtorët dhe Anëtarët e Kuvendit

*Volumi dhe kualiteti i informatave të publikuara rreth të zgjedhurve dhe emëruarve politik (në Komunën e Ferizajt në këtë kategori hyjnë Kryetari, Drejtorët, dhe Anëtarët e Kuvendeve Komunale), duhet të jenë të mjaftueshme për të vlerësuar kredibilitetin e tyre, mbikëqyrur angazhimin e tyre në vazhdimësi, dhe për të kontaktuar në mënyrën më të përshtatshme me personat që mbajnë këto pozita.*

Kryetarin të Ferizajt në uebfaqen e komunës, <https://kk.rks-gov.net/ferizaj/Home.aspx>, i është publikuar biografia e plotë. Për dallim prej tij, drejtorëve të drejtorive në përgjithësi u janë publikuar të dhënat biografike, përpos në disa raste kur nuk ka një informacion të precizuar në lidhje me përfundimin e shkollimit superior. Ka raste kur, është evidentuar përfundimi i fakultetit juridik, por pa ndonjë informacion shtesë në funksion të plotësisimit të informatës. Anëtarëve të Kuvendit nuk u janë publikuar CV-të, mungojnë profilet e tyre,<sup>1</sup> ndërsa është publikuar një listë me emrat e mbiemrat e këshilltarëve, numrat e telefonit të tyre dhe adresat elektronike.<sup>2</sup>

Deklaratat e pasurisë të krerëve të komunës dhe këshilltarëve komunalë ekzistojnë vetëm në uebfaqen e Agjencisë Kundër Korrupsion,<sup>3</sup> por jo edhe në ndonjë vegëz në kuadër të uebfaqes së komunës. Njësoj është vepruar edhe me ndryshimin e pasurisë së këtyre zyrtarëve në krahasim me vitin/vitet paraprake, e cila është publikuar vetëm në uebfaqen e AKK-së, por nuk ka asnjë informacion në atë të komunës. Nuk janë të publikuara në uebfaqe të ardhurat si dhe kompensimet shtesë nga puna në Komunë, të ardhurat nga angazhimet në vende tjera të punës dhe deklaratat e konfliktit të interesit. Por, janë 15 raste më 2015, në të cilat është ngritur hetim nga AKK-ja për konflikt interesi, teksa vendimet në lidhje me shmangien e konfliktit të interesit janë të publikuara vetëm në uebfaqen e AKK-së, por jo edhe në atë të komunës.

Nga ana tjetër, nuk janë publikuar deklaratat të tjera në lidhje me interesa të ndryshme.

Për të realizuar kontaktet me zyrtarët dhe drejtorët komunalë, në uebfaqe janë publikuar numrat e telefonisë fikse, celularët dhe adresat elektronike. Në këtë linjë, drejtorët komunalë, realizojnë çdo ditë takime me palë dhe atë dy herë në ditë, prej orës 10:00-12:00 dhe 13:00-15:00. Kreu i komunës mban takim me palë një herë në javë, ndërkohë që koha kur mund ta takojnë atë figuron në objektin komunal.

1 Për më shumë, shih <https://kk.rks-gov.net/ferizaj/Municipality/Assembly/Profilet-e-keshilltarve.aspx>

2 Për më shumë, shih <https://kk.rks-gov.net/ferizaj/getattachment/Municipality/Assembly/Asambleistet/Emrat-e-anetareve-te-KK-se-Lista-e-re-e-zgjedhjeve-2013.pdf.aspx>

3 Për më shumë, shih <http://www.akk-ks.org/sq/vendimet/date/2015&name=ferizaj>

Informatat mbi aktivitetet e Kryetarit publikohen rregullisht, ndërkohë që raportime ka edhe për aktivitetet e Kuvendit. Jepet edhe përshkrimi i aktiviteteve dhe çështjet e diskutuara.



### Nota: 3 (Neutrale)

*Arsyetimi: Duke pasur parasysh se kontakti me qytetarët është shtylla kryesore mbi të cilën duhet të funksionojë komuna, Ferizaj ka ndërmarrë masa solide për të krijuar mundësi për ta përmbushur këtë funksion. Informacionet e publikuara, në pjesën më të madhe ju hyjnë në funksion qytetarëve, teksa mbetet ende punë që disa informacione më specifike të bëhen publike, siç është p.sh. deklarimi apo krahasimi i pasurisë së zyrtarëve komunalë dhe paraqitja e interesave.*

## 2. Organizimi dhe funksionimi

*Publiku duhet të ketë informata të mjaftueshme për të kuptuar organizimin, kompetencat, funksionimin, procesin e vendimmarrjes dhe të politikëbërjes të trupave të ndryshme komunale.*

Struktura organizative e Komunës së Ferizajt është e publikuar nga viti 2009.<sup>4</sup> Por, nga ajo kohë, kjo strukturë ka pësuar ndryshime, të cilat nuk janë freskuar dhe rrjedhimisht nuk është ndryshuar as organogrami, i cili ekziston i publikuar, porse nuk është azhurnuar. Me këtë organogram nuk ekziston fare Drejtoria e Inspeksionit, teksa ka pasur disa ndryshime edhe në disa drejtori të tjera, të cilat janë ndarë me vendimin e mëvonshme të KK-së. P.sh. nga Drejtoria e Urbanizmit, Pronës, Kadastrit, Gjeodezisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit është ndarë në dy; në atë të urbanizmit dhe të kadastrës dhe pronës. Por, organogrami me organizimin e ri të komunës, megjithatë është vendosur në korridoret e objektit të komunës për secilën trupë komunale. Arsyetimi i zyrtarëve komunalë për këtë mungesë lidhet me pengesa nga niveli qendror. Sipas tyre ky dokument është bllokuar nga Ministria e Administratës Publike, shkak i një katalogu të vendeve të punës, të cilin është duke e përgatitur kjo ministri.<sup>5</sup> Përshkrimet e obligimeve të drejtuesve të komunës dhe zyrtarëve të tjerë komunalë janë publikuar sipas ligjit, statutit dhe rregulloreve. Por, mungon përshkrimi për funksionimin e trupave të ndryshëm komunal, organeve të decentralizuara dhe organeve/institucioneve ku autoritetet komunale kanë kompetenca. Informatat dhe përshkrimi i detyrave të pozitive kyçe është bërë konform sipas ligjit, statutit dhe rregulloreve. I njëjti veprim nuk është bërë me publikimin e informatave për personat që mbajnë poste kyçe. Janë publikuar vetëm numrat e telefonit, adresat elektronike, por jo informacione të tjera me rëndësi për punën që kryejnë këta zyrtarë.

Komuna e Ferizajt ka të publikuar statutin në kuadër të cilit jepen shpjegime legale mbi procesin e ligjëbërjes, politikëbërjes, vendimmarrjes dhe mënyrat e

<sup>4</sup> Për më shumë shih: <https://kk.rks-gov.net/ferizaj/getattachment/Temat/Organogrami-i-Komunes/Organogrami-i-Komunes-se-Ferizaj.pdf.aspx>

<sup>5</sup> Fokus Grup, Ferizaj, 12 shkurt 2016, Naim Ferati, Drejtor

ndikimit në këto procese, por nuk ka informata më të qarta mbi mënyrat më efikase për ndikim.

Kontaktet e komunikimit efikas janë publikuar, për personat kryesor në Komunë.

Nga strategjitë që përfshijnë qëllimet, aktivitetet dhe afatet kohore janë publikuar Strategjia e zhvillimit afatmesëm e Komunës së Ferizajt 2014-2017 dhe draft-korniza Afatmesme Buxhetore 2016-2018, sikurse plani trevjeçar i banimit 2014-2016. Ka edhe draft-dokumente të politikave të publikuara, si draft-korniza Afatmesme Buxhetore 2016-2018, draftrregullorja për të hyrat vetanake të Komunës së Ferizajt, draft-rregullorja për të miturit dhe dukuritë që dëmtojnë shëndetin dhe zhvillimin e tyre.<sup>6</sup>

Të dhënat informative mbi komunën, janë përmbledhur në një vegëz të veçantë të titulluar “Udhërrëfyesi i Ferizajt”, i botuar në shqip, anglisht dhe serbisht.<sup>7</sup> Në të, në mënyrë përmbledhëse në 40 faqe është prezantuar një historik i Ferizajt, në të cilën janë përfshirë aspekte historike, gjeografike, kulturore, ekonomike e sportive.



### Nota: 3 (Neutrale)

*Arsyetimi: Organogrami me organizimin e ri të komunës, është vendosur në korridorët e objektit të komunës, por duhet të përditësohet në ueb. Kontaktet e komunikimit efikas janë publikuar, për personat kryesor në Komunë. “Udhërrëfyesi i Ferizajt” është një praktikë e mirë. Mbetet ende punë për të bërë sa i përket informatave më të qarta mbi mënyrat më efikase për ndikim nga publiku.*

## 3. Puna e organeve politikë-bërëse dhe vendim-marrëse

*Publiku duhet të ketë informata të detajuara, përditësuara, dhe të mjaftueshme për të vlerësuar problematikat kryesore të debatuar dhe vendimet kryesore të marra nga organet politikë-bërëse dhe vendim-marrëse të Komunës.*

Kjo komunë nuk e bën njoftimin me kohë për mbledhjet e Kuvendit dhe KPF-së. Madje shpeshherë, mbledhjet e KPF-së, mbahen 2-3 ditë para mbledhjes së Kuvendit. Në këtë mënyrë nuk respektohen procedurat për organizimin e këtyre dy mbledhjeve si dhe njoftimi nuk bëhet me kohë. P.sh. Ftesa për mbledhjen e 11-të rregullt të Kuvendit është publikuar më 23 dhjetor, ndërsa është mbajtur më 30 dhjetor. Pra, publikimi i njoftimit është bërë 6 ditë pune më herët edhe jo 7 ditë, sikurse është e paraparë me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale<sup>8</sup>

<sup>6</sup> Për më shumë shih: <https://kk.rks-gov.net/ferizaj/Municipality/Assembly/Regulations.aspx>

<sup>7</sup> Për më shumë shih: <https://kk.rks-gov.net/ferizaj/getattachment/Home/Udherrefyesi-i-Ferizajt111.pdf.aspx>

<sup>8</sup> Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, për më shumë shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2530>

dhe me Rregulloren për Transparencë të KK-së së Ferizajt.<sup>9</sup> Ftesa për mbledhjen e KPF-së, është publikuar më 23 dhjetor, ndërsa mbledhja e KPF-së është mbajtur më 28 dhjetor. Pra publikimi i njoftimit për mbledhjen e KPF-së është bërë 3 ditë pune më herët dhe jo 7 ditë, siç përcaktohet me Udhëzimin Administrativ Nr.03/2014 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme në komunë.<sup>10</sup> Agjenda e takimeve është publikuar, por materialet përcjellëse nuk janë publikuar. Në këtë kontekst, nuk janë publikuar agjendat dhe as informacione të tjera relevante për takimet e komisioneve, apo komiteteve, përveç atij për Politikë e Financa. Kjo komunë nuk i ka kushtuar kujdes as informimit të qytetarëve, ndaj rrjedhimisht ato i ka karakterizuar pjesëmarrja e ulët. Nga ana tjetër vërehet pjesëmarrje e theksuar e organizatave të shoqërisë civile që e monitorojnë punën e KK-së, si: INPO dhe AVONET, sikur edhe e OSBE-së. Seancat e Kuvendit Komunal transmetohen live në media lokale.

Raportimi i kryetarit apo drejtorëve në Kuvend apo komisione përkatëse, zakonisht ndodh vetëm në afatet kohore që e ka paraparë ligji, kur kërkohet nga Kuvendi apo komisionet, por jo në raste të tjera.

Strategjitë, aktet normative, politikat dhe dokumentet tjera që udhëzojnë punën e komunës, kryesisht janë të publikuara. Procesverbalet e mbledhjeve të Kuvendit dhe të Komisioneve janë publikuar, por jo në mënyrë sistematike. Kjo vlen për ato të Kuvendit dhe takimet e Komitetit për Politikë e Financa, por jo edhe për komitetet e tjera. Vendimet e Kuvendit Komunal janë të publikuara në uebfaqe, por nuk ka asnjë arsytim përcjellës për to. Kurse draft-aktet normative dhe draftet e dokumenteve të tjera nuk janë publikuar. Propozimet legjislative dhe iniciativat e rëndësishme legjislative që janë në proces në Kuvend janë publikuar pjesërisht. Rregullorja për ndarjen e banesave është publikuar. Nga një intervistë me kryesuesin e KK-së, del se nuk janë të publikuara në uebfaqen e komunës, projektet e propozuara nga anëtarët e Kuvendit, përshkrimi i shkurtër, shumat dhe statusi i tyre.<sup>11</sup> Megjithëse arsyetimet ligjore për vendimet e marra i hartojnë drejtoritë përkatëse, ato nuk janë të publikuara. Marrëveshjet e Ekzekutivit dhe vendimet e tij publikohen. Seancat e Kuvendit transmetohen live, porse xhirimet e tyre nuk janë postuar në uebsajtin e komunës. Ndërkohë votat e kuvendarëve për vendime në KK, pasqyrohen në procesverbale.



### Nota: 2.3 (Negative)

*Arsyetimi: Informatat për punën e organeve politikë-bërëse dhe vendim-marrëse përmbushin vetëm kriteret minimale. Përkundër disa nismave të mira për publikim të vendimeve, megjithatë mbetet ende punë për shtytjen e publikut për të qenë pjesë e vendimmarrjes.*

<sup>9</sup> Rregullorja për transparencë, për më shumë shih: <https://kk.rks-gov.net/ferizaj/getattachment/2e17e37b-7c08-4818-be88-f194dbf356b3/Rregullorja-per-transparence.aspx>

<sup>10</sup> Për më shumë shih: <http://mapl.rks-gov.net/getattachment/c49e7fc0-808d-4ae1-9d09-b7a9fee0ebb7/Udhezim-administrativ-%28MAPL%29-Nr-032014-per-proced.aspx>

<sup>11</sup> Intervistë e monitorueses me Faruk Guri, Kryesues i Kuvendit, datë 18 shtator 2015

## 4. Luftimi i sjelljeve të pahijshme dhe keqpërdorimeve

*Komuna duhet të publikojë informata të rëndësishme nga të cilat lehtësisht mund të vlerësohet niveli i përkushtimit të saj në luftimin e sjelljeve të pahijshme dhe keqpërdorimeve.*

Konflikti i interesit përkufizohet në Statutin e Komunës, derisa nga intervista me Drejtorin e Administratës së Përgjithshme, del se Kodi i Etikës për Shërbyesit civil nuk është i publikuar.<sup>12</sup> Pavarësisht kësaj, ekziston një Komision disiplinor komunal, megjithëse nuk ka ndonjë informacion për veprimet e ndërmarra nga ky trup.

Numri i personave të angazhuar për të hetuar rastet varet nga specifikat e rasteve, siç ka pohuar Drejtori i Administratës së Përgjithshme.<sup>13</sup> Në këtë kontekst, nuk dihet se sa raste janë hetuar, e as veprimet që janë ndërmarrë. Komuna gjatë 2015-s nuk ka pas strategji për luftimin e dukurive të pahijshme. Plani strategjik i Komunës së Ferizajt për trajtimin dhe parandalimin e korrupsionit, ka qenë në proces të hartimit.<sup>14</sup>

Niveli i informimit të publikut për mekanizmat e raportimit të keqpërdorimeve të mundshme ka qenë i ultë gjatë vitit 2015. Komuna nuk ka ofruar informata të mjaftueshme për të shpjeguar me saktësi se çfarë përbën keqpërdorim. Ndër kanalet e pakta të komunikimit me publikun ka qenë kutia e ankesave në ambientet e objektit të administratës komunale, porse nuk ka të dhëna të publikuara se sa qytetarë e kanë shfrytëzuar këtë mundësi për raportim të sjelljeve të pahijshme.



### Nota: 2 (Negative)

*Arsyetimi: Komuna ka treguar transparencë të ultë sa i përket rasteve të ndërmarra në aspektin e luftimit të sjelljeve të pahijshme dhe keqpërdorimeve eventuale.*

## 5. Integrimi Evropian

*Publikut duhet t'i ofrohet mundësia që të mësoj në mënyrë të saktë dhe të detajuar obligimet, arritjet dhe sfidat që i ka komuna në procesin e integritimit të Kosovës në BE.*

Komuna e Ferizajt nuk e ka bërë publike listën e obligimeve që burojnë nga integrimi në BE. Megjithatë në uebfaqen e komunës ekziston një vegëz, në të

<sup>12</sup> Intervistë e monitorueses me Faruk Hyseni, Drejtori i Administratës së Përgjithshme, datë 4 shtator 2015

<sup>13</sup> Intervistë e monitorueses me Faruk Hyseni, Drejtori i Administratës së Përgjithshme, datë 4 shtator 2015

<sup>14</sup> Vërejtje: Ky plan është publikuar në 2016-n, <https://kk.rks-gov.net/ferizaj/getattachment/e225b370-9cbe-45e3-8c17-221ca9c60e40/Plani-strategjik-i-Komunes-se-Ferizajt-per-trajtim.aspx>


cilën është postuar një videoincizim kundër migrimit ilegal në vendet e BE-së.<sup>15</sup>

Nga ana tjetër, mungojnë informacione për statusin e përmbushjes së obligimeve dhe afatet kohore për arritje të qëllimeve të caktuara, informata mbi çështjet e caktuara që ndërlidhen me integrimin në BE (të drejtat e njeriut, barazia gjinore, etj). Për riadhesimin ka një vegëz që lidhet me seksionin e riadhesimit në MPB. Po ashtu mungojnë edhe informatat mbi ndikimet e procesit (ekonominë, çështjet sociale, administratën publike, etj).



### Nota: 1.5 (Negative)

*Arsyetimi: Të ky indikator, në përgjithësi nga të dhënat që kanë dalë nga monitorimi del se komuna e Ferizajt ka bërë fare pak për informimin e publikut sa i përket integritetit evropian.*



## II. Menaxhimi ekonomik dhe financiar

### 6. Kontabiliteti dhe buxheti

*Të dhënat dhe raportet e ndryshme dhe të përditësuara rreth të hyrave financiare, alokimeve buxhetore, shpenzimeve financiare, borxheve dhe kontesteve me pasoja financiare për komunën, duhet të jenë në dispozicion të publikut për të pasë pasqyrë të qartë mbi menaxhimin e parasë publike në nivel lokal.*

Kreu i Komunës ka mbajtur 9 takime me qytetarë për planifikimin e buxhetit të vitit 2016, derisa KPF-ja ka mbajtur 6 takime. Draft-Korniza Afatmesme Buxhetore 2016-2018 është publikuar me kohë. Projekt propozimet e anëtarëve të KK-së nuk janë publikuar. Gjithashtu nuk ka informata mbi fatin e propozimeve të adresuara nga komuniteti, nëse ato janë miratuar apo hedhur poshtë.

Komuna publikon rregullisht buxhetin vjetor, ku pasqyrohen ndarjet e zërave buxhetorë. Ndërsa për shpenzimet e buxhetit të dhënat e vizualizuara paraqiten në platformën e Insitutit GAP dhe INPO-s,<sup>16</sup> vegëza e të cilës është publikuar në ueb të Komunës. Raportet mbi ecurinë e realizimit të buxhetit publikohen periodikisht. Të dhëna tabelare ka për projektet kapitale, si dhe për burimin e financimit të tyre. Por nuk ka tabela interaktive të buxhetit shumëvjeçar.

Publiku mund të informohet për praktikatat e mira dhe të metat e komunës në

<sup>15</sup> Për më shumë shih: <https://www.youtube.com/watch?v=649p63k9G6s&feature=youtu.be>

<sup>16</sup> Për më shumë, shih: <http://www.institutigap.org/spendings/?ferizaj/2015-TM3#/~ferizaj>

menaxhimin e financave publike në saje të gjeturave të Auditorit, raporti i të cilit është i publikuar në ueb faqen e Komunës. Por nuk ka raportime për të gjeturat e auditorit të brendshëm.

Komuna informatat për burimet e të ardhurave i publikon në draftin e buxhetit dhe buxhetin e miratuar.

Qytetarët për suficitin, deficitin dhe borxhin e komunës, si dhe detyrimet kontigjente mund të informohen vetëm nga të dhënat në raportin vjetor financiar, dhe nuk ka të dhëna të përditësuara në baza periodike mbi zhvillimet në këtë drejtim.

Nuk ka të dhëna mbi funksionimin e organizatave, të cilat ofrojnë shërbime për qytetarët ku komuna ka kompetenca, përfshi të vogla.



### Nota: 2.5 (Neutrale)

*Arsyetimi: Komuna ofron informata në nivel mesatar sa i përket menaxhimit të buxhetit. Me një përkushtim më të madh, mund të përmirësoj disa nga nën-indikatorët. Më së shumti angazhim i mbetet të bëj në ofrimin e informatave për suficitin e borxhet, si dhe më shumë të dhëna mbi funksionimin e organizatave, të cilat ofrojnë shërbime për qytetarët.*

## 7. Kontratat e prokurimit publik, furnizimit dhe granteve

*Marrëdhëniet kontraktuale me implikime financiare në mes të komunës dhe personave fizik dhe juridik duhet të zhvillohen në transparencë të plotë, për të siguruar menaxhimin e mirë të parasë publike dhe vlerën e duhur për shërbimet, punët apo furnizimet.*

Komuna e Ferizajt nuk ka publikuar informata në lidhje me mënyrën e përzgjedhjes dhe përbërjes së komisioneve vlerësuese. Në ueb faqen e Komunës janë publikuar vetëm një numër i vogël i njoftimeve për kontratë, derisa këto njoftime janë të rregullta në uebfaqen e KRPP-së.<sup>17</sup> Arsyetimet për vendosjen e kritereve të caktuara nuk janë publike e as procesverbalet e komisioneve vlerësuese. Procesverbalet e komisioneve vlerësuese i posedon Zyra për Informim, porse të njëjtat nuk janë publikuar. Gjithashtu raporti vlerësues për dhënie të kontratës, bëhet publik në uebfaqen e KRPP-së, porse jo në atë të komunës. Nuk janë të publikuara manualat për procese të konkurrimit e as parimet dhe kodi i mirësjelljes në procese kontraktuese. Njoftimi mbi kontraktimet/tenderët e shumave të vogla dhe mënyrën e përzgjedhjes bëhet në një tabelë njoftimesh në hyrje të objektit të administratës komunale, ndërsa fituesi në sistemin e KRPP-së. Ka përputhshmëri të projekteve aktuale me listën e projekteve të aprovuara nga Kuvendi Komunal. Nuk ka informata të publikuara për aneks kontratat, apo për mësimet e nxjerra nga kontratat në të kaluarën.

Transparenca në menaxhimin e projekteve dhe kontratave ka qenë e ulët. Ka

<sup>17</sup> Për më shumë shih: <https://krpp.rks-gov.net/>




raste kur anëtarët e Kuvendit Komunal, në disa seanca, kanë bërë kërkesë që të marrin raporte në lidhje me çështjet e prokurimit publik, por nuk i kanë marrë ato.<sup>18</sup> Nuk janë publikuar raporte mbi performancën e kontraktorëve bazuar në indikatorët e paracaktuar në kontratë. Baza e të dhënave për kontratat e nënshkruara ekziston në komunë, por kontratat në përgjithësi nuk bëhen publike. Shumat e tyre, si dhe procedura e përdorur, e numri i konkurrentëve kryesisht figurojnë në njoftimet për dhënie të kontratës që publikohet në KRPP. Në këto njoftime figurojnë vetëm të dhënat bazike për fituesin e tenderit. Por nuk ka raporte të publikuara mbi përmbushjen e parametrevë të parapara në kontratë, apo të mbikëqyrjes së punimeve gjatë realizimit.



### Nota: 1.5 (Negative)

*Arsyetimi: Në këtë sektor, i cili konsiderohet më i ndjeshmi në menaxhimin e punëve të komunës, informacionet që i ofrohen publikut janë tejet minimale.*



## III. Menaxhimi i resurseve njerëzore dhe resurseve tjera

### 8. Të punësuarit në administratën publike dhe organizatat/institucionet publike

*Menaxhimi i resurseve njerëzore duhet të bëhet në mënyrë transparente duke përfutur nga mbikëqyrja e vazhdueshme e publikut mbi performancën e administratës.*

Struktura organizative e komunës së Ferizajt është e kompletuar. Por, megjithatë, nuk janë të publikuara: përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të pozitave kryesore, raportet/analizat e sektorit të administratës publike si dhe lista e të gjithë personave të administratës. Kurse informata kontaktuese të personave kryesor, janë publikuar. Për pagat për pozita të ndryshme është publikuar vetëm koeficienti kur shpallet konkursi.

Pak informata mbi funksionimin e organizatave/institucioneve të ndryshme komunale janë të prezantuara shkurt në Udhërrëfyesin për Ferizajin. Por nuk ka të dhëna të publikuara mbi strukturat organizative, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të pozitave kryesore, listën e të punësuarve, apo sqarime mbi kompetencat.

Struktura organizative sipas zyrtarëve komunale nuk është aprovuar nga organet

qendrore. Thirrjet për aplikim, me kriteret e caktuara, janë publikuar përpos në uebfaqen e Komunës, edhe në mediat lokale. Ndërkaq vendimet e mekanizmave të ankesës nuk publikohen. Ka konkurse të publikuara për punësimet në pozita publike (posaçërisht shkolla). Por transparenca është e ultë në emërimin e anëtarëve të Bordeve të ndërmarrjeve publike.

Kodi i etikës dhe mirësjelljes nuk është i publikuar fare. Njësoj ndodh edhe me raportin mbi aktivitetet dhe vendimet e mekanizmave për vlerësim të performancës dhe sjelljes. Por ka rast kur shkarkimet nga postet publike janë publikuar në formë të lajmit.<sup>19</sup> Nuk ka të publikuar asnjë raportim për konflikt të interesit. Megjithëse, PDK-ja opozitare dhe një organizatë joqeveritare<sup>20</sup> kanë hedhur akuza publike në drejtim të kryetarit Muharrem Sfarqa, të cilin e kanë akuzuar për nepotizëm. Ata kanë publikuar edhe emra të familjarëve të punësuar.<sup>21</sup>



### Nota: 2.5 (Neutrale)

*Arsyetimi: Nga të dhënat e indikatorëve të mësipërm shihet se komuna ka bërë përpjekje për t'i ofruar informacione publikut. Megjithëse ato nuk janë të mjaftueshme, janë përpjekje e mirë për hapje ndaj publikut, ani pse ka mungesa në disa çështje esenciale.*

## 9. Pasuria kapitale dhe jokapitale

*Publiku duhet të ketë informata të përditësuara dhe të plota mbi menaxhimin e pasurisë publike nga ana e pushtetit komunal.*

Ferizaj nuk ofron informacione për publikun lidhur me pasurinë kapitale dhe jokapitale. Lista e të gjitha pronave dhe ndërtesave që i ka në pronësi, si dhe vlera e këtyre pronave nuk është bërë publike, e nuk ka as hartë interaktive për to. Pronat janë të regjistruara, ndërkaq objektet jo.

Vendimet dhe arsyetimet se për çfarë përdoren apo si dhe në çfarë shume janë dhënë me qira nuk janë publike. Nuk ka publikim as të listës së pronave që janë transferuar nga komuna tek pronarët tjerë, si dhe arsyetimet për vendimet e tilla.

Lista e inventarit dhe vlera e tij është bërë, porse nuk është publike. Kurse nuk është publikuar lista e automjeteve përfshirë përshkrimin dhe vlerën e tyre, lista e pasurive tjera me përshkrim dhe vlerë të përcaktuar.

Informatat mbi aksionet që mban komuna në kompani të ndryshme nuk janë paraqitur.

<sup>19</sup> Për më shumë shih: <https://kk.rks-gov.net/ferizaj/News/Shkarkimet-e-fundit--ne-funksion-te-ngritjes-se-e.aspx>


<sup>20</sup> Për më shumë shih: <http://koha.net/?id=&l=48011>

<sup>21</sup> Për më shumë shih: <http://indeksonline.net/?FaqelID=2&LajmiID=144185>



## Nota: 1 (Negative)

Arsyetimi: Në përgjithësi ka mungesë të informacioneve të gjithëmbarshme sa i përket pasurisë kapitale dhe jokapitale.



## IV. Marrëdhëniet me qytetarët dhe shoqërinë

### 10. Informimi dhe shërbimi i qytetarëve

*Transparenca komunale duhet të jetë e avancuar duke i mundësuar publikut qasje të lehtë në informata, informim të saktë, të shpejtë dhe të detajuar rreth çështjeve që ndërlidhen me politikat, vendimet dhe shërbimet për qytetarët.*

Zyrtari për informim është i caktuar dhe kontakti vendoset lehtë. Kontaktet e zyrtarit për informim dhe zyrës për informim janë publikuar. Komuna vazhdon të operojë me kapacitete minimale në zyrën për informim, ngase ka vetëm një zyrtare për informim, që brenda mundësive kthen përgjigje. Komuna nuk ka bërë publikuar raporte me statistika rreth përdorimit të rrjeteve sociale, pajisjeve mobile, shërbimeve përmes telefonit, apo këshillimit të qytetarëve dhe shërbimeve të informatave.

Ferizaj ka rregulloren për transparencë, që daton nga nëntori i vitit 2014, por nuk ka strategji apo plan veprimi për avancim të transparencës në nivelin komunal.

Ueb faqja e komunës është mesatarisht e dobishme. Ka seksione ku ngarkimi i materialeve bëhet në baza të rregullta. Janë bërë përpjekje për strukturimin e saj, megjithatë ka vështirësi në navigim. Nuk ka infografika apo materiale të ngjashme. Nuk ka ndonjë raport për shkallën e përdorimit të uebfaqes së komunës. Ka një forum diskutimi në këtë faqe, porse ai është jofunksional.

Komuna e Ferizajt nuk posedon ndonjë mekanizëm për të mbledhur sugjerime për përmirësimin të transparencës dhe as ndonjë hulumtim të publikut rreth transparencës në komunë.

Komuna ka edhe një profil në rrjetin social “Facebook”, i cili freskohet çdo ditë me të dhëna për aktivitetet e komunës.<sup>22</sup> Ky profil i ka mbi 30 mijë ndjekës. Nuk ka materiale të publikuara në formë infografikave, videove apo animacioneve, as aplikacione të zhvilluara për telefona të mençur me informata të ndryshme për komunën.

Materialet, të cilat janë postuar në uebfaqen e komunës janë përkthyer në gjuhën

<sup>22</sup> Për më shumë shih: <https://www.facebook.com/KomunaFerizajFaqjaZyrtare/?fref=ts>

serbe pjesërisht.<sup>23</sup> Gjuha e përdorur në përgjithësi është kopjuar nga legjislacioni.

Raporti vjetor i qasjes në dokumentet publike thekson se Komuna ka aprovuar 46 kërkesa për qasje në dokumente publike. Parashtrues të tyre janë: bizneset (3), shoqëria civile (28), individë (12), studentë (1) dhe media (2). Përveç këtyre, komuna ka bërë të ditur se janë refuzuar 5 kërkesa për qasje në dokumente publike mbi bazën e ruajtjes së privatësisë dhe interesave të tjera private. Përfaqësues nga opozita kanë theksuar se ka ngecje në ofrimin e përgjigjeve për qasje në dokumente publike, pasi ka raste kur nuk kanë marrë as përgjigje pozitive e as negative.<sup>24</sup>

Informatat mbi shërbimet për qytetarët (shëndetësi, arsim, siguri, kompani publike, hapësira gjelbëruese, etj.), janë të dhëna në forma të përgjithësuara në Udhërrëfyesin e Ferizajt, por pa ndonjë hartë interaktive.



### Nota: 2.5 (Neutrale)

*Ansytimi: Komuna e Ferizajt ka një Zyrë informimi relativisht aktive. Ajo mbanë publikun të informuar nëpërmjet përditësimit të informacioneve ditore në uebfaqe, por edhe duke u dërguar direkt medieve njoftime në lidhje me aktivitetet ditore të komunës. Të njëjtën gjë e bënë edhe në llogarinë e komunës në rrjetin social "Facebook". Por, ngecë në plasimin e të dhënave nga të gjitha dikasteret si dhe duhet të përmirësojë efikasitetin në ofrimin e qasjes për dokumente publike.*

## 11. Bashkëpunimi me shoqërinë civile

*Organet komunale duhet të jenë të hapura dhe të angazhohen për qeverisje transparente duke thelluar bashkëpunimin me shoqërinë civile.*

Komuna ka bashkëpunim me OJQ-të, dhe punën e saj e monitoron rregullisht organizata INPO, rrjeti i OJQ-ve "Avonet", dhe Forumi Politik i të Rinjve. Zyrtarët komunal, kanë bërë të ditur se me organizatat joqeveritare të sipërpërmendura kanë nënshkruar memorandume, sikurse edhe me organizatën FOL, porse të njëjtat nuk janë publikuar për shkaqe teknike.<sup>25</sup> Gjatë vitit 2015, në uebfaqen e Komunës është publikuar aneks marrëveshja me Caritas Kosovën. Komuna e Ferizajt nuk e ka të publikuar udhëzuesin për pjesëmarrje qytetare dhe për shfrytëzimin e kanaleve të ndryshme për të kuptuar më mirë dokumentet dhe informatat e publikuara nga komuna.

Nga monitorimi del se komuna ka mbajtur 20 takime/konsultime publike, porse ka pak publikime në uebfaqe për to. Komiteti për Politikë e Financa ka mbajtur gjashtë takime, ndërkaq kryetari nëntë, në zona urbane dhe rurale. Por ende nuk është krijuar një konsistencë në bashkëpunim me qytetarë. Nga monitorimi

<sup>23</sup> Për më shumë shih: <https://kk.rks-gov.net/ferizaj/Services/Sherbimet-Publike.aspx>

<sup>24</sup> Fokus Grup, Ferizaj, 12 shkurt 2016, Bujar Ukësmajli [LVV]

<sup>25</sup> Fokus Grup, Ferizaj, 12 shkurt 2016, Feim Ibrahim, Zyrtar i Prokurimit


i bërë del se numri i pjesëmarrësve në takimet publike është simbolik, ndërkohë që nuk ekziston ndonjë raportim me shkrim për takimet me ta. Nuk ka as informata për aktivitetin e këshillave lokalë.

Diskutimi i rregulloreve me interes publik me qytetarët zhvillohet sipas procedurave ligjore, porse autoritetet komunale nuk bëjnë asgjë për ta nxitur një diskutim përmbajtësor. Ka pas konsultime publike para miratimit të buxhetit. Por nuk ka raporte përmbledhëse mbi këto konsultime. Sipas zyrtarëve komunal takimi i fundit ku është diskutuar buxheti komunal ka zgjatur mbi 3 orë, ndaj sipas tyre afro 100 faqe procesverbal është zor të publikohen në uebfaqe.<sup>26</sup> Ata janë ankuar në mundësinë e kufizuar që e ofron uebsajti komunal, i cili menaxhohet nga MAPL-ja. Por, nga ana tjetër, zyrtar të kësaj ministrie kanë thënë se bëhet fjalë për njohuri të pamjaftueshme të personelit të IT-së, sepse realisht uebsajti ofron mundësi të madhe për plasim të shumë dokumenteve komunale. Për këtë shkak, kjo ministri ka mbajtur një takim me IT-të e komunave, të cilët janë njoftuar se domenat aktuale janë të mjaftueshme për plasim të çfarëdo informate, duke përfshirë edhe videoincizimet.<sup>27</sup> Komuna nuk ka një mekanizëm përcjellës për regjistrim të kërkesave të qytetarëve si dhe statusit të kërkesave të tyre (përkrahjes apo hedhjes poshtë të kërkesave). Ato zakonisht regjistrohen në zyrat përkatëse, por nuk publikohen në uebfaqe. Në funksion të komunikimit me qytetarët, kryetari i Ferizajt, Muharrem Sfarqa ka caktuar ditën e enjte, për komunikim me ta.



### Nota: 2.5 (Neutrale)

*Ansytimi: Pjesëmarrja qytetare në takime publike vazhdon të mbetet në nivel simbolik, derisa komuna nuk ka bërë asnjë përpjekje për të nxitur ata që të jenë pjesë e debateve ku diskutohen çështjet që kanë të bëjnë me lehtësimin e jetës së tyre. Shoqëria civile është aktive në përcjelljen e punës së Kuvendit Komunal, por komuna duhet të hartojë dhe publikoj udhëzuesin për pjesëmarrje qytetare.*



## V. Planifikimi dhe zhvillimi urban

### 12. Planifikimi urban

*Publiku duhet të ketë qasje në informata të rëndësishme që ndërlidhen me planifikimin urban, pasi kjo përbën një nga parimet themelore të qeverisjes së mirë.*

Ferizaj nuk ofron pothuajse fare informacione për qytetarët lidhur me çështjen

<sup>26</sup> Fokus Grup, Ferizaj, 12 shkurt 2016, Naim Ferati, Drejtor

<sup>27</sup> Fokus Grup, Ferizaj, 12 shkurt 2016, Ardita Latifi, MAPL

e urbanizmit. Uebfaqja e komunës është shumë e varfër në ofrimin e informacioneve që lidhen me çështjen e urbanizmit, siç është publikimi i planeve rregulluese urbane, lejet e ndërtimit, procedurat e marrjes së tyre, objektet pa leje etj. Rregullorja ekzistuese për planifikim urban, PZHU, është e skaduar, ndërkohë që në uebfaqen komunale është publikuar vetëm Plani rregullues urban për zonën I dhe VIII. Informacione të tjera të kësaj natyre nuk ka. Rrjedhimisht nuk është bërë publik asnjë informacion i domosdoshëm për publikun, për procesin e marrjes së lejeve.

Komuna nuk ka publikuar ndonjë hartë interaktive në uebfaqe në të cilën përfshihen informatat mbi shërbimet, aktivitetet dhe resurset në territor, planet për mbrojtje të mjedisit dhe menaxhimin e resurseve natyrore, kualitetin e ujit në hapësira të caktuara, emetimin e gazrave apo informata të sakta të destinimit të tokës.

Përgjatë vitit 2015, Ferizaj ka dhënë 72 leje ndërtimi, nga të cilat 19 kolektive dhe 53 individuale.<sup>28</sup> Por, asnjë nga to nuk është publikuar. Në këtë kontekst nuk janë bërë publike as vendimet dhe arsyetimet për lejet e ndërtimit të lëshuara. Procesverbalet e mbledhjeve të komisioneve, të cilat i kanë aprovuar lejet e ndërtimeve nuk janë të publikuara. Vlerësimin për aprovim e lejes ndërtimore e bën inxhinieri, ndërkaq drejtori e nënshkruan në bazë të këtij rekomandimi. Nuk ka asnjë të dhënë në uebfaqe sa i përket përputhshmërisë së lejeve të lëshuara me planet aktuale të komunës.



### Nota: 1 (Negative)

*Arsyetimi: Ferizaj nuk ofron pothuajse fare informacione për qytetarët lidhur me çështjen e urbanizmit, ani pse bëhet fjalë për një sektor mjaft të rëndësishëm, që ka ndikim në jetesën e qytetarëve të Ferizajt.*

## 13. Monitorimi i projekteve urbanistike

*Komuna duhet në vazhdimësi ta informojë publikun për rrjedhën e projekteve të cilat kanë ndikim në planifikimin dhe zhvillimin urban.*

Komuna e Ferizajt nuk ka publikuar informacione qofshin edhe ato simbolike, sa i përket rasteve të ndërhyrjeve të inspektorëve, rezultatet dhe efikasitetin, pastaj raportet për këto angazhime, bazën e të dhënave mbi punën dhe aktivitetet e inspektoratit e as mekanizmin për t'i përcjellë rastet e raportuara nga publiku dhe shenjëzimin e hartës ku janë duke u bërë shkelje.

Publiku gjatë vitit 2015 nuk është informuar mbi emrat e kompanive që kanë kryer projektet kryesore të zhvillimit urban, mekanizmin për monitorim dhe përcjelljen e punëve që janë duke u zhvilluar, as nuk është informuar hollësisht mbi projektet kryesore infrastrukturore që janë duke u zhvilluar, qëllimet e projekteve dhe përfaqësuesit komunal që e kanë për detyrë; kontraktorët, buxheti

<sup>28</sup> Intervistë e monitorueses me Faik Grainca, Drejtor i Urbanizmit dhe Mjedisit, datë 13 tetor 2015

dhe periudha e zbatimit, me përjashtim të tabelave në vendpunim.



### Nota: 1 (Negative)

*Arsyetimi: Te ky indikator, komuna e Ferizajt ka shpërfillur totalisht publikun, duke e privuar atë nga çfarëdo informacioni që lidhet me sferën e monitorimit të projekteve urbane.*



## VI. Notimi

	Pesha	%	Notimi	%
<b>Organizimi, përbërja, kompetencat, dokumentacioni dhe funksionimi</b>				
1. Kryetari, Drejtorët dhe Anëtarët e Kuvendit	3	5.56%	3	3%
2. Organizimi dhe funksionimi	2	3.70%	3	2%
3. Puna e organeve politikë-bërëse dhe vendim-marrëse	4	7.41%	2.3	3%
4. Luftimi i sjelljeve të pahijshme dhe keqpërdorimeve	3	5.56%	2	2%
5. Integrimi Evropian	2	3.70%	1.5	1%

### Menaxhimi ekonomik dhe financiar

6. Kontabiliteti dhe buxheti	5	9.26%	2.5	5%
7. Kontratat e prokurimit publik, furnizimit dhe granteve	5	9.26%	1.5	3%

### Menaxhimi i resurseve njerëzore dhe resurseve tjera

8. Të punësuarit në administratën publike dhe organizatat/institucionet publike	5	9.26%	2.5	5%
9. Pasuria kapitale dhe jokatipale	5	9.26%	1	2%

### Marrëdhëniet me qytetarët dhe shoqërinë

10. Informimi dhe shërbimi i qytetarëve	5	9.26%	2.5	5%
11. Bashkëpunimi me shoqërinë civile	5	9.26%	2.5	5%

### Planifikimi dhe zhvillimi urban

12. Planifikimi urban	5	9.26%	1	2%
13. Monitorimi i projekteve urbanistike	5	9.26%	1	2%

54

100%

40%

	Pesha	%	Notimi	%
<b>1. Kryetari, Drejtorët dhe Anëtarët e Kuvendit</b>				
1. Cili është kualiteti i informatave që përmbajnë resimet?	5	20%	3	12%
2. Sa janë të plota deklaratat e pasurisë?	5	20%	2	8%
3. Sa janë të kuptueshme, të plota dhe të qasshme informatat mbi interesat personale?	5	20%	1	4%
4. Sa efikase janë kanalet e komunikimit që përdoren nga personat e zgjedhur dhe emëruar politikisht?	5	20%	4	16%
5. Sa janë të përditësuara dhe të plota informatat mbi aktivitetet e Kryetarit, Kuvendit, dhe personave tjerë të zgjedhur dhe të emëruar?	5	20%	3.5	14%

25

100%

13.5

54%

	Pesha	%	Notimi	%
<b>2. Organizimi dhe funksionimi</b>				
6. Sa janë të plota dhe të lehtësisht të kuptueshme informatat mbi organizmin dhe kompetencat komunale?	5	20%	2.5	10%
7. A kanë qytetarët informata të mjaftueshme mbi mënyrat më efikase për ndikim në politikëbërje dhe vendimmarrje?	5	20%	2	8%
8. Sa janë të dobishme kanalet e komunikimit?	5	20%	3	12%
9. Cili është kualiteti i informatave për planet në të ardhmen?	5	20%	3	12%
10. A ka të dhëna mbi komunën?	5	20%	4	16%
	<b>25</b>	<b>100%</b>	<b>14.5</b>	<b>58%</b>

	Pesha	%	Notimi	%
<b>3. Puna e organeve politikë-bërëse dhe vendim-marrëse</b>				
11. Sa inkurajohet publiku të jetë vëzhgues aktiv i debateve dhe proceseve vendimmarrëse?	5	33.33%	2	13%
12. A është raportimi i Ekzekutivit i rregullt dhe i plotë në Kuvend?	5	33.33%	2	13%
13. Sa kanë mundësi qytetarët të informohen për punën e komunës, politikat dhe aktet normative?	5	33.33%	3	20%
	<b>15</b>	<b>100%</b>	<b>7</b>	<b>46.67%</b>

	Pesha	%	Notimi	%
<b>4. Luftimi i sjelljeve të pahijshme dhe keqpërdorimeve</b>				
14. A ka komuna mekanizma për të hetuar dhe gjykuar sjelljet e pahijshme dhe keqpërdorimet tjera?	5	33.33%	2	13%
15. A është komuna transparente në aktivitetet e saj në luftën kundër mashtrimeve/keqpërdorimeve?	5	33.33%	2	13%
16. Cili është niveli i informimit të publikut për mekanizmat e raportimit të keqpërdorimeve të mundshme?	5	33.33%	2	13%
	<b>15</b>	<b>100%</b>	<b>6</b>	<b>40%</b>

	Pesha	%	Notimi	%
<b>5. Integrimi Evropian</b>				
17. A ka publiku informata të mjaftueshme për obligimet e komunës në procesin e integritit në BE?	5	50%	2	20%
18. A ka publiku informata të mjaftueshme mbi ndikimet e mundshme të procesit të integritit në BE?	5	50%	1	10%
	<b>10</b>	<b>100%</b>	<b>3</b>	<b>30%</b>

	Pesha	%	Notimi	%
<b>6. Kontabiliteti dhe buxheti</b>				
19. A është publiku i informuar mirë rreth planifikimit buxhetor?	5	16.67%	3	10%
20. A publikohen të dhëna të mjaftueshme mbi ndarjet dhe realizimet buxhetore të komunës?	5	16.67%	3	10%
21. Sa është i informuar publiku për praktikën e mira dhe të metat e komunës në menaxhimin e financave publike?	5	16.67%	3	10%
22. A ka informata të mjaftueshme për të kuptuar burimet e të ardhurave të komunave?	5	16.67%	3	10%
23. Sa janë të informuar qytetarët për suficitin, deficitin dhe borxhin e komunës?	5	16.67%	2	7%
24. Sa transparente është funksionimi i organizatave të cilat ofrojnë shërbime për qytetarët ku komuna ka kompetenca (përfshi kompetenca të vogla)?	5	16.67%	1	3%

<b>30</b>	<b>100%</b>	<b>15</b>	<b>50%</b>
-----------	-------------	-----------	------------

	Pesha	%	Notimi	%
<b>7. Kontratat e prokurimit publik, furnizimit dhe granteve</b>				
25. Sa është transparent procesi përzgjedhjes dhe lidhjes së marrëdhënies kontraktuale, më saktësisht procesi i vlerësimit të përshtatshmërisë për hyrje në marrëdhënie kontraktuale me palën e caktuar?	5	50%	2	20%
26. A ka transparencë në menaxhimin e projekteve dhe kontratave?	5	50%	1	10%

<b>10</b>	<b>100%</b>	<b>3</b>	<b>30%</b>
-----------	-------------	----------	------------

	Pesha	%	Notimi	%
<b>8. Të punësuarit në administratën publike dhe organizatat/institucionet publike</b>				
27. A është i qartë organizimi i administratës komunale dhe funksionet e personave kyc?	5	25%	3	15%
28. Sa janë të qarta strukturat organizative dhe informatat mbi funksionimin e organizatave/institucioneve të ndryshme komunale?	5	25%	2	10%
29. A zbatohen praktikën më të mira të rekrutimit/punësimit?	5	25%	3	15%
30. A ka informata publike rreth performancës së administratës në bazë të standardeve më të larta?	5	25%	2	10%

<b>20</b>	<b>100%</b>	<b>10</b>	<b>50%</b>
-----------	-------------	-----------	------------

	Pesha	%	Notimi	%
<b>9. Pasuria kapitale dhe jokapitale</b>				
31. A ka publikuar komuna listë të të gjitha patundshmërive?	5	25%	1	5%
32. A kemi informata dhe vendime të publikuara të cilat synojnë të arsyetojnë se përdorimi i tillë i tyre është në të mirë të sovranit?	5	25%	1	5%
33. A ka publikuar komuna listë të pasurive të ndryshme (inventar, automobila, piktura, pasuri tjetër me vlerë)?	5	25%	1	5%
34. A janë paraqitur aksionet dhe pronësia e komunës në kompani të ndryshme?	5	25%	1	5%
	<b>20</b>	<b>100%</b>	<b>4</b>	<b>20%</b>

	Pesha	%	Notimi	%
<b>10. Informimi dhe shërbimi i qytetarëve</b>				
35. Sa është efikase zyra për informim?	5	12.50%	3	8%
36. A ka Komuna plane apo strategji të veprimit për transparencën në komunë?	5	12.50%	2	5%
37. Sa është e dobishme ueb faqja e komunës?	5	12.50%	3	8%
38. A ofron komuna mundësi për të marrë mendimin e qytetarëve për përmirësim të transparencës?	5	12.50%	1	3%
39. Sa përdoren mjetet inovative për transparencë dhe komunikim me publikun?	5	12.50%	3	8%
40. A janë të dhënat të kuptueshme për qytetarët e komunës?	5	12.50%	2.5	6%
41. A mundësohet qasja në dokumente publike?	5	12.50%	2.5	6%
42. Cili është kualiteti i informatave rreth shërbimeve për qytetarët?	5	12.50%	2.5	6%
	<b>40</b>	<b>100%</b>	<b>19.5</b>	<b>48.75%</b>

	Pesha	%	Notimi	%
<b>11. Bashkëpunimi me shoqërinë civile</b>				
43. A janë krijuar forma të strukturuar të bashkëpunimit me shoqërinë civile?	5	33.33%	3	20%
44. A mbahen takime me publikun?	5	33.33%	2	13%
45. A konsultohen qytetarët rreth dokumenteve me interes para se ato të aprovohen?	5	33.33%	2.5	17%
	<b>15</b>	<b>100%</b>	<b>7.5</b>	<b>50%</b>


	Pesha	%	Notimi	%
<b>12. Planifikimi urban</b>				
46. Sa është publiku i informuar rreth akteve normative dhe dokumenteve strategjike në fushën e planifikimit urban?	5	33.33%	1	7%
47. A përdor komuna mjetet më të avancuara për t'iu mundësuar publikut të vëzhgojnë të gjithë elementet që ndërlidhen me planet urbane?	5	33.33%	1	7%
48. Sa është komuna transparente me lejet e ndërtimit dhe shfrytëzimit të hapësirave?	5	33.33%	1	7%
	<b>15</b>	<b>100%</b>	<b>3</b>	<b>20%</b>

	Pesha	%	Notimi	%
<b>13. Monitorimi i projekteve urbanistike</b>				
49. Sa është komuna efikase për të raportuar për aktivitetet e saja për monitorimin e zbatimit të planit urbanistik?	5	50%	1	10%
50. A ka publiku informata të mjaftueshme për performancën e kompanive të kontraktuara nga komuna për të zhvilluar projekte urbanistike?	5	50%	1	10%
	<b>10</b>	<b>100%</b>	<b>2</b>	<b>20%</b>



# Komuna e G


Autor: Dren Pozhegu



# Gjakovës

I. Organizimi, përbërja, kompetencat, dokumentacioni dhe funksionimi _____	38
1. Kryetari, Drejtorët dhe Anëtarët e Kuvendit _____	38
2. Organizimi dhe funksionimi _____	40
3. Puna e organeve politike-bërëse dhe vendim-marrëse _____	41
4. Luftimi i sjelljeve të pahijshme dhe keqpërdorimeve _____	42
5. Integrimi Evropian _____	43
II. Menaxhimi ekonomik dhe financiar _____	44
6. Kontabiliteti dhe buxheti _____	44
7. Kontratat e prokurimit publik, furnizimit dhe granteve _____	46
III. Menaxhimi i resurseve njerëzore dhe resurseve tjera _____	47
8. Të punësuarit në administratën publike dhe organizatat/ institucionet publike _____	47
9. Pasuria kapitale dhe jokatitale _____	48
IV. Marrëdhëniet me qytetarët dhe shoqërinë _____	49
10. Informimi dhe shërbimi i qytetarëve _____	49
11. Bashkëpunimi me shoqërinë civile _____	51
V. Planifikimi dhe zhvillimi urban _____	52
12. Planifikimi urban _____	52
13. Monitorimi i projekteve urbanistike _____	53
VI. Notimi _____	54





## I. Organizimi, përbërja, kompetencat, dokumentacioni dhe funksionimi

### 1. Kryetari, Drejtorët dhe Anëtarët e Kuvendit

*Volumi dhe kualiteti i informatave të publikuara rreth të zgjedhurve dhe emëruarve politik (në Komunën e Gjakovës në këtë kategori hyjnë Kryetari, Drejtorët, dhe Anëtarët e Kuvendeve Komunale), duhet të jenë të mjaftueshme për të vlerësuar kredibilitetin e tyre, mbikëqyrur angazhimin e tyre në vazhdimësi, dhe për të kontaktuar në mënyrën më të përshtatshme me personat që mbajnë këto pozita.*

I gjithë personeli i ekzekutivit të komunës - kryetarja, nënkryetarët dhe drejtorët e drejtorive – kanë të publikuara CV-të e shkurtra, në të cilat qytetarët mund të njoftohen me kredencialet profesionale të tyre. Përjashtim bënë drejtoria për urbanizëm dhe mbrojtje të mjedisit, drejtori i të cilës kishte dhënë dorëheqje në shtator të 2015.<sup>1</sup> Por gjendja është komplet e kundërt me Kuvendin Komunal. Të vetmet informata që figurojnë për këshilltarët komunal është emri dhe mbiemri dhe një fotografi. Për ironi, kryesuesi jo vetëm që nuk ka asnjë informatë, por nuk ka as fotografi.<sup>2</sup>

Shumica e deklaratave të pasurisë së zyrtarëve të lartë të pushtetit lokal në Gjakovë janë të publikuara në ueb faqen e Agjencisë Kundër Korrupsion (AKK), por të njëjtat nuk figurojnë edhe në uebin e komunës.<sup>3</sup> Mungon vetëm deklarata e drejtorit të drejtorisë së buxhetit dhe financave. E njëjta nuk mund të thuhet edhe për Kuvendin Komunal. Nga gjithsejtë 36 anëtarë të Kuvendit Komunal, 8 prej tyre nuk kanë të deklaruar pasurinë. Megjithatë, në disa raste përgjegjësia nuk është e qartë, pasi që disa deklarata nuk ekzistojnë gjatë një periudhe kohore por ishin publikuar nga fundi i vitit. Ndërsa në një rast ekziston emri i anëtares komunale por deklarata e pasurisë është e tjetër kujt, gjë e cila sugjeron që anëtarja komunale ka dorëzuar deklaratën e pasurisë por AKK gabimisht ka ngarkuar deklaratë tjetër.<sup>4</sup> Në përgjithësi, deklaratat e pasurisë nuk ofrojnë të dhëna krahasuese kohore, që të bëhen krahasime të pasurisë gjatë mandatit, dhe në disa raste deklaratat janë konfuzë dhe të paplota. Përjashtim këtu bën kryetarja e komunës, e cila figuron në platformën e Lëvizjes FOL dhe ku mund

1 Komuna e Gjakovës e konfirmon dorëheqjen e Hoxhës <http://www.gazetaexpress.com/lajme/komuna-e-gjakoves-e-konfirmon-doreheqjen-e-hoxhes-132267/>

2 Rubrika e kryesuesit të Kuvendit Komunal në uebfaqe <https://kk.rks-gov.net/gjakove/Kuvendi/Kryesuesi-i-Kuvendit.aspx>

3 Deklarimet e pasurisë mund të gjinden në uebsajtin e AKK-së [http://www.akk-ks.org/sq/deklarimet?path=declaration\\_assets%2F2015%2FKomunat%2FKomuna\\_e\\_Gjakoves#indexmain](http://www.akk-ks.org/sq/deklarimet?path=declaration_assets%2F2015%2FKomunat%2FKomuna_e_Gjakoves#indexmain)

4 Rasti i Ndue Muqaj apo i Xhavit Ukes, [http://akk-ks.org/declaration/2015/Komunat/Komuna\\_e\\_Gjakoves/Ndue\\_Muqaj.pdf](http://akk-ks.org/declaration/2015/Komunat/Komuna_e_Gjakoves/Ndue_Muqaj.pdf); [http://akk-ks.org/declaration/2015/Komunat/Komuna\\_e\\_Gjakoves/Xhavit\\_Uka.pdf](http://akk-ks.org/declaration/2015/Komunat/Komuna_e_Gjakoves/Xhavit_Uka.pdf)

të krahasohen deklaratat e pasurisë ndër vite.<sup>5</sup> Ndërsa sa i përket qartësisë dhe cilësisë të deklaratave të pasurisë, në shumicën dërmuese pagat janë të deklaruara por jo edhe kompensimet shtesë – si mëditje, shtesa, etj.

Sa i përket konfliktit të interesit, informatat janë jo ekzistente për të gjithë zyrtarët e lartë politik të Komunës dhe Kuvendit Komunal. Në bazë të statutit të Komunës, para mbledhjes së parë të Kuvendit të Komunës, anëtarët e Kuvendit janë të obliguar të shënojnë një deklaratë të plotë dhe të hapur për interesat e tyre financiare, por këto dokumente nuk janë të publikuara. Bazuar në informatat e brendshme të vet AKK, AKK i ka njoftuar kryetaren, disa drejtorë dhe anëtarë të Kuvendit Komunal për konflikt interesi. Pas njoftimit të AKK-së, këta të fundit kanë marrë masa për shmangien e konfliktit të interesit.

Edhe në kanalet e komunikimit me qytetarë, ekziston një kontrast i madh ndërmjet ekzekutivit dhe Kuvendit. Anëtarët e ekzekutivit kanë të publikuar vetëm e-mail adresat. Kryetarja nuk ka pas të publikuar asnjë informatë kontakti; megjithatë të gjithë anëtarët e kabinetit të saj kanë të publikuara informata të hollësishme të kontaktit. Në anën tjetër, asnjë anëtar i kuvendit, duke përfshirë edhe kryesuesin, nuk ka të publikuar informata qoftë edhe bazike kontaktuese. Ndërsa sa i përket takimeve me qytetarë, drejtorët e drejtorive takohen rregullisht tri herë në javë në orar të caktuar, kurse kryetarja takohet çdo ditë. Në përgjithësi kontakti me anëtarët e ekzekutivit është relativisht i lehtë.

Njoftimet për seancat e Kuvendit në përputhje me ligjin publikohen në ueb dhe vende publike 7 ditë para takimit, me rendin e ditës. KK publikon procesverbalet, vendimet, dhe seancat transmetohen drejtpërdrejt në televizionin lokal Syri Vision.<sup>6</sup> Nuk ka kalendar të publikuar – është intern – me informata të plota mbi aktivitetet e kryetares. Njoftimet paralajmëruese i dërgohen gazetarëve dhe shoqërisë civile. Pjesa më e madhe e tyre publikohen në formë lajmesh edhe në ueb faqe.



### Nota: 2.5 (Neutrale)

*Arsyetimi: Ekziston një kontrast i madh ndërmjet ekzekutivit dhe Kuvendit të Komunës. CV-të për anëtarët e Kuvendit Komunal mungojnë plotësisht, ndërsa për ekzekutivin ekzistojnë plotësisht. Deklaratat e pasurisë janë të publikuara për pothuajse të gjithë anëtarët e ekzekutivit, por një e katërta e anëtarëve të kuvendit nuk i kanë të publikuara. Mosdeklarimi i konflikteve të interesit nga zyrtarët e lartë publik është një dukuri shumë negative. Informatat kontaktuese janë prezentë për të gjithë anëtarët e stafit politik, por asnjë informatë nuk ekziston për anëtarët e kuvendit komunal.*

<sup>5</sup> Platforma e krahasimit të pasurisë, Lëvizja FOL <http://deklarimi.lvizjafol.org/Zyrtaret/Pasuria/1487/Mimoza-Kusari-Lila>

<sup>6</sup> Televizioni Syri Vision mund të përcillet edhe online në uebfaqen e tij, dhe si rezultat edhe seancat mund të përcjellën në këtë uebfaqe <http://www.syri-vision.tv/tv/live.html>

## 2. Organizimi dhe funksionimi

*Publiku duhet të ketë informata të mjaftueshme për të kuptuar organizimin, kompetencat, funksionimin, procesin e vendimmarrjes dhe të politikëbërjes të trupave të ndryshme komunale.*

Komuna e Gjakovës ka të publikuar në ueb faqe organogramin e përgjithshëm të komunës. Ka një shpërputhje ndërmjet organogramit dhe përshkrimit të Kuvendit sa i përket anëtarëve të kuvendit (organogrami thotë që janë 35 ndërsa përshkrimi i kuvendit thotë 42), por organogrami ka informatat e përditësuara, ndërsa informatat mbi Kuvendin janë të gabuara. Përveç organogramit, kompetencat për kuvendin, komisionet e kuvendit, drejtorive, zyrave dhe kryetares përveç se janë të përshkruara në statut janë të përshkruara edhe për secilën në ueb faqe. Megjithatë mungojnë përshkrimet e obligimeve të drejtorëve dhe të institucioneve vartëse. Ndërsa për organet e decentralizuara dhe për institucionet ku autoritetet komunale kanë kompetenca nuk ka informata në ueb faqe zyrtare të komunës. Mirëpo, komuna e Gjakovës ka krijuar një ueb faqe tjetër, [www.gjakovaportal.com](http://www.gjakovaportal.com), jashtë domainit të Ministrisë së Administratës Publike, ku janë të paraqitura shumë informata, ndër të tjera edhe informata rreth organeve të decentralizuara dhe institucioneve ku komuna ka kompetenca. Kryesisht këto informata janë ose brenda ueb faqes ose ueb faqja të referon tek ueb faqet e këtyre institucioneve.

Mënyrat më efektive për ndikim në politikëbërje dhe vendimmarrje nuk janë të shpalosura në mënyrë të qartë për publikun. Përveç informatave në statutin e komunës, nuk ekzistojnë informata tjera mbi procesin e politikëbërjes. Në ueb faqe janë të publikuara rregulloret e aprovuara, vendimet e Kuvendit, dhe procesverbalet, gjë të cilat mund të ndihmojnë në njohuritë mbi procedurat e politikëbërjes apo për politikën në fuqi. Megjithatë, këto dokumente nuk ndihmojnë shumë qytetarët për procesin e bërjes së politikave, strategjive, apo nxjerrjes së akteve normative, si dhe për mënyrën e vendimmarrjes në Ekzekutivin e Komunës dhe në Kuvend.

Kanalet e komunikimit zyrtar janë të publikuara dhe inkurajuar për ekzekutivin e komunës. Përveç informatave kontaktuese të anëtarëve të kabinetit ekzekutiv, në ueb faqe janë të publikuara edhe numrat e telefonit për secilën drejtori. Gjithashtu janë të publikuara edhe informatat kontaktuese për të gjitha institucionet varëse të komunës dhe institucionet ku komuna ka kompetenca – si muzetë, teatrot, shkollat, institucionet shëndetësore, kompanitë e ujësjellësit, etj. Përkundër gjithë kësaj, komunikimi është më efikas në baza personale me zyrtarët komunal. Ndërsa edhe pse komunikimi mund të jetë i lehtë, mungesa e të dhënave kontaktuese e anëtarëve të Kuvendit i bën ata të jenë vështirë të qasshëm.

Informatat e publikuara për planet afatmesme, afatgjata dhe draft-dokumentet janë kryesisht të publikuara. Të gjitha drejtoritë kanë hapësirën për publikimin e planit vjetor të punës së tyre, ani pse jo të gjitha drejtoritë kanë të publikuara këtë plan. Gjithashtu janë të publikuara projektet komunale të kaluara, ato që janë në progres e sipër, dhe të planifikuara. Dokumentet strategjike buxhetore, të zhvillimit urban, dhe strategji tjera janë gjithashtu të publikuara.

Sa i përket të dhënave për komunën, ka mjaft shumë të dhëna kualitative dhe të përditësuara. Ueb faqja [gjakovaportal.com](http://gjakovaportal.com) është jo më pak se një guidë për

komunën. Në të gjinden informata të përgjithshme mbi demografinë, gjeografinë, historinë, dhe ekonominë e komunës, dhe informata tjera mbi bizneset, aktivitetet kulturore, OJQ-të, trashëgiminë kulturore, dhe vendet rekreative. Përpos këtyre informatave të detajuara, komuna e Gjakovës gjithashtu ka të publikuar një hartë interaktive ku mund të shihen jo vetëm emrat e rrugëve, gjeografia e komunës, por edhe lokacioni dhe informatat kontaktuese për institucionet, OJQ-të, bizneset, objekteve kulturore, fetare, sportive, të trashëgimisë kulturore, etj. Të gjitha këto informata janë të qasshme në tri gjuhë: Shqip, Anglisht, dhe Serbisht.



### Nota: 4 (Pozitive)

*Arsyetimi: Informatat aktuale të ofruara nga Komuna i mundësojnë publikut të gjerë që të kuptojë lehtë organizimin, kompetencat, dhe funksionimin e komunës. Përveç anëtarëve të kuvendit, pjesa tjetër e komunës është lehtë e qasshme për sa i përket komunikimit. Të dhëna mbi komunën ka mjaftë shumë dhe këto të dhëna janë të organizuara mirë. Dokumentet strategjike, planet e punës, projektet e planifikuara, buxhetet, dhe planet urbanistike janë të gjitha të publikuara, gjë e cila mundëson informimin e qytetarëve për orientimin e komunës. Megjithatë, mënyrat më efikase për ndikim në politikbërje dhe vendimmarrja nuk janë të shpalosura në mënyrë të qartë për publikun.*

## 3. Puna e organeve politikë-bërëse dhe vendim-marrëse

*Publiku duhet të ketë informata të detajuara, përditësuara, dhe të mjaftueshme për të vlerësuar problematikat kryesore të debatuar dhe vendimet kryesore të marra nga organet politikë-bërëse dhe vendim-marrëse të Komunës.*

Organet komunale të Komunës së Gjakovës kanë aplikuar praktika të rregullta për shtytjen e qytetarëve që të jenë vëzhgues aktiv të debateve dhe proceseve vendimmarrëse. Qytetarët njoftohen me kohë rreth takimeve, publikohen procesverbalet dhe rendet e ditës. Në debate, seanca dhe takime tjera, qytetarët marrin pjesë edhe pse jo në numër shumë të kënaqshëm. Përveç qytetarëve marrin pjesë edhe organizata të ndryshme vëzhguese, si OSBE, KFOR, apo organizata tjera të shoqërisë civile. Seancat e Kuvendit transmetohen drejtpërdrejtë në televizionin lokal. Ndërsa sfidë mbetet pjesëmarrja relativisht e ulët e qytetarëve në takimet e komisioneve të Kuvendit.

Ekzekutivit raporton në Kuvend në baza të rregullta. Kryetarja raporton në Kuvend dhe në komision bashkë dhe këto raporte janë të publikuar. Drejtoritë gjithashtu raportojnë mbi punën e tyre dhe këto raporte janë të publikuara në ueb faqe.

Përgjithësisht, qytetarët mund të informohen për punën e komunës. Pasqyrat financiare, planet komunale, rregulloret, vendimet e kuvendit, vendimet e kryetares, vendimet e bordit të drejtorëve, procesverbalet, planet zhvillimore dhe urbane, dhe dokumente tjera janë të publikuara në ueb faqe. Përkundër gjithë këtyre dokumenteve të publikuara, janë disa zbrazëtira që pengojnë qasjen më të lehtë. Për shembull, vendimet gjinden të publikuara por jo edhe arsyetimet, dhe propozimet legislative dhe nismat tjera janë të publikuara por vetëm si pjesë e

procesverbaleve gjë e cila e bën shumë të vështirë qasjen në to. Mungojnë raportet e Kuvendit për vitet 2013-2015. Gjithashtu, këto dokumente kanë tendencë të jenë të paorganizuara, gjë e cila e vështirëson tejet shumë qasjen efektive në to. Opsioni i kërkimit nuk funksionon, ndërsa dokumentet shpesh nuk janë të kategorizuara. Në anën tjetër, mungon një bazë e të dhënave me rregullore të shqyrtuara, aprovuara, dhe sa vota kanë qënë për, sa kundër, dhe sa abstenime. Nuk ekzistojnë as video të mbledhjeve. Ndërsa sa i përket punës së komisioneve të kuvendit, ka mungesë të informatave për punën e tyre – duke filluar nga oraret e mbledhjeve deri tek raportet e punës së komisioneve - dhe lista e anëtarëve të komisioneve shpesh nuk është e azhurnuar.



## Nota: 4 (Pozitive)

*Arsyetimi: Komuna ka aplikuar praktika të mira sa i përket kontaktit me qytetarë dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në debate publike, edhe pse numri i qytetarëve që marrin pjesë vazhdon të jetë relativisht i ulët. Ekzekutivi i komunës rregullisht i raporton Kuvendit. Qytetarët përgjithësisht mund të informohen rreth punës së Komunës, por mungon një organizim më i mirë që do të mund të lehtësonte qasjen më efektive në informata.*

## 4. Luftimi i sjelljeve të pahijshme dhe keqpërdorimeve

*Komuna duhet të publikojë informata të rëndësishme nga të cilat lehtësisht mund të vlerësohet niveli i përkushtimit të saj në luftimin e sjelljeve të pahijshme dhe keqpërdorimeve.*

Në Komunën e Gjakovës, konfliktet e interesit të anëtarëve të Kuvendit, të kryetarit të Komunës, të nënkryetarëve, të drejtorëve të drejtorive të Komunës dhe të nëpunësve të administratës komunale përkufizohen në statutin e Komunës<sup>7</sup> dhe udhëzimin administrativ për përgjegjësitë në punë. Përveç këtyre dy dokumenteve ekziston edhe Kodi i Etikës. Të dy këto dokumente janë të publikuara. Për të zbatuar këto dokumente është formuar komisioni disiplinor, i përbërë nga pesë anëtar.

Niveli i transparencës për aktivitetet në luftën kundër mashtrimeve apo keqpërdorimeve është mesatar. Vendimet e marra vendosen në raporte dhe i jepen parashtruesit dhe zyrave përkatëse por ato nuk publikohen. Gjithashtu, udhëzimi administrativ për përgjegjësitë në punë nuk është i publikuar në ueb faqe të komunës. Numri i rasteve të hetuara ka qënë 3 në total. Ndërsa si mekanizëm përcjellës ekziston grupi punues prej 3 personave në kuadër të drejtorisë së administratës.

Niveli i informimit të publikut për mekanizmat e raportimit të keqpërdorimeve të mundshme është relativisht i lartë, pasi komuna ofron disa mënyra për raportimin e keqpërdorimeve. Në sportelet e komunës ekzistojnë njoftime se si të

<sup>7</sup> Statuti i Komunës, Konflikti i interesave, Neni 26 <https://kk.rks-gov.net/gjakove/getattachment/Assembly/Statut/statuti-i-komunes.pdf.aspx>

raportojnë rastet e korrupsionit, sjelljeve të pahijshme dhe ankesave në shërbime. Gjithashtu, ekzistojnë dy numra ku qytetarët mund të thërrasin pa pagesë për paraqitjen e këtyre rasteve. Përveç këtyre mënyrave, ekziston një vegëz që lidhë ueb faqen e komunës me ueb faqen e kallxo.com ku qytetarët mund të shkruajnë ankesat për keqpërdorime të mundshme, por kjo vegëz nuk funksionon. Si praktikë e gjerë, deri më tani, kanë qenë vetëm vërejtjet me gojë tek eprorët apo te kryetarja e Komunës.



### Nota: 4 (Pozitive)

*Arsyetimi: Në bazë të akteve në fuqi dhe praktikave të zbatuara del se Komuna e Gjakovës ka mekanizma relativisht të mirë për luftimin e sjelljeve të pahijshme. Niveli i informimit të publikut për mekanizmat e raportimit është relativisht i mirë, por praktikat e tanishme janë kryesisht informale gjë e cila anashkalon procedurat institucionale. Ndërsa në aspektin e transparencës, komuna është relativisht transparente.*

## 5. Integrimi Evropian

*Publikut duhet t'i ofrohet mundësia që të mësoj në mënyrë të saktë dhe të detajuar obligimet, arritjet dhe sfidat që i ka komuna në procesin e integritit të Kosovës në BE.*


Komuna e Gjakovës në aspektin e integritimeve evropiane ka publikuar kryesisht informata rreth obligimeve dhe proceseve. Komuna ka të publikuar listën e obligimeve që burojnë nga procesi i integritit në BE. Publiku ka informata për obligimet, gjendjen e tanishme, dhe qëllimet në çështje të ndryshme si riatdhësimi, të drejtat e njeriut, barazia gjinore, dhuna në familje, të drejtat e komuniteteve, përdorimi i gjuhëve dhe çështje të tjera. Megjithatë, nuk ka informata rreth gjendjes momentale dhe statusit të përmbushjes së obligimeve të Komunës kundrejt këtyre proceseve.

Komuna ka publikuar informata rreth asaj se çfarë do të jetë ndikimi mbi çështjet ekonomike, çështjet sociale, çështjet e administratës publike, dhe të tjera nga procesi i integritit evropian. Shumë prej këtyre informatave janë në formë të broshurave, raporteve, dhe udhëzuesve. Megjithatë, shumë nga këto dokumente flasin prej perspektives dhe përvojës evropiane gjë me të cilën qytetarët mund të kenë problem të bashkëndejnë. Pra, mungojnë dokumente që i përkthejnë këto informata në kontekstin lokal.



### Nota: 3 (Neutrale)

Arsyetimi: Përgjithësisht, komuna e Gjakovës ka bërë një punë të mirë në shpërndarjen e raporteve, broshurave, udhëzuesve dhe dokumenteve tjera rreth procesit të integrimeve evropiane. Por shumë nga këto dokumente kanë nevojë të 'përkthehen' në kontekstin lokal. Gjithashtu, komuna ka publikuar obligimet komunale për proceset evropiane, por nuk ka dhënë informata më të hollësishme rreth përmbushjes së këtyre obligimeve.



## II. Menaxhimi ekonomik dhe financiar

### 6. Kontabiliteti dhe buxheti

*Të dhënat dhe raportet e ndryshme dhe të përditësuara rreth të hyrave financiare, alokimeve buxhetore, shpenzimeve financiare, borxheve dhe kontesteve me pasojat financiare për komunën, duhet të jenë në dispozicion të publikut për të pasë pasqyrë të qartë mbi menaxhimin e parasë publike në nivel lokal.*

Komuna e Gjakovës ka ndërmarrë disa hapa drejt përfshirjes së publikut në planifikimin buxhetor. Autoritetet komunale gjatë vitit 2015 kanë realizuar 6 debate publike me qytetarët për buxhetin e vitit 2016, 4 nga të cilat në zona rurale dhe 2 në zona urbane. Raportet e këtyre debateve gjinden në Kuvend. Megjithatë, numri i debateve mund të mos jetë i mjaftueshëm duke pasur parasysh numrin e madh të popullsisë së komunës. Draft-buxheti nuk është publikuar online, por janë shpërndarë kopjet e shtypura. Në bazë të deklaratave të zyrtarëve komunal dhe anëtarëve të Kuvendit, ka pasur propozime dhe ide nga qytetarët edhe anëtarët e KPF që janë pranuar.<sup>8</sup> Por, Komuna akoma nuk ka ndërtuar një mekanizëm për regjistrimin e propozimeve të qytetarëve, si dhe për publikimin e vendimeve në qoftë se këto propozime janë përkrahur apo hedhur poshtë.

Të dhënat mbi ndarjet dhe realizimet buxhetore publikohen online në kuadër të 'Si i shpenzon shteti paret tona?'<sup>9</sup> platformë e Institutit GAP që ka linkun edhe në ueb faqen e Komunës. Të dhënat mbi ndarjet dhe realizimet buxhetore publikohen edhe në formë të raporteve, vjetore dhe tremujore. Në dokumentin e buxhetit figurojnë të dhënat mbi projektin, shumën e planifikuar për shpenzim dhe burimet nëse janë nga granti qeveritar apo të hyrat vetanake dhe viti kur do të realizohet projekti i caktuar. Nuk ka shpjegime mbi qëllimet e projekteve. Ato në të shumtën e rasteve pasqyrohen në propozimet që adresohen te kryetari për

<sup>8</sup> Armend Vokshi, drejtor i Administratës, në Fokus Grupin e mbajtur me datën 09.02.2016

<sup>9</sup> Si i shpenzon shteti paret tona?, Instituti GAP, <http://www.institutigap.org/spendings/?gjakove/2014#/~/~gjakove/shpenzimet-komunale>



lejimin e shpalljes së tenderëve. Këto propozime janë të qasshme për gazetarët dhe shoqërinë civile. Në Kornizën Afatmesme Buxhetore, figuron praktika e ngjashme sikurse në buxhetin vjetor, ku është edhe lista me projekte. Komuna ka arritur që të zhvillojë një tabelë interaktive të buxhetit shumëvjeçar dhe këto tabela janë të publikuara.

Komuna e Gjakovës, njëjtë si të gjitha komunat tjera, auditohet rregullisht nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP).<sup>10</sup> Raporti i ZAP është i publikuar në ueb faqen e komunës dhe është gjithashtu i qasshëm nga ueb faqja e ZAP. Në këtë raport qytetarët mund të njoftohen mbi praktikën e menaxhimit të financave publike. Përveç kësaj, komuna ka krijuar një komision të veçantë për adresimin e të gjeturave të raportit të auditimit të ZAP.<sup>11</sup>

Ashtu si në rastin e planifikimit buxhetor, raportet për burimet e të ardhurave të komunës publikohen në formë të raporteve, vjetore dhe tremujore. Në përgjithësi mund të thuhet se ka informata të kënaqshme për të kuptuar burimet e të hyrave të Komunës. Mirëpo në shumicën e rasteve, tabelat publikohen në format të skenuar apo në format PDF, gjë e cila e vështirëson analizën numerike.

Në listën e dokumenteve buxhetore, komuna ofron edhe informata për qytetarët mbi suficitin/deficitin buxhetor apo borxhet e saj, dhe llogaritë e arkëtueshme, apo detyrimet kontigjente. Publikimi i shumës së borxheve të komunës ndaj operatorëve të ndryshëm dhe llogarive të arkëtueshme, si dhe detyrimeve kontigjente ndodh zakonisht në kuadër të raportit vjetor të financave, pa sqarime të detajuara, por vetëm në mënyrë të përmbledhur.

Komuna nuk ofron informata mbi funksionimin e organizatave të cilat ofrojnë shërbime për qytetarët, ku komuna ka kompetenca, apo të dhëna buxhetore të këtyre organizatave publike në mënyrë direkte. Mirëpo, në ueb faqen e komunës janë të ndërlidhura ueb faqet e këtyre organizatave, në të cilat mund të gjinden raportet vjetore, tabelat buxhetore, raportet e auditorëve, dhe informatat tjera relevante për menaxhim të mirë të financave publike. Në shumicën e rasteve, informatat nuk janë të detajuara sa informatat e komunës, por ekzistojnë vetëm në vija të trasha.



### Nota: 3.6 (Pozitive)

*Arsyetimi: Gjatë vitit 2015, Komuna e Gjakovës ka aplikuar politika dhe praktika për përfshirjen e publikut në hartimin e buxhetit. Megjithatë, mbetet një hapësirë jo e vogël që duhet mbushur për të arritur një transparencë të kënaqshme, dhe në publikimin e propozimeve nga qytetarët dhe realizim apo mosrealizimin e atyre propozimeve, përkundër progresit që është bërë në këtë fushë. Në anën tjetër, komuna është relativisht transparente në publikimin e të dhënave të shpenzimeve dhe të hyrave të komunës dhe praktikën e mira dhe të metat e menaxhimit të financave publike.*

<sup>10</sup> Shih raportet e auditorit në këtë vegëz <http://oag-rks.org/sq/Komunat?date=2014>

<sup>11</sup> Vendim për të gjeturat e auditorit, <https://kk.rks-gov.net/gjakove/getattachment/c7920c8a-9add-4095-b9c2-91ad7136d962/Vendim-per-te-gjeturat-e-auditorit-dt-24-07-2015.aspx>

## 7. Kontratat e prokurimit publik, furnizimit dhe granteve

*Marrëdhëniet kontraktuale me implikime financiare në mes të komunës dhe personave fizik dhe juridik duhet të zhvillohen në transparencë të plotë, për të siguruar menaxhimin e mirë të parasë publike dhe vlerën e duhur për shërbimet, punët apo furnizimet.*

Komuna e Gjakovës është treguar relativisht transparente sa i përket shpalosjes së informatave të vlerësimit të përshtatshmërisë së operatorëve për hyrje në marrëdhënie kontraktuale me ta, edhe pse ka shumë hapësirë për përmirësim të transparencës. Nuk ka informata të publikuara lidhur me mënyrën e përzgjedhjes dhe përbërjes së komisioneve vlerësuese, ani pse deri më tani ka qenë praktikë e gjerë që kjo të ishte nën diskrecionin e kryetares që pastaj të interesuarit mund të njoftohen në Zyrë të Prokurimit (ZP). Njoftimet për kontrata nga Sektori i Prokurimit publikohen në KRPP<sup>12</sup> dhe në ueb faqen e Komunës.<sup>13</sup> Arsyetimet për vendosjen e kritereve zakonisht janë të publikuara në dosjen e tenderit në KRPP. Procesverbalet e komisioneve vlerësuese ekzistojnë, por nuk publikohen përveç nëse ka kërkesë zyrtare. Manuale për proceset e konkurimit, parime dhe kod të mirësjelljes për procese kontraktuale ekzistojnë në KRPP. Njoftimet mbi kontraktimet dhe tenderët e shumave të vogla shpallen në KRPP dhe në ueb faqen e komunës. Të gjitha projektet kalojnë përmes Kuvendit Komunal, gjë e cila siguron përputhjen e projekteve aktuale me ato të aprovuara nga Kuvendi Komunal. Ndërsa për hulumtimin e tregut për caktimin e çmimeve të përafërta, komuna përdorë draft-rregulloren e KRPP-së.

Si pjesë e projektit Open Data të UNDP-së, komuna e Gjakovës ka krijuar një databazë me të dhënat e prokurimit në të cilën janë të gjitha kontratat e dhëna që nga viti 2011. Këto të dhëna përfshijnë emrin e kompanisë fituese, datën e nënshkrimit të kontratës, vlerën e parashikuar të kontratës, afatet kyçe, datat e fillimit dhe mbarimit, raporte mbi përmbushjen e parametrave të paraparë në kontratë, etj. Përkundër publikimit të databazës me të dhëna të detajuara, komuna publikon raporte - edhe pse jo shumë të detajuara - mbi performancën e kontraktorëve bazuar në indikatorët e paracaktuar në kontratë. Megjithatë, këto raporte publikohen nga drejtoritë përkatëse në mënyrë jo të harmonizuar, dhe disa informata bazike gjithashtu publikohen në Gjakova Portal.




### Nota: 3.5 (Pozitive)

*Arsyetimi: Komuna e Gjakovës aplikon praktika relativisht të mira – por që janë procedura standarde të KRPP-së – sa i përket procesit të prokurimit. Krijimi i databazës së të gjitha kontratave të dhëna përmes prokurimit ka rritur nivelin e transparencës për kontratat e kaluara. Me vazhdimin e saj, komuna siguron që të ketë transparencë edhe në të ardhmen. Përkundër hapave pozitiv, Komuna duhet gjithashtu të publikojë raporte mbi performancën e kontraktorëve bazuar në indikatorët e paracaktuar në kontratë.*

<sup>12</sup> Për më shumë, shih [http://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Home&LID=1&PPRCMenu\\_OpenNode=60](http://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Home&LID=1&PPRCMenu_OpenNode=60)

<sup>13</sup> Për më shumë, shih <https://kk.rks-gov.net/gjakove/Prokurimi/Njoftim-per-kontrate.aspx>



### III. Menaxhimi i resurseve njerëzore dhe resurseve tjera

#### 8. Të punësuarit në administratën publike dhe organizatat/institucionet publike

*Menaxhimi i resurseve njerëzore duhet të bëhet në mënyrë transparente duke përfituar nga mbikëqyrja e vazhdueshme e publikut mbi performancën e administratës.*

Administrata komunale e komunës së Gjakovës organizohet në drejtori, si dhe Zyra. Secila drejtori e zyre komunale udhëhiqet nga drejtori përkatësisht shefi. Drejtorët emërohen dhe shkarkohen nga Kryetari i Komunës. Në bazë të ligjit, në dosjet e secilit punëtor të komunës ekziston akti i emërimit dhe përshkrimi i vendit të punës, ndërsa dosjet janë të qasshme me kërkesë zyrtare. Analiza dhe raporte për administratën janë bërë nga drejtoria e administratës por këto raporte nuk janë të publikuara. Informata kontaktuese të personave kryesorë kryesisht nuk ka, derisa pagat nuk bëhen publike.

Informatat mbi funksionimin e organizatave/institucioneve të ndryshme komunale jo gjithherë janë të qarta për publikun. Ekzistojnë përshkrime të funksioneve dhe organizimit, që tregojnë lidhjen, përgjegjësitë dhe kompetencat; megjithatë, këto përshkrime janë ose shumë të përgjithshme ose nuk figurojnë në të gjitha drejtoritë.

Praktikat e rekrutimit/punësimit janë të rregullta në ndjekjen e procesit ligjor. Për reklamimin e një vendi të lirë pune bëhen publikime të thirrjes për aplikim në disa gazeta, si dhe thirrja vendoset në ueb faqe dhe rrjete sociale. Gjatë procesit të rekrutimit të punëtorëve në fushën e edukimit, emrat e të gjithë të intervistuarve dhe fituesve janë publikuar. Megjithatë mungojnë mekanizmat e ankesës, në rast mospajtimi nga ana e aplikantëve.

Drejtoria e Administratës ka përgatitur raport mbi aktivitetet dhe vendimet e mekanizmave për vlerësim të performancës dhe sjelljes së Administratës, por ky raport nuk është i publikuar. Kodi i Etikës dhe Mirësjelljes ekziston dhe i jepet të punësuarve në ditët e para të punësimit. Kodi i Etikës është gjithashtu i publikuar në Zyrën për Informim, e cila gjendet në hyrje të objektit të komunës. Ndërsa raportimet për konfliktit të interesit bëhen tek AKK, e cila pastaj ndërmerr procedurat e saja për zgjidhjen e problemit.



### Nota: 3.4 (Pozitive)

*Arsyetimi: Drejtoria e Administratës bën raporte përtëpërmirësuar performancën e administratës. Publikimi i Kodit të Etikës është hap i mirë. Në përgjithësi, praktikat e rekrutimit ndjekin procedurat standarde ligjore, por mungesa e mekanizmave të ankesës kontribuon negativisht në nivel të transparencës.*

## 9. Pasuria kapitale dhe jokapitale

*Publiku duhet të ketë informata të përditësuara dhe të plota mbi menaxhimin e pasurisë publike nga ana e pushtetit komunal.*

Komuna e Gjakovës është kryesisht transparente në publikimin e pasurisë së patundshme. Lista e të gjitha ndërtesave që i ka në pronësi është publikuar bashkë me vlerën e këtyre pronave, edhe pse jo të gjitha pronat janë të përfshira në këtë listë. Këto prona gjithashtu janë paraqitura në hartë, ku mund të shihet qartë lokacioni i tyre, mirëpo kjo hartë është në versionin PDF gjë e cila dukshëm kufizon kualitetin e hartës. Megjithatë, komuna është duke punuar në përgatitjen e GIS hartave ku këto prona do të paraqiten në mënyrë shumë më të mirë dhe interaktive. Gjithashtu, kjo listë përshkruan përdorimin, sipërfaqen dhe numrin e parcelave.

Sa i përket vendimeve dhe arsytimit të komunës për të përdorur apo për të lëshuar me qira këto prona, ato ekzistojnë në kuadër të Asamblesë, por nuk gjenden në ueb faqe. Gjithashtu lista e pronave të cilat janë transferuar nga Komuna tek shfrytëzues/pronar tjerë me arsyetimet për vendimet e tilla nuk janë të publikuara edhe pse kjo listë është nën posedim të komunës.


Komuna nuk ka publikuar listë të pasurive jo-kapitale, si inventar, automjete, etj edhe pse një liste e tillë gjendet në Drejtori të Administratës.

Komuna nuk ka publikuar informata mbi aksionet që mban komuna në kompani të ndryshme, etj edhe pse një listë e tillë gjendet në Drejtori të Administratës.



### Nota: 2 (Negative)

*Arsyetimi: Komuna është relativisht transparente në publikimin e listës së patundshmërive. Megjithatë, kjo transparence kundërbalancohet nga mungesa totale e transparencës në listën e pasurive jo-kapitale dhe informatave mbi aksionet që mban komuna në kompani të ndryshme.*



## IV. Marrëdhëniet me qytetarët dhe shoqërinë

### 10. Informimi dhe shërbimi i qytetarëve

*Transparenca komunale duhet të jetë e avancuar duke i mundësuar publikut qasje të lehtë në informata, informim të saktë, të shpejtë dhe të detajuar rreth çështjeve që ndërlidhen me politikën, vendimet dhe shërbimet për qytetarët.*

Në Komunën e Gjakovës ekziston Zyra për Informim, kontakti me të cilën mund të vendoset lehtë. Zyra është efiçase në kthimin e përgjigjeve, gjë e cila ndodhë kryesisht brenda afatit të caktuar me ligj. Ekzistojnë statistika bazike rreth kërkesave në qasje të dokumenteve zyrtare, si për shembull që gjatë vitit 2015 është lejuar qasja në dokumente zyrtare 38 kërkesave dhe nuk i'u është refuzuar qasja, as pjesërisht, asnjë kërkesë. Nuk ka publikuar statistika rreth përdorimit të rrjeteve sociale, rreth përdorimit të mjeteve mobile, rreth shërbimeve përmes telefonit. Nuk ka statistika as rreth këshillimit të qytetarëve dhe shërbimeve të informatave.

Plan i veprimit i komunës për avancim të transparencës në nivelin komunal ekziston si rregullore. Me këtë rregullore përkufizohen parimet, kushtet dhe kriteret që kanë për qëllim forcimin e transparencës së organeve të komunës së Gjakovës, rritjen e pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje, lehtësimin e qasjes së publikut në dokumentet zyrtare të komunës së Gjakovës dhe nxitjen e praktikave të mira administrative për qasjen në dokumente zyrtare.

Ueb faqja e Komunës së Gjakovës përmban relativisht shumë informata. Organizimi i ueb faqes është relativisht i mirë edhe pse ka shumë vend për përmirësim. Ueb faqja tjetër e komunës, gjakovaportal.com gjithashtu ka shumë të dhëna, por edhe është shumë më e organizuar dhe praktike. Informatat janë të përditësuara. Nuk ka infografika në sensin tradicional të fjalës, por ekziston një hartë interaktive me informata mbi institucionet shtetërore, kulturore dhe rekreative të komunës së Gjakovës. Nuk ka as raporte rreth popullaritetit të ueb faqes. Nuk ka ndonjë masë promovuese për të rritur numrin e vizitorëve dhe përdoruesve të shërbimeve.

Nuk ka forum për diskutim në ueb faqet e komunës, nga e cila mund të merreshin opinionet e qytetarëve. Komuna gjithashtu nuk ka kryer hulumtime të opinionit publik rreth transparencës në komunë. Megjithatë një hulumtim për transparencën ishte bërë nga Instituti Demokratik i Kosovës, i cili kishte shpallur Komunën e Gjakovës si komunë më transparente në vitin 2014.<sup>14</sup>

Komuna e Gjakovës përdor dhe rrjetin social Facebook për pasqyrimin e aktiviteteve të saj, e cila ndiqet prej më shumë se 15 mijë vetave.<sup>15</sup> Me një popullaritet

<sup>14</sup> Transparometri Komunal. Instituti Demokratik i Kosovës. 2014. [http://www.kdi-kosova.org/publikime/14-kdi\\_transparometri-komunal.pdf](http://www.kdi-kosova.org/publikime/14-kdi_transparometri-komunal.pdf)

<sup>15</sup> Për më shumë, shih <https://www.facebook.com/KuvendiKomunalGjakove>

të tillë, faqja e komunës në Facebook është bërë mjet i rëndësishëm i informimit publik. Rrjetet sociale ndërkohë i përdorë edhe kryetarja – e cila është edhe me e popullarizuar, me mbi 150 mijë ndjekës në Facebook dhe rreth 4,500 në Twitter, përmes të cilës njofton qytetarët për aktivitetet e saj dhe të komunës. Në rrjetet sociale kryesisht postohen lajmet që publikohen dhe në ueb faqe dhe nuk ka infografika, video apo animacione. Nuk ka aplikacione as për telefona të mençur me informata të ndryshme për komunën.

Materialet përkthehen në të gjitha gjuhët zyrtare, mirëpo nuk publikohen në ueb faqen e vjetër ndërsa në gjakovaportal.com të gjitha informatat janë në tri gjuhe: shqip, anglisht, dhe serbisht. Sipas komunës, mungesa e tri gjuhëve në ueb faqe primare ndodhë për shkak të problemeve teknike me ueb faqe, që ishte edhe arsyeja e krijimit të ueb faqes së re.

Qasja në dokumentet publike mundësohet plotësisht. Gjatë vitit 2015 është lejuar qasja në dokumente zyrtare 38 kërkesave dhe nuk ju është refuzuar qasja, as pjesërisht, asnjë kërkesë.

Me lansimin e portalit të ri në dhjetor 2015, www.gjakovaportal.com shumë nga shërbimet për qytetarë janë bërë të mundura. Në ueb faqen e vjetër kishte shumë pak të dhëna. Ndërsa tani ka informata nga më të ndryshmet, duke filluar nga shërbimet administrative (mundësia e nxjerrjes së certifikatave online), oraret e mbledhjes së mbeturinave, oraret e ngrohjes së qytetit, informata mbi emergjencat lokale, etj. Shumë nga këto informata janë të inkuadruara në hartën interaktive. Megjithatë përmirësimet e ueb faqes së re, mbeten edhe shumë informata që nuk janë, si kontrolli i ndotjes së ajrit, informata për barnat esenciale, mundësitë e aplikimit për pune online, etj. Shumë nga këto pritet që lansohen online së shpejti. Megjithatë, meqë ky raport merret vetëm me vitin 2015, përkundër përmirësimeve në fundvitin 2015, viti në tërësi ka qenë relativisht i dobët në këtë aspekt.



### Nota: 3.3 (Pozitive)

*Arsyetimi: Vlerësimi për Informimin dhe shërbimin e qytetarëve është kryesisht pozitiv. Qasja e komunës ndaj informimit dhe shërbimit të qytetarëve ka qenë kryesisht pozitive dhe janë arritur shumë përmirësime, sidomos me lansimin e portalit të ri. Gjithashtu komuna ka shfrytëzuar mjetet inovative, si rrjetet sociale, për përmirësim të transparencës.*

## 11. Bashkëpunimi me shoqërinë civile

*Organet komunale duhet të jenë të hapura dhe të angazhohen për qeverisje transparente duke thelluar bashkëpunimin me shoqërinë civile.*

Komuna e Gjakovës ka bashkëpunim me disa organizata të shoqërisë civile, mirëpo memorandumet nuk janë të publikuara.<sup>16</sup> Komuna gjithashtu ka përzgjedhur anëtarët e ri të Këshillit të Veprimit Rinor Lokal, dhe në këtë mënyrë kanë riaktivizuar këtë organ që i përmbledh organizatat rinore. Gjithashtu ekzistojnë disa komitete konsultative, mirëpo këto komitete janë pothuajse jo-funksionale dhe nuk janë të përbërë vetëm nga anëtarë të shoqërisë civile siç do të duhej të ishte. Përveç memorandumëve individuale me organizata të ndryshme të shoqërisë civile, nuk ka udhëzues për pjesëmarrje qytetare dhe për shfrytëzimin e kanaleve të ndryshme për të kuptuar më mirë dokumentet dhe informatat e publikuara nga komuna.

Komuna mban takime me qytetarë për të raportuar punën e ekzekutivit, për të marrë komente nga qytetarët sa i përket politikave komunale dhe projekteve. Sipas komunës, numri i takimeve ka qenë 12. Megjithatë, pjesëmarrja e qytetarëve në këto takime jo gjithmonë është e kënaqshme, edhe pse duket të jetë më mirë së ç'ka qenë në të kaluarën.<sup>17</sup> Raportimi i komunës dhe bashkëbisedimi me qytetarë bëhet zakonisht në mënyrë të shkruar, përmes fletushkave dhe raporteve, por nuk mungon as bashkëbisedimi. Ndërsa informata mbi këshillat lokale nuk janë të publikuara.

Komuna e Gjakovës ka aplikuar disa praktika për konsultimin e qytetarëve rreth dokumenteve me interes para se ato të aprovohen. Numri i konsultimeve publike ka qenë 25 gjatë vitit 2015. Ndër dokumentet që janë aprovuar pas konsultimit me qytetarë janë buxhetet. Propozimet e qytetarëve janë të dokumentuara në procesverbale edhe pse mekanizmi përcjellës mbetet i paqartë. Ndërsa kryetarja takohet me qytetarë çdo ditë, por jo në një orë të rregullt.




### Nota: 3.3 (Pozitive)

*Ansytimi: Në aspektin negativ, komuna ende nuk ka iniciuar ndonjë proces për themelimin, apo përmirësimin e mekanizmave konsultativ, që do të shponte bashkëpunimin me organizatat e shoqërisë civile. Përkundër kësaj, komuna ka disa memorandumë të mirëkuptimit me organizata individuale të shoqërisë civile. Komuna gjithashtu organizon takime me qytetarët ose përmes drejtorive ose përmes bashkësive territoriale. Ndërsa kryetarja nuk ka një termin të caktuar javor por takon qytetarët çdo ditë në orë të pacaktuara.*

<sup>16</sup> Ali Tafarshiku, Këshilltar i Kryetares, i ka ofruar monitoruesit të EC Ma Ndryshe një listë me emrat e 25 organizatave të shoqërisë civile, me të cilat Komuna e Gjakovës ka bashkëpunim, datë 9 mars 2016.

<sup>17</sup> Bazuar në disa raporte në të kaluarën, si "Praktikat e Buxhetimit në Gjashtë Komuna të Kosovës" nga Instituti GAP, dhe vlerësimet e përgjithshme nga intervistat për takimet gjatë vitit të fundit.





## V. Planifikimi dhe zhvillimi urban

### 12. Planifikimi urban

*Publiku duhet të ketë qasje në informata të rëndësishme që ndërlidhen me planifikimin urban, pasi kjo përbën një nga parimet themelore të qeverisjes së mirë.*

Publiku është relativisht i informuar sa i përket akteve normative dhe dokumenteve strategjike në fushën e planifikimit urban. Në ueb faqe mund të qasen planet rregulltave, plani zhvillimor urban, planet dhe programet mjedisore. Por mungojnë dokumente për procesin e marrjes së lejes së ndërtimit, dhe informata më të detajuara rreth mundësive, kufizimeve dhe autoriteteve përgjegjëse rreth urbanizimit.

Në ueb faqe komuna nuk ka momentalisht harta interaktive të pasur me informata mbi shërbimet, aktivitetet dhe resurset në territor, planet për mbrojtje të mjedisit dhe menaxhimin e resurseve natyrore, kualiteti i ujit në hapësira të caktuara, emitimi i gazrave, informata të sakta të destinimit të tokës, apo mjete tjera të avancuara. Komuna thotë që është duke punuar në GIS hartë e cila do të ketë të gjitha veçoritë e sipërpërmendura.<sup>18</sup>

Komuna e Gjakovës është relativisht jo transparente në lidhje me lejet e ndërtimit dhe shfrytëzimit të hapësirave. Çdo vit vendoset numri i lejeve të ndërtimit që do të lëshohen, por një numër i tillë nuk figuron në ueb faqe. Lejet e ndërtimit gjithashtu nuk janë të publikuara. Nuk janë të publikuara as procesverbalet e mbledhjeve të komisioneve që kanë aprovuar leje të ndërtimit. Të gjitha lejet e lëshuara të ndërtimit janë në përputhje me planet aktuale urbane të komunës.



#### Nota: 2 (Negative)

*Arsyetimi: Komuna e Gjakovës është relativisht jo transparente sa i përket planifikimit urban. Një pjesë e dokumenteve normative janë të publikuara në ueb faqe, edhe pse ka shumë dokumente me rëndësi që mungojnë. Hartat interaktive apo mjetet tjera të avancuara ende nuk janë publike. Ndërsa në lejet e ndërtimit dhe shfrytëzimit të hapësirave, komuna e Gjakovës është shumë pak transparente.*

<sup>18</sup> Armend Vokshi, drejtor i Administratës, në Fokus Grupin e mbajtur me datën 09.02.2016

## 13. Monitorimi i projekteve urbanistike

*Komuna duhet në vazhdimësi ta informojë publikun për rrjedhën e projekteve të cilat kanë ndikim në planifikimin dhe zhvillimin urban.*

Komuna e Gjakovës është relativisht efi­kase për të raportuar aktivitetet e saja për monitorimin e zbatimit të planit urbanistik. Rastet e ndërhyrjeve të inspektorëve, rezultatet, dhe efi­kasiteti publikohen në raporte vjetore. Në këto raporte prezantohet edhe të dhëna rreth punës së inspektoratit, të dhëna të cilat nxirren nga baza e të dhënave për punën dhe aktivitetin e inspektoratit. Megjithatë, cilësisht ka shumë hapësirë për të përmirësuar këto raporte, si për ka aspekti i të dhënave deri tek aspekti i organizimit të këtyre të dhënave. Ndërsa si mjete përmes të cilës përcillen rastet nga publiku janë telefoni pa pagesë, i cili është në shërbim 24 orë edhe faqja zyrtare në Facebook.

Publiku ka relativisht shumë informata rreth kompanive të kontraktuara nga komuna për të zhvilluar projekte urbanistike. Komuna ka zhvilluar një hartë interaktive ku shenjëzon saktë vendin ku janë duke ndodhur projektet urbanistike, bashkë me informatat rreth të kontraktuarit për punë. Ndërsa përmes projektit “Open Data” bëhen publike edhe informatat tjera mbi të kontraktuarin dhe mbi projektin.<sup>19</sup> Për më shumë projektet e mëdha mund të shihen në KAB dhe dokumentet tjera strategjike. Mirëpo, as harta interaktive as të dhënat tjera nuk tregojnë për shkelje, përveç nëse anulohet e gjithë kontrata. Si mekanizëm për monitorimin dhe përcjelljen e punëve që janë duke u zhvilluar është drejtoria për shërbime publike dhe inxhinieret komunal.



### Nota: 3 (Neutrale)

*Arsyetimi: Përmes publikimit të raporteve vjetore të inspektorateve, komuna e Gjakovës është relativisht efi­kase për të raportuar për aktivitetet e saja për monitorimin e planit urbanistik. Ndërsa përmes hartës interaktive edhe projektit “Open Data”, komuna mundëson që publiku të ketë mjaft shumë të dhëna rreth performancës së kompanive të kontraktuara nga komuna për zhvillimin e projekteve urbanistike. Megjithatë mos raportimi i shkeljeve e bën që transparenca të mos jetë e plotë.*

<sup>19</sup> Për më shumë rreth projektit “Open Data”, shih <http://opendatakosovo.org/>

## VI. Notimi

	Pesha	%	Notimi	%
<b>Organizimi, përbërja, kompetencat, dokumentacioni dhe funksionimi</b>				
1. Kryetari, Drejtorët dhe Anëtarët e Kuvendit	3	5.56%	2.5	3%
2. Organizimi dhe funksionimi	2	3.70%	4	3%
3. Puna e organeve politikë-bërëse dhe vendim-marrëse	4	7.41%	4	6%
4. Luftimi i sjelljeve të pahijshme dhe keqpërdorimeve	3	5.56%	4	4%
5. Integrimi Evropian	2	3.70%	3	2%

### Menaxhimi ekonomik dhe financiar

6. Kontabiliteti dhe buxheti	5	9.26%	3.6	7%
7. Kontratat e prokurimit publik, furnizimit dhe granteve	5	9.26%	3.5	6%

### Menaxhimi i resurseve njerëzore dhe resurseve tjera

8. Të punësuarit në administratën publike dhe organizatat/institucionet publike	5	9.26%	3.4	6%
9. Pasuria kapitale dhe jokatitale	5	9.26%	2	4%

### Marrëdhëniet me qytetarët dhe shoqërinë

10. Informimi dhe shërbimi i qytetarëve	5	9.26%	3.3	6%
11. Bashkëpunimi me shoqërinë civile	5	9.26%	3.3	6%

### Planifikimi dhe zhvillimi urban

12. Planifikimi urban	5	9.26%	2	4%
13. Monitorimi i projekteve urbanistike	5	9.26%	3	6%

54

100%

63%

	Pesha	%	Notimi	%
<b>1. Kryetari, Drejtorët dhe Anëtarët e Kuvendit</b>				
1. Cili është kualiteti i informatave që përmbajnë resimet?	5	20%	2	8%
2. Sa janë të plota deklaratat e pasurisë?	5	20%	2	8%
3. Sa janë të kuptueshme, të plota dhe të qasshme informatat mbi interesat personale?	5	20%	1	4%
4. Sa efikase janë kanalet e komunikimit që përdoren nga personat e zgjedhur dhe emëruar politikisht?	5	20%	4	16%
5. Sa janë të përditësuara dhe të plota informatat mbi aktivitetet e Kryetarit, Kuvendit, dhe personave tjerë të zgjedhur dhe të emëruar?	5	20%	4	16%

25

100%

13

52%

	Pesha	%	Notimi	%
<b>2. Organizimi dhe funksionimi</b>				
6. Sa janë të plota dhe të lehtësisht të kuptueshme informatat mbi organizmin dhe kompetencat komunale?	5	20%	4	16%
7. A kanë qytetarët informata të mjaftueshme mbi mënyrat më efikase për ndikim në politikëbërje dhe vendimmarrje?	5	20%	2	8%
8. Sa janë të dobishme kanalet e komunikimit?	5	20%	4	16%
9. Cili është kualiteti i informatave për planet në të ardhmen?	5	20%	5	20%
10. A ka të dhëna mbi komunën?	5	20%	5	20%

<b>25</b>	<b>100%</b>	<b>20</b>	<b>80%</b>
-----------	-------------	-----------	------------

	Pesha	%	Notimi	%
<b>3. Puna e organeve politikë-bërëse dhe vendim-marrëse</b>				
11. Sa inkurajohet publiku të jetë vëzhgues aktiv i debateve dhe proceseve vendimmarrëse?	5	33.33%	4	27%
12. A është raportimi i Ekzekutivit i rregullt dhe i plotë në Kuvend?	5	33.33%	5	33%
13. Sa kanë mundësi qytetarët të informohen për punën e komunës, politikat dhe aktet normative?	5	33.33%	3	20%

<b>15</b>	<b>100%</b>	<b>12</b>	<b>80%</b>
-----------	-------------	-----------	------------

	Pesha	%	Notimi	%
<b>4. Luftimi i sjelljeve të pahijshme dhe keqpërdorimeve</b>				
14. A ka komuna mekanizma për të hetuar dhe gjykuar sjelljet e pahijshme dhe keqpërdorimet tjera?	5	33.33%	5	33%
15. A është komuna transparente në aktivitetet e saj në luftën kundër mashtrimeve/keqpërdorimeve?	5	33.33%	3	20%
16. Cili është niveli i informimit të publikut për mekanizmat e raportimit të keqpërdorimeve të mundshme?	5	33.33%	4	27%

<b>15</b>	<b>100%</b>	<b>12</b>	<b>80%</b>
-----------	-------------	-----------	------------

	Pesha	%	Notimi	%
<b>5. Integrimi Evropian</b>				
17. A ka publiku informata të mjaftueshme për obligimet e komunës në procesin e integritit në BE?	5	50%	3	30%
18. A ka publiku informata të mjaftueshme mbi ndikimet e mundshme të procesit të integritit në BE?	5	50%	3	30%

<b>10</b>	<b>100%</b>	<b>6</b>	<b>60%</b>
-----------	-------------	----------	------------

	Pesha	%	Notimi	%
<b>6. Kontabiliteti dhe buxheti</b>				
19. A është publiku i informuar mirë rreth planifikimit buxhetor?	5	16.67%	3	10%
20. A publikohen të dhëna të mjaftueshme mbi ndarjet dhe realizimet buxhetore të komunës?	5	16.67%	4	13%
21. Sa është i informuar publiku për praktikën e mira dhe të metat e komunës në menaxhimin e financave publike?	5	16.67%	4	13%
22. A ka informata të mjaftueshme për të kuptuar burimet e të ardhurave të komunave?	5	16.67%	4	13%
23. Sa janë të informuar qytetarët për suficitin, deficitin dhe borxhin e komunës?	5	16.67%	3	10%
24. Sa transparente është funksionimi i organizatave të cilat ofrojnë shërbime për qytetarët ku komuna ka kompetenca (përfshi kompetenca të vogla)?	5	16.67%	4	13%

<b>30</b>	<b>100%</b>	<b>22</b>	<b>73.33%</b>
-----------	-------------	-----------	---------------

	Pesha	%	Notimi	%
<b>7. Kontratat e prokurimit publik, furnizimit dhe granteve</b>				
25. Sa është transparent procesi përzgjedhjes dhe lidhjes së marrëdhënies kontraktuale, më saktësisht procesi i vlerësimit të përshtatshmërisë për hyrje në marrëdhënie kontraktuale me palën e caktuar?	5	50%	3	30%
26. A ka transparencë në menaxhimin e projekteve dhe kontratave?	5	50%	4	40%

<b>10</b>	<b>100%</b>	<b>7</b>	<b>70%</b>
-----------	-------------	----------	------------

	Pesha	%	Notimi	%
<b>8. Të punësuarit në administratën publike dhe organizatat/institucionet publike</b>				
27. A është i qartë organizimi i administratës komunale dhe funksionet e personave kyc?	5	25%	4	20%
28. Sa janë të qarta strukturat organizative dhe informatat mbi funksionimin e organizatave/institucioneve të ndryshme komunale?	5	25%	2	10%
29. A zbatohen praktikën më të mira të rekrutimit/punësimit?	5	25%	3	15%
30. A ka informata publike rreth performancës së administratës në bazë të standardeve më të larta?	5	25%	4	20%

<b>20</b>	<b>100%</b>	<b>13</b>	<b>65%</b>
-----------	-------------	-----------	------------

	Pesha	%	Notimi	%
<b>9. Pasuria kapitale dhe jokapitale</b>				
31. A ka publikuar komuna listë të të gjitha patundshmërive?	5	25%	4	20%
32. A kemi informata dhe vendime të publikuara të cilat synojnë të arsyetojnë se përdorimi i tillë i tyre është në të mirë të sovranit?	5	25%	2	10%
33. A ka publikuar komuna listë të pasurive të ndryshme (inventar, automobila, piktura, pasuri tjetër me vlerë)?	5	25%	1	5%
34. A janë paraqitur aksionet dhe pronësia e komunës në kompani të ndryshme?	5	25%	1	5%
	<b>20</b>	<b>100%</b>	<b>8</b>	<b>40%</b>

	Pesha	%	Notimi	%
<b>10. Informimi dhe shërbimi i qytetarëve</b>				
35. Sa është efikase zyra për informim?	5	12.50%	4	10%
36. A ka Komuna plane apo strategji të veprimit për transparencën në komunë?	5	12.50%	3	8%
37. Sa është e dobishme ueb faqja e komunës?	5	12.50%	4	10%
38. A ofron komuna mundësi për të marrë mendimin e qytetarëve për përmirësim të transparencës?	5	12.50%	3	8%
39. Sa përdoren mjetet inovative për transparencë dhe komunikim me publikun?	5	12.50%	4	10%
40. A janë të dhënat të kuptueshme për qytetarët e komunës?	5	12.50%	2	5%
41. A mundësohet qasja në dokumente publike?	5	12.50%	4	10%
42. Cili është kualiteti i informatave rreth shërbimeve për qytetarët?	5	12.50%	2	5%
	<b>40</b>	<b>100%</b>	<b>26</b>	<b>65%</b>

	Pesha	%	Notimi	%
<b>11. Bashkëpunimi me shoqërinë civile</b>				
43. A janë krijuar forma të strukturuar të bashkëpunimit me shoqërinë civile?	5	33.33%	3	20%
44. A mbahen takime me publikun?	5	33.33%	3	20%
45. A konsultohen qytetarët rreth dokumenteve me interes para se ato të aprovohen?	5	33.33%	4	27%
	<b>15</b>	<b>100%</b>	<b>10</b>	<b>67%</b>

	Pesha	%	Notimi	%
<b>12. Planifikimi urban</b>				
46. Sa është publiku i informuar rreth akteve normative dhe dokumenteve strategjike në fushën e planifikimit urban?	5	33.33%	3	20%
47. A përdor komuna mjetet më të avancuara për t'iu mundësuar publikut të vëzhgojnë të gjithë elementet që ndërlidhen me planet urbane?	5	33.33%	1	7%
48. Sa është komuna transparente me lejet e ndërtimit dhe shfrytëzimit të hapësirave?	5	33.33%	2	13%
	<b>15</b>	<b>100%</b>	<b>6</b>	<b>40%</b>


	Pesha	%	Notimi	%
<b>13. Monitorimi i projekteve urbanistike</b>				
49. Sa është komuna efektive për të raportuar për aktivitetet e saja për monitorimin e zbatimit të planit urbanistik?	5	50%	3	30%
50. A ka publiku informata të mjaftueshme për performancën e kompanive të kontraktuara nga komuna për të zhvilluar projekte urbanistike?	5	50%	3	30%
	<b>10</b>	<b>100%</b>	<b>6</b>	<b>60%</b>






# Komuna e G

Autor: Bekim Kupina



# Gjilanit

I. Organizimi, përbërja, kompetencat, dokumentacioni dhe funksionimi _____	62
1. Kryetari, Drejtorët dhe Anëtarët e Kuvendit _____	62
2. Organizimi dhe funksionimi _____	63
3. Puna e organeve politike-bërëse dhe vendim-marrëse _____	65
4. Luftimi i sjelljeve të pahijshme dhe keqpërdorimeve _____	66
5. Integrimi Evropian _____	67
II. Menaxhimi ekonomik dhe financiar _____	68
6. Kontabiliteti dhe buxheti _____	68
7. Kontratat e prokurimit publik, furnizimit dhe granteve _____	70
III. Menaxhimi i resurseve njerëzore dhe resurseve tjera _____	71
8. Të punësuarit në administratën publike dhe organizatat/ institucionet publike _____	71
9. Pasuria kapitale dhe jokapitale _____	72
IV. Marrëdhëniet me qytetarët dhe shoqërinë _____	73
10. Informimi dhe shërbimi i qytetarëve _____	73
11. Bashkëpunimi me shoqërinë civile _____	75
V. Planifikimi dhe zhvillimi urban _____	76
12. Planifikimi urban _____	76
13. Monitorimi i projekteve urbanistike _____	76
VI. Notimi _____	78



## I. Organizimi, përbërja, kompetencat, dokumentacioni dhe funksionimi

### 1. Kryetari, Drejtorët dhe Anëtarët e Kuvendit

*Volumi dhe kualiteti i informatave të publikuara rreth të zgjedhurve dhe emëruarve politik (në Komunën e Prizrenit në këtë kategori hyjnë Kryetari, Drejtorët, dhe Anëtarët e Kuvendeve Komunale), duhet të jenë të mjaftueshme për të vlerësuar kredibilitetin e tyre, mbikëqyrur angazhimin e tyre në vazhdimësi, dhe për të kontaktuar në mënyrën më të përshtatshme me personat që mbajnë këto pozita.*

Autoritetet drejtuese të komunës së Gjilanit në uebfaqen zyrtare të komunës <http://kk.rks-gov.net/gjilan/Municipality/> gjatë vitit 2015 kanë zbatuar minimalisht transparencën në lidhje me biografinë jetësore dhe përgatitjen profesionale të kryetarit dhe ekipit të drejtorëve të tij. Kështu nga 10 drejtorë sa ka Komuna e Gjilanit, komuna pati bërë publike CV-të e vetëm 4 drejtorëve, kundrejt 6 të tjerëve për të cilët nuk ka pas informacione të hollësishme për përgatitjen profesionale apo biografinë jetësore. Zyrtarë nga Zyra për Informim e komunës janë arsyetuar me faktin se kërkesës së tyre drejtuar zyrtarëve komunalë që t'i dërgojnë CV-të e tyre për prezantim në uebfaqe, i janë përgjigjur minimalisht. Për këtë shkak, sipas tyre ka mungesë të disave në uebfaqe. Para publikimit të raportit janë publikuar rezymetë e shkurtra, por jo të uniformuara. Për dallim prej drejtorëve, një biografi përmbledhëse më e gjerë është afishuar për kryetarin e komunës, Lutfi Haziri.<sup>1</sup> Kurse informacione nuk ka pas as për nënkryetarin Rexhep Kadriu,<sup>2</sup> gjë që është plotësuar para publikimit të këtij raporti. Ndërkaq sa i përket përbërjes së Kuvendit Komunal nuk ka pas asnjë informatë, përpos detyrave që i takojnë atij. Nuk kanë qenë të publikuar as fotot e anëtarëve të KK-së e as ndonjë informacione tjetër relevant mbi ta. Para publikimit të raportit janë publikuar fotot dhe email adresat e këshilltarëve të KK-së.

Në uebfaqen e komunës nuk është publikuar asnjë informacion rreth pasurisë së deklaruar të kryetarit apo zyrtarëve të tjerë publik. Një informacion i tillë ndodhet vetëm në uebsajtin e Agjencisë Anti Korrupsion të Kosovës.<sup>3</sup> Kurse sa i përket pasurisë së kreut komunal të Gjilanit, pesha e pasurisë së tij të deklaruar është publikuar në Platformën e Lëvizjes FOL dhe ku mund të shihet edhe lëvizja e saj në relacion më vitet paraprake.<sup>4</sup>

1 Uebfaqja e komunës së Gjilanit, Kryetari i komunës, <http://kk.rks-gov.net/gjilan/Municipality/President/President-profile.aspx>

2 Uebfaqja e komunës së Gjilanit, Kabineti i kryetarit të komunës, <http://kk.rks-gov.net/gjilan/Municipality/Kabineti/Major%60s-profile.aspx>

3 Agjencia Kundër Korrupsionit, Regjistër për deklarimin e pasurisë, [http://www.akk-ks.org/declaration/2015/Komunat/Komuna\\_e\\_Gjilanit/Nazim\\_Gagica.pdf](http://www.akk-ks.org/declaration/2015/Komunat/Komuna_e_Gjilanit/Nazim_Gagica.pdf)

4 Lëvizja FOL, Krahësimi i pasurisë, Lutfi Haziri, <http://deklarimi.levizjafol.org/Zyrtaret/Pasuria/1478/Lutfi-Haziri>

Nuk ka asgjë publike në lidhje me të ardhurat si dhe kompensimet shtesë nga puna në Komunë apo ato nga angazhimet në vende tjera të punës. E njëjta qasje është përdorur edhe kur është puna të deklarata për konfliktin e interesit apo ndonjë konflikt të ndonjë natyre tjetër.

Numrat e telefonisë fikse të kryetarit, drejtorive dhe disa zyra të tjera komunale janë vendosur në rubrikën ‘kontakti’ në ueb faqe. Por kanalet e komunikimit që përdoren nga personat e zgjedhur dhe emëruar politikisht nuk kanë qenë edhe aq efikase. Bazuar në një hulumtim të organizatës KCIC të vitit 2015, mbi 75.7 për qind të qytetarëve të anketuar kanë theksuar se nuk kanë pas ndonjë mundësi që problemet aktuale t’i paraqesin para kryetarit apo drejtorëve të Ekzekutivit, përkundër 24.3 për qind të tyre që e kanë pas një mundësi të tillë.<sup>5</sup> Megjithatë zyrarët komunal pohojnë se takimet individuale me palët organizohen në baza ditore.<sup>6</sup>

Lajmërimet për mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe KPF-së kryesisht publikohen në ueb faqen e Komunës. Lajmërimet, jo gjithmonë janë publikuar nëpër hapësira ku frekuentojnë qytetarët, si në zonat urbane ashtu edhe ato rurale. Nga gjetjet, njoftimet, publikohen kryesisht në objektin e Shërbimeve për Qytetarë dhe Zyrës së Kryetarit.<sup>7</sup> Informatat janë të plota mbi kalendarin e aktiviteteve të realizuara nga kryetari, por e njëjta nuk mund të thuhet edhe për paralajmërimin e agjendës së tij.



### Nota: 2.2 (Negative)

*Arsyetimi: Informacionet, të cilat i ka vënë në dispozicion të publikut, Komuna e Gjilanit janë minimale karshi nevojave të taksapaguesve. Mungojnë të dhënat për konfliktin e interesit. Kanalet e komunikimit që përdoren nga personat e zgjedhur dhe emëruar politikisht nuk kanë qenë edhe aq efikase.*

## 2. Organizimi dhe funksionimi

*Publiku duhet të ketë informata të mjaftueshme për të kuptuar organizimin, kompetencat, funksionimin, procesin e vendimmarrjes dhe të politikëbërjes të trupave të ndryshme komunale.*

Struktura organizative e komunës së Gjilanit është e publikuar në një organogram në uebfaqe, porse i njëjti nuk ka qenë i vendosur në hapësirat e objektit të administratës komunale. Kompetencat e kryetarit të komunës dhe drejtorive janë të përshkruara, porse nuk ka një përshkrim të tillë edhe për trupat e ndryshëm komunal, organet e decentralizuara apo institucionet komunale mbi të cilat komuna ka kompetencë. Ka munguar përshkrimi i detyrave për pozitat kyçe,

<sup>5</sup> “Përfshirja e publikut në vendimmarrje në Komunën e Gjilanit”, raport monitorimi, KCIC, dhjetor 2015, [http://behupjese.org/docs/Perfshirja\\_e\\_publikut\\_ne\\_vendimmarrje\\_ne\\_Komunen\\_e\\_Gjilanit\\_-\\_KCIC\\_dhjetor\\_2015.pdf](http://behupjese.org/docs/Perfshirja_e_publikut_ne_vendimmarrje_ne_Komunen_e_Gjilanit_-_KCIC_dhjetor_2015.pdf)

<sup>6</sup> Muhamet Pajaziti, zyrtar për informim, Fokus Grup, Gjilan, 5 shkurt 2016

<sup>7</sup> Po aty

sikurse edhe informatat mbi personat që i mbajnë këto pozita. Para publikimit të raportit janë bërë përmirësime në këtë drejtim. Por ka ende defekte, sikurse shembulli kur për departamentin e prokurimit është publikuar rezymeja e drejtuesit, porse asnjë informacion tjetër relevant për këtë sferë.<sup>8</sup> Informatat e paraqitura nuk janë lehtë të kuptueshme për qytetarët.

Pavarësisht se Kuvendi Komunal është institucion që kujdeset për përmirësimin e jetës së qytetarëve, në uebfaqe nuk ka të publikuar informata të shtjelluara qartë mbi procesin e ligjbërjes, politikëbërjes, vendimmarrjes si dhe mënyrës së ndikimit në këto procese. Këto të dhëna mund të gjenden vetëm brenda statutit të Komunës. Nuk ka të dhëna shpjeguese as për mënyrën e marrjes së vendimeve nga Ekzekutivi.

Kontaktet e personave kryesor në komunë janë publikuar në mënyrë të pjesërishme. Të dhëna të plota ka vetëm shefi i kabinetit të kryetarit të komunës. Porse nuk ka të dhëna të kësaj natyre për njësi dhe zyra të tjera me rëndësi në komunë. Kësisoj, është publikuar vetëm numri i telefonit dhe personi përgjegjës për pesë njësi dhe pesë zyra në kuadër të komunës. Mungon përshkrimi i pozitave të tjera.

Komuna e Gjilanit nuk ka bërë publike në uebfaqe apo forma të tjera ndonjë strategji të saj dhe kohën e realizimit. Megjithatë ka të publikuara, Projektpropozimin e buxhetit 2016-2018, Kornizën Afatmesme, Planin e punës së Kuvendit dhe dokumente të tilla të ngjashme.<sup>9</sup> Komuna ka bërë publike Projekt-rregulloren mbi organizimin e organeve komunale të administratës. Kurse draft rregullorja për plotësimin dhe harmonizimin e rregullores për taksa ngarkesa dhe gjopa komunale nuk është e publikuar, derisa ka qenë në proces të miratimit.

Të dhënat e përgjithshme për komunën, numrin e banorëve, strukturën gjinore dhe atë etnike janë publikuar në uebfaqe, teksa mungojnë ato për shkallën e natalitetit dhe mortalitetit në këtë komunë. Në kuadër të këtij prezantimi, gjithashtu ka mungesë të informacioneve për gjendjen infrastrukturore në komunë. Në çfarë mase është shtrirë rrjeti i ujësjellësit dhe kanalizimit dhe asfaltimi i rrugëve. Gjithashtu ka pas mungesë të informacioneve për gjendjen ekonomike në komunë, trashëgiminë kulturore apo informacione të tjera natyrës gjithëpërfshirëse.



## Nota: 2.5 (Neutrale)

*Arsyetimi: Informacionet aktuale që i ofron komuna e Gjilanit i mundësojnë publikut një qasje solide në informacionet themelore për interesimin e tyre. Megjithatë, kjo nuk përbën bazë të mjaftueshme për informim cilësor, ngase ka përshkallëzim të informacioneve varësisht nga sektorët, ndaj nuk ka një përfaqësim të barasvlershëm të informacioneve për sektorët, personat, apo përshkrimin e detyrave.*

<sup>8</sup> Ueb faqja e komunës së Gjilanit, Departamenti i Prokurimit, <http://kk.rks-gov.net/gjilan/Zyret/Departamenti-i-Prokurimit.aspx>

<sup>9</sup> Ueb faqja e komunës së Gjilanit, Buxheti, <http://kk.rks-gov.net/gjilan/Projects/Budget.aspx>



### 3. Puna e organeve politikë-bërëse dhe vendim-marrëse

*Publiku duhet të ketë informata të detajuara, përditësuara, dhe të mjaftueshme për të vlerësuar problematikat kryesore të debatuar dhe vendimet kryesore të marra nga organet politikë-bërëse dhe vendim-marrëse të Komunës.*

Praktikat e zbatuara nga pushteti lokal i Gjilanit në vitin 2015 për inkurajimin e publikut që të jetë vëzhgues aktiv i debateve dhe proceseve vendimmarrëse nuk kanë qenë pozitive. Lajmërimet sipas monitoruesve për mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe KPF-së kryesisht publikohen në ueb faqen e Komunës. Lajmërimet, jo gjithmonë janë publikuar nëpër hapësira ku frekuentojnë qytetarët, si në zonat urbane ashtu edhe ato rurale. Kjo çështje është adresuar nëpërmjet afishimit të informacioneve në rrjetin social “Facebook”.<sup>10</sup> KK-ja ka hartuar Planin e Punës për vitin 2015, por kalendari i datave të seancave të Kuvendit, nuk është publikuar. Njëjtë është edhe për Komitetin për Politikë dhe Financa.<sup>11</sup> Ka raste kur madje as anëtarët e KK-së nuk i kanë marrë të gjitha materialet për pikat e rendit të ditës që janë diskutuar gjatë seancës.<sup>12</sup> Por në përgjithësi ato përcillen te mediat dhe monitoruesit përmes formës elektronike. Janë tri organizata që e kanë monitoruar punën e KK-së: OSBE-ja, KCIC dhe Forumi Demokratik “Anamorava”. Seancat e Kuvendit Komunal, transmetohen në mediat lokale. Seancat e Komunës janë transmetuar drejtpërdrejt në dy radio stacione lokale, në Radio Star dhe Radio Victoria. Gjithashtu, janë transmetuar si përmbledhje, 2 orë, përmes televizionit lokal, TV Vali.<sup>13</sup> Gjatë vitit KK-ja ka ndryshuar vendin e mbajtjes së mbledhjeve, me ç’rast ka kushte minimale për pjesëmarrjen e publikut.

Raporti i Ekzekutivit në Kuvend përmbush vetëm kriteret ligjore. Kreu i Komunës, sipas zyrtarit për informim, raportimin në Kuvend e bën sipas përcaktimit ligjor, por jo nëse një gjë të tillë e kërkojnë këshilltarët në ndonjë rast tjetër. Megjithatë, nuk ka një transparencë në lidhje me raportimin e kryetarit në Kuvend, ngase nuk ka ndonjë të dhënë të bërë publike se sa herë gjatë vitit 2015 ai është paraqitur para kuvendarëve. Nga ana tjetër, kryetari i komunës ka krijuar një blog në emër të vetin, në të cilin prezantohen aktivitetet e tij dhe komunës që drejton.<sup>14</sup> Zyrtarët komunal kanë vlerësuar se blogu i kryetarit është një element pozitiv për transparencë.<sup>15</sup> Aty është publikuar biografia e kryetarit, ndërkohë që në një vegëz, është lënë e hapur mundësia që të kontaktohet kryetari i komunës në formë të shkruar apo nëpërmjet një numri telefoni, të afishuar në këtë faqe. Aty mungon programi qeverisës i kryetarit, përshkrimi i detyrave, projektet e realizuara ose ato në pritje, buxheti i komunës apo informacione të tjera të kësaj natyre me interes për qytetarin. Ai nuk ka raportuar në Kuvend apo për publikun as për vizitat e tij jashtë vendit, ndaj disa sosh janë kontestuar nga opozita, e cila

<sup>10</sup> Faqja zyrtare e komunës së Gjilanit në Facebook, <https://www.facebook.com/Komuna-e-Gjilanit-Faqja-Zyrtare-1410141205896819/>

<sup>11</sup> “Përfshirja e publikut në vendimmarrje në Komunën e Gjilanit”, raport monitorimi, KCIC, dhjetor 2015, [http://behupjese.org/docs/Perfshirja\\_e\\_publikut\\_ne\\_vendimmarrje\\_ne\\_Komunen\\_e\\_Gjilanit\\_-\\_KCIC\\_dhjetor\\_2015.pdf](http://behupjese.org/docs/Perfshirja_e_publikut_ne_vendimmarrje_ne_Komunen_e_Gjilanit_-_KCIC_dhjetor_2015.pdf)

<sup>12</sup> Po aty

<sup>13</sup> Po aty

<sup>14</sup> Ueb faqja personale e Lutfi Hazirit, <http://lutfihaziri.com/>

<sup>15</sup> Muhamet Pajaziti, zyrtar për informim, Fokus Grup, Gjilan, 5 shkurt 2016

ka kërkuar transparencë dhe llogaridhënie.<sup>16</sup>

Statuti, rregullorja e punës së Kuvendit dhe rregullore të tjera janë të publikuara. KK-ja e Gjilanit i publikon procesverbalet. Por problemi është tek koha e përditësimit të tyre.<sup>17</sup> Procesverbal i Komisionit për plotësimin e emërtimeve dhe adresa, është publikuar, por jo edhe i organeve tjera të KK-së. Vendimet e Kuvendit janë publikuara, porse pa arsyetime përkatëse, teksa disa vendime të kreut të komunës figurojnë si vegëza, por nuk janë të qasshme. Draftet-aktet normative janë të qasshme. Si p.sh. Projekt-rregullorja mbi organizimin e organeve komunale të administratës është publikuar, por qytetarët kanë pas mundësi që për të qëndrimet e tyre t'i shfaqin vetëm në takime publike. Në këtë kontekst, komuna nuk ka mekanizëm për pranim të sugjerimeve apo mendimeve për aktet e caktuara. Propozimet legjislative dhe iniciativat e rëndësishme legjislative që janë në proces në Kuvend nuk janë publikuar. Njësoj ka ndodhur edhe me projektet e propozuara nga anëtarët e Kuvendit dhe Ekzekutivit. Informata nuk ka as për arsyetimet ligjore për vendimet e marra, bazën e të dhënave me rregullore të shqyrtuara, të aprovuara dhe votimin. Votimi mund të gjendet vetëm në procesverbale. Megjithëse seancat e KK-së, transmetohen direkt dhe incizohen, janë publikuar vetëm dy të tilla, ajo e janarit dhe e marsit të vitit 2015.



### Nota: 2.5 (Neutrale)

*Arsyetimi: Publikut i është ofruar një sasi e informacioneve, të cilat nuk e përmbushin nevojën për një informim cilësor, përmbajtësor e në kohë reale. Ka shkëputje në pasimin e informatave të nevojshme për publikun. Rrjedhimisht, mbetet më shumë angazhim që kjo shkallë e transparencës të rritet në funksion të interesit qytetar.*

## 4. Luftimi i sjelljeve të pahijshme dhe keqpërdorimeve

*Komuna duhet të publikojë informata të rëndësishme nga të cilat lehtësisht mund të vlerësohet niveli i përkushtimit të saj në luftimin e sjelljeve të pahijshme dhe keqpërdorimeve.*

Sa i përket sjelljeve të pahijshme dhe çfarë nënkupton ajo, nuk ka ndonjë sanksion të paraparë me Statutin e komunës. I vetmi veprim për të cilin ekziston korniza ligjore është konflikti i interesit. Ai është i përkufizuar nëpërmjet tri neneve: 55, 83 dhe 87 të Statutit të Komunës dhe i referohet këtu kryetarit të komunës, drejtorëve dhe këshilltarëve komunalë.<sup>18</sup> Përkufizimet në këto nene i referohen, gjithashtu është Ligjit për Vetëqeverisje lokale. Kodi i Etikës nuk ka qenë i publikuar, sikundër që nuk ka pas informacione në lidhje me mekanizmat funksional për ndjekje dhe gjykim të rasteve. Plani strategjik lokal për trajtimin dhe parandalimin e korrupsionit, nga Komuna e Gjilanit është publikuar tek në ditët e fundit të 2015-s, por

<sup>16</sup> KOHA Net, Opozita e akuzon kryetarin Haziri për mashtrim, <http://koha.net/?id=9&l=91266>

<sup>17</sup> Nevzat Isufi, anëtar i Kuvendit nga Lëvizja Vetëvendosje, Fokus Grup, Gjilan, 5 shkurt 2016

<sup>18</sup> Ueb faqja e komunës së Gjilanit, Statuti, <http://kk.rks-gov.net/gjilan/Municipality/Statuti.aspx>



që mund të shërbej si stimulim për veprime në vitin 2016.

Në këtë kontekst nuk dihet as për numrin e personave të angazhuar për të hetuar rastet. Rrjedhimisht nuk ka as numër të rasteve të hetuara. Por, zyrtarët kanë thënë se në Rregulloren e Punës së Kuvendit, ekziston përkufizimi çfarë është sjellje e pahijshme.<sup>19</sup> Gjithashtu është bërë e ditur se ekziston një kod etik i Ministrisë së Administratës Publike, i cili i jepet çdo të punësuarit në Kuvendin Komunal.<sup>20</sup> Mungojnë informacionet edhe për vendimet e ndërmarra, mekanizmin përcjellës dhe dyshimet e ngritura. Për më tepër, në komunë ekziston një kuti për ankesa, porse në lidhje me të nuk ekziston asnjë e dhënë e publikuar.

Pra niveli i informimit të publikut për mekanizmat e raportimit të keqpërdorimeve të mundshme dhe për të shpjeguar se çfarë përbën keqpërdorim nuk është i mjaftueshëm. Mirëpo në ueb faqen e komunës është integruar vegëza e platformës 'Kallxo' për denoncimin e rasteve të shkeljeve.



### Nota: 2 (Negative)

*Arsyetimi: Duke u nisur nga faktet e mësipërme, del se komuna e Gjilanit sferën e keqpërdorimit dhe sjelljeve të pahijshme e ka lënë mjaft të panjohur për publikun. Kjo dëshmohet me mungesën e çfarëdo informacioni publik në uebfaqen e komunës, si adresë të parë të kontaktit të qytetarëve me këtë institucion. Në këtë kontekst nuk ka asnjë të dhënë nëse kjo komunë ka bërë diçka në drejtim të luftimit të keqpërdorimeve dhe sjelljeve të pahijshme.*

## 5. Integrimi Evropian

*Publikut duhet t'i ofrohet mundësia që të mësoj në mënyrë të saktë dhe të detajuar obligimet, arritjet dhe sfidat që i ka komuna në procesin e integrimit të Kosovës në BE.*

Zyra për Integrim Evropian që vepron në kuadër të komunës, kryen raportimet e rregullta për përmbushje të agjendës evropiane dhe aktivitetet e ndërmarra në zbatimin e obligimeve. Ky lloj i raportimit bëhet në MAPL, institucion ky që ka mandat të bashkërendimit të aktiviteteve nëpër komuna.<sup>21</sup> Por ky raportim nuk është i qasshëm për publikun e Gjilanit. Praktikisht, nuk ka asnjë të dhënë sa i përket obligimeve që burojnë nga integrimi evropian, e gjithashtu as status të përmbushjes së obligimeve dhe afatet kohore për arritje të qëllimeve të caktuara. Kjo komunë ka Zyrën për Integrim Evropian, porse në uebfaqe përveç emrit

<sup>19</sup> Sadri Arifi, përgjegjës në Njësinë e Kuvendit, Fokus Grup, Gjilan, 5 shkurt 2016

<sup>20</sup> Sadri Arifi, përgjegjës në Njësinë e Kuvendit, Fokus Grup, Gjilan, 5 shkurt 2016

<sup>21</sup> Departamenti për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave, MAPL. <https://mapl.rks-gov.net/Main-menu/Departamentet/Departamenti-per-Integrim-Evropiane.aspx>

të zyrarit që e drejton atë, nuk ekziston asnjë e dhënë tjetër.<sup>22</sup>

Prandaj, mungojnë tërësisht informatat mbi çështje të caktuara që lidhen me integrimin në BE, riatdhësimin, të drejtat e njeriut, apo barazinë gjinore. Nuk ka informacione as për ndikimin e procesit në ekonomi, çështje sociale apo administratë publike.




### Nota: 1 (Negative)

*Arsyetimi: Komuna e Gjilanit nuk ka ofruar informacion minimal për obligimet e komunës në relacion me integrimet evropiane. E tëra që ka bërë komuna është themelimi i Zyrës për Integrimet, në vegzën e së cilës nuk ka asnjë informacion për aktivitetet ose zhvillime të tjera në këtë sferë.*

### Komentet e Komunës:

*Zyrtarët komunalë theksojnë se është funksionalizuar regjistri online i procedurave administrative. Sipas tyre, Komuna e Gjilanit është e para në nivel vendi që e ka bërë këtë, <https://rpa.rks-gov.net/>, ku merren të gjitha të dhënat kudo nëpër sektorë, nëpër të gjitha drejtoritë. Informatat këtu lidhen direkt edhe me sektorin e integrimi ekonomike. Gjithashtu në këtë faqe ekziston edhe Zyra për integrimet ekonomike të BE-së, e cila paraqet detyrimet dhe obligimet e institucioneve për të prurë në ekuilibër me vendet e BE-së, të atyre vendeve që ia mësojnë BE-së.<sup>23</sup>*



## II. Menaxhimi ekonomik dhe financiar

### 6. Kontabiliteti dhe buxheti

*Të dhënat dhe raportet e ndryshme dhe të përditësuara rreth të hyrave financiare, alokimeve buxhetore, shpenzimeve financiare, borxheve dhe kontesteve me pasojë financiare për komunën, duhet të jenë në dispozicion të publikut për të pasë pasqyrë të qartë mbi menaxhimin e parasë publike në nivel lokal.*

Gjatë vitit 2015, komuna e Gjilanit ka mbajtur 5 takime për buxhet, prej tyre 4 në

<sup>22</sup> Ueb faqja e komunës së Gjilanit, Zyra për Integrimet Evropiane, <http://kk.rks-gov.net/gjilan/Municipality/Zyret/Zyra-per-Integrimet-Evropiane.aspx>

<sup>23</sup> Nazim Gagica, drejtor i Administratës, Fokus Grup, Gjilan, 5 shkurt 2016

fshatra dhe 1 në qytet.<sup>24</sup> Debatet publike këtë vit Komuna i ka organizuar, gjatë ditëve të fundjavës. Është mbajtur edhe një për kornizën afatmesme buxhetore edhe një tjetër me këshillat e fshatrave. Njoftimi është bërë përmes posterëve dhe medimeve lokale në Gjilan. Por, në vegëzat që ndodhen në uebfaqe nuk ka asnjë të dhënë për temat të cilat janë diskutuara në takimet me qytetarë,<sup>25</sup> pos procesverbalit nga tubimi publik i kryetarit të Komunës me qytetarët, të mbajtur me 30 dhjetor 2015, e të publikuar më 29 janar 2016. Prandaj nuk dihet nëse rekomandimet që kanë dalë nga këto debate janë përfillur nga autoritetet komunale dhe në cilën masë. Propozim buxheti për vitin 2016-2018 është publikuar, ndërkohë që buxhetin për vitin 2015 e ka publikuar Instituti GAP. Në të janë prezantuar edhe linjat buxhetore dhe shuma e buxhetit që shpenzohet për secilën kategori veç e veç.<sup>26</sup> Monitorues nga shoqëria civile kanë pohuar se nëpër debate dhe takime me publikun nuk është prezantuar përmbajtja e detajuar e draft-buxhetit për vitin 2016, përpos që është treguar për prioritetet dhe projekte që do të realizohen në vitin vijues. Sipas tyre përkundër kërkesave për të pasur në dispozicion draftin e buxhetit të Komunës për vitin 2016, kjo gjë nuk ka ndodhur.<sup>27</sup> Nga ana tjetër, nuk dihet se cilat propozime i kanë dhënë këshilltarët komunal të Gjilanit dhe për cilat çështje. Në këtë kontekst nuk ka një informacion as për marrëveshjet e nënshkruara dhe koston financiare të realizimit të tyre. Komuna e Gjilanit nuk ka mekanizëm për regjistrim të propozimeve të qytetarëve gjatë takimeve me ta. Gjithashtu nuk ka ndonjë të dhënë nëse propozimet e qytetarëve janë aprovuar nga ana e komunës, apo janë hedhur poshtë. Drejtori për Buxhet dhe Financa ka pohuar se janë evidentuar kërkesat e qytetarëve, por të njëjtat si tërësi nuk kanë mund të publikohen.<sup>28</sup>

Gjilani ka publikuar të dhëna mbi ndarjet dhe realizimet buxhetore të komunës, në formë të raporteve periodike por edhe vjetore, me të dhëna mbi projektet, qëllimet, shumën e financimit, dhe burimin e financimit. Por nuk ka tabela interaktive të buxhetit shumëvjeçar. Lista me projekte është pjesë e planeve buxhetore.

Në vitin 2015, Komuna e Gjilanit ka ngecur në informimin e publikut për praktikën e mira dhe të metat e komunës në menaxhimin e financave publike, ngase nuk ka publikuar raportin e Auditorit të Përgjithshëm, siç ka bërë në vitet paraprake.

Informatat mbi burimet e të ardhurave të komunës janë paraqitur në planifikimin buxhetor dhe raportet financiare.

Ndërkohë të dhënat mbi suficitin, deficitin, borxhin e komunës dhe detyrimet kontingjente, si dhe shuma e paguar apo përfitur për rastet e humbura apo fituara në gjykata pasqyrohen vetëm një herë në vit para publikut, në kuadër të raportit vjetor financiar.

24 Ueb faqja e komunës së Gjilanit, Lajmet, <http://kk.rks-gov.net/gjilan/News/Gjilani-mban-takimin-publik-me-qytetaret,-i-10-ti.aspx>

25 Ueb faqja e komunës së Gjilanit, Takimet publike me qytetarët, <http://kk.rks-gov.net/gjilan/Takimet-Publike-me-Qytetare/Procesverbalet.aspx>

26 Instituti GAP, Si i shpenzon shteti paratë tona, Komuna e Gjilanit, <http://www.institutigap.org/spendings/?gjilan/2014/embed#/~gjilan>

27 "Përfshirja e publikut në vendimmarrje në Komunën e Gjilanit", raport monitorimi, KCIC, dhjetor 2015, [http://behupjese.org/docs/Perfshirja\\_e\\_publikut\\_ne\\_vendimmarrje\\_ne\\_Komunen\\_e\\_Gjilanit\\_-\\_KCIC\\_dhjetor\\_2015.pdf](http://behupjese.org/docs/Perfshirja_e_publikut_ne_vendimmarrje_ne_Komunen_e_Gjilanit_-_KCIC_dhjetor_2015.pdf)

28 Zijadin Maliqi, drejtor për Buxhet dhe Financa, Fokus Grup, Gjilan, 5 shkurt 2016

Publikimi i tabelave buxhetore, apo borxheve të kompanive dhe organizatave ku komuna ka pronësi dhe kompetenca, apo raporteve të auditorit për to, nuk është bërë gjatë vitit.



### Nota: 2.5 (Neutrale)

*Arsyetimi: Komuna e Gjilanit ka publikuar informata mesatare sa i përket indikatorit të kontabilitetit dhe buxhetit. Të dhënat e publikuara janë të përgjithshme, por nuk ofrojnë një pasqyrë të hollësishme as për tepricën apo mungesën e mjeteve buxhetore.*

## 7. Kontratat e prokurimit publik, furnizimit dhe granteve

*Marrëdhëniet kontraktuale me implikime financiare në mes të komunës dhe personave fizik dhe juridik duhet të zhvillohen në transparencë të plotë, për të siguruar menaxhimin e mirë të parasë publike dhe vlerën e duhur për shërbimet, punët apo furnizimet.*

Duke qenë një prej pikave qendrore për mirëqeverisje dhe transparencë karshi publikut, komuna e Gjilanit nuk ka arritur ta zbatojë në praktikë që publikun ta njoftoj për kontratat e prokurimit, komisionet vlerësuese, por edhe përzgjedhjen e operatorëve në tenderët e saj. Komuna e Gjilanit nuk është treguar transparente sa i përket shpalosjes së informatave të vlerësimit të përshtatshmërisë së operatorëve për hyrje në marrëdhënie kontraktuale me ta. Nuk ka informata të publikuara lidhur me mënyrën e përzgjedhjes dhe përbërjes së komisioneve vlerësuese, ani pse zyrtarët komunal pohojnë se këto komisione përbëhen nga zyrtarë të prokurimit, profesionistët dhe zyrtarë të caktuar të drejtorive përkatëse. Njoftimet për kontrata nga Departamenti i Prokurimit publikohen në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP), e pjesërisht edhe në ueb faqen e Komunës. Për shembull nga 71 aktivitete të prokurimit në periudhën 1 janar - 21 shtator 2015, në uebfaqen e komunës janë publikuar vetëm 29 njoftime për dhënie të tenderit. Përgjatë gjithë vitit 2015, sipas zyrtarëve të prokurimit, janë zhvilluar 124 aktivitete. Me procedurë të hapur 77 aktivitete, konkurs për projekte - 3, ftesa për kuotim - 29, vlera minimale - 13 dhe 2 ankande publike. Ka pasur edhe një partneritet publiko privat dhe një me procedurë të negociuar. Nuk ka arsytetime për vendosjen e kritereve. Procesverbalet e komisioneve vlerësuese ekzistojnë, por nuk publikohen. Sa i përket komisioneve të vlerësimeve, sipas drejtuesit të Departamentit të Prokurimit ato nuk guxojnë me qenë publike, sepse me ligj është e precizuar.<sup>29</sup> Udhëzues për proceset e konkurrimit, parime dhe kod të mirësjelljes për procese kontraktuese nuk ka, por zbatohen dispozitat e LPP-së. Nuk ka raportime rreth përgjegjshmërisë së kompanive të kontraktuara, apo transparencë për dhënien e punëve plotësuese (aneks kontratat), apo raporte të publikuara mbi mësimet e nxjerra nga kontratat në të kaluarën.


Nuk ka raporte mbi performancën e kontraktorëve bazuar në indikatorët e paracaktuar në kontratë. Baza e të dhënave për kontratat e nënshkruara ekziston në komunë, por kontratat në përgjithësi nuk bëhen publike. Shumat e tyre, si dhe

procedura e përdorur, e numri i konkurrentëve kryesisht figurojnë në njoftimet për dhënien e kontratës që publikohet në KRPP, dhe pjesërisht në ueb faqen e Komunës. Në këto njoftime figurojnë dhe të dhënat bazike për fituesin e tenderit. Statistikat ekzistojnë për aktivitetet e prokurimit, të ndara në shumë të mëdha, të mesme dhe me kuotim, si dhe për ato me Partneritet-publiko-privat, por nuk publikohen. Nuk ka raporte mbi përmbushjen e parametrevë të paraparë në kontratë. Transparenca mbi përmbylljen e suksesshme të projekteve është e kufizuar vetëm në lajmet mbi përrurimin e projekteve të caktuara. Raportet e mbikëqyrjes së punimeve gjatë realizimit të projekteve, ndonëse përpilohen nuk publikohen.



### Nota: 2 (Negative)

*Arsyetimi: Duke marrë parasysh faktet e mësipërme del se komuna e Gjilanit në asnjë rrethanë nuk ka shfaqur gatishmëri që taksapaguesit e saj t'i mbajë të informuar për rrjedhat dhe zhvillimet në lidhje me tenderët, me të cilët synohet përmirësimi i jetës së qytetarëve.*



## III. Menaxhimi i resurseve njerëzore dhe resurseve tjera

### 8. Të punësuarit në administratën publike dhe organizatat/institucionet publike

*Menaxhimi i resurseve njerëzore duhet të bëhet në mënyrë transparente duke përfutuar nga mbikëqyrja e vazhdueshme e publikut mbi performancën e administratës.*

Organizimi i administratës komunale është i qartë, por jo edhe funksionet e të gjithë personave kyç në të. Struktura organizative e komunës së Gjilan ka qenë e vendosur ambientet e ndërtesës së administratës komunale. Më vonë është publikuar edhe në ueb faqe. Detajet me përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të pozitive kryesore janë të rralla, duke veçuar këtu drejtorët. Mungojnë raportet/analizat e sektorit të administratës publike, si dhe lista e të gjithë personave të administratës. Ka informata kontaktuese të departamenteve apo organeve komunale. Nuk ka të dhëna të publikuara rreth pagave për pozita, pos koeficientit që publikohet në konkurse.

Informatat mbi funksionimin e organizatave/institucioneve të ndryshme komunale nuk janë të publikuara e as përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të pozitive kryesore, lista e të gjithë personave të punësuar, e as s'ka sqarime për kompetencat.

Sipas zyrtarëve komunal të gjitha konkurset që janë të organizuar në Komunë,

dukë përfshirë edhe konkurset për anëtarë të bordeve nëpër ndërmarrjet publike publikohen në ueb-faqe të Komunës, por edhe në media, në gazeta, po ashtu në portale lokale dhe në tri radiot lokale që kanë kontratë me Komunën. Por nuk ka transparencë sa i përket publikimit të vlerësimit për kriteret e paracaktuara. Vendimet e mekanizmave nuk publikohen, ngase ankesat shkojnë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës. Kurse njoftimet për vende të lira dhe punësim në pozita publike, publikohen në uebfaqe dhe atë posaçërisht për vendet e lira në shkolla.

Nuk ka informata publike rreth performancës së administratës në bazë të standardeve më të larta. Kodi i etikës dhe mirësjelljes nuk janë të publikuara, por jepen në mënyrë interne. Nuk ka publikime as për aktivitetet dhe vendimet e mekanizmave për vlerësim të performancës, apo aktivitetet e zyrave për parandalimin e konfliktit të interesit. Nuk është hasur as në ndonjë publikim rreth performancës individuale të fundvitit, ani pse ato aplikohen.



### Nota: 2 (Negative)

*Arsyetimi: Informacionet e publikuara në lidhje me të punësuarit dhe menaxhimin e burimeve njerëzore apo atyre nuk ofrojnë nivel të mjaftueshëm të transparencës.*

## 9. Pasuria kapitale dhe jokapitale

*Publiku duhet të ketë informata të përditësuara dhe të plota mbi menaxhimin e pasurisë publike nga ana e pushtetit komunal.*

Komuna e Gjilanit nuk ka publikuar listën e të gjitha patundshmërive. Nuk ka të dhëna për pronat dhe ndërtesat në pronësi të komunës e as për vlerën e tyre. Pronat i ka të regjistruara, teksa objektet ende jo. Nuk ka as hartë interaktive që paraqet saktësisht lokacionin e tyre, apo bazë të dhënave se për çfarë përdoren ato.

Rrjedhimisht, komuna nuk e ka bërë publike listën e pronave të cilat janë transferuar nga komuna tek shfrytëzues/pronar tjerë, apo arsyetimet për vendimet e tilla.


Lista e inventarit dhe vlera e tij nuk është publike. Lista e automjeteve përfshirë përshkrimin dhe vlerën e tyre nuk është publikuar. Njësoj është vepruar edhe me listën e pasurive të tjera me përshkrim dhe vlerë të përcaktuar.

Ndërkaq ka fare informata publike mbi aksionet që mban komuna në kompani të ndryshme.



### Nota: 1 (Negative)

*Arsyetimi: Nga 9 nënfaktorë të radhitur te Pasuria kapitale dhe jokapitale, te të gjitha figuron pengjigja Jo sa i përket transparencës së pushtetit lokal kundrejt qytetarëve. Zyrtarët e komunës kanë pranuar dobësitë në këtë faktor dhe kanë pohuar se mbetet që në të ardhmen të ndërmarrin diçka në këtë drejtim.*



## IV. Marrëdhëniet me qytetarët dhe shoqërinë

### 10. Informimi dhe shërbimi i qytetarëve

*Transparenca komunale duhet të jetë e avancuar duke i mundësuar publikut qasje të lehtë në informata, informim të saktë, të shpejtë dhe të detajuar rreth çështjeve që ndërlidhen me politikën, vendimet dhe shërbimet për qytetarët.*

Zyra për Informim e Komunës është efiçase. Zyrtari për informim është caktuar dhe kontakti me zyrën vendoset lehtë. Zyra për informim ka marrë nisma për ngritjen e transparencës dhe publikon “Buletinin” informativ, ku përfshihen aktivitetet e komunës, kurse për këtë botim kujdeset e gjithë zyra për informim e komunës. Nuk ka publikim të raporteve me statistika rreth përdorimit të rrjeteve sociale, rreth përdorimit të pajisjeve mobile, shërbimeve përmes telefonit, këshillimit të qytetarëve dhe shërbimeve të informatave. Zyra për informim ka bërë të ditur se Komuna ka provuar disa herë të sigurojë statistikën për klikimet e ueb faqes së Komunës, por se sipas IT-së është e pamundur për shkaqe teknike, ngase domeni është i centralizuar. Profili në Facebook i Komunës së Gjilanit i ka mbi 11 mijë ndjekës.

Komuna ka rregullore për transparencë, derisa në proces ka qenë hartimi i planit të veprimit për transparencë. (Plani i veprimit për transparencë është finalizuar para publikimit të këtij raporti).

Ueb faqja e komunës është konsoliduar për të pas një navigim më të lehtë. Lajmet janë publikuar në baza të rregullta, derisa materialet gradualisht. Nuk ka infografika, apo raporte për popullaritetin e ueb faqes. Ka një forum në uebfaqe, porse ai nuk është aktiv.

Ekziston edhe një vegëz që ju mundëson qytetarëve të drejtojnë këshilla, vërejtje apo sugjerime në adresë të komunës, porse nuk ka të dhëna se sa shkresa kanë marrë nga qytetarët dhe çfarë ka bërë komuna për t'i përfillë ato.<sup>30</sup> Në këtë vegëz mungon termi “kritika”, teksa nuk ka gjithashtu edhe një mundësi të veçantë për qytetarët që me sugjerimet e tyre eventuale ta përmirësojnë përmbajtjen e uebfaqes.

Një linjë informimi për qytetarët, kjo komunë e ka të hapur edhe nëpërmjet llogarisë në rrjetin socialë ‘Facebook’, e cila i ka mbi 11 mijë ndjekës<sup>31</sup>.

Materialet përkthehen në të gjitha gjuhët zyrtare që përdoren në këtë komunë, derisa disa informata paraqiten në formë të kuptueshme e pjesa dërmuese në formë konvencionale dhe në gjuhë legale.

<sup>30</sup> Ueb faqja e komunës së Gjilanit, Kontaktet, <http://kk.rks-gov.net/gjilan/Important-Phone.aspx>

<sup>31</sup> Faqja zyrtare e komunës së Gjilanit në Facebook, <https://www.facebook.com/Komuna-e-Gjilanit-Faqja-Zyrtare-1410141205896819/>



Në periudhën janar-dhjetor 2015, komuna e Gjilanit ka bërë të ditur se ka pranuar 57 kërkesa për qasje në dokumente publike. Në 50 kërkesa, komuna është përgjigjur me shkrim (në letër), dhe 7 me anë të versionit elektronik. Në 48 kërkesa, përgjigjet janë dërguar brenda afatit kohor, teksa në 2 sosh pas skadimit të afatit ligjor. Profilët e aplikuesve për qasje në dokumente publike janë të ndryshme: gazetarë (3 kërkesa), shoqëria civile (19), organizatat buxhetore (1), individë (11), studentë (8), parti politike (12) kompani private (3). Dokumentet e kërkuara, gjithashtu janë të natyrave të ndryshme. Buxhet, shpenzime (20), vendime (4), statistika (7), kontrata (6), projekte (7), konkurse (8) dhe 4 kërkesa të tjera për qasje në procesverbal, dosje personale të një punëtori të larguar nga puna më 2012. Megjithatë sipas organizatave të shoqërisë civile Komuna e Gjilanit nuk është treguar transparente sa i përket dhënies në dispozicion të dokumenteve publike. KCIC ka bërë të ditur se përmes Qendrës për Shërbime për Qytetarë, gjatë periudhës mars-dhjetor ka bërë 9 kërkesa, për qasje në dokumente publike dhe se vetëm në dy raste Komuna e Gjilanit ka kthyer përgjigje në formë elektronike.<sup>32</sup>

Me vendim të Kryetarit, Komuna e Gjilanit ka themeluar Regjistrin e Procedurave Administrative ku publikohen të gjitha informatat mbi procedurat që qytetarët marrin nga Komuna.<sup>33</sup> Për secilën procedurë është detajuar baza ligjore, informacioni dhe dokumentet e nevojshme për të aplikuar, tarifat dhe pagesat për aplikim si dhe koha e përcaktuar për kthimin e përgjigjes. Por ka mungesë të informatave mbi shërbimet e kompanive publike (mbledhja e mbeturinave), hapësirat gjelbëruese, barërat nga lista esenciale (shëndetësi), efikasitetin e inspektorëve komunal, edukimi para universitar: numri i shkollave, statusi ligjor, mënyra e financimit, mësuesit dhe nxënësit, harta interaktive, gjendja e trafikut, incidentet që ndërliken me shërbime komunale, informata të përditësuara mbi ndotjen e ajrit dhe zhurmës.



### Nota: 3.2 (Neutrale)

*Arsyetimi: Në këtë faktor ka zhvillime që tregojnë ecjen pozitive të Komunës së Gjilanit drejt përqafimit të praktikave të mira për transparencë në raport me publikun, por kjo kundërbalancohet me mungesën e efikasitetit të plotë për ofrimin e qasjes në dokumente publike brenda afateve të parapara me ligj. Krijimi i Regjistrin të Procedurave Administrative është një praktikë e mirë e aplikuar nga kjo komunë.*

32 "Përfshirja e publikut në vendimmarrje në Komunën e Gjilanit", raport monitorimi, KCIC, dhjetor 2015, [http://behupjese.org/docs/Perfshirja\\_e\\_publikut\\_ne\\_vendimmarrje\\_ne\\_Komunen\\_e\\_Gjilanit\\_-\\_KCIC\\_dhjetor\\_2015.pdf](http://behupjese.org/docs/Perfshirja_e_publikut_ne_vendimmarrje_ne_Komunen_e_Gjilanit_-_KCIC_dhjetor_2015.pdf)

33 Regjistrimi i procedurave administrative në komunën e Gjilanit, <https://rpa.rks-gov.net/sq/>



## 11. Bashkëpunimi me shoqërinë civile

*Organet komunale duhet të jenë të hapura dhe të angazhohen për qeverisje transparente duke thelluar bashkëpunimin me shoqërinë civile.*

Komuna nuk ka një udhëzues për pjesëmarrje qytetare dhe për shfrytëzimin e kanaleve të ndryshme për të kuptuar më mirë dokumentet dhe informatat e publikuara nga komuna. Kjo çështje ka qenë e rregulluar vetëm nëpërmjet rregullores për transparencë. Nuk ka të dhëna për memorandumet e mundshme të mirëkuptimit të komunës me organizatat e shoqërisë civile. Nga ana tjetër, nga veprimtaria publike në këtë komunë, nuk ka një informatë se sa OJQ janë aktive dhe sa të tilla e monitorojnë punën e komunës.


Nga monitorimi, del se komuna e Gjilan i ka mbajtur 9 takime publike. Koha e mbajtjes së takimeve ka qenë e përshtatshme për qytetarët, ngase një pjesë e tyre janë mbajtur gjatë ditëve të fundjavës. Mundësia për të paraqitur brengat dhe kërkesat i është dhënë qytetarëve nga zonat urbane dhe rurale. Por ajo që vërehet është se në këto takime ka nevojë për pjesëmarrje më të madhe të qytetarëve. Raportimi kryesisht bëhet gojarisht në këto takime. Këshillat lokal janë funksionalizuar.

Nuk ka të dhëna për numrin e akteve të miratuara nga KK-ja me interes të përgjithshëm për qytetarët, sikundër as për konsultimet publike. Kurse për takimet konsultative para miratimit të buxhetit sipas monitorimit del të jenë mbajtur 5 sosh. Gjashtë rregullore me interes për publikun janë diskutuar me qytetarë, porse nuk janë publikuar raporte përmbledhëse nga këto konsultime. Komuna nuk posedon mekanizëm përcjellës për regjistrim të kërkesave të qytetarëve si dhe statusit të kërkesave të tyre (përkrahjes apo hedhjes poshtë të kërkesave). Dita e martë është caktuar zyrtarisht për takimin e kreut të komunës me qytetarë. Por, nuk ka asnjë statistikë publike sa qytetarët ka takuar kryetari brenda një viti dhe çfarë kërkesash janë shtruar.



### Nota: 2.7 (Neutrale)

*Arsyetimi: Te ky indikator, i vetmi aspekt pozitiv është numri i takimeve publike me qytetarët që është nëntë. Por, kur analizohen indikatorët e tjerë, ky numër i takimeve marginalizohet në relacion me veprimet e tjera që synojnë përfshirjen e qytetarëve në vendimarrje, prandaj dhe vlerësimi është neutral.*



## V. Planifikimi dhe zhvillimi urban

### 12. Planifikimi urban

*Publiku duhet të ketë qasje në informata të rëndësishme që ndërlidhen me planifikimin urban, pasi kjo përbën një nga parimet themelore të qeverisjes së mirë.*

Publiku është pak i informuar rreth dokumenteve strategjike në fushën e planifikimit urban. Por Komuna e Gjilanit përmes regjistrit të procedurave administrative ka krijuar lehtësira për ndjekjen e kriterëve dhe atë të procesit të marrjes së lejeve ndërtimore e mjedisore. Mirëpo nuk ka informata për Hartën Zonale të Komunës, derisa ka mjaft pak informata për Planet Rregulluese të Hollësishme, dhe është vetëm një skicë për modelin e zhvillimit komunal.

Mungon harta interaktive e pasur me informata mbi shërbimet, aktivitetet dhe resurset në territor, planet për mbrojtje të mjedisit, menaxhimin e resurseve natyrore, kualiteti i ujit në hapësira të caktuara, emetimi i gazrave apo informata të sakta të destinimit të tokës.

Komuna ka publikuar listën me lejet e ndërtimit për vitin 2014, në fund të atij viti. Në ueb faqe figuron vegëza edhe për listën me lejet e ndërtimit për vitin 2015, por dokumenti i publikuar është ngatërruar<sup>34</sup>. Por vendimet dhe arsyetime për lejet e lëshuara, sikurse edhe procesverbalet e mbledhjeve të komisioneve që kanë aprovuar lejet e ndërtimeve, nuk janë publikuar sikurse as informatat në lidhje me përputhshmërinë e lejeve të lëshuara me planet aktuale të komunës.



#### Nota: 2 (Negative)

*Arsyetimi: Në sferën më të ndjeshme jo vetëm për këtë komunë, Gjilani ka ngecur tërësisht sa i përket transparencës në relacion me publikun. Nuk ekziston asnjë informacion, qoftë edhe simbolik me të cilin qytetarët mund të njoftohen për zhvillimet në këtë sektor.*

### 13. Monitorimi i projekteve urbanistike

*Komuna duhet në vazhdimësi ta informojë publikun për rrjedhën e projekteve të cilat kanë ndikim në planifikimin dhe zhvillimin urban.*

Aktivitetet e ndërmarra nga inspektorët e ndërtimtarisë gjatë vitit 2015, janë

<sup>34</sup> Lejet Urbanistike, Regjistri i lejeve të ndërtimit, <http://kk.rks-gov.net/gjilan/Reguloret-dhe-Pasqyrat-Komunale/Lejet-Urbanistike.aspx>

pasqyruar në raportin vjetor të drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim Hapësinor dhe Mbrojtje të Mjedisit. Gjithsej ka pasur 596 inspektime në terren, 180 procesverbale për ndërprerje të punëve, 111 vendime për ndërprerje të punëve, 42 vendime për rrënimin e objekteve, 10 dënime mandatore (2,300 €), 19 kallëzime penale në organet e drejtësisë, 2 konkluzë për rrënimë dhe 13 kërkesa-ankesa qytetare për shqyrtim. Por nuk ka mekanizëm për të përcjellë rastet e raportuara nga publiku, as shenjzim të hartës ku ka rrezik.

Publiku nuk ka informata të mjaftueshme për performancën e kompanive të kontraktuara nga komuna për të zhvilluar projekte urbanistike, ngase nuk janë publikuar emrat e kompanive që kanë kryer projektet kryesore të zhvillimit urban, as të dhëna mbi monitorimin dhe përcjelljen e punëve që janë duke u zhvilluar. Monitorimi dhe përcjellja e punëve që janë duke u zhvilluar kryhet nga dikasteret që janë bartës të projekteve. Informatat mbi projektet kryesore infrastrukturore që janë duke u zhvilluar, qëllimi i projektit dhe përfaqësuesit komunal që e kanë për detyrë; kontraktorë; buxheti; periudha e zbatimit, figurojnë vetëm në tabelat informuese në vendpunime.



### Nota: 2 (Negative)

*Arsyetimi: Te ky indikator, komuna e Gjilanit ka paraqitur të dhëna bazike mbi aktivitetet e inspektorëve, por jo edhe mekanizmat për përcjelljen e raportimeve që vijnë nga publiku. Gjithashtu në nënindikatorin e dytë nuk ka pothuajse asnjë informatë të publikuar. Kësisoj, publikun është privuar nga informatat që lidhen me sferën e monitorimit të projekteve urbane.*

## VI. Notimi

	Pesha	%	Notimi	%
<b>Organizimi, përbërja, kompetencat, dokumentacioni dhe funksionimi</b>				
1. Kryetari, Drejtorët dhe Anëtarët e Kuvendit	3	5.56%	2.2	2%
2. Organizimi dhe funksionimi	2	3.70%	2.5	2%
3. Puna e organeve politikë-bërëse dhe vendim-marrëse	4	7.41%	2.5	4%
4. Luftimi i sjelljeve të pahijshme dhe keqpërdorimeve	3	5.56%	2	2%
5. Integrimi Evropian	2	3.70%	1	1%

### Menaxhimi ekonomik dhe financiar

6. Kontabiliteti dhe buxheti	5	9.26%	2.5	5%
7. Kontratat e prokurimit publik, furnizimit dhe granteve	5	9.26%	2	4%

### Menaxhimi i resurseve njerëzore dhe resurseve tjera

8. Të punësuarit në administratën publike dhe organizatat/institucionet publike	5	9.26%	2	4%
9. Pasuria kapitale dhe jokatitale	5	9.26%	1	2%

### Marrëdhëniet me qytetarët dhe shoqërinë

10. Informimi dhe shërbimi i qytetarëve	5	9.26%	3.2	6%
11. Bashkëpunimi me shoqërinë civile	5	9.26%	2.7	5%

### Planifikimi dhe zhvillimi urban

12. Planifikimi urban	5	9.26%	2	4%
13. Monitorimi i projekteve urbanistike	5	9.26%	2	4%

54

100%

45%

	Pesha	%	Notimi	%
<b>1. Kryetari, Drejtorët dhe Anëtarët e Kuvendit</b>				
1. Cili është kualiteti i informatave që përmbajnë resimet?	5	20%	3	12%
2. Sa janë të plota deklaratat e pasurisë?	5	20%	2	8%
3. Sa janë të kuptueshme, të plota dhe të qasshme informatat mbi interesat personale?	5	20%	1	4%
4. Sa efikase janë kanalet e komunikimit që përdoren nga personat e zgjedhur dhe emëruar politikisht?	5	20%	2	8%
5. Sa janë të përditësuara dhe të plota informatat mbi aktivitetet e Kryetarit, Kuvendit, dhe personave tjerë të zgjedhur dhe të emëruar?	5	20%	3	12%

25

100%

11

44%

	Pesha	%	Notimi	%
<b>2. Organizimi dhe funksionimi</b>				
6. Sa janë të plota dhe të lehtësisht të kuptueshme informatat mbi organizmin dhe kompetencat komunale?	5	20%	3	12%
7. A kanë qytetarët informata të mjaftueshme mbi mënyrat më efikase për ndikim në politikëbërje dhe vendimmarrje?	5	20%	2	8%
8. Sa janë të dobishme kanalet e komunikimit?	5	20%	2	8%
9. Cili është kualiteti i informatave për planet në të ardhmen?	5	20%	3	12%
10. A ka të dhëna mbi komunën?	5	20%	2.5	10%

<b>25</b>	<b>100%</b>	<b>12.5</b>	<b>50%</b>
-----------	-------------	-------------	------------

	Pesha	%	Notimi	%
<b>3. Puna e organeve politikë-bërëse dhe vendim-marrëse</b>				
11. Sa inkurajohet publiku të jetë vëzhgues aktiv i debateve dhe proceseve vendimmarrëse?	5	33.33%	2	13%
12. A është raportimi i Ekzekutivit i rregullt dhe i plotë në Kuvend?	5	33.33%	2.5	17%
13. Sa kanë mundësi qytetarët të informohen për punën e komunës, politikat dhe aktet normative?	5	33.33%	3	20%

<b>15</b>	<b>100%</b>	<b>7.5</b>	<b>50%</b>
-----------	-------------	------------	------------

	Pesha	%	Notimi	%
<b>4. Luftimi i sjelljeve të pahijshme dhe keqpërdorimeve</b>				
14. A ka komuna mekanizma për të hetuar dhe gjykuar sjelljet e pahijshme dhe keqpërdorimet tjera?	5	33.33%	3	20%
15. A është komuna transparente në aktivitetet e saj në luftën kundër mashtrimeve/keqpërdorimeve?	5	33.33%	1	7%
16. Cili është niveli i informimit të publikut për mekanizmat e raportimit të keqpërdorimeve të mundshme?	5	33.33%	2	13%

<b>15</b>	<b>100%</b>	<b>6</b>	<b>40%</b>
-----------	-------------	----------	------------

	Pesha	%	Notimi	%
<b>5. Integrimi Evropian</b>				
17. A ka publiku informata të mjaftueshme për obligimet e komunës në procesin e integritit në BE?	5	50%	1	10%
18. A ka publiku informata të mjaftueshme mbi ndikimet e mundshme të procesit të integritit në BE?	5	50%	1	10%

<b>10</b>	<b>100%</b>	<b>2</b>	<b>20%</b>
-----------	-------------	----------	------------

	Pesha	%	Notimi	%
<b>6. Kontabiliteti dhe buxheti</b>				
19. A është publiku i informuar mirë rreth planifikimit buxhetor?	5	16.67%	3	10%
20. A publikohen të dhëna të mjaftueshme mbi ndarjet dhe realizimet buxhetore të komunës?	5	16.67%	3	10%
21. Sa është i informuar publiku për praktikën e mira dhe të metat e komunës në menaxhimin e financave publike?	5	16.67%	2	7%
22. A ka informata të mjaftueshme për të kuptuar burimet e të ardhurave të komunave?	5	16.67%	3	10%
23. Sa janë të informuar qytetarët për suficitin, deficitin dhe borxhin e komunës?	5	16.67%	2.5	8%
24. Sa transparente është funksionimi i organizatave të cilat ofrojnë shërbime për qytetarët ku komuna ka kompetenca (përfshi kompetenca të vogla)?	5	16.67%	1	3%

<b>30</b>	<b>100%</b>	<b>14.5</b>	<b>48.33%</b>
-----------	-------------	-------------	---------------

	Pesha	%	Notimi	%
<b>7. Kontratat e prokurimit publik, furnizimit dhe granteve</b>				
25. Sa është transparent procesi përzgjedhjes dhe lidhjes së marrëdhënies kontraktuale, më saktësisht procesi i vlerësimit të përshtatshmërisë për hyrje në marrëdhënie kontraktuale me palën e caktuar?	5	50%	2	20%
26. A ka transparencë në menaxhimin e projekteve dhe kontratave?	5	50%	2	20%

<b>10</b>	<b>100%</b>	<b>4</b>	<b>40%</b>
-----------	-------------	----------	------------

	Pesha	%	Notimi	%
<b>8. Të punësuarit në administratën publike dhe organizatat/institucionet publike</b>				
27. A është i qartë organizimi i administratës komunale dhe funksionet e personave kyc?	5	25%	3	15%
28. Sa janë të qarta strukturat organizative dhe informatat mbi funksionimin e organizatave/institucioneve të ndryshme komunale?	5	25%	1	5%
29. A zbatohen praktikën më të mira të rekrutimit/punësimit?	5	25%	3	15%
30. A ka informata publike rreth performancës së administratës në bazë të standardeve më të larta?	5	25%	1	5%

<b>20</b>	<b>100%</b>	<b>8</b>	<b>40%</b>
-----------	-------------	----------	------------

	Pesha	%	Notimi	%
<b>9. Pasuria kapitale dhe jokapitale</b>				
31. A ka publikuar komuna listë të të gjitha patundshmërive?	5	25%	1	5%
32. A kemi informata dhe vendime të publikuara të cilat synojnë të arsyetojnë se përdorimi i tillë i tyre është në të mirë të sovranit?	5	25%	1	5%
33. A ka publikuar komuna listë të pasurive të ndryshme (inventar, automobila, piktura, pasuri tjetër me vlerë)?	5	25%	1	5%
34. A janë paraqitur aksionet dhe pronësia e komunës në kompani të ndryshme?	5	25%	1	5%
	<b>20</b>	<b>100%</b>	<b>4</b>	<b>20%</b>

	Pesha	%	Notimi	%
<b>10. Informimi dhe shërbimi i qytetarëve</b>				
35. Sa është efikase zyra për informim?	5	12.50%	4	10%
36. A ka Komuna plane apo strategji të veprimit për transparencën në komunë?	5	12.50%	3	8%
37. Sa është e dobishme ueb faqja e komunës?	5	12.50%	3	8%
38. A ofron komuna mundësi për të marrë mendimin e qytetarëve për përmirësim të transparencës?	5	12.50%	3	8%
39. Sa përdoren mjetet inovative për transparencë dhe komunikim me publikun?	5	12.50%	3	8%
40. A janë të dhënat të kuptueshme për qytetarët e komunës?	5	12.50%	3	8%
41. A mundësohet qasja në dokumente publike?	5	12.50%	2	5%
42. Cili është kualiteti i informatave rreth shërbimeve për qytetarët?	5	12.50%	4	10%
	<b>40</b>	<b>100%</b>	<b>25</b>	<b>62.50%</b>

	Pesha	%	Notimi	%
<b>11. Bashkëpunimi me shoqërinë civile</b>				
43. A janë krijuar forma të strukturuar të bashkëpunimit me shoqërinë civile?	5	33.33%	2	13%
44. A mbahen takime me publikun?	5	33.33%	3	20%
45. A konsultohen qytetarët rreth dokumenteve me interes para se ato të aprovohen?	5	33.33%	3	20%
	<b>15</b>	<b>100%</b>	<b>8</b>	<b>53.33%</b>

	Pesha	%	Notimi	%
<b>12. Planifikimi urban</b>				
46. Sa është publiku i informuar rreth akteve normative dhe dokumenteve strategjike në fushën e planifikimit urban?	5	33.33%	3	20%
47. A përdor komuna mjetet më të avancuara për t'iu mundësuar publikut të vëzhgojnë të gjithë elementet që ndërlidhen me planet urbane?	5	33.33%	1	7%
48. Sa është komuna transparente me lejet e ndërtimit dhe shfrytëzimit të hapësirave?	5	33.33%	2	13%
	<b>15</b>	<b>100%</b>	<b>6</b>	<b>40.00%</b>



	Pesha	%	Notimi	%
<b>13. Monitorimi i projekteve urbanistike</b>				
49. Sa është komuna efektive për të raportuar për aktivitetet e saja për monitorimin e zbatimit të planit urbanistik?	5	50%	3	30%
50. A ka publiku informata të mjaftueshme për performancën e kompanive të kontraktuara nga komuna për të zhvilluar projekte urbanistike?	5	50%	1	10%
	<b>10</b>	<b>100%</b>	<b>4</b>	<b>40%</b>






# Komuna e M

Autor: Albert Krasniqi



# Mitrovicës

I. Organizimi, përbërja, kompetencat, dokumentacioni dhe funksionimi _____	86
1. Kryetari, Drejtorët dhe Anëtarët e Kuvendit _____	86
2. Organizimi dhe funksionimi _____	88
3. Puna e organeve politike-bërëse dhe vendim-marrëse _____	89
4. Luftimi i sjelljeve të pahijshme dhe keqpërdorimeve _____	90
5. Integrimi Evropian _____	91
II. Menaxhimi ekonomik dhe financiar _____	92
6. Kontabiliteti dhe buxheti _____	92
7. Kontratat e prokurimit publik, furnizimit dhe granteve _____	93
III. Menaxhimi i resurseve njerëzore dhe resurseve tjera _____	94
8. Të punësuarit në administratën publike dhe organizatat/ institucionet publike _____	94
9. Pasuria kapitale dhe jokapitale _____	95
IV. Marrëdhëniet me qytetarët dhe shoqërinë _____	96
10. Informimi dhe shërbimi i qytetarëve _____	96
11. Bashkëpunimi me shoqërinë civile _____	98
V. Planifikimi dhe zhvillimi urban _____	99
12. Planifikimi urban _____	99
13. Monitorimi i projekteve urbanistike _____	100
VI. Notimi _____	101



# I. Organizimi, përbërja, kompetencat, dokumentacioni dhe funksionimi

## 1. Kryetari, Drejtorët dhe Anëtarët e Kuvendit

*Volumi dhe kualiteti i informatave të publikuara rreth të zgjedhurve dhe emëruarve politik (në Komunë në këtë kategori hyjnë Kryetari, Drejtorët, dhe Anëtarët e Kuvendeve Komunale), duhet të jenë të mjaftueshme për të vlerësuar kredibilitetin e tyre, mbikëqyrur angazhimin e tyre në vazhdimësi, dhe për të kontaktuar në mënyrën më të përshtatshme me personat që mbajnë këto pozita.*

Kualiteti i informatave të rezymesë së Kryetarit të komunës e vendosur në ueb faqen zyrtare, është i dobët dhe jo i plotë. E gjitha çfarë mund të gjendet është një përmbledhje e shkurtër e aktiviteteve të tija afariste.<sup>1</sup> Pothuajse kualiteti i njëjtë i informatave është edhe për Nënkryetarin e komunës, që përmban një përmbledhje të të dhënave mbi arsimin dhe përvojën e punës. Të dhënat mbi drejtorët e drejtorive në komunës, si persona të emëruar, janë të plota dhe përfshijnë rezymetë për secilin/secilën prej tyre. Rezymeja e kryesuesit të Kuvendit Komunal është e publikuar në ueb faqen e komunës, por jo edhe ato të anëtarëve të këtij organi legjislativ të nivelit lokal. Të vetmet informatat për anëtarët e Kuvendit Komunal janë emrat dhe mbiemrat e tyre dhe subjektet politike përkatëse.<sup>2</sup>

Deklarimet e pasurisë të zyrtarëve komunal të Mitrovicës janë të publikuara në Agjencinë Kundër Korrupsionit,<sup>3</sup> dhe ato përfshijnë informatat e kërkuara sipas kriterëve ligjore. Në përgjithësi, kualiteti i informatave është bazik dhe nuk ofrohen të dhëna për angazhimet dhe benefitet shtesë. Informatat mbi interesat personale, që do të mund të shpien në vlerësimin e konflikteve të mundshme të interesit, nuk janë të publikuara nga ana e komunës. Të gjitha pretendimet që mund të bëhen nga palët e treta për konflikte të interesit të zyrtarëve komunal, mbesin në rrafshin e spekulimeve me shumë pak mundësi që të njëjtat të dokumentohen.

<sup>1</sup> Profili i Kryetarit të Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri. Qasur më 14 janar 2016. Vegëza: <https://kk.rks-gov.net/mitrovice/Municipality/President/President-profile.aspx>

<sup>2</sup> Lista e anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Mitrovicës, qasur më 14 janar 2016. Vegëza: <https://kk.rks-gov.net/mitrovice/Municipality/Assembly/Major-s-deputies.aspx>

<sup>3</sup> Deklarimet e pasurisë së zyrtarëve të Komunës së Mitrovicës. Agjenci Kundër Korrupsionit. Qasur më 14 janar 2016. Vegëza: [http://akk-ks.org/sq/deklarimet?path=declaration\\_assets%2F2015%2FKomunat%2FKomuna\\_e\\_Mitrovices\\_Jugore](http://akk-ks.org/sq/deklarimet?path=declaration_assets%2F2015%2FKomunat%2FKomuna_e_Mitrovices_Jugore)

Komuna ka bërë hapa pozitiv në drejtim të përmirësimit të komunikimit të zgjedhësve me të zgjedhurit e tyre, përfshirë të emëruarit. Në ueb faqen e komunës është mundësuar komunikimi elektronik, përmes zhvillimit të një forumi të komunikimit,<sup>4</sup> që do të mund të shërbente si kanal mjaft efikas nëse shfrytëzohet dhe për më tepër pyetjet/komentet e qytetarëve janë publike. Përkundër krijimit të këtij mekanizmi, i njëjti nuk është shfrytëzuar që nga viti 2012 kur është vendosur postimi i fundit. Përveç kësaj, komuna ka zhvilluar formën e caktimit të takimeve online me zyrtarë komunal të quajtur “Cakto takim online me zyrtarët komunal”.<sup>5</sup> Kjo platformë është në dispozicion edhe në formatin e telefonave të mençur, për të lehtësuar komunikimin me përdoruesit që nuk kanë pajisje tjera elektronike. Komuna qëndron keq në publikimin e numrave kontaktues. Një banderolë e vendosur në ueb faqe e quajtur “Telefonat kontaktues” është tërësisht e zbrazët dhe nuk ofron asnjë mundësi kontakti. Në seksionin “Komuna” është vendosur një numër i kontaktit, përderisa numrat kontaktues për Kryetarin mungojnë tërësisht. Informata kontaktuese për Kryesuesin dhe anëtarët e Kuvendit Komunal përfshijnë vetëm adresat e postës elektronike.

Sa i përket njoftimeve për aktivitetet që zhvillohen në kuadër të komunës, ato janë të bollshme dhe ueb faqja rifreskohet vazhdimisht. Praktikë e mirë e vendosur në Komunën e Mitrovicës është njoftimi për aktivitetet që planifikohen të mbahen, dhe për të njëjtat aktivitete postohen kronikat që përmbledhin ngjarjet e ndodhura gjatë atyre rasteve.



### Nota: 3 (Neutral)

*Arsyetimi: Informatat për organet ekzekutive të komunës, janë të pakta dhe jo kualitative. Mungojnë informatat për anëtarët e Kuvendit Komunal, kurse për të emëruarit politik informatat janë më të plota. Deklarimet e pasurisë janë të mangëta dhe nuk ofrohen informata për konfliktet e mundshme të interesit. Pozitive është ofrimi i kanaleve të ndryshme të komunikimit dhe caktimi i takimeve përmes formave elektronike.*

## 2. Organizimi dhe funksionimi

*Publiku duhet të ketë informata të mjaftueshme për të kuptuar organizimin, kompetencat, funksionimin, procesin e vendimmarrjes dhe të politikëbërjes të trupave të ndryshme komunale.*

Komuna ka publikuar në ueb faqen e saj Statutin, si aktin më të lartë juridik, përmes së cilit përcaktohet zbatimi i përgjegjësive, kompetencave dhe pushtetin e komunës.<sup>6</sup> Përgjegjësitë e Kryetarit dhe të drejtorëve të drejtorive të komunës janë të publikuara dhe lehtë të qasshme. Sa i përket përgjegjësive të organit

<sup>4</sup> Komuna e Mitrovicës, <https://kk.rks-gov.net/mitrovice/Forums.aspx>

<sup>5</sup> Platforma “Cakto takim online me zyrtarët komunal”. Komuna e Mitrovicës. Shih: <http://www.komunamitrovices-takimet.com/>

<sup>6</sup> Statuti i Komunës së Mitrovicës, vegëza: <https://kk.rks-gov.net/mitrovice/Municipality/Statut.aspx>

legjislativ të komunës, Kuvendit, në ueb faqe janë publikuar pjesë të shkëputura nga Statuti i komunës që përcaktojnë kompetencat e këtij organi. Komuna nuk ka zbërthyer këtë dokument ligjorë një përshkrim më lehtë të kuptueshëm për qytetarët. Informatat për organet/institucionet ku komuna është aksionar, nuk janë në dispozicion për publikun. Skema organizative e komunës është e publikuar dhe nga ku mund të kuptohet mënyra e organizimit të komunës.<sup>7</sup>

Asnjë informatat mbi mënyrat për ndikim në politikëbërje dhe vendim-marrje në komunë nuk është në dispozicion të publikut. Përveç publikimit të këtyre informatave, komuna nuk ka bërë përpjeke të ndërmarr edhe kampanja informuese për vetëdijesim të rëndësisë së pjesëmarrjes dhe ndikimit të qytetarëve në politikëbërje.

Kanalet e komunikimit të komunës janë kryesisht në bazuar në format elektronike, që janë efikase për grup moshat më të reja. Forumi i komunikimi të komunës është një shembull i mirë në këtë aspekt. Komuna është aktive në shfrytëzimin e rrjeteve të ndryshme sociale, por janë lënë anash format më konvencionale të komunikimit. Numrat kontaktues të telefonave nuk janë të publikuara, mjet ky që do të ishte më efikas sidomos për grup moshat më të vjetra.

Komuna ka të publikuar Planin Lokal të Veprimit në Mjedis 2011-2016, dhe disa plane rregulluese urbane. Planet tjera të publikura janë për periudhat e mëparshme që tashmë kanë skaduar.<sup>8</sup> Në ueb faqen e komunës gjenden informata rreth territorit, ekonomisë, urbanizmit, gjeografisë, historisë dhe një historik rreth jetës kulturore në këtë qytet. Po ashtu, mund të gjenden edhe informata të shkurtra për sportin, më saktësisht për klubet sportive në këtë qytet. Nuk ka asnjë të dhënë rreth sistemit të ujit dhe të kanalizimit, apo edhe furnizimit me energji elektrike.



### Nota: 2.5 [Neutral]

*Ansytimi: Mënyra e organizimit dhe përgjegjësitë e komunës janë të publikuara, ndonëse komuna nuk ka zbërthyer aktet ligjore në dokumente më të kuptueshme për qytetarët. Gjuha juridike nuk mund të kuptohet lehtësisht nga të gjithë. Mungojnë tërësisht informatat për mundësitë e ndikimit në politikëbërje, gjë që ka ndikuar në zbritje të pikëve në vlerësimin e përgjithshëm. Përkundër shfrytëzimit të rrjeteve sociale si Facebook dhe Youtube është hap pozitiv, kanalet konvencionale të komunikimit nuk janë efikase për të gjitha kategoritë. Mungesa e numrave kontaktues është domethënëse.*

<sup>7</sup> Skema organizative e Komunës së Mitrovicës, shih: <https://kk.rks-gov.net/mitrovice/getattachment/Municipality/Organogrami-i-Komunes-se-Mitrovices/SKEMA-ORGANIZATIV-ORGANOGRAMI-KOMUNA-MITROVICE.pdf.aspx>

<sup>8</sup> Planet rregulluese të Kuvendit Komunal të Mitrovicës 2010–2015, shih: <https://kk.rks-gov.net/mitrovice/Projects/Planet-rregulluse-komunale-2010-2015.aspx>



### 3. Puna e organeve politikë-bërëse dhe vendim-marrëse

*Publiku duhet të ketë informata të detajuara, përditësuara, dhe të mjaftueshme për të vlerësuar problematikat kryesore të debatuar dhe vendimet kryesore të marra nga organet politikë-bërëse dhe vendim-marrëse të Komunës.*

Në përgjithësi, komuna inkurajon publikun të jetë vëzhgues i debateve dhe proceseve vendimmarrëse. Ndër format e përdorura për të arritur këtë qëllim, është njoftimi me kohë për mbledhjet dhe takimet në të cilat diskutohet për çështjet në interes të qytetarëve. Ueb faqja e komunës është kanali kryesorë i kumtimit të këtyre njoftimeve, që plotësohen me vendosjen e afisheve në hapësirat publike, në ndërtesën e komunës, si dhe shfrytëzohet transmetimi përmes mediave lokale.<sup>9</sup> Komuna publikon të gjitha vendimet që merr, por informatat lidhur me zbatimin e këtyre vendimeve të marra në mbledhjet/takimet që i zhvillon nuk janë të mjaftueshme. Procesverbalet që publikohen i takojnë vetëm mbledhjeve të Kuvendit Komunal, dhe Komitetit për Politikë dhe Financa, por jo edhe organeve tjera.

Llogaridhënia e ekzekutivit karshi legjislativit të komunës është tejet e dobët dhe nuk bëhet në baza të rregullta. Interpelancat, si një instrument i kontrollit, nuk shfrytëzohen fare nga anëtarët e Kuvendit Komunal, gjë që shfrytëzohet më pastaj nga ana e drejtorëve të drejtorive për të dërguar vetëm raportet që përmbajnë vetëm anët pozitive dhe për të raportuar atë që ata/ato dëshirojnë.

Mundësitë që qytetarët të informohen për punën e komunës, politikat dhe aktet normative janë pjesërisht të kënaqshme. Mbledhjet e Kuvendit Komunal janë publikuar në formë të audio incizimeve vetëm për vitin 2014, për më tepër asnjëra prej këtyre audiove nuk hapet.<sup>10</sup> Vendimet e komunës publikohen rregullisht, por nuk përmbajnë arsyetimet, me përjashtim të disa vendimeve që konsiderohen më të rëndësishme.



#### Nota: 2.5 (Neutral)

*Ansytimi: Megjithëse publikohen me kohë njoftimet për mbledhjet e komunës, mungesa e publikimit të vendimeve të të gjitha organeve të komunës është negative. Kur kësaj i shtohet edhe raportimi jo i rregullt të ekzekutivit, dhe mundësitë që qytetarët të informohen më mirë me arsyetimet për marrjen e vendimeve të komunës, bënë që ky indikator të jetë neutral. Inkurajimi i qytetarëve të jetë vëzhgues aktiv i debateve dhe proceseve vendimmarrëse është inkurajues për përmirësim të mëtejshme edhe në fushat tjera.*

<sup>9</sup> Komuna i transmeton njoftimet në TV Mitrovica.

<sup>10</sup> Mbledhjet e Kuvendit, audio incizimet. Komuna e Mitrovicës. Shih: <https://kk.rks-gov.net/mitrovica/Municipality/Seances/Mbledhjet-e-Kuvendit-2014-Audio.aspx>

## 4. Luftimi i sjelljeve të pahijshme dhe keqpërdorimeve

*Komuna duhet të publikojë informata të rëndësishme nga të cilat lehtësisht mund të vlerësohet niveli i përkushtimit të saj në luftimin e sjelljeve të pahijshme dhe keqpërdorimeve.*

Përmes mekanizmave të cilët janë publikuar nga komuna për hetimin dhe gjykimin e sjelljeve të pahijshme dhe keqpërdorimeve, nuk është e mundur të vlerësohet niveli i përkushtimit në luftimin e këtyre dukurive, apo për të vlerësuar efikasitetin e tyre. Si formë e mekanizmit të jashtëm është dhënia e hapësirës për vendosjen e banderolave në ueb faqen e komunës, për organizatat e shoqërisë civile të specializuara në fushën e luftimit të korrupsionit siç është “kallxo.com”. Në anën tjetër, për të inkurajuar raportimin e rasteve të korrupsionit të zyrtarëve komunal, Kryetari i Komunës së fundmi ka premtuar shpërblim prej pesë mijë euro për personat që dokumentojnë rastet e tilla.<sup>11</sup> Kodi i Mirësjelljes në Shërbimin Civil është i publikuar në ueb faqen e komunës, përmes së cilës mund të kuptohet nga qytetarët se cilat raste do të përbënin shkelje të kodit nga zyrtarët komunal.<sup>12</sup>

Aktivitetet e komunës në luftën kundër mashtrimeve/keqpërdorimeve nuk janë transparente dhe është e pamundur të vlerësohet nëse ndërmerren hapa konkret dhe se cili është efikasiteti i tyre. Nuk ka njoftime për aktivitetet, çfarë lloji kanë qenë ato, numri i personave të angazhuar, apo diçka më shumë. Mungesa e mekanizmave të raportimit të keqpërdorimeve të mundshme, ka bërë që të mos ketë informim të publikut lidhur me këta mekanizma.



### Nota: 2 (Negativ)

*Arsyetimi: Përnjashimisht vendosjes së banderolave të OJQ-ve në ueb faqen e komunës për raportim të korrupsionit dhe ofrimit të shpërblimit nga ana e Kryetarit të Komunës, nuk ka mekanizma të tjerë publik për të inkurajuar qytetarët të raportojnë këto dukuri. Aktivitetet e komunës, nëse ka pasur të tilla, nuk janë publike dhe në mungesë të mekanizmave adekuate ato nuk promovohen.*

<sup>11</sup> Shih: <http://www.kosovalive360.com/bahtiri-premton-50-mije-euro-per-denoncuesit-e-korrupsionit-ne-ferizaj.html>, qasur më 20 janar 2016.

<sup>12</sup> Kodi i Mirësjelljes në Shërbimin Civil. Qasur më 20 shkurt, 2016. Vegëza: [https://kk.rks-gov.net/mitrovice/getattachment/Municipality/Statut/Kodi-i-Miresjelljes-ne-SHCK-ZM\\_MAP-.pdf.aspx](https://kk.rks-gov.net/mitrovice/getattachment/Municipality/Statut/Kodi-i-Miresjelljes-ne-SHCK-ZM_MAP-.pdf.aspx)



## 5. Integrimi Evropian

*Publikut duhet t'i ofrohet mundësia që të mësoj në mënyrë të saktë dhe të detajuar obligimet, arritjet dhe sfidat që i ka komuna në procesin e integritit të Kosovës në BE.*

Përkundër faktit se në komunë është e themeluar Drejtoria për Integritime Evropian dhe Mirëqenie Sociale, kjo drejtori nuk publikon informata të rregullta për punën e saj dhe progresin e bërë në përmbushje të agjendës evropiane. Në seksionin e drejtorive janë përshkruar detyrat e kësaj drejtorie,<sup>13</sup> si dhe është publikuar raporti gjashtë mujor për periudhën janar – qershor 2015.<sup>14</sup>

Çështja e “Riatdhesimi”, si një prej kritereve që duhet përmbushur Kosova në rrugën e saj drejt integritit në BE, nuk është trajtuar mjaftueshëm nga komuna, duke u mjaftuar me publikimin e një vegëze që drejton në ueb faqen e Ministrisë së Punëve të Brendshme ku shpjegohen procedurat e riatdhesimit.

Publikut nuk i ofrohen informata mbi ndikimet e mundshme të procesit të integritit në BE. Në ueb faqen e komunës nuk mund të gjenden informata të tilla dhe as nuk diskutohen me qytetarët në diskutimet publike me këtë temë.




### Nota: 2 (Negativ)

*Arsyetimi: Në fushën e integritimeve evropiane, komuna ka publikuar një raport për punën në gjashtë mujorin e parë të vitit 2015. Megjithëkëtë, nuk publikohen informata në baza të rregullta për përmbushjen e agjendës evropiane, si dhe publikut nuk i ofrohen informata të mjaftueshme për ndikimet në procesin e integritimeve në BE.*

<sup>13</sup> Drejtoria për Integritime Evropian dhe Mirëqenie Sociale. Komuna e Mitrovicës. Gasur me 16 janar 2016, vegëza: <https://kk.rks-gov.net/mitrovice/Municipality/Departments/Integritimeve-Evropiane-dhe-Mireqenies-Sociale.aspx>

<sup>14</sup> Raport i punës i drejtorisë për Integritime Evropiane dhe Mirëqenie Sociale. Komuna e Mitrovicës. Shih raportin: <https://kk.rks-gov.net/mitrovice/getattachment/1eaf0a30-2744-4fdf-a005-2eb28eef84b4/Raport-i-punes-per-gjashtemujorin-e-pare-per-vitin.aspx>



## II. Menaxhimi ekonomik dhe financiar

### 6. Kontabiliteti dhe buxheti

*Të dhënat dhe raportet e ndryshme dhe të përditësuara rreth të hyrave financiare, alokimeve buxhetore, shpenzimeve financiare, borxheve dhe kontesteve me pasoja financiare për komunën, duhet të jenë në dispozicion të publikut për të pasë pasqyrë të qartë mbi menaxhimin e parasë publike në nivel lokal.*

Përgjatë fazës së planifikimit buxhetor të komunës, shpërndahen ftesat për dëgjime publike me qytetarë për të diskutuar lidhur me prioritetet dhe nevojat e tyre, si dhe shfrytëzohet edhe informimi përmes mediave televizive lokale. Mbledhjet e Kuvendit Komunal paralajmërohen, dhe publiku informohet për vendimet e marra me rastin e miratimit të buxhetit. Propozimet e anëtarëve të Kuvendit Komunal nuk janë të qasshme për publikun, siç nuk janë as propozimet e qytetarëve. Komuna nuk publikon rialokimet buxhetore. Të qasshme nuk janë as propozimet e projekteve që janë hedhur poshtë, si ato të ekzekutivit apo të asamblesë.

Të dhënat mbi projekt-buxhetin e komunës për secilin vit janë të publikuara, ndërsa mungojnë raportet për realizimin e buxhetit. Përfundim të publikimi i një raporti financiar gjashtë mujor, që përmban programin e investimeve kapitale të vitit 2012. Korniza afat-mesme buxhetore 2016-2018 është hartuar dhe publikuar në ueb faqen e komunës. Realizimi i projekteve komunale dokumentohet vetëm përmes fotografive dhe kostos buxhetore, pa dhënë detaje tjera. Burimet e financimit të projekteve janë publike, përderisa mungojnë tabelat e buxhetit për vitet paraprake.

Publikut nuk i ofrohen të dhëna të mjaftueshme që të jetë i informuar për praktikën e mira dhe të metat në menaxhimin e financave publike. Raportet e auditimit të jashtëm janë të publikuara edhe në ueb faqen e komunës përveç asaj të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, njoftimet për borxhet që ka komuna ndaj palëve tjera, ndërsa nuk paraqitet ndonjë informatë për pagesat që kanë dështuar të bëhen sipas ligjit. Burimet e të ardhurave të komunës mund të kuptohen nga raportet e auditimit të jashtëm dhe Draft Buxheti Komunal i publikuar nga Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, por që nuk ka ndonjë formë më lehtë të kuptueshme.

Informatat për suficitin, deficitin dhe borxhin e komunës, janë të publikuara vetëm në shifra, pa detaje dhe arsyetime. Borxhet e komunës ndaj operatorëve ekonomik, mund të gjenden në raportin financiar gjashtë mujor të përgatitur nga Drejtoria për Financa e komunës.

Komuna nuk është fare transparente në ofrimin e informatave lidhur me funksionimin e organizatave të cilat ofrojnë shërbime për qytetarët, ku komuna ka kompetenca. Nuk mund të gjendet buxheti i tyre, raportet e auditorëve, borxhet të cilat kanë, apo pagat e funksionarëve kyç të këtyre organizatave.



## Nota: 2.5 (Neutral)

Arsyetimi: Publiku është mirë i informuar për planifikimin fillestar të buxhetit, por jo edhe për rialokimet buxhetore apo propozimet e opozitës. Burimet e të ardhurave të komunës janë publike, përdërisa informatat për praktikën e mirë apo të metat e menaxhimit të buxhetit mund të kuptohen vetëm nga raportet e auditimit të jashtëm.

## 7. Kontratat e prokurimit publik, furnizimit dhe granteve

*Marrëdhëniet kontraktuale me implikime financiare në mes të komunës dhe personave fizik dhe juridik duhet të zhvillohen në transparencë të plotë, për të siguruar menaxhimin e mirë të parasë publike dhe vlerën e duhur për shërbimet, punët apo furnizimet.*

Procesi i përzgjedhjes dhe hyrjes në marrëdhënie kontraktuale i Komunës së Mitrovicës, karakterizohet me mungesë të transparencës në shumë fusha. Përdërisa njoftimet për hyrje në marrëdhënie kontraktuale me palë të caktuara bëhen në formë të lajmeve, pra informata të përgjithshme pa dhënë detaje për procedurat e ndjekura, të njëjtat nuk shoqërohen me procesverbale të komisioneve vlerësuese. Kriteret për hyrje në marrëdhënie kontraktuale bëhen publike paraprakisht nga komuna. Mungesa e informatave është e theksuar për punët plotësuese apo aneks kontratat që bëhen me kompanitë e kontraktuara. Nuk ka të publikuara raporte të hulumtimit të tregut, dhe është pikëpyetje nëse të tilla raporte prodhohen nga komuna me qëllim të kuptimit më të mirë të nevojave dhe kërkesave, apo të hartohen raporte të veçanta lidhur me mësimet e nxjerra nga kontratat e kaluara.


Transparenca në menaxhimin e projekteve dhe kontratave është një tjetër faktor i rëndësishëm në menaxhimin efektiv të shpenzimeve publike. Në këtë sferë, qasja e komunës është *ad-hoc*, në varësi të vëmendjes së publikut për projekte të caktuara. Në shumicën e rasteve, komuna shpërndanë informata të përmbledhura në një komunikatë për media, komunikatë e cila vendoset edhe në ueb faqen e komunës. Për raste të caktuara, siç është ai për rregullimin e sheshit të qytetit, komuna ka qenë mjaftë transparente dhe ka raportuar në baza të rregullta për problemet e hasura gjatë zbatimit të projektit. Profilet e fituesve të tenderëve nuk janë të vendosura në ueb faqen e komunës, por që të njëjtat mund të gjenden vetëm në atë të KRPP-së. Sa i përket nënshkrimit të kontratave, vlerave financiare, afateve kyçe, datës së fillimit dhe të mbarimit të projektit, të gjitha publikohen në ueb faqen e KRPP-së.<sup>15</sup> Komuna nuk prodhon raporte të veçanta për secilin projekt të realizuar apo për mbikëqyrjen e punimeve gjatë realizimit të tyre.

<sup>15</sup> Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Njoftimet për Komunën e Mitrovicës: [https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=1&CtlID=SearchNotices&ind=1&PPRCMe nu\\_OpenNode=63](https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=1&CtlID=SearchNotices&ind=1&PPRCMe nu_OpenNode=63)



## Nota: 2.5 (Neutral)

*Arsyetimi: Transparenca e pjesshme për hyrje në marrëdhënie kontraktuale me palë të caktuara, që nënkupton se për disa projekte publikohen të dhëna të mjaftueshme si për lidhje të kontratave ashtu edhe për përcjelljen e zbatimit të tyre, kurse për disa të tjera jo. Kjo ka bërë që vlerësimi të jetë i përgjysmuar nga pikët maksimale.*



### III. Menaxhimi i resurseve njerëzore dhe resurseve tjera

#### 8. Të punësuarit në administratën publike dhe organizatat/institucionet publike

*Menaxhimi i resurseve njerëzore duhet të bëhet në mënyrë transparente duke përfutur nga mbikëqyrja e vazhdueshme e publikut mbi performancën e administratës.*

Organizimi i komunës së Mitrovicës është ilustruar në skemën organizative, dokument ky publik në ueb faqen zyrtare.<sup>16</sup> Përshkrimet e detyrave dhe përgjegjësitë e drejtorëve janë listuar në seksionet e drejtorive në ueb faqe të komunës, kurse sa i përket pozitave kyçe të administratës nuk janë të publikuara përgjegjësitë dhe detyrat e tyre. Gjithashtu, komuna nuk ka vënë në dispozicion të publikut as listën e të gjithë personave të punësuar në administratën komunal, lere më pagat për pozitat e ndryshme apo informatat kontaktuese.

Struktura organizative dhe informatat mbi funksionimin e organizatave/institucioneve të ndryshme komunal nuk janë publike dhe komuna nuk ofron asnjë informatë shtesë për këtë.

Publikimi i Kodit të Mirësjelljes në Shërbimin Civil, është një hap drejtë qasjes serioze të ekzekutivit komunal për të garantuar sjellje të punonjësve të administratës në bazë të standardeve më të larta. Megjithatë në ueb faqen e komunës nuk janë publike informatat për konfliktet e mundshme të interesit. Deri më tani, nuk është publikuar ndonjë raport rreth vlerësimeve të performancës individuale të administratës.

<sup>16</sup> Skema Organizative e Komunës së Mitrovicës, qasur më 24 janar 2016: <https://kk.rks-gov.net/mitrovice/Municipality/Organogrami-i-Komunes-se-Mitrovices.aspx>



## Nota: 2 (Negativ)

*Arsyetimi: Publikimi i skemës organizative dhe përshkrimi i përgjegjësive të drejtorëve nuk është i mjaftueshëm për të dhënë vlerësim të plotë. Mungesa e përshkrimit të detyrave dhe përgjegjësive të personave kyç të administratës, pastaj mos publikimi i vlerësimeve të performancës individuale dhe pagat e tyre, është thelbësore në vlerësimin e përgjithshëm. Asnjë informatë nuk ofrohet për organizatat/institucionet e ndryshme të komunës.*

## 9. Pasuria kapitale dhe jokapitale

*Publiku duhet të ketë informata të përditësuara dhe të plota mbi menaxhimin e pasurisë publike nga ana e pushtetit komunal.*

Komuna nuk ka publikuar asnjë listë të patundshmërive të saj (pronave dhe ndërtesave që i ka në pronësi). Një listë e tillë do të duhej të përmbante vlerat e këtyre pronave, lokacionet se ku gjenden, si dhe një bazë të të dhënave që do të paraqiste se për çfarë përdoren këto pasuri. Vërejtje në këtë aspekt janë bërë edhe nga Auditori i Përgjithshëm në raportin e viti 2014.<sup>17</sup> Në këtë raport konstatohet se komuna nuk ka procedurë të brendshme për menaxhimin e pasurive të saja dhe nuk përfillet rregullorja për menaxhimin e pasurive që mund të shpije në humbjen, keqpërdorimin dhe përdorimin e paautorizuar të pasurisë publike.


Mungesë të informatave ka edhe për vendimet të cilat do të synonin të arsyetojnë përdorimin e pasurive të komunës, ashtu siç nuk ka informata publike për pasuritë e ndryshme si inventarë apo automobila. Aksionet dhe pronësia e komunës në kompani të ndryshme nuk janë të paraqitura.



## Nota: 1 (Negativ)

*Arsyetimi: Komuna nuk ka publikuar fare listë të pasurive të saja, përfshirë listën e pasurive të patundshme si dhe atyre të ndryshme jo financiare. Mungojnë informatat edhe për aksionet dhe pronësinë e komunës në kompani të ndryshme.*

<sup>17</sup> Raporti i Auditimit për Komunën e Mitrovicës për vitin 2014, [http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit\\_KMT\\_2014\\_Shqip\\_989613.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_KMT_2014_Shqip_989613.pdf)



## IV. Marrëdhëniet me qytetarët dhe shoqërinë

### 10. Informimi dhe shërbimi i qytetarëve

*Transparenca komunale duhet të jetë e avancuar duke i mundësuar publikut qasje të lehtë në informata, informim të saktë, të shpejtë dhe të detajuar rreth çështjeve që ndërlidhen me politikat, vendimet dhe shërbimet për qytetarët.*

Komuna ka caktuar zyrtarin për informim, dhe zyra është aktive në ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësi që ka. Zyrtari për informim ka gatishmëri të bashkëpunimit, por mbetet negative mos publikimi i informatave në ueb faqen e komunës, pjesa që i përket kësaj zyre është tërësisht e zbrazët.<sup>18</sup> Shumë nga raportet e komunës që nuk janë publike, nuk bien drejtpërdrejtë në përgjegjësi të zyrës, pasi që kjo varet edhe nga gatishmëria e organeve tjera që të ofrojnë materialet për publikim.

Komuna pohon se ka plan të veprimit për transparencë,<sup>19</sup> por që i njëjti nuk është publik. Në të kaluarën komuna ka ndërmarrë veprime për promovim të ueb faqes, por që aktualisht nuk e konsideron të nevojshme një veprim të tillë.

Informatat të cilat ofrohen në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës janë të bollshme në aspektin e sasisë. Komunikatat për media dhe njoftimet janë mjaft të rregullta, por që vërejtjet e organizatave të shoqërisë civile aktive në këtë komunë janë se komunikatat mbulojnë më shumë aktivitetet e disa drejtorive, kurse për disa të tjera janë më të pakta. Mungesa e klasifikimit të informatave gjithashtu është një çështje që vihet në dukje nga përfaqësuesit e OSHC-ve.<sup>20</sup> Ueb faqja nuk është mirë e organizuar për shkak të kufizimeve që i ka si pasojë e centralizimit të ueb faqeve nga MAPL-ja. Megjithatë, një formë e kontaktit “Kontakt komunen” është e vendosur në ueb faqe, si dhe ofrohen një numër i kontaktit. Mbetet e paqartë se sa shfrytëzohet kjo dhe në ç’masë është funksionale, pasi nuk ka të dhëna të publikuara për numrin e shërbimeve që iu janë dhënë qytetarëve nga kjo formë.

Matja e opinionit publik rreth transparencës nuk është përdorur nga komuna si mekanizëm. Po ashtu, mekanizma tjerë më pak të kushtueshëm të dedikuar për marrje të sugjerimeve të qytetarëve për përmirësim të transparencës nuk janë zbatuar. Në ueb faqe ekziston një seksion i veçantë për diskutime me qytetarët “Forum”, por që nuk është duke u përdorur. Postimet e fundit janë bërë në vitin 2012, dhe prej temave të shtruara asnjëra nuk ka të bëjë me përmirësim të transparencës.<sup>21</sup>

18 Zyra për Informim. Komuna e Mitrovicës. Gasur më 27 janar 2016, <https://kk.rks-gov.net/mitrovice/Municipality/Zyrat-Njesite/Zyra-per-Informim.aspx>

19 Hysni Sylja, Zyrtar i Zyrës për Informim, Komuna e Mitrovicës, deklarin në Fokus Grupin e organizuar nga EC Ma Ndryshe, me datë 16 shkurt 2016.

20 Deklarim i përfaqësuesve të OShC nga Mitrovica, në Fokus Grupin e organizuar nga EC Ma Ndryshe me datë 16.02.2016

21 Forumi. K. e Mitrovicës. Gasur më 27 janar 2016. Shih: <https://kk.rks-gov.net/mitrovice/Forums.aspx>

Komuna përdorë mjetet inovative për transparencë dhe komunikim me publikun, siç janë rrjetet e ndryshme sociale (Facebook<sup>22</sup> dhe Youtube<sup>23</sup>). Informacionet që publikohen janë të kuptueshme në shumicën e rasteve, por komuna nuk zbërthen informatat zyrtare siç mund të jenë ato ligjore në informata më lehtë të kuptueshme dhe në formate të përpunueshme për gjenerim të statistikave. Gjuha juridike e përdorur në këto dokumente nuk mund të kuptohet lehtë nga ata/ato që nuk kanë njohuri në këtë lëmi. Informatat që ofrohen në ueb faqe janë vetëm në gjuhën shqipe, dhe mungojnë në gjuhët tjera zyrtare.

Qasja në dokumentet publike është një e drejtë e garantuar me ligj,<sup>24</sup> dhe në këtë drejtim komuna ju është përgjigjur pozitivisht kërkesave të pranuar. Për më tepër, komuna ka publikuar edhe raporte statistikore për numrin e kërkesave të pranuar apo të refuzuara,<sup>25</sup> si dhe në faqen e parë është promovuar qasja në dokumente publike.

Qytetarët kanë mundësi të japin mendimin e tyre në lidhje me shërbimet e ofiqarëve në Komunën e Mitrovicës. Komuna ka vendosur një anketë në ueb faqen e saj dhe prej aty prezantohen rezultatet e opinionit të qytetarëve për kualitetin e shërbimeve që marrin. Komuna ka publikuar edhe raporte të veçanta për performancën e arritur në shërbimet e administratës.<sup>26</sup>



### Nota: 3 (Neutral)

*Arsyetimi: Zyra për informim publik është mjaft aktive në punën e saj, por që mungojnë informatat në ueb faqe për këtë zyrë. Komuna nuk ka të publikuar plan të veprimit për transparencë, ndonëse pohohet që ekziston një e tillë. Ueb faqja nuk është mirë e organizuar në seksione. Komuna shfrytëzon edhe rrjetet e ndryshme sociale për komunikim me qytetarët. Ka mundësi të qasjes në dokumente publike dhe publikohen të dhëna statistikore.*

<sup>22</sup> Profili i Komunës së Mitrovicës në Facebook: <https://www.facebook.com/komuna.mitrovices>

<sup>23</sup> Kanali i Komunës së Mitrovicës në Youtube: <https://www.youtube.com/user/MBNz96p6c7gF3Wf7ODPY>

<sup>24</sup> Ligji për qasje në dokumente publike, Shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2724>

<sup>25</sup> Raporti lidhur me kërkesat për qasje në dokumentet publike. Komuna e Mitrovicës, qasur me 2 mars, 2016. Shih: <https://kk.rks-gov.net/mitrovica/getattachment/1915fc06-83ce-430d-b37c-5201943faddb/RAPORT-Lidhur-me-kerkesat-per-qasje-ne-dokumente-p.aspx>

<sup>26</sup> Raporti vjetor i Komunës së Mitrovicës për performancën e arritur në shërbimet administrative për vitin 2015: <https://kk.rks-gov.net/mitrovica/getattachment/d16aed6c-346c-4141-8b60-3c5e8166c42d/Raporti-vjetor-i-Komunes-se-Mitrovices-per-perfo.aspx>

## 11. Bashkëpunimi me shoqërinë civile

*Organet komunale duhet të jenë të hapura dhe të angazhohen për qeverisje transparente duke thelluar bashkëpunimin me shoqërinë civile.*

Bashkëpunimi i komunës me shoqërinë civile është i kënaqshëm, sidomos në realizimin e projekteve të ndryshme. Përkundër kësaj, ueb faja e komunës nuk ofron informata për këtë segment, siç mund të ishin publikimi i memorandumeve të bashkëpunimit në mes të komunës dhe shoqatave/organizatave. Ndonëse njoftimet për lidhjen e memorandumeve bëhen në ueb faqe, të njëjtat nuk publikohen të plota.

Pushteti aktual i komunës, ka rritur ndjeshëm numrin e takimeve me publikun në raport me qeverisjet e kaluara. Takimet më të shpeshta janë ato për buxhetin dhe planet rregulluese, por nuk mungojnë as në fushat tjera të interesit. Mungesa e raporteve të prodhuara nga komuna me qëllim të informimit më të saktë të publikut është e evidente. Sugjerimet dhe vërejtjet e dhëna në këto takime nuk publikohen dhe është e paqartë nëse evidencat e tilla mbahen.


Konsultimi i qytetarëve para aprovimit të dokumenteve që janë me interes, bëhet vetëm për një numër të kufizuar të rasteve. Më saktësisht, konsultimet për projektbuxhetin zënë vendin kryesor, kurse më rrallë ndodhin për planet rregullative të lagjeve. Qytetarët nuk janë konsultuar për projekte të rëndësishme, siç janë pallati i kulturës, pallati i sporteve apo rregullimi i sheshit. Po ashtu, komuna nuk ka të vendosur ndonjë mekanizëm që regjistron kërkesat e qytetarëve.



### Nota: 2.5 (Neutral)

*Arsyetimi: Në të gjitha aspektet e këtij indikator, komuna vetëm pjesërisht janë përmbushur kriteret, që ka bërë të ketë një vlerësim neutral. Komuna ka bashkëpunim me shoqërinë civile, por nuk ka informata në dispozicion për të vlerësuar nëse ky bashkëpunim po bëhet në formë të strukturuar. Komuna ka rritur numrin e takimeve me publikun, por negative mbetet mos publikimi i evidencave për këto takime. Konsultimet me qytetarë para aprovimit të dokumenteve të rëndësishme bëhen vetëm pjesërisht.*





## V. Planifikimi dhe zhvillimi urban

### 12. Planifikimi urban

*Publiku duhet të ketë qasje në informata të rëndësishme që ndërlidhen me planifikimin urban, pasi kjo përbën një nga parimet themelore të qeverisjes së mirë.*

Me qëllim të informimit të publikut rreth akteve normative dhe dokumenteve strategjike në fushën e planifikimit urban, Komuna e Mitrovicës ka organizuar disa diskutime publike. Informata të pjesshme janë publikuar edhe në ueb faqen e komunës për këtë qëllim. Procesi i marrjes së lejeve është i qartë dhe ofrohen informata të mjaftueshme.

Në seksionin e Drejtorisë për Planifikim dhe Urbanizmit është vendosur një broshurë ku shpjegohen kushtet e përgjithshme për sipërfaqet urbane, dokumentet e nevojshme për leje, etj.<sup>27</sup> Njëherësh, kjo broshurë është edhe mjete kryesorë që është përdoruar nga komuna për t'i mundësuar publikut të vëzhgoj elementet që ndërlidhen me planet urbane.

Komuna ka miratuar Rregulloren për Mbrojtjen e Mjedisit,<sup>28</sup> në të cilën përfshihen edhe mbrojtja e ujit, por që në ueb faqe nuk ka të dhëna për kualitetin e ujit, emetim e gazrave apo për destinimin e tokës.

Komuna e Mitrovicës nuk është transparente me lejet e ndërtimit dhe shfrytëzimit të hapësirave, pasi që nuk ka asnjë listë të veçantë për lejet e lëshuara, e cila është publike dhe rifreskohet vazhdimisht, që ndër të tjera përmbanë edhe arsyetimet e dhënies apo refuzimit të tyre. Nuk janë të publikuara as procesverbalet e mbledhjeve të komisioneve që kanë aprovuar lejet ndërtimore apo përputhshmërinë e lejeve të lëshuara me planet aktuale të komunës.



#### Nota: 2 (Negativ)

*Arsyetimi: Janë organizuar një sërë diskutimesh me qytetarët rreth akteve normative që ndërlidhen me planifikimin urban, megjithëkëtë komuna qëndron keq në përdorimin e mjeteve të avancuara për t'iu mundësuar publikut të vëzhgoj elementet që ndërlidhen me planifikimin urban. Komuna nuk ka asnjë listë të publikuar me lejet e lëshuara.*

<sup>27</sup> Fletëpalosje e Drejtorisë për Planifikim dhe Urbanizëm, Komuna e Mitrovicës. Shih: <https://kk.rks-gov.net/mitrovica/getattachment/Municipality/Departments/Urban-Planning-Cadastre-and-Environmental-Protect/Drejtoria-per-Planifikim-dhe-Urbanizem.pdf.aspx>

<sup>28</sup> Shih Rregulloren për Mbrojtjen e Mjedisit të Komunës së Mitrovicës: [https://kk.rks-gov.net/mitrovica/getattachment/Shpalljet/Rreguloret/Rreguloret-2010/Rregullorja-Komunale-Nr\\_-02-2010-per-mbrojtjen-e-mjedisit.pdf.aspx](https://kk.rks-gov.net/mitrovica/getattachment/Shpalljet/Rreguloret/Rreguloret-2010/Rregullorja-Komunale-Nr_-02-2010-per-mbrojtjen-e-mjedisit.pdf.aspx)

### 13. Monitorimi i projekteve urbanistike

*Komuna duhet në vazhdimësi ta informojë publikun për rrjedhën e projekteve të cilat kanë ndikim në planifikimin dhe zhvillimin urban.*

Raportimi për aktivitetet e organeve komunale lidhur me monitorimin e zbatimit të planit urbanistik nuk është aspak efikas. Kjo për faktin se raporte të tilla nuk publikohen fare në ueb faqen e komunës dhe nuk dihet nëse hartohen këto raporte. Po ashtu, mungon edhe publikimi i raporteve për aktivitetet e ndërmarra nga inspektorët. Nuk ka bazë të të dhënave të këtyre aktiviteteve apo mekanizëm për të përcjellë rastet e raportuara nga publiku.

Publiku nuk ka informata të mjaftueshme për performancën e kompanive të kontraktura nga komuna për të zhvilluara projekte urbanistike. Zakonisht informatat e tilla publikohen në formë të lajmeve apo dërgohen komunikata për media, por që janë mjaftë të mangëta në aspektin e informatave që ofrojnë. Mungesa e informatave për monitorimin e punëve që janë duke u monitoruar, qëllimeve të projektit, buxhetit, periudhës së zbatimit, janë qenësore për informim të plotë dhe të drejtë.



#### Nota: 1.5 (Negativ)

*Arsyetimi: Mungesa e efikasitetit në informimin e publikut për aktivitetet komunale lidhur me monitorimin e zbatimit të planit urbanistik, si dhe shpërndarja e informatave të pamjaftueshme për performancën e kompanive të kontraktuara nga komuna për të zhvilluara projekte urbanistike, kanë bërë që Komuna e Mitrovicës të vlerësohet me notë negative në këtë indikator.*

## VI. Notimi

	Pesha	%	Notimi	%
<b>Organizimi, përbërja, kompetencat, dokumentacioni dhe funksionimi</b>				
1. Kryetari, Drejtorët dhe Anëtarët e Kuvendit	3	5.56%	3	3%
2. Organizimi dhe funksionimi	2	3.70%	2.5	2%
3. Puna e organeve politike-bërëse dhe vendim-marrëse	4	7.41%	2.5	4%
4. Luftimi i sjelljeve të pahijshme dhe keqpërdorimeve	3	5.56%	2	2%
5. Integrimi Evropian	2	3.70%	2	1%
<b>Menaxhimi ekonomik dhe financiar</b>				
6. Kontabiliteti dhe buxheti	5	9.26%	2.5	5%
7. Kontratat e prokurimit publik, furnizimit dhe granteve	5	9.26%	2.5	5%
<b>Menaxhimi i resurseve njerëzore dhe resurseve tjera</b>				
8. Të punësuarit në administratën publike dhe organizatat/institucionet publike	5	9.26%	2	4%
9. Pasuria kapitale dhe jokatipale	5	9.26%	1	2%
<b>Marrëdhëniet me qytetarët dhe shoqërinë</b>				
10. Informimi dhe shërbimi i qytetarëve	5	9.26%	3	6%
11. Bashkëpunimi me shoqërinë civile	5	9.26%	2.5	5%
<b>Planifikimi dhe zhvillimi urban</b>				
12. Planifikimi urban	5	9.26%	2	4%
13. Monitorimi i projekteve urbanistike	5	9.26%	1.5	3%

54

100%

46%

	Pesha	%	Notimi	%
<b>1. Kryetari, Drejtorët dhe Anëtarët e Kuvendit</b>				
1. Cili është kualiteti i informatave që përmbajnë resumat?	5	20%	2.5	10%
2. Sa janë të plota deklaratat e pasurisë?	5	20%	2.5	10%
3. Sa janë të kuptueshme, të plota dhe të qasshme informatat mbi interesat personale?	5	20%	1	4%
4. Sa efikase janë kanalet e komunikimit që përdoren nga personat e zgjedhur dhe emëruar politikisht?	5	20%	4	16%
5. Sa janë të përditësuarat dhe të plota informatat mbi aktivitetet e Kryetarit, Kuvendit, dhe personave tjerë të zgjedhur dhe të emëruar?	5	20%	3	12%

25

100%

13

52%

	Pesha	%	Notimi	%
<b>2. Organizimi dhe funksionimi</b>				
6. Sa janë të plota dhe të lehtësisht të kuptueshme informatat mbi organizmin dhe kompetencat komunale?	5	20%	3	12%
7. A kanë qytetarët informata të mjaftueshme mbi mënyrat më efikase për ndikim në politikëbërje dhe vendimmarrje?	5	20%	1	4%
8. Sa janë të dobishme kanalet e komunikimit?	5	20%	2.5	10%
9. Cili është kualiteti i informatave për planet në të ardhmen?	5	20%	2	8%
10. A ka të dhëna mbi komunën?	5	20%	3	12%

<b>25</b>	<b>100%</b>	<b>11.5</b>	<b>46%</b>
-----------	-------------	-------------	------------

	Pesha	%	Notimi	%
<b>3. Puna e organeve politikë-bërëse dhe vendim-marrëse</b>				
11. Sa inkurajohet publiku të jetë vëzhgues aktiv i debateve dhe proceseve vendimmarrëse?	5	33.33%	3	20%
12. A është raportimi i Ekzekutivit i rregullt dhe i plotë në Kuvend?	5	33.33%	1.5	10%
13. Sa kanë mundësi qytetarët të informohen për punën e komunës, politikat dhe aktet normative?	5	33.33%	3	20%

<b>15</b>	<b>100%</b>	<b>7.5</b>	<b>50%</b>
-----------	-------------	------------	------------

	Pesha	%	Notimi	%
<b>4. Luftimi i sjelljeve të pahijshme dhe keqpërdorimeve</b>				
14. A ka komuna mekanizma për të hetuar dhe gjykuar sjelljet e pahijshme dhe keqpërdorimet tjera?	5	33.33%	2.5	17%
15. A është komuna transparente në aktivitetet e saj në luftën kundër mashtrimeve/keqpërdorimeve?	5	33.33%	1	7%
16. Cili është niveli i informimit të publikut për mekanizmat e raportimit të keqpërdorimeve të mundshme?	5	33.33%	3	20%

<b>15</b>	<b>100%</b>	<b>6.5</b>	<b>43.33%</b>
-----------	-------------	------------	---------------

	Pesha	%	Notimi	%
<b>5. Integrimi Evropian</b>				
17. A ka publiku informata të mjaftueshme për obligimet e komunës në procesin e integritimit në BE?	5	50%	3	30%
18. A ka publiku informata të mjaftueshme mbi ndikimet e mundshme të procesit të integritimit në BE?	5	50%	1	10%

<b>10</b>	<b>100%</b>	<b>4</b>	<b>40%</b>
-----------	-------------	----------	------------

	Pesha	%	Notimi	%
<b>6. Kontabiliteti dhe buxheti</b>				
19. A është publiku i informuar mirë rreth planifikimit buxhetor?	5	16.67%	3	10%
20. A publikohen të dhëna të mjaftueshme mbi ndarjet dhe realizimet buxhetore të komunës?	5	16.67%	3	10%
21. Sa është i informuar publiku për praktikën e mira dhe të metat e komunës në menaxhimin e financave publike?	5	16.67%	2	7%
22. A ka informata të mjaftueshme për të kuptuar burimet e të ardhurave të komunave?	5	16.67%	3	10%
23. Sa janë të informuar qytetarët për suficitin, deficitin dhe borxhin e komunës?	5	16.67%	3	10%
24. Sa transparente është funksionimi i organizatave të cilat ofrojnë shërbime për qytetarët ku komuna ka kompetenca (përfshi kompetenca të vogla)?	5	16.67%	1	3%
	<b>30</b>	<b>100%</b>	<b>15</b>	<b>50%</b>

	Pesha	%	Notimi	%
<b>7. Kontratat e prokurimit publik, furnizimit dhe granteve</b>				
25. Sa është transparent procesi përzgjedhjes dhe lidhjes së marrëdhënies kontraktuale, më saktësisht procesi i vlerësimit të përshtatshmërisë për hyrje në marrëdhënie kontraktuale me palën e caktuar?	5	50%	2.5	25%
26. A ka transparencë në menaxhimin e projekteve dhe kontratave?	5	50%	2.5	25%
	<b>10</b>	<b>100%</b>	<b>5</b>	<b>50%</b>

	Pesha	%	Notimi	%
<b>8. Të punësuarit në administratën publike dhe organizatat/institucionet publike</b>				
27. A është i qartë organizimi i administratës komunale dhe funksionet e personave kyc?	5	25%	2.5	13%
28. Sa janë të qarta strukturat organizative dhe informatat mbi funksionimin e organizatave/institucioneve të ndryshme komunale?	5	25%	1	5%
29. A zbatohen praktikën më të mira të rekrutimit/punësimit?	5	25%	3	15%
30. A ka informata publike rreth performancës së administratës në bazë të standardeve më të larta?	5	25%	2	10%
	<b>20</b>	<b>100%</b>	<b>8.5</b>	<b>42.50%</b>

	Pesha	%	Notimi	%
<b>9. Pasuria kapitale dhe jokatitale</b>				
31. A ka publikuar komuna listë të të gjitha patundshmërive?	5	25%	1	5%
32. A kemi informata dhe vendime të publikuara të cilat synojnë të arsyetojnë se përdorimi i tillë i tyre është në të mirë të sovranit?	5	25%	1	5%
33. A ka publikuar komuna listë të pasurive të ndryshme (inventar, automobila, piktura, pasuri tjetër me vlerë)?	5	25%	1	5%
34. A janë paraqitur aksionet dhe pronësia e komunës në kompani të ndryshme?	5	25%	1	5%
	<b>20</b>	<b>100%</b>	<b>4</b>	<b>20%</b>

	Pesha	%	Notimi	%
<b>10. Informimi dhe shërbimi i qytetarëve</b>				
35. Sa është efikase zyra për informim?	5	12.50%	3	8%
36. A ka Komuna plane apo strategji të veprimit për transparencën në komunë?	5	12.50%	2.5	6%
37. Sa është e dobishme ueb faqja e komunës?	5	12.50%	2	5%
38. A ofron komuna mundësi për të marrë mendimin e qytetarëve për përmirësim të transparencës?	5	12.50%	2	5%
39. Sa përdoren mjetet inovative për transparencë dhe komunikim me publikun?	5	12.50%	3	8%
40. A janë të dhënat të kuptueshme për qytetarët e komunës?	5	12.50%	2	5%
41. A mundësohet qasja në dokumente publike?	5	12.50%	5	13%
42. Cili është kualiteti i informatave rreth shërbimeve për qytetarët?	5	12.50%	3	8%
	<b>40</b>	<b>100%</b>	<b>22.5</b>	<b>56.25%</b>

	Pesha	%	Notimi	%
<b>11. Bashkëpunimi me shoqërinë civile</b>				
43. A janë krijuar forma të strukturuar të bashkëpunimit me shoqërinë civile?	5	33.33%	2.5	17%
44. A mbahen takime me publikun?	5	33.33%	2.5	17%
45. A konsultohen qytetarët rreth dokumenteve me interes para se ato të aprovohen?	5	33.33%	2.5	17%
	<b>15</b>	<b>100%</b>	<b>7.5</b>	<b>50%</b>

	Pesha	%	Notimi	%
<b>12. Planifikimi urban</b>				
46. Sa është publiku i informuar rreth akteve normative dhe dokumenteve strategjike në fushën e planifikimit urban?	5	33.33%	3	20%
47. A përdor komuna mjetet më të avancuara për t'iu mundësuar publikut të vëzhgojnë të gjithë elementet që ndërlidhen me planet urbane?	5	33.33%	2	13%
48. Sa është komuna transparente me lejet e ndërtimit dhe shfrytëzimit të hapësirave?	5	33.33%	1	7%
	<b>15</b>	<b>100%</b>	<b>6</b>	<b>40%</b>

	Pesha	%	Notimi	%
<b>13. Monitorimi i projekteve urbanistike</b>				
49. Sa është komuna efikase për të raportuar për aktivitetet e saja për monitorimin e zbatimit të planit urbanistik?	5	50%	1	10%
50. A ka publiku informata të mjaftueshme për performancën e kompanive të kontraktuara nga komuna për të zhvilluar projekte urbanistike?	5	50%	2	20%
	<b>10</b>	<b>100%</b>	<b>3</b>	<b>30%</b>

# Komuna e Po


Autor: Dren Pozhegu

.....

|||||

|||||


.....





# Pejës

I. Organizimi, përbërja, kompetencat, dokumentacioni dhe funksionimi _____	108
1. Kryetari, Drejtorët dhe Anëtarët e Kuvendit _____	108
2. Organizimi dhe funksionimi _____	109
3. Puna e organeve politike-bërëse dhe vendim-marrëse _____	111
4. Luftimi i sjelljeve të pahijshme dhe keqpërdorimeve _____	112
5. Integrimi Evropian _____	113
II. Menaxhimi ekonomik dhe financiar _____	113
6. Kontabiliteti dhe buxheti _____	113
7. Kontratat e prokurimit publik, furnizimit dhe granteve _____	115
III. Menaxhimi i resurseve njerëzore dhe resurseve tjera _____	116
8. Të punësuarit në administratën publike dhe organizatat/ institucionet publike _____	116
9. Pasuria kapitale dhe jokatitale _____	117
IV. Marrëdhëniet me qytetarët dhe shoqërinë _____	119
10. Informimi dhe shërbimi i qytetarëve _____	119
11. Bashkëpunimi me shoqërinë civile _____	120
V. Planifikimi dhe zhvillimi urban _____	121
12. Planifikimi urban _____	121
13. Monitorimi i projekteve urbanistike _____	122
VI. Notimi _____	124



## I. Organizimi, përbërja, kompetencat, dokumentacioni dhe funksionimi

### 1. Kryetari, Drejtorët dhe Anëtarët e Kuvendit

*Volumi dhe kualiteti i informatave të publikuara rreth të zgjedhurve dhe emëruarve politik (në Komunën e Pejës në këtë kategori hyjnë Kryetari, Drejtorët, dhe Anëtarët e Kuvendeve Komunale), duhet të jenë të mjaftueshme për të vlerësuar kredibilitetin e tyre, mbikëqyrur angazhimin e tyre në vazhdimësi, dhe për të kontaktuar në mënyrën më të përshtatshme me personat që mbajnë këto pozita.*

Në përgjithësi stafi politik - kryetari, nënkryetarët dhe drejtorët e drejtorive – kanë të publikuara CV-të e shkurtra, në të cilat qytetarët mund të njoftohen me kredencialet profesionale të tyre. Prej të gjithë stafit politik përjashtim bëjnë vetëm dy drejtorë të cilët nuk i kanë të publikuara CV-të. Megjithatë, një gjë e ngjashme nuk mund të thuhet edhe për Kuvendin Komunal. Asnjë anëtar i KK-së, duke përfshirë edhe kryesuesin dhe zëvendëskryesuesin, nuk i kanë të publikuara CV-të. Shumica – 33 nga gjithsejtë 35 – prej tyre kanë të publikuar vetëm informatat kontaktuese, edhe pse në këtë shumicë nuk hyjnë as nënkryesuesi, i cili nuk ka asnjë informate të publikuar.

Deklaratat e pasurisë të zyrtarëve të lartë të pushtetit lokal në Pejë janë të publikuara në ueb faqen e Agjencisë Kundër Korrupsion (AKK), por të njëjtat nuk figurojnë edhe në uebin e komunës. E njëjta mund të thuhet edhe për Kuvendin Komunal, me dallimin e vetëm që disa anëtar të KK-së nuk e kanë të publikuar deklaratën e pasurisë as në AKK.<sup>1</sup> Megjithatë, përgjegjësia nuk është e qartë, pasi që disa deklaratat nuk ekzistojnë gjatë një periudhe kohore por ishin publikuar rreth fundit të vitit. Ndërsa në një rast ekziston emri i anëtares komunale por deklaratat e pasurisë është e tjetër kujt, gjë e cila sugjeron që anëtarja komunale ka dorëzuar deklaratën e pasurisë, por AKK gabimisht ka ngarkuar deklarate tjetër.<sup>2</sup> Në përgjithësi, deklaratat e pasurisë nuk ofrojnë të dhëna krahasuese kohore, që të bëhen krahasime të pasurisë gjatë mandatit, dhe në disa raste deklaratat janë konfuze dhe të paplota. Përjashtim këtu bën kryetari i komunës, cili figuron në platformën e Lëvizjes FOL dhe ku mund të krahasohen deklaratat e pasurisë ndër vite.<sup>3</sup> Ndërsa sa i përket qartësisë dhe cilësisë të deklaratave të pasurisë, në shumicën dërmuese pagat janë të deklaruara por jo edhe kompensimet shtesë.

Sa i përket konfliktit të interesit, informatat janë jo ekzistente për pothuajse të gjithë zyrtarët e lartë politik të komunës dhe kuvendit komunal. Bazuar në infor-

<sup>1</sup> Për më shumë, shih vegezen [http://akk-ks.org/sq/deklarimet?path=declaration\\_assets%2F2015%2FKomunat%2FKomuna\\_e\\_Pejes#indexmain](http://akk-ks.org/sq/deklarimet?path=declaration_assets%2F2015%2FKomunat%2FKomuna_e_Pejes#indexmain)

<sup>2</sup> Rasti i Luljeta Kelmendi-Rexhepi, [http://www.akk-ks.org/sq/deklarimet?path=declaration\\_assets%2F2015%2FKomunat%2FKomuna\\_e\\_Pejes#indexmain](http://www.akk-ks.org/sq/deklarimet?path=declaration_assets%2F2015%2FKomunat%2FKomuna_e_Pejes#indexmain)

<sup>3</sup> Platforma e krahasimit të pasurisë, Lëvizja FOL <http://deklarimi.levizjafol.org/Zyrtaret/Pasuria/1493/Gazmend-Muhaxheri>

matat e brendshme, ndonjëherë edhe të dërguara në mënyrë anonime,<sup>4</sup> AKK i ka njoftuar nënkryetarin, disa drejtorë dhe anëtarë të KK-së për konflikt interesi. Pas njoftimit të AKK-së, këta të fundit kanë marrë masa për shmangien e konfliktit të interesit. Disa prej tyre janë tërhequr plotësisht nga pozita politike – për shembull, Musa Nikqi.<sup>5</sup>

Kanalet e komunikimit me qytetarë ekzistojnë ani pse jo gjithmonë janë efektive. Është praktikë e përgjithshme që pothuajse të gjithë anëtarët politik në komunën e Pejës i kanë të publikuara informatat kontaktuese. Gjithashtu, kryetari i komunës ka në agjendën e tij një termin javor kur takohet me qytetarë, ndërsa drejtorët nuk kanë një termin të tillë javor, edhe pse janë të hapur për takime. Megjithatë, ka pasur disa raste që qytetarët nuk kanë mundur të kontaktojnë me drejtorët, kryetarin apo nuk kanë pranuar përgjigje në pyetjet dhe shqetësimet e tyre drejtuar në postën elektronike.

Njoftimet për seancat e Kuvendit në përputhje me ligjin publikohen në ueb dhe vende publike 7 ditë para takimit, me rendin e ditës. KK publikon procesverbalet, vendimet, dhe transmeton drejtpërdrejtë seancat. Nuk ka kalendar të publikuar me informata të plota mbi aktivitetet e kryetarit. Njoftimet paralajmëruese i dërgohen gazetarëve dhe shoqërisë civile. Një pjesë e tyre në formë lajmesh publikohen edhe në ueb faqe.<sup>6</sup>



### Nota: 3 (Neutrale)

*Arsyetimi: CV-të për anëtarët e KK-së mungojnë për shumicën dërmuese, si dhe për dy drejtorë. Deklaratat e pasurisë janë të publikuara për pothuajse të gjithë, por në disa raste ato janë konfuzë apo të paplota. Mosdeklarimi i konflikteve të interesit nga zyrtarët e lartë publik është një dukuri shumë negative. Informatat kontaktuese janë prezentë për pothuajse të gjithë zyrtarët e lartë publik, edhe pse ka ende shumë hapësirë për përmirësim të efikasitetit të tyre. KK-ja aplikon praktika të mira për informim, edhe pse mungon një kalendar mbi aktivitetet e kryetarit.*

## 2. Organizimi dhe funksionimi

*Publiku duhet të ketë informata të mjaftueshme për të kuptuar organizimin, kompetencat, funksionimin, procesin e vendimmarrjes dhe të politikëbërjes të trupave të ndryshme komunale.*

Komuna e Pejës ka të publikuar në ueb faqe organogramin e përgjithshëm të komunës. Të publikuara janë gjithashtu edhe organogramet specifike të disa drejtorive; megjithatë, këto organograme jo gjithmonë janë të përditësuara, si për shembull organogrami i drejtorisë së zhvillimit ekonomik. Ndërsa për KK-në,

<sup>4</sup> Rasti i anëtarit të Kuvendit Komunal, Musa Nikqi <http://akk-ks.org/repository/docs/01-169-2015-Musa%20Nikqi.pdf>

<sup>5</sup> Po aty

<sup>6</sup> <https://kk.rks-gov.net/peje/>

nuk ka organogram apo informata shitesë, përveç informatave rreth organizimit të komunës dhe rreth kompetencave të kryetarit, drejtorëve, dhe kuvendit, që vijnë nga statuti i komunës. Mirëpo as këto informata nuk janë të përditësuara. Përderisa ka pasur amandamentime në statut, këto amandamente nuk figurojnë në dokumentin e prezantuar në uebin e komunës. Ndërsa për organet e decentralizuara nuk ka pothuajse aspak informata, apo në rastin më të mirë këto informata janë tejet sipërfaqësore. Gjithashtu në të gjithë dokumentet gjuha teknike dhe ligjore mund të jetë barrierë për qytetarët që të kuptojnë organizimin, kompetencat dhe funksionin e të gjitha organeve komunale.

Mënyrat më efektive për ndikim në politikëbërje dhe vendimmarrja janë të shpalosura në mënyrë të kufizuar. Në njërin anë, janë të publikuara rregulloret e aprovuara, vendimet e kuvendit, dhe procesverbalet. Në anën tjetër, mungojnë rendet e ditës – së paku për vitin 2015 – dhe informata tjera rreth ciklit të politikbërjes dhe si mund të marrin pjesë edhe qytetarët. Ato pak informata janë të paplota. Ndërsa rregulloret, vendimet dhe procesverbalet nuk janë të renditura kronologjikisht dhe funksioni i kërkimit në ueb faqe nuk funksionon, gjë e cila e bën shumë të vështirë qasjen në këto dokumente.

Kanalet e komunikimit zyrtar, ndonëse përgjithësisht të publikuara, nuk janë të përhapura e as të promovuara. Komunikimi është më efikas në baza personale me zyrtarët komunal. Nuk ekziston një sistem që do të fuqizonte kanalet e komunikimit zyrtar, në mënyrë që ta bëjë më të përhapur dhe më të qëndrueshme këtë praktikë. Ndërsa për informatat kontaktuese për institucionet vartëse të komunës – si muzetë, teatrot, etj – nuk ekzistojnë.

Informatat e publikuara për planet afatmesme, afatgjata dhe draft-dokumente janë të kufizuara. Së pari, edhe pse ekziston hapësira në ueb faqe për draft-dokumentet, përmes të cilave qytetarët do të ishin në gjendje të shihnin dhe potencialisht të shprehnin dëshirën për ndryshime, asnjë dokument nuk është i publikuar. Sa i përket dokumenteve strategjike, janë të publikuara dokumente si plani zhvillimor komunal dhe urban, strategjia për zhvillim ekonomik, dhe korniza afatmesme e shpenzimeve. Megjithatë, shumë prej dokumenteve – sidomos ato buxhetore – nuk janë të përditësuara. Ato që janë të publikuara i nuk janë të organizuara mirë, kanë formate të ndryshme, dhe përgjithësisht janë një lëmsh.

Të dhënat mbi komunën ekzistojnë, por janë të mangëta dhe në disa raste edhe të pa përditësuara. Ekzistojnë të dhëna statistikore mbi popullsinë, historinë, kulturën, sportin, por shumë prej këtyre të dhënave janë të pa përditësuara. Mirëpo këto të dhëna nuk janë të qasshme për të gjithë pasi që shumë prej tyre janë vetëm në gjuhën shqipe, dhe mungojnë versionet për gjuhën serbe apo angleze.



## Nota: 2 (Negative)

*Arsyetimi: Informatat aktuale të ofruara nga Komuna nuk i mundësojnë publikut të gjerë që të kuptojë lehtë organizimin, kompetencat, funksionimin, procesin e vendimmarrjes dhe të politikëbërjes të trupave të ndryshme komunale. Ato kryesisht mjaftojnë për përmbushjen e obligimeve minimale ligjore, por jo edhe për promovimin e një qasjeje proaktive për afrimin e publikut. Shumë prej të dhënave nuk janë të përditësuara, dhe në disa raste dokumentet dhe informatat ekzistojnë vetëm në gjuhën shqipe.*

### 3. Puna e organeve politikë-bërëse dhe vendim-marrëse

*Publiku duhet të ketë informata të detajuara, përditësuara, dhe të mjaftueshme për të vlerësuar problematikat kryesore të debatuar dhe vendimet kryesore të marra nga organet politikë-bërëse dhe vendim-marrëse të Komunës.*

Organet komunale të Komunës së Pejës kanë aplikuar praktika të rregullta për shtytjen e qytetarëve që të jenë vëzhgues aktiv të debateve dhe proceseve vendim-marrëse. Qytetarët njoftohen me kohë rreth takimeve, publikohen proces-verbalet dhe rendet e ditës. Përmes projektit “Open Doors”, mbështetur nga OSBE, komuna e Pejës është takuar me qytetarë për të rritur transparencën. Në takime marrin pjesë edhe organizata të ndryshme, si OSBE, KFOR, apo organizata tjera të shoqërisë civile. Komuna nuk ka nënshkruar kontratën për transmetimin direkt të seancave të Kuvendit në TV lokale, megjithatë ekziston një kanal në ueb faqe (livestreaming) përmes të cilit mundësohet ndjekja direkt e seancave.<sup>7</sup> Ndërsa sfidë mbetet pjesëmarrja relativisht e ulët e qytetarëve në takimet e komisioneve të Kuvendit.

Raportimi i Ekzekutivit në Kuvend ndodhë por jo në baza të rregullta. Kryetari raporton në kuvend dhe në komision, mirëpo këto raportime rrallë herë dokumentohen. Në vitin 2011 dhe 2012 zyra e kryetarit kishte përgatitur një raport për punën e komunës, mirëpo një gjë e tillë nuk ka vazhduar edhe në vitet tjera.<sup>8</sup> Ndërsa drejtorët kanë dërguar raportet e punës, mirëpo raportime direkte në kuvend dhe komision në përgjithësi nuk ka.

Përgjithësisht, qytetarët mund të informohen për punën e komunës. Pasqyrat financiare, planet komunale, rregulloret, vendimet, procesverbalet, planet zhvillimore dhe urbane, dhe dokumente tjera janë të publikuara në ueb faqe. Por, përkundër gjithë këtyre dokumenteve të publikuara, ka gjithashtu mangësi të mëdha. Për shembull, vendimet gjinden të publikuara por jo edhe arsyetimet, ekziston rubrika për publikimin e draft-dokumenteve, por draft dokumentet nuk janë publikuar,<sup>9</sup> dhe propozimet legjislative dhe nismat tjera janë të publikuara por vetëm si pjesë e procesverbaleve gjë e cila e bën shumë të vështirë qasjen në to. Gjithashtu, këto dokumente janë një lëmsh në aspektin e organizimit, gjë e cila e vështirëson tejet shumë qasjen efektive në to. Në anën tjetër, mungon një bazë e të dhënave me rregullore të shqyrtuara, aprovuara, dhe sa vota kanë qenë për, sa kundër, dhe sa abstenime. Nuk ekzistojnë as video të mbledhjeve, edhe pse ekziston mundësia – e karakterizuar me shumë probleme teknike megjithatë – që mbledhjet të shihen drejtpërdrejt në uebin e komunës.

<sup>7</sup> Për më shumë, shih <https://kk.rks-gov.net/peje/Assembly{1}/Transmetim-live.aspx> [Vërejtje: linku funksionon vetëm kur ka seanca]

<sup>8</sup> Shih raportet këtu: <https://kk.rks-gov.net/peje/Temat/Raport-Pune-i-Kryetarit.aspx>

<sup>9</sup> Gjatë kohës së hulumtimit, nuk ka pas asnjë dokument të publikuar. Pas diskutimit për validitetin e të gjeturave të këtij raporti, janë shtuar disa dokumente. Për më shumë, shih <https://kk.rks-gov.net/peje/Assembly{1}/Draft-Dokumentet.aspx>



### Nota: 3 (Neutrale)

*Arsyetimi: Komuna ka aplikuar praktika të mira sa i përket kontaktit me qytetarë dhe pjesëmarrjen e tyre në debate publike. Megjithatë, ka mungesë të madhe të dokumenteve të detajuara, përditësuara, dhe organizuara mirë për vlerësimin e punës së komunës si nga ana e kuvendit për ekzekutivin, po ashtu edhe për qytetarët për komunën në përgjithësi.*

## 4. Luftimi i sjelljeve të pahijshme dhe keqpërdorimeve

*Komuna duhet të publikojë informata të rëndësishme nga të cilat lehtësisht mund të vlerësohet niveli i përkushtimit të saj në luftimin e sjelljeve të pahijshme dhe keqpërdorimeve.*

Në Komunën e Pejës, konfliktet e interesit të anëtarëve të Kuvendit, të kryetarit të Komunës, të nënkryetarëve, të drejtorëve të drejtorive të Komunës dhe të nëpunësve të administratës komunale përkufizohen në statutin e Komunës<sup>10</sup> dhe udhëzimin administrativ për përgjegjësitë në punë. Përveç këtyre dy dokumenteve ekziston edhe kodi i etikës. Për të aplikuar këto dokumente është formuar komisioni disiplinor, i përbërë nga tre anëtarë.

Mirëpo, niveli i transparencës për aktivitetet në luftën kundër mashtrimeve apo keqpërdorimeve është relativisht i ulët. Kjo ndodhë kryesisht për shkak se vendimet e marra i jepen parashtruesit por ato nuk publikohen. Gjithashtu, udhëzimi administrativ për përgjegjësitë në punë nuk është i publikuar në ueb faqe të komunës. Numri i rasteve të hetuara ka qenë 10 në total, nga të cilët 5 janë cilësuar si raste të lehta ndërsa 5 tjera si raste të rënda. Ndërsa si mekanizëm përcjellës është udhëzimi administrativ për përgjegjësitë në punë.

Niveli i informimit të publikut për mekanizmat e raportimit të keqpërdorimeve të mundshme është tejet i ulët, pasi komuna nuk ofron informata të mjaftueshme për të shpjeguar me saktësi se çfarë përbën keqpërdorim dhe nuk ka ofruar asnjë mundësi për publikun që t'i komunikojë rastet e tilla. Si praktikë e gjerë deri më tani kanë qenë vetëm vërejtjet me gojë tek eprorët apo te kryetari i komunës.



### Nota: 3 (Neutrale)

*Arsyetimi: Në bazë të akteve në fuqi dhe praktikave të zbatuara del se Komuna e Pejës ka mekanizma relativisht të mirë për luftimin e sjelljeve të pahijshme. Megjithatë, niveli i informimit të publikut për mekanizmat e raportimit është shumë i ulët dhe praktikat e tanishme janë kryesisht informale gjë e cila anashkalon procedurat institucionale. Ndërsa në aspektin e transparencës, komuna është relativisht transparente edhe pse ka edhe shumë hapësirë për më shumë transparencë.*

<sup>10</sup> Statuti i Komunës, Kapitulli VI, Konflikti i interesave, <https://kk.rks-gov.net/peje/Files/Dokumente/statuti-2008.aspx>

## 5. Integrimi Evropian

*Publikut duhet t'i ofrohet mundësia që të mësoj në mënyrë të saktë dhe të detajuar obligimet, arritjet dhe sfidat që i ka komuna në procesin e integrimit të Kosovës në BE.*


Në vitin 2015, Komuna e Pejës nuk ka publikuar asnjë informatë për obligimet që ka komuna në procesin e integrimit të vendit në BE. Komuna posedon listën e obligimeve që ka në procesin e integrimi evropiane, por ajo nuk është e publikuar, përkundër pretendimit nga drejtoresha e Integrimi evropiane që ajo është e publikuar në ueb faqe. Për më shumë, nuk janë të publikuara as statusi i përmbushjes së obligimeve dhe afatet kohore për arritje të këtyre qëllimeve. Komuna raporton tek Ministria e Administratës dhe Pushtetit Lokal, por një gjë të tillë nuk e bën tek qytetarët.

Publiku gjithashtu nuk ka informata mbi ndikimin në integrimi evropiane lidhur me çështjet ekonomike, çështjet sociale, çështjet e administratës publike, dhe të tjera.



### Nota: 1 (Negative)

*Arsyetimi: Publikut nuk i është ofruar asnjë mundësi që të ketë informata për aktivitetet e Komunës në raport me procesin e integrimit në BE. Gjithashtu publikut nuk iu janë ofruar as informata mbi ndikimin e procesit të integrimi evropiane.*



## II. Menaxhimi ekonomik dhe financiar

### 6. Kontabiliteti dhe buxheti

*Të dhënat dhe raportet e ndryshme dhe të përditësuara rreth të hyrave financiare, alokimeve buxhetore, shpenzimeve financiare, borxheve dhe kontesteve me pasoja financiare për komunën, duhet të jenë në dispozicion të publikut për të pasë pasqyrë të qartë mbi menaxhimin e parasë publike në nivel lokal.*

Komuna e Pejës ka ndërmarrë disa hapa drejt përfshirjes së publikut në planifikimin buxhetor. Autoritetet komunale gjatë vitit 2015 kanë planifikuar 11 debate publike me qytetarët në zonat rurale dhe një tjetër në sallën e KK-së për buxhetin e vitit 2016, nga të cilat 10 janë mbajtur. Raportet për këto debate ekzistojnë, por nuk janë të publikuara. Draft-buxheti nuk është publikuar online, por janë shpërndarë kopjet e shtypura. Procesverbalet e diskutimeve publike nuk janë publikuar e as propozimet që janë pranuar nga qytetarët apo nga anëtarët e komi-



sionit për financa. Në bazë të deklaratave të zyrtarëve komunal dhe anëtareve të kuvendit, ka pasur propozime dhe ide nga qytetarët edhe anëtarët e KPF që janë pranuar. Por, komuna akoma nuk ka ndërtuar një mekanizëm për regjistrimin e propozimeve të qytetarëve, si dhe për publikimin e vendimeve në qoftë se këto propozime janë përkrahur apo hedhur poshtë.

Të dhënat mbi ndarjet dhe realizimet buxhetore publikohen online në kuadër të "Si i shpenzon shteti parat tona?",<sup>11</sup> platformë e Institutit GAP që ka linkun edhe në ueb faqen e Komunës. Të dhënat mbi ndarjet dhe realizimet buxhetore publikohen edhe në formë të raporteve, vjetore dhe tremujore. Në dokumentin e buxhetit figurojnë të dhënat mbi projektin, shumën e planifikuar për shpenzim dhe burimet nëse janë nga granti qeveritar apo të hyrat vetanake dhe viti kur do të realizohet projekti i caktuar. Nuk ka shpjegime mbi qëllimet e projekteve. Ato në të shumtën e rasteve pasqyrohen në propozimet që adresohen te kryetari për lejimin e shpalljes së tenderëve. Këto propozime janë të qasshme për gazetarët dhe shoqërinë civile. Në Kornizën Afatmesme Buxhetore, figuron praktika e ngjashme sikurse në buxhetin vjetor, ku është edhe lista me projekte.<sup>12</sup> Komuna nuk ka arritur që të zhvillojë një tabelë interaktive të buxhetit shumëvjeçar.

Komuna e Pejës, njëjtë si të gjitha komunat tjera, auditohet rregullisht nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP). Raporti i ZAP është i publikuar në ueb faqen e komunës dhe është gjithashtu i qasshëm nga ueb faqja e ZAP. Në këtë raport qytetarët mund të njoftohen mbi praktikën e menaxhimit të financave publike.<sup>13</sup>

Ashtu si në rastin e planifikimit buxhetor, raportet për burimet e të ardhurave të komunës publikohen në formë të raporteve, vjetore dhe tremujore. Në përgjithësi mund të thuhet se ka informata të kënaqshme për të kuptuar burimet e të hyrave të Komunës.

Mirëpo, Komuna ofron pak informata për qytetarët mbi suficitin/deficitin buxhetor apo borxhet e saj, dhe llogaritë e arkëtueshme, apo detyrimet kontingjente. Publikimi i shumës së borxheve të komunës ndaj operatorëve të ndryshëm dhe llogarive të arkëtueshme, si dhe detyrimeve kontingjente ndodh zakonisht në kuadër të raportit vjetor të financave, pa sqarime, por vetëm në mënyrë të përmblendhur, që zakonisht nuk publikohet online.

Komuna nuk ofron informata mbi funksionimin e organizatave të cilat ofrojnë shërbime për qytetarët, ku komuna ka kompetenca, e aq më pak ndonjë të dhënë buxhetore të këtyre organizatave publike.

11 Si i shpenzon shteti parat tona?, Instituti GAP, <http://www.institutigap.org/spendings/?peje/2014#/~peje/shpenzimet-komunale>

12 Për më shumë, shih Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve këtu <https://kk.rks-gov.net/peje/Temat/KAB-2014-2016.aspx>

13 Raportet e Auditorit të Përgjithshëm mund të lexohen këtu <http://www.oag-rks.org/sq/Komunat?date=2014>





### Nota: 3 (Neutral)

Arsyetimi: Gjatë vitit 2015, Komuna e Pejës ka aplikuar politika dhe praktika për përfshirjen e publikut në hartimin e buxhetit. Megjithatë, mbetet një hapësirë e madhe që duhet mbushur për të arritur një transparencë të kënaqshme, s'komos në publikimin e propozimeve nga qytetarët dhe realizim apo mosrealizimin e atyre propozimeve, dhënien e më shumë sqarimeve rreth projekteve, detyrimeve kontigjente, borxheve, dhe mbi të gjitha ofrimin e së paku të dhënave bazike mbi funksionimin e organizatave të cilat ofrojnë shërbime për qytetarët ku komuna ka kompetenca.

## 7. Kontratat e prokurimit publik, furnizimit dhe granteve

*Marrëdhëniet kontraktuale me implikime financiare në mes të komunës dhe personave fizik dhe juridik duhet të zhvillohen në transparencë të plotë, për të siguruar menaxhimin e mirë të parasë publike dhe vlerën e duhur për shërbimet, punët apo furnizimet.*

Komuna e Pejës është treguar relativisht transparente sa i përket shpalesjes së informatave të vlerësimit të përshtatshmërisë së operatorëve për hyrje në marrëdhënie kontraktuale me ta, edhe pse ka shumë hapësirë për përmirësim të transparencës. Nuk ka informata të publikuara lidhur me mënyrën e përzgjedhjes dhe përbërjes së komisioneve vlerësuese, ani pse deri më tani ka qenë praktikë e gjerë që kjo të ishte nën diskrecionin e kryetarit që pastaj të interesuarit mund të njoftohen në Zyrë të Prokurimit (ZP). Njoftimet për kontrata nga Sektori i Prokurimit publikohen në KRPP dhe në të shumtën e rasteve edhe në ueb faqen e Komunës.<sup>14</sup> Arsyetimet për vendosjen e kriterëve zakonisht janë të publikuara në dosjen e tenderit në KRPP. Procesverbalet e komisioneve vlerësuese ekzistojnë, por nuk publikohen përveç nëse ka kërkesë zyrtare – që deri më tani komuna pohon që nuk ka pasur kërkesa të tilla. Manuale për proceset e konkurrimit, parime dhe kod të mirësjelljes për procese kontraktuese ekzistojnë në KRPP. Njoftimet mbi kontraktimet dhe tenderët e shumave të vogla shpallen në KRPP dhe në ueb faqen e komunës. Të gjitha projektet kalojnë përmes kuvendit komunal, gjë e cila siguron përputhjen e projekteve aktuale me ato të aprovuara nga kuvendi komunal. Ndërsa për hulumtimin e tregut, komuna përdorë draft-rregulloren e KRPP-së.

Transparenca në menaxhimin e projekteve dhe kontratave, ashtu edhe si në dhënien e tenderëve dhe kontratave, është kryesisht në dorë të KRPP-së dhe organeve që nuk kanë të bëjnë me komunën. Komuna në përgjithësi ka një qëndrim që këto çështje kanë të bëjnë me shumë me institucionet tjera sesa me vetë komunën. Për shembull, në intervistë me përfaqësuesit e ZP mbi performancën e kontraktorëve bazuar në indikatorët e përcaktuar në kontratë, qëndrimi ka qenë që kjo çështje i takon auditorit dhe jo ZP-së.<sup>15</sup> Gjithashtu në çështjen e përmbylljes së suksesshme të projekteve dhe raporteve mbikëqyrëse së puni-

<sup>14</sup> Për më shumë rreth njoftimeve të KRPP, shih [https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CID=SearchNotices&ind=1&PPRCMenu\\_OpenNode=63](https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CID=SearchNotices&ind=1&PPRCMenu_OpenNode=63)


<sup>15</sup> Haxhi Gashi interviste me Vullnet Sanaja me datën 09.10.2015

meve gjatë realizimit të projekteve, ZP konsideron që nuk është e obliguar t'i bëjnë këto informata publike, por që ZP raporton tek kryetari i cili pastaj raporton në kuvend komunal.<sup>16</sup> Gjatë këtij zinxhiri, shumë nga informatat nuk përfundojnë në publik.



### Nota: 2 (Negative)

*Arsyetimi: Vlerësimi për këtë indikator është negativ kryesisht për shkak të qëndrimit të komunës që transparencën në menaxhimin e projekteve dhe kontratave është në pjesën më të madhe në institucione tjera (ZAP dhe KRPP). Përkundër kësaj, komuna e Pejës aplikon praktika relativisht të mira të transparencës në procesin e përzgjedhjes së marrëdhënies kontraktuale, edhe pse ka hapësirë të madhe për përmirësim.*



## III. Menaxhimi i resurseve njerëzore dhe resurseve tjera

### 8. Të punësuarit në administratën publike dhe organizatat/institucionet publike

*Menaxhimi i resurseve njerëzore duhet të bëhet në mënyrë transparente duke përfutur nga mbikëqyrja evazhdueshme e publikut mbi performancën e administratës.*

Administrata komunale e Pejës organizohet në drejtori, si dhe Zyra. Secila drejtori e zyre komunale udhëhiqet nga drejtori përkatësisht shefi. Drejtorët emërohen dhe shkarkohen nga Kryetari i Komunës. Në përgjithësi, ka përshkrim të detyrave dhe përgjegjësisve të pozitave kryesore të cilat iu jepen punëtoreve në dosje të punës. Nuk ka raporte apo analiza të publikuara të sektorit të administratës publike, e as listë të gjithë personave të administratës. Informata kontaktuese të personave kryesorë ka, derisa pagat nuk bëhen publike.

Informatat mbi funksionimin e organizatave/institucioneve të ndryshme komunale jo gjithëherë janë të qarta për publikun. Ekzistojnë disa organograme apo udhëzime të publikuara, që tregojnë lidhjen, përgjegjësitë dhe kompetencat. Megjithatë, këto organograme janë ose shumë të përgjithshme ose nuk figurojnë në të gjitha drejtoritë.

<sup>16</sup> Haxhi Gashi interviste me Vullnet Sanaja me datën 09.10.2015

Praktikat e rekrutimit/punësimit janë të rregullta në ndjekjen e procesit ligjor. Për reklamimin e një vendi të lirë punë bëhen publikime të thirrjes për aplikim në disa gazeta, si dhe thirrja vendoset në hapësirat fizike të caktuara në objektin e komunës, dhe në ueb faqe. Gjithashtu thirrja postohet edhe në Vitomiricë për të siguruar pjesëmarrjen e grupeve minoritare. Përkundër procesit të rregullt ligjor, janë ngritur shqetësime nga gazetarë që në shumë raste personat e punësuar janë caktuar përpara fillimit të procesit zyrtar për punësim. Në këtë mënyrë procesi i punësimit është njollosur me motive politike apo nepotiste.

Nuk ka informata sa i përket performancës së administratës. Kodi i Etikës dhe Mirësjelljes ekziston dhe i jepet te punësuarve në ditët e para të punësimit, por ky dokument nuk është i publikuar. Për aktivitetet dhe vendimet e mekanizmave për vlerësim të performancës dhe sjelljes i'u është dërguar kërkesë zyrtare por komuna nuk është përgjigjur.<sup>17</sup> Komuna nuk është përgjigjur as në kërkesën për dokumentet për vlerësimin dhe emërimin e anëtarëve të boreve të ndërmarrjeve publike.<sup>18</sup> Në të dy rastet mund të supozohet që këto dokumente nuk janë publike. Nuk ka pasur raportime të konfliktit të interesit, pos rasteve që të janë iniciuar e hetuar nga AKK-ja.<sup>19</sup>



## Nota: 2 (Negative)

*Arsyetimi: Organizimi i administratës, funksionet e personave kyç, organizatave dhe institucionet tjera përtej disa organogrameve të përgjithshme nuk janë të shpjeguara mirë. Praktikrat e punësimit, përkundër procedurave të rregullta ligjore në reklamim, janë karakterizuara nga parregullsi në përzgjedhje të personave. Ndërsa ka shumë pak – pothuajse aspak – informata rreth performancës së administratës në bazë të standardeve më të larta.*

## 9. Pasuria kapitale dhe jokatitale

*Publiku duhet të ketë informata të përditësuara dhe të plota mbi menaxhimin e pasurisë publike nga ana e pushtetit komunal.*

Komuna nuk ka publikuar një listë të të gjitha patundshmërive. Në kërkesën për listën e të gjitha patundshmërive, komuna nuk është përgjigjur asnjëherë gjë e cila pamundëson njohurinë për regjistrin e pronës, regjistrin e ndërtesave dhe banesave, regjistrin e pronave, dhe informata si vlera, sipërfaqja, përdorimi etj i këtyre pronave.<sup>20</sup> Në mungesë të përgjigjes, nuk dihet nëse ka harta interaktive që paraqesin saktësisht lokacionin e këtyre pronave, apo bazë të të dhënave për çfarëdo informate tjetër. Sido që të jetë, komuna me mospërgjigje ka qenë shumë e mbyllur dhe jo transparente.

<sup>17</sup> Kërkesë zyrtare përmes email-it drejtuar zyrtares për qasje në dokumente publike, 21.10.2015

<sup>18</sup> Kërkesë zyrtare përmes email-it drejtuar zyrtares për qasje në dokumente publike, 26.10.2015

<sup>19</sup> Për më shumë rreth raporteve të AKK-së, shih <http://akk-ks.org/sq/vendimet>

<sup>20</sup> Kërkesë zyrtare përmes email-it drejtuar zyrtares për qasje në dokumente publike, 26.10.2015

Nuk ka informata apo vendime të publikuara me të cilat synohet që të arsyetohet se përdorimi i tillë i këtyre patundshmërive është në të mirë të përgjithshme. Vendimet dhe arsyetimet e komunës për të përdorur apo për të lëshuar me qira këto prona në disa raste gjinden brenda vendimeve të kuvendit, por nuk ka as ndonjë vend të veçantë për këto vendime e as një listë të vendimeve për të gjitha pronat. Ndërsa kërkesës për listën e publikuar të pronave që janë transferuar nga komuna të pronarët tjerë me arsyetimet e duhura komuna gjithashtu nuk i'u është përgjigjur.<sup>21</sup>

Komuna nuk ka publikuar listë të pasurive jo-kapitale, si inventar, automjete, etj.

Komuna nuk ka ofruar ndonjë të dhënë për aksionet apo pronësinë në kompani të ndryshme.



### Nota: 1 (Negative)


Arsyetimi: Sa i përket pasurisë kapitale dhe jokapitale, komuna ka ofruar aq pak informacione saqë është vështirë të elaborohet më shumë në këtë pikë. Andaj edhe vlerësimi nuk mund të jetë më shumë se më i ulëti i mundshëm.

### Komentet e Komunës:

Me ndihmën e USAID-it, Komuna vite më parë e ka bërë një regjistër, i cili nuk ka qenë i kompletuar, prandaj nuk është publikuar. Bazuar në ligj ka qenë e pamundur që të bëhet vlerësimi i pasurisë, se sa është vlera, në një vend ku mungon indeksi i çmimeve apo bursa e tregut, dhe për këtë është shumë e vështirë që të bëhet. Pasuria jo-kapitale e Komunës regjistrohet çdo herë dhe të gjithë regjistrin e bën secili komision administrativ për secilën njësi. Ndërsa për regjistrin e pasurisë kapitale, në kadastër ekziston komplet regjistri, por mungon vlerësimi dhe është e vështirë që të bëhet ai vlerësim nëse ligji nuk e ka përcaktuar se kush mund ta bëjë këtë vlerësim<sup>22</sup>.

21 Kërkesë zyrtare përmes email-it drejtuar zyrtares për qasje në dokumente publike, 26.10.2015

22 Gazmend Muhaxheri, Kryetar i Komunës së Pejës, Fokus Grup, Pejë, 29 janar 2016



## IV. Marrëdhëniet me qytetarët dhe shoqërinë

### 10. Informimi dhe shërbimi i qytetarëve

*Transparenca komunale duhet të jetë e avancuar duke i mundësuar publikut qasje të lehtë në informata, informim të saktë, të shpejtë dhe të detajuar rreth çështjeve që ndërlidhen me politikën, vendimet dhe shërbimet për qytetarët.*

Në Komunën e Pejës ekziston Zyra për Informim, kontakti me të cilën mund të vendoset lehtë. Zyra është efikase në kthimin e përgjigjeve në raste kur qasja në dokumente publike aprovohet, por jo edhe aq efikase në mundësimin e qasjes së plotë në dokumentet publike. Nuk ka publikuar statistika rreth përdorimit të rrjeteve sociale, rreth përdorimit të mjeteve mobile, rreth shërbimeve përmes telefonit. Nuk ka statistika as rreth këshillimit të qytetarëve dhe shërbimeve të informatave.

Plan i veprimit i komunës për avancim të transparencës në nivelin komunal ekziston si draft-rregullorë. Meqë është ende e pa miratuar, është e pamundur të komentohet më shumë. Ndërsa miratimi i saj pritet së shpejti.

Ueb faqja e Komunës së Pejës - <https://kk.rks-gov.net/peje> - përmban relativisht shumë informata. Organizimi i ueb faqes duhet të përmirësohet për të lehtësuar qasjen dhe të jetë më praktike. Në të shumën e rasteve informatat dhe dokumentet janë publikuara nëpër linqe të ndryshme, vështirë për t'u identifikuar, që nganjëherë krijojnë huti te përdoruesi. Në shumë raste informatat nuk janë të përditësuara. Nuk ka infografika. Nuk ka as raporte rreth popullaritetit të ueb faqes. Nuk ka ndonjë masë promovuese për të rritur numrin e vizitorëve dhe përdoruesve të shërbimeve.

Nuk ka forum për diskutim në ueb faqen e komunës përveç rubrikës së dërgimit të komenteve, të cilat dërgohen tek komuna por nuk shfaqen publikisht dhe nuk ka hapësirë për diskutim. Komuna nuk ka kryer hulumtime të opinionit publik rreth transparencës në komunë.

Komuna e Pejës përdor dhe rrjetin social Facebook për pasqyrimin e aktiviteteve të saj.<sup>23</sup> Rrjetet sociale i përdorë edhe kryetari, përmes të cilës njofton qytetarët për aktivitetet e tij.<sup>24</sup> Nuk ka publikuar raporte me statistika rreth përdorimit dhe efikasitetit të rrjetit social, e as nuk është vërejtur ndonjë fushatë promovuese për shtimin e ndjekësve. Në rrjetet sociale kryesisht postohen lajmet që publikohen dhe në ueb faqe dhe nuk ka infografika, video apo animacione. Nuk ka aplikacione as për telefona të mençur me informata të ndryshme për komunën.

Materialet përkthehen në të gjitha gjuhët zyrtare, mirëpo nuk publikohen. Sipas komunës, kjo ndodhë për shkak të problemeve teknike me ueb faqe.

<sup>23</sup> Për më shumë, shih <https://www.facebook.com/komuna.peje>

<sup>24</sup> Për më shumë, shih <https://www.facebook.com/gazmuaxheri/?fref=ts>

Qasja në dokumentet publike mundësohet. Sipas zyrës për informim në tre muajt e fundit janë bërë pesë kërkesa për qasje në dokumente publike, dhe që të pesta janë aprovuar.<sup>25</sup> Përkundër pretendimeve të komunës për efikasitetin e plotë për qasje në dokumente publike, ka ankesa që kërkesat e shoqërisë civile jo gjithmonë janë marrë parasysh nga komuna, apo së paku jo brenda afatit të caktuar me ligj. Shembull i kësaj të fundit janë kërkesat për përpilimin e këtij raporti. Numerikisht, komuna ka garantuar qasjen në dokumente publike në shumicën e rasteve, megjithatë numrat, të vetëm, nuk janë indikator i qasjes në dokumente publike sidomos duke pasur parasysh që disa dokumente janë më të rëndësishme se tjerat.

Informatat rreth shërbimeve për qytetarët janë të mangëta. Nuk ka statistika mbi shërbimet e ndryshme, Shërbimet Administrative, Mirëqenia Sociale dhe Familjare, Kulturë-Rini-Sport, Emergjencat Lokale, Parqet dhe Sheshet, Trotualet, Transporti Publik Komunal, Parkingjet Publike, Ndriçimi Publik, Furnizimi me ujë, Kanalizimi, Grumbullimi i Mbeturinave, Deponimi i Mbeturinave, pastaj për çështjet që ndërlidhen me shëndetësinë, arsimin, sigurinë, kompanitë publike, hapësirat gjelbëruese, barërat nga lista esenciale, edukimi para universitar, harta interaktive, temat, kapaciteti, gjendja e trafikut, incidentet që ndërlidhen me shërbime komunale, informata të përditësuara mbi ndotjen e ajrit dhe zhurmës.



## Nota: 2 (Negative)

*Arsyetimi: Vlerësimi për Informimin dhe shërbimin e qytetarëve është karakterizuar nga kontraste. Aspektet pozitive të përdorimit të rrjeteve sociale dhe qasjes në dokumente publike janë të kundërbalancuara nga aspektet negative të mungesës së informatave rreth shërbimeve për qytetarë dhe mungesës së publikimit të informatave në gjuhë tjera përveç gjuhës shqipe. Me relativisht pak punë dhe mund në zgjidhjen e problemeve teknike dhe shtimin e informatave rreth shërbimeve për qytetarë i gjithë ky seksion mund të përmirësohet lehtë. Megjithatë, përderisa situata e tanishme vazhdon, vlerësimi për këtë seksion vazhdon të mbetet vetëm në notën dy.*

## 11. Bashkëpunimi me shoqërinë civile

*Organet komunale duhet të jenë të hapura dhe të angazhohen për qeverisje transparente duke thelluar bashkëpunimin me shoqërinë civile.*

Komuna e Pejës ka disa memorandume bashkëpunimi me organizata të shoqërisë civile, mirëpo këto memorandume nuk janë të publikuara. Përveç memorandumeve individuale me organizata të ndryshme të shoqërisë civile, nuk ka udhëzues për pjesëmarrje qytetare dhe për shfrytëzimin e kanaleve të ndryshme për të kuptuar më mirë dokumentet dhe informatat e publikuara nga komuna, përkundër një numri relativisht të madh dhe aktiv të organizatave të shoqërisë civile.

Komuna mban takime me qytetarë për të raportuar punën e ekzekutivit, për të marrë komente nga qytetarë sa i përket politikave komunale dhe projekteve.

<sup>25</sup> Ariana Lukaj intervistë me Vullnet Sanaja me datën 09.10.2015


Sipas komunës, numri i takimeve ka qenë 20. Megjithatë, sipas disa gazetarëve, pjesëmarrja e qytetarëve në këto takime jo gjithmonë është kënaqshme. Në disa raste tjera sallat ishin të mbushura nga militantë partiak. Raportimi i komunës dhe bashkëbisedimi bëhet në mënyrë gojore dhe shpesh mungojnë dokumentimet e këtyre takimeve. Ndërsa informata mbi këshillat lokal nuk janë të publikuara.

Komuna e Pejës ka aplikuar disa praktika për konsultimin e qytetarëve rreth dokumenteve me interes para se ato të aprovohen. Numri i konsultimeve publike nuk është dhënë, megjithatë konsultime janë organizuar në bashkësitë territoriale. Drejtoria e Kulturës gjithashtu ka organizuar një takim për diskutim me qytetarë për një rregullore me interes publik.<sup>26</sup> Ndërsa kryetari ka të ndarë një termin ditëve të enjte të cilin e shfrytëzon për takimin me qytetarë.



### Nota: 3 (Neutrale)

*Arsyetimi: Në aspektin negativ, komuna ende nuk ka iniciuar ndonjë proces për themelimin e mekanizmave konsultativ, që do të shtonte bashkëpunimin me organizatat e shoqërisë civile. Përkundër kësaj, komuna ka disa memorandume të mirëkuptimit me organizata individuale të shoqërisë civile. Komuna gjithashtu organizon takime me qytetarët ose përmes drejtorive ose përmes bashkësive territoriale. Ndërsa kryetari ka një termin të caktuar javor në të cilin takohet me qytetarë.*



## V. Planifikimi dhe zhvillimi urban

### 12. Planifikimi urban

*Publiku duhet të ketë qasje në informata të rëndësishme që ndërlidhen me planifikimin urban, pasi kjo përbën një nga parimet themelore të qeverisjes së mirë.*

Publiku është pjesërisht i informuar sa i përket akteve normative dhe dokumenteve strategjike në fushën e planifikimit urban. Sa i përket strategjive, në ueb faqe mund të qaset Plani Zhvillimor Urban 2006-2025, ndërsa aty mund të qasen gjithashtu planet rregulluese urbane, kushtet e ndërtimit, dhe raportet për lëshimin e lejeve ndërtimore. Por mungojnë dokumente për procesin e marrjes së lejes së ndërtimit, dhe informata me të detajuara rreth mundësive, kufizimeve dhe autoriteteve përgjegjëse rreth urbanizimit.

Komuna përdor hartat e tipit të sistemit informativ gjeografik (GIS hartat) të cilat i ofrojnë qytetarëve shumë informata rreth shërbimeve, aktiviteteve dhe resurseve në territorin e komunës. Megjithatë ky shërbim është i shquar të jetë

<sup>26</sup> Dëgjimi publik lidhur me draft rregulloren i organizuar me 05.10.2015

tejet i ngadalshëm, shpesh deri në pikën që është jofunksional. Në anën tjetër, nuk ka të dhëna për planet për mbrojtje të ambientit dhe menaxhimin të resurseve natyrore, kualitetin të ujit në hapësira të caktuara, emitimit të gazrave, dhe informata të sakta të destinimit të tokës.

Komuna e Pejës është relativisht jo transparente në lidhje me lejet e ndërtimit dhe shfrytëzimit të hapësirave. Lejet e ndërtimit janë të publikuara, megjithatë nuk janë të publikuara vendimet apo arsyetimet për lejet e ndërtimit të lëshuara. Gjithashtu nuk janë të publikuara as procesverbalet e mbledhjeve të komisioneve që kanë aprovuar leje e ndërtimit. Ndërsa shumica dërmuese e lejeve të lëshuara të ndërtimit janë në përputhje me planet aktuale urbane të komunës – gjë e cila do të duhej të ishte plotësisht në përputhje.



### Nota: 3 (Neutrale)

*Arsyetimi: Komuna e Pejës është relativisht transparente sa i përket planifikimit urban. Një pjesë e madhe e dokumenteve normative janë të publikuara në ueb faqe, edhe pse ka shumë dokumente me rëndësi që mungojnë. Një hap shumë pozitiv është futja në përdorim e GIS hartave, por jo edhe mungesa e informatave ambientale dhe të destinimit të tokës. Publikimi i lejeve të lëshuara për ndërtim gjithashtu prezanton një hap pozitiv, por bashkë me to duhet të publikohen edhe procesverbalet, vendimet dhe arsyetimet për këto leje.*

### Komentet e Komunës:

*Planet dhe lejet e ndërtimit janë të publikuara, por jo edhe vendimet apo arsyetimet. Ka nisur zbatimin e një projekti me USAID-in dhe nga viti 2016 do t'i skanojmë edhe do t'i postojmë edhe vendimet dhe arsyetimet. Në vitin 2016 në ueb-faqe do t'i kemi të publikuara.<sup>27</sup>*

## 13. Monitorimi i projekteve urbanistike

*Komuna duhet në vazhdimësi ta informojë publikun për rrjedhën e projekteve të cilat kanë ndikim në planifikimin dhe zhvillimin urban.*

Komuna e Pejës nuk i është përgjigjur kërkesës për informata rreth rasteve të ndërhyrjes së inspektorëve, rezultateve dhe efikasitetit të tyre.<sup>28</sup> Nuk ka ndonjë informate rreth kësaj teme në ueb faqe apo dokument tjetër fizik që është publik në objektet e komunës. Një raport mbi punën e inspektoreve ekziston, por ofron vetëm të dhëna tejet bazike dhe sipërfaqësore për punën e inspektorëve. Nuk ka mekanizëm për të përcjellur rastet e raportuara nga publiku. Gjithashtu nuk ka shenjëzim të hartave ku është duke u bërë shkelje. Përgjithësisht ka mungesë të

<sup>27</sup> Arbnesha Kryeziu Goga nga Drejtoria e Urbanizmit, Fokus Grup, Pejë, 29 janar 2016

<sup>28</sup> Kërkesë zyrtare përmes email-it drejtuar zyrtares për qasje në dokumente publike, 26.10.2015



madhe të informatave dhe transparencës sa i përket aktiviteteve të komunës për monitorimin e planit urbanistik.

Publiku nuk ka informata të mjaftueshme për performancën e kompanive të kontraktuara nga komuna për të zhvilluar projekte urbanistike. Nuk ka të dhëna specifike me emrat e kompanive që kanë kryer projektet kryesore të zhvillimit urban. Monitorimi dhe përcjellja e punëve që janë duke u zhvilluar kryhet nga dikasteret që janë bartës të projekteve. Informatat mbi projektet kryesore infrastrukturore që janë duke u zhvilluar, qëllimi i projektit dhe përfaqësuesit komunal që e kanë për detyrë; kontraktorë; buxheti; periudha e zbatimit, figurojnë vetëm në tabelat informuese në vendpunime. Nuk ka ndonjë listë specifike që i prezantohet online publikut.



### Nota: 1.5 (Negative)

*Arsyetimi: Transparenca e Komunës së Pejës lidhur me monitorimin e projekteve urbanistike vlerësohet negativisht në mungesë të plotë të informatave publike në këtë drejtim.*

## VI. Notimi

	Pesha	%	Notimi	%
<b>Organizimi, përbërja, kompetencat, dokumentacioni dhe funksionimi</b>				
1. Kryetari, Drejtorët dhe Anëtarët e Kuvendit	3	5.56%	3	3%
2. Organizimi dhe funksionimi	2	3.70%	2	1%
3. Puna e organeve politikë-bërëse dhe vendim-marrëse	4	7.41%	3	4%
4. Luftimi i sjelljeve të pahijshme dhe keqpërdorimeve	3	5.56%	3	3%
5. Integrimi Evropian	2	3.70%	1	1%

### Menaxhimi ekonomik dhe financiar

6. Kontabiliteti dhe buxheti	5	9.26%	3	6%
7. Kontratat e prokurimit publik, furnizimit dhe granteve	5	9.26%	2	4%

### Menaxhimi i resurseve njerëzore dhe resurseve tjera

8. Të punësuarit në administratën publike dhe organizatat/institucionet publike	5	9.26%	2	4%
9. Pasuria kapitale dhe jokatipale	5	9.26%	1	2%

### Marrëdhëniet me qytetarët dhe shoqërinë

10. Informimi dhe shërbimi i qytetarëve	5	9.26%	2	4%
11. Bashkëpunimi me shoqërinë civile	5	9.26%	3	6%

### Planifikimi dhe zhvillimi urban

12. Planifikimi urban	5	9.26%	3	6%
13. Monitorimi i projekteve urbanistike	5	9.26%	1.5	3%

54

100%

47%

	Pesha	%	Notimi	%
<b>1. Kryetari, Drejtorët dhe Anëtarët e Kuvendit</b>				
1. Cili është kualiteti i informatave që përmbajnë resimet?	5	20%	2	8%
2. Sa janë të plota deklaratat e pasurisë?	5	20%	2	8%
3. Sa janë të kuptueshme, të plota dhe të qasshme informatat mbi interesat personale?	5	20%	1	4%
4. Sa efikase janë kanalet e komunikimit që përdoren nga personat e zgjedhur dhe emëruar politikisht?	5	20%	4	16%
5. Sa janë të përditësuara dhe të plota informatat mbi aktivitetet e Kryetarit, Kuvendit, dhe personave tjerë të zgjedhur dhe të emëruar?	5	20%	4	16%

25

100%

13

52%

	Pesha	%	Notimi	%
<b>2. Organizimi dhe funksionimi</b>				
6. Sa janë të plota dhe të lehtësisht të kuptueshme informatat mbi organizmin dhe kompetencat komunale?	5	20%	2	8%
7. A kanë qytetarët informata të mjaftueshme mbi mënyrat më efikase për ndikim në politikëbërje dhe vendimmarrje?	5	20%	2	8%
8. Sa janë të dobishme kanalet e komunikimit?	5	20%	2	8%
9. Cili është kualiteti i informatave për planet në të ardhmen?	5	20%	2	8%
10. A ka të dhëna mbi komunën?	5	20%	2	8%

<b>25</b>	<b>100%</b>	<b>10</b>	<b>40%</b>
-----------	-------------	-----------	------------

	Pesha	%	Notimi	%
<b>3. Puna e organeve politikë-bërëse dhe vendim-marrëse</b>				
11. Sa inkurajohet publiku të jetë vëzhgues aktiv i debateve dhe proceseve vendimmarrëse?	5	33.33%	4	27%
12. A është raportimi i Ekzekutivit i rregullt dhe i plotë në Kuvend?	5	33.33%	2	13%
13. Sa kanë mundësi qytetarët të informohen për punën e komunës, politikat dhe aktet normative?	5	33.33%	2	13%

<b>15</b>	<b>100%</b>	<b>8</b>	<b>53.33%</b>
-----------	-------------	----------	---------------

	Pesha	%	Notimi	%
<b>4. Luftimi i sjelljeve të pahijshme dhe keqpërdorimeve</b>				
14. A ka komuna mekanizma për të hetuar dhe gjykuar sjelljet e pahijshme dhe keqpërdorimet tjera?	5	33.33%	4	27%
15. A është komuna transparente në aktivitetet e saj në luftën kundër mashtrimeve/keqpërdorimeve?	5	33.33%	3	20%
16. Cili është niveli i informimit të publikut për mekanizmat e raportimit të keqpërdorimeve të mundshme?	5	33.33%	1	7%

<b>15</b>	<b>100%</b>	<b>8</b>	<b>53.33%</b>
-----------	-------------	----------	---------------

	Pesha	%	Notimi	%
<b>5. Integrimi Evropian</b>				
17. A ka publiku informata të mjaftueshme për obligimet e komunës në procesin e integritit në BE?	5	50%	1	10%
18. A ka publiku informata të mjaftueshme mbi ndikimet e mundshme të procesit të integritit në BE?	5	50%	1	10%

<b>10</b>	<b>100%</b>	<b>2</b>	<b>20%</b>
-----------	-------------	----------	------------

	Pesha	%	Notimi	%
<b>6. Kontabiliteti dhe buxheti</b>				
19. A është publiku i informuar mirë rreth planifikimit buxhetor?	5	16.67%	4	13%
20. A publikohen të dhëna të mjaftueshme mbi ndarjet dhe realizimet buxhetore të komunës?	5	16.67%	3	10%
21. Sa është i informuar publiku për praktikën e mira dhe të metat e komunës në menaxhimin e financave publike?	5	16.67%	4	13%
22. A ka informata të mjaftueshme për të kuptuar burimet e të ardhurave të komunave?	5	16.67%	3	10%
23. Sa janë të informuar qytetarët për suficitin, deficitin dhe borxhin e komunës?	5	16.67%	2	7%
24. Sa transparente është funksionimi i organizatave të cilat ofrojnë shërbime për qytetarët ku komuna ka kompetenca (përfshi kompetenca të vogla)?	5	16.67%	1	3%

<b>30</b>	<b>100%</b>	<b>17</b>	<b>56.67%</b>
-----------	-------------	-----------	---------------

	Pesha	%	Notimi	%
<b>7. Kontratat e prokurimit publik, furnizimit dhe granteve</b>				
25. Sa është transparent procesi përzgjedhjes dhe lidhjes së marrëdhënies kontraktuale, më saktësisht procesi i vlerësimit të përshtatshmërisë për hyrje në marrëdhënie kontraktuale me palën e caktuar?	5	50%	3	30%
26. A ka transparencë në menaxhimin e projekteve dhe kontratave?	5	50%	2	20%

<b>10</b>	<b>100%</b>	<b>5</b>	<b>50%</b>
-----------	-------------	----------	------------

	Pesha	%	Notimi	%
<b>8. Të punësuarit në administratën publike dhe organizatat/institucionet publike</b>				
27. A është i qartë organizimi i administratës komunale dhe funksionet e personave kyc?	5	25%	2	10%
28. Sa janë të qarta strukturat organizative dhe informatat mbi funksionimin e organizatave/institucioneve të ndryshme komunale?	5	25%	2	10%
29. A zbatohen praktikat më të mira të rekrutimit/punësimit?	5	25%	2	10%
30. A ka informata publike rreth performancës së administratës në bazë të standardeve më të larta?	5	25%	1	5%

<b>20</b>	<b>100%</b>	<b>7</b>	<b>35%</b>
-----------	-------------	----------	------------

	Pesha	%	Notimi	%
<b>9. Pasuria kapitale dhe jokapitale</b>				
31. A ka publikuar komuna listë të të gjitha patundshmërive?	5	25%	1	5%
32. A kemi informata dhe vendime të publikuara të cilat synojnë të arsyetojnë se përdorimi i tillë i tyre është në të mirë të sovranit?	5	25%	1	5%
33. A ka publikuar komuna listë të pasurive të ndryshme (inventar, automobila, piktura, pasuri tjetër me vlerë)?	5	25%	1	5%
34. A janë paraqitur aksionet dhe pronësia e komunës në kompani të ndryshme?	5	25%	1	5%
	<b>20</b>	<b>100%</b>	<b>4</b>	<b>20%</b>

	Pesha	%	Notimi	%
<b>10. Informimi dhe shërbimi i qytetarëve</b>				
35. Sa është efikase zyra për informim?	5	12.50%	3	8%
36. A ka Komuna plane apo strategji të veprimit për transparencën në komunë?	5	12.50%	3	8%
37. Sa është e dobishme ueb faqja e komunës?	5	12.50%	3	8%
38. A ofron komuna mundësi për të marrë mendimin e qytetarëve për përmirësim të transparencës?	5	12.50%	2	5%
39. Sa përdoren mjetet inovative për transparencë dhe komunikim me publikun?	5	12.50%	2	5%
40. A janë të dhënat të kuptueshme për qytetarët e komunës?	5	12.50%	1	3%
41. A mundësohet qasja në dokumente publike?	5	12.50%	3	8%
42. Cili është kualiteti i informatave rreth shërbimeve për qytetarët?	5	12.50%	1	3%
	<b>40</b>	<b>100%</b>	<b>18</b>	<b>45%</b>

	Pesha	%	Notimi	%
<b>11. Bashkëpunimi me shoqërinë civile</b>				
43. A janë krijuar forma të strukturuar të bashkëpunimit me shoqërinë civile?	5	33.33%	3	20%
44. A mbahen takime me publikun?	5	33.33%	2	13%
45. A konsultohen qytetarët rreth dokumenteve me interes para se ato të aprovohen?	5	33.33%	4	27%
	<b>15</b>	<b>100%</b>	<b>9</b>	<b>60%</b>


	Pesha	%	Notimi	%
<b>12. Planifikimi urban</b>				
46. Sa është publiku i informuar rreth akteve normative dhe dokumenteve strategjike në fushën e planifikimit urban?	5	33.33%	3	20%
47. A përdor komuna mjetet më të avancuara për t'iu mundësuar publikut të vëzhgojnë të gjithë elementet që ndërlidhen me planet urbane?	5	33.33%	3	20%
48. Sa është komuna transparente me lejet e ndërtimit dhe shfrytëzimit të hapësirave?	5	33.33%	2	13%
	<b>15</b>	<b>100%</b>	<b>8</b>	<b>53%</b>

	Pesha	%	Notimi	%
<b>13. Monitorimi i projekteve urbanistike</b>				
49. Sa është komuna efektive për të raportuar për aktivitetet e saja për monitorimin e zbatimit të planit urbanistik?	5	50%	1	10%
50. A ka publiku informata të mjaftueshme për performancën e kompanive të kontraktuara nga komuna për të zhvilluar projekte urbanistike?	5	50%	1	10%
	<b>10</b>	<b>100%</b>	<b>2</b>	<b>20%</b>



# Komuna e Pr


Autor: Albert Krasniqi





# Prishtinës

I. Organizimi, përbërja, kompetencat, dokumentacioni dhe funksionimi _____	132
1. Kryetari, Drejtorët dhe Anëtarët e Kuvendit _____	132
2. Organizimi dhe funksionimi _____	133
3. Puna e organeve politike-bërëse dhe vendim-marrëse _____	135
4. Luftimi i sjelljeve të pahijshme dhe keqpërdorimeve _____	136
5. Integrimi Evropian _____	137
II. Menaxhimi ekonomik dhe financiar _____	138
6. Kontabiliteti dhe buxheti _____	138
7. Kontratat e prokurimit publik, furnizimit dhe granteve _____	139
III. Menaxhimi i resurseve njerëzore dhe resurseve tjera _____	140
8. Të punësuarit në administratën publike dhe organizatat/ institucionet publike _____	141
9. Pasuria kapitale dhe jokapitale _____	142
IV. Marrëdhëniet me qytetarët dhe shoqërinë _____	143
10. Informimi dhe shërbimi i qytetarëve _____	143
11. Bashkëpunimi me shoqërinë civile _____	145
V. Planifikimi dhe zhvillimi urban _____	146
12. Planifikimi urban _____	146
13. Monitorimi i projekteve urbanistike _____	147
VI. Notimi _____	148



## I. Organizimi, përbërja, kompetencat, dokumentacioni dhe funksionimi

### 1. Kryetari, Drejtorët dhe Anëtarët e Kuvendit

*Volumi dhe kualiteti i informatave të publikuara rreth të zgjedhurve dhe emëruarve politik (në Komunën e Prizrenit në këtë kategori hyjnë Kryetari, Drejtorët, dhe Anëtarët e Kuvendeve Komunale), duhet të jenë të mjaftueshme për të vlerësuar kredibilitetin e tyre, mbikëqyrur angazhimin e tyre në vazhdimësi, dhe për të kontaktuar në mënyrën më të përshtatshme me personat që mbajnë këto pozita.*

Në përgjithësi, rezymetë e përfaqësuesve të Komunës së Prishtinës të publikuara në ueb faqen e komunës nuk ofrojnë informata të mjaftueshme, përmes së cilave qytetarët do të mund të krijojnë një pasqyrë më të qartë për profilet e personave që udhëheqin këtë institucion. Me përjashtim të rezymëve të Kryetarit dhe të Nënkyetarit të Komunës që janë më të plota në aspektin e kualitetit të informatave që ofrojnë, rezymetë e drejtorëve të komunës nuk ofrojnë më shumë se informatat bazike. Rezymetë e anëtarëve të Kuvendit Komunal janë edhe më të dobëta në aspektin e sasisë së informatave që ofrojnë, për tu mjaftuar vetëm me të dhëna të pjesshme.<sup>1</sup> Në dispozicion është vënë numri personal i kontaktit dhe adresa elektronike, kurse mungojnë të dhënat rreth shkollimit, institucioneve arsimore dhe të përvojës së punës, që të paktën do të plotësonin kriteret për publikim të të dhënave bazike. Asnjë informatë nuk është publike për Kryesuesin e Kuvendit Komunal, madje nuk ka të dhëna as për personin që mbanë këtë pozitë. Në seksionin dedikuar Kryesuesit, është paraqitur vetëm një përshkrim i fushë-veprimtarisë.

Deklarimi i pasurisë së zyrtarëve të lartë publik është një obligim ligjor që duhet kryer në Agjencinë Kundër Korrupsionit.<sup>2</sup> Formulari i deklaramit për plotësim me të dhëna që kërkohen është i caktuar paraprakisht. Të dhënat që janë ofruar nga Kryetari, Nënkyetari, drejtorët dhe anëtarët e Kuvendit Komunal, janë të plota dhe ndër të tjera përmbajnë të hyrat vjetore, pasurinë e paluajtshme dhe të luajtshme.

Nuk ka asnjë të dhënë të publikuar mbi interesat financiare, ndërsa të dhënat e ofruara nuk janë lehtë të kuptueshme për arsye të mungesës së informatave të plota në rezymetë e zyrtarëve komunal. Vlen të theksohet se anëtarët e Kuvendit Komunal kanë të publikuar vetëm profesionet, ndërsa nuk tregohet se në cilin universitet kanë studiuar dhe çfarë grade akademike mbajnë. Mos publikimi i përvojës së punës apo edhe të angazhimeve aktuale jashtë veprimtarisë në

<sup>1</sup> Rezymetë e anëtarëve të Kuvendit Komunal. Komuna e Prishtinës. Gasur me 8 janar, 2016: <https://kk.rks-gov.net/prishtina/Municipality/Assembly/Asamblistet.aspx>

<sup>2</sup> Shih Ligjin Nr. 04/L-050 për Deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklaramin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë. Gasur me 14 dhjetor 2015, vegza: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2767>

Komunë, pamundëson që të kuptohet ndonjë informatë mbi interesat personale.

Informatat kontaktuese të anëtarëve të Kuvendit janë të mjaftueshme, ato përfshijë numrin personal të kontaktit dhe adresat e postës elektronike. Numri i kontaktit të zyrës dhe adresa e postës elektronike të nënkryetarit është publike, kurse të dhënat kontaktuese të Kryetarit përbëhen vetëm nga adresa e postës elektronike. Kryetari i komunës ka orientuar komunikimin me qytetarët përmes shesheve të kabinetit të tij, që ka të publikuara më shumë informata kontaktuese. Drejtorët e komunës, si persona të emëruar politikisht, kanë të publikuar numrat kontaktues dhe adresat elektronike në pjesën e kontakteve të përgjithshme të komunës, por nuk janë të qasshme në seksionet e veçanta për drejtoritë e që mund të shkaktojnë vështirësi në gjetjen e tyre.

Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, rregullisht mbanë të informuar publikun me aktivitetet e tij. Njoftimi për takimet, vizitat në teren, investimet e komunës dhe projektet tjera publikohen në faqen zyrtare të komunës si dhe dërgohen përmes komunikatave për media. Shfrytëzim i rrjeteve sociale për të plasuar informata në formë më të shpejtë dhe tek një audiencë më e re në moshë, bëhet si nga profili i Kryetarit<sup>3</sup> ashtu edhe nga faja e komunës.<sup>4</sup> Ueb faja zyrtare e komunës është e populluar me informata të shumta rreth aktiviteteve që kryhen nga drejtoritë e komunës dhe zyrtarët tjerë komunal, por nuk është dedikuar hapësirë për aktivitetet e anëtarëve tjerë të Kuvendit, veçanërisht të aktiviteteve të subjekteve politike opozitare. Zyra për Marrëdhënie me Media, pothuajse asnjëherë nuk shpërndanë informata për aktivitetet e opozitës apo edhe për fjalimet që mbajnë në mbledhjet e Kuvendit.



### Nota: 2.5 (Neutral)

*Arsyetimi: Informatat për udhëheqësin e komunës janë të mjaftueshme, por të dhënat për nivelet tjera janë tejet bazike ose mungojnë krejtësisht. Deklaratat e pasurisë përmbushin obligimin ligjor, por si negative është mosdeklarimi i konflikteve të interesit. Inkurajuese është vendosja e kontakteve, por pikëpyetje është efikasiteti i tyre. Komuna aplikon kanale të ndryshme të informimit dhe volumi i informatave është i kënaqshëm. Negative mbetet mos publikimi i aktiviteteve të opozitës.*

## 2. Organizimi dhe funksionimi

*Publiku duhet të ketë informata të mjaftueshme për të kuptuar organizimin, kompetencat, funksionimin, procesin e vendimmarrjes dhe të politikëbërjes të trupave të ndryshme komunale.*

Përcaktimi i kompetencave dhe përgjegjësi të komunës është i përcaktuar në

<sup>3</sup> Profili personal në Facebook i Kryetarit të komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti: <https://www.facebook.com/shpend.ahmeti>

Statutin e saj si akti më i lartë juridik i komunës.<sup>4</sup> Të gjitha kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të komunës janë të rregulluara ma anë të statutit, përfshirë detyrimet dhe të drejtat. Statuti i Komunës rregullon edhe organizimin e administratës të cilën e ndanë në drejtori. Kompetencat e drejtorive janë të publikuara në ueb faqen e komunës prej nga publiku mund të qaset lehtësisht. Informatat e prezantuara për kompetencat e drejtorive janë të plota dhe të kuptueshme. Ndërmarrjet publike komunale në të cilat është aksionar komuna, janë të listuara në ueb faqe dhe ofrohen të dhënat e tyre kontaktuese.

Përgjatë një viti, komuna organizon të paktën dy dëgjime publike me qytetarët për të diskutuar lidhur me strategjitë dhe punën e drejtorive përkatëse. Në dëgjime publike marrin pjesë drejtorët e drejtorive të Komunës për të prezantuar aktivitetet e tyre, por edhe aktet dhe vendimet tjera të Komunës. Në këtë mënyrë drejtorët mund të mbahen direkt llogaridhënës nga qytetarët, por edhe të marrin në konsideratë brengat e tyre të cilat mund të adresohen përmes krijimit të politikave më të favorshme nga ana e ekzekutivit të Komunës.

Marrë parasysh që mjetet konvencionale të komunikimit gjithmonë e më pak po gjejnë përdorim, shfrytëzimit i teknologjisë informative për qëllime të komunikimit është më i lehtë dhe po has në pranim më të madh. Në këtë drejtim komuna nuk ka marrë ndonjë iniciativë që do të ishte më e dobishme, por është mjaftuar me publikimin e numrave të telefonit të zyrës dhe adresave të postës elektronike. Komuna ka të publikuar të gjitha kontaktet për organet e saja drejtuese për të komunikuar me palët e interesuara.

Një pjesë e madhe e dëgjimeve publike të organizuara nga komuna i dedikohen planeve për zhvillim afatgjatë. Publikimi i kornizës afatmesme buxhetore bëhet në kohë dhe në mënyrë të detajuar prezantohen planet për investime dhe orientim të buxhetit. Komuna është në fazën fillestare të planifikimeve në të ardhmen, por indikatorët fillestar janë premtues pasi gjatë hartimit të tyre përfshihen edhe nevojat e qytetarëve dhe përcjellën me analiza buxhetore planet për investime.

Të dhënat e përgjithshme për Komunën e Prishtinës janë të mjaftueshme për të krijuar një pasqyrë mbi karakteristikat e qytetit dhe historikun. Informatat për rrugët e qytetit dhe harta janë të publikuara, ndonëse paraqitja e tyre në mënyrë më interaktive do të lehtësonte orientimin. Pjesë të veçanta i janë dedikuar edhe informacioneve për pikat turistike dhe rekreative. Informatat rreth sektorit komercial si bankat dhe hotelet zënë gjithashtu hapësirë në seksionin për qytetin në ueb faqen e Komunës.



### Nota: 3 (Neutral)

*Arsyetimi: Komuna ka publikuar informata të mjaftueshme për mënyrën e organizimit, përfshirë detyrat dhe obligimet e drejtorive përkatëse. Procesi i vendimmarrjes është më vështirë i kuptueshëm. Organizimi i herë pas hershëm i dëgjimeve publike është inkurajues, por nuk duhet të kufizohet vetëm në obligimet ligjore. Komuna ka vënë në dispozicion kanale të shumta të komunikimit përfshirë edhe ato përmes rrjeteve sociale, por mungojnë platformat e komunikimit përmes shfrytëzimit të formave online në ueb faqen e komunës.*

<sup>4</sup> Statuti i Komunës së Prishtinës, miratuar më 25 shkurt 2010, qasur më 15 dhjetor 2015. Shih: <https://kk.rks.gov.net/prishtina/getattachment/Home/STATUTI-KOMUNES-SE-PRISHTINES-2010.pdf.aspx>

### 3. Puna e organeve politikë-bërëse dhe vendim-marrëse

*Publiku duhet të ketë informata të detajuara, përditësuara, dhe të mjaftueshme për të vlerësuar problematikat kryesore të debatuar dhe vendimet kryesore të marra nga organet politikë-bërëse dhe vendim-marrëse të Komunës.*

Komuna e Prishtinës deklarohet se promovon qytetarinë aktive dhe inkurajon qytetarët të jenë pjesëmarrës në çdo dëgjim publik.<sup>5</sup> Komuna pranon komente dhe shqetësime të qytetarëve përmes zyrës së informimit, por edhe vetë Kryetari i Komunës përmes rrjeteve sociale iu përgjigjet komenteve të qytetarëve. Komunikimi i Komunës me qytetarët bëhet kryesisht përmes postës elektronike, dhe të gjitha shkresat që merren evidentohen, regjistrohen dhe paraqiten pranë strukturave udhëheqëse,<sup>6</sup> megjithëse nga këto pyetje të qytetarëve nuk janë të publikuar në ueb faqen e Komunës. Njoftimet për qytetarët bëhen me kohë për të diskutuar lidhur me planifikimin urban të lagjeve duke përdorur mjete të ndryshme, siç janë dëgjimet publike, ueb faqja e Komunës por edhe rrjetet sociale. Publikimi i planeve bëhet në hapësirat dhe objektet publike të atyre lagjeve që ndikohen nga ndryshimet e parapara.

Mungesa e hapësirës në ambientet ku zhvillohen punimet e Kuvendit Komunal pamundëson që qytetarët të ndjekin nga afër diskutimet e të zgjedhurve të tyre. Përkundër kësaj, vende të veçanta janë të rezervuara për organizatat e shoqërisë civile dhe mediat të cilët ftohen rregullisht të përcjellin punimet e mbledhjeve të Komunës dhe të komisioneve të ndryshme. Komuna nuk shpërndanë për mediat dhe organizatat e shoqërisë civile materialet të cilat janë objekt i shqyrtimit në Kuvend, materiale të cilat duhet të sigurohen përmes asamblistëve.

Shmangja e Kryetarit të Komunës për të raportuar për planifikimin e buxhetit dhe raportimin vjetor, ka dobësuar procesin politik-bërës dhe vendimmarrës. Raportimi i të emëruarve politik të ekzekutivit, respektivisht i drejtorëve të drejtorive bëhet në varësi të rendit të ditës, kjo për shkak të bojkotimit që subjektet politike opozitare po i bëjnë Drejtorit të Planifikimit Urban z. Liburn Aliu. Opozita është duke kërkuar shkarkimin e këtij drejtori, gjë të cilën është duke e refuzuar Kryetari i Komunës z. Ahmeti. Si pasojë e kësaj përplasje, debatet në Kuvendin Komunal janë gjithnjë e më pak të dobishme.

Vendimet e Komunës, përfshirë ato të Kryetarit dhe të drejtorive janë të publikuara në formën standarde të dokumenteve, por nuk ofrohet ndonjë lehtësi në navigacion dhe kërkim të informatave të vlefshme. Procesverbalet e mbledhjeve nuk janë publike por mund të gjenden vendimet e marra nga Kuvendi në ato mbledhje. Raportet për iniciativat e rëndësishme legislative nuk janë publike, njëjtë sikurse nuk publikohen projektet e propozuara nga anëtarët e Kuvendit dhe as votimet e anëtarëve. Nuk ka arkiv të videove të mbledhjeve dhe të njëjtat nuk incizohen. Komuna është duke shikuar mundësitë që përmes projekteve të përbashkëta të organizatave të shoqërisë civile të bëhet incizimi dhe publikimi në kohë reale i mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.

<sup>5</sup> Intervistë e EC Ma Ndryshe me Zyrtaren për Informim në Komunën e Prishtinës, Miranda Mullafazliu

<sup>6</sup> Po aty.



## Nota: 2.2 (Negative)

Arsyetimi: Vendimet e komunës janë publike, por mungojnë procesverbalet e mbledhjeve. Kryetari i Komunës është shmangur Kuvendit për të paraqitur raportin vjetor të punës dhe atë financiar, që është veprim në dëm të transparencës dhe llogaridhënies. Mos publikimi i votimeve individuale të asamblistëve dhe aktivitetet e tyre, len të paqartë për publikun nëse po përfaqësohen më së miri interesat e tyre. Mungesa e arkivit të mbledhjeve si dhe mos incizimi i tyre pamundëson kërkimin e informatave retroaktive.

## 4. Luftimi i sjelljeve të pahijshme dhe keqpërdorimeve

*Komuna duhet të publikojë informata të rëndësishme nga të cilat lehtësisht mund të vlerësohet niveli i përkushtimit të saj në luftimin e sjelljeve të pahijshme dhe keqpërdorimeve.*

Kodi i mirësjelljes për nëpunësit civil i miratuar nga niveli qendror, është mekanizmi i vetëm për gjykuar sjelljet e pahijshme të zyrtarëve komunal. Komuna nuk ka të publikuar këtë kod në ueb faqen e saj zyrtare, por me rastin e nënshkrimit të kontratës u transmetohen nëpunësve. Ky lloj i legjislacionit primar që propozon funksionet e nëpunësve civil nuk është një mjet shumë efektiv për t'iu transmetuar vetë nëpunësve civilë ose publikut vlerat profesionale që pritet të përmbushen nga një shërbim i pavarur publik. Hartimi i rregullimeve dytësore është mjet shumë më efektiv dhe i rekomandueshëm.<sup>7</sup> Si mekanizëm të hetimit të sjelljeve të pahijshme dhe keqpërdorimeve të nëpunësve të saj, komuna ka vendosur kutitë e ankesave në hapësirat e ndërtesave të saj. Kutitë e ankesave hapen një herë në muaj dhe shqyrtohen.

Mekanizmat e përcjelljes së rasteve për të gjitha dyshimet e ngritura për mashtrime/keqpërdorime janë të vendosura përmes trajtimit të tyre nga Komisioni Disiplinor. Megjithatë nuk ka informata të publikuara lidhur me numrin e rasteve të trajtuara, vendimet e marra apo llojin e aktiviteteve të kryera për të zvogëluar mundësitë e keqpërdorimeve.

Komuna ka shpërndarë broshura informuese nëpër hapësirat e ndërtesës së Komunës, por që të njëjtat nuk janë publike. Në dispozicion për qytetarët janë edhe katër numra telefonik pa pagesë për të lajmëruar keqpërdorimet e mundshme. Mekanizmat e jashtëm të raportimit janë inkurajuar nga ana e Komunës. Në ueb faqen e Komunës është publikuar numri kontaktues për raportim të korrupsionit në organizatat e shoqërisë civile të specializuara në këtë fushë (i.e. platforma e denoncimit të korrupsionit [www.kallxo.com](http://www.kallxo.com)).

<sup>7</sup> Legjislacioni mbi shërbimin civil: listë për verifikimin e legjislacionit dytësor, sigma, 1997. Qasur me 19 dhjetor 2015, shih: [http://www.Sigmaweb.Org/publications/alb\\_sp14\\_97.Pdf](http://www.Sigmaweb.Org/publications/alb_sp14_97.Pdf).



### Nota: 2 (Negativ)

*Arsyetimi: Vendorsja e kutisë së ankesave, ofrimi i numrave pa pagesë për të raportuar keqpërdorimet dhe promovimi i mekanizmave të jashtëm është inkurajues, por që pikëpyetje është efikasiteti i tyre. Numri i rasteve të trajtuara dhe masat e ndërmarra nga komuna nuk janë publike. Komuna nuk ka bërë mjaftueshëm për vetëdijesimin e qytetarëve për obligimet e nëpunësve civil, që është tregues i mungesës së përkushtimit të komunës për të parandaluar këto dukuri. Prodhimi i broshurave informuese nuk është shumë e dobishme, për më tepër nuk janë as publike.*

## 5. Integrimi Evropian

*Publikut duhet t'i ofrohet mundësia që të mësoj në mënyrë të saktë dhe të detajuar obligimet, arrijtet dhe sfidat që i ka komuna në procesin e integritit të Kosovës në BE.*

Zyra për Integritime Evropiane që vepron në kuadër të komunës, kryen raportimet e rregullta për përmbushje të agjendës evropiane dhe aktivitetet e ndërmarra në zbatimin e obligimeve. Ky lloj i raportimit bëhet në MAPL, institucion ky që ka mandat të bashkërendimit të aktiviteteve nëpër komuna.<sup>8</sup> Mirëpo, komuna nuk i ka vënë në dispozicion të publikut obligimet dhe progresin që ka bërë në procesin e integritit në BE.

Publiku nuk ka informata mbi ndikimet e mundshme të procesit të integritit në BE. Nuk ka të publikuara as informata të përgjithshme as të zërthyer në çështje më specifike si ato ekonomike, sociale apo administratës publike, që ndër të tjera do të mund të bëheshin përmes kampanjave të ndryshme informuese.




### Nota: 1 (Negativ)

*Arsyetimi: Komuna nuk publikon asnjë informata lidhur me aktivitetet dhe obligimet e saj në kuadër të përmbushjes së agjendës evropiane. Gjithashtu, publiku nuk ka informata as për ndikimin e mundshëm në procesin e integritimeve në BE.*

<sup>8</sup> Departamenti për Integritim Evropian dhe Koordinim të Politikave, MAPL. Qasur me 5 janar 2015, <https://mapl.rks-gov.net/Main-menu/Departamentet/Departamenti-per-Integritime-Evropiane.aspx>





## II. Menaxhimi ekonomik dhe financiar

### 6. Kontabiliteti dhe buxheti

*Të dhënat dhe raportet e ndryshme dhe të përditësuara rreth të hyrave financiare, alokimeve buxhetore, shpenzimeve financiare, borxheve dhe kontesteve me pasoja financiare për komunën, duhet të jenë në dispozicion të publikut për të pasë pasqyrë të qartë mbi menaxhimin e parasë publike në nivel lokal.*

Komuna e Prishtinës i kushton rëndësi pjesëmarrjes së qytetarëve në dëgjimet publike për të diskutuar buxhetin. Organizimi i 12 dëgjimeve publike në lokacione të ndryshme tregon për përkushtimin që të kuptohen më mirë nevojat e qytetarëve. Në këtë drejtim, komuna angazhohet të njoftoj me kohë qytetarët për këto dëgjime duke shfrytëzuar publikimin e lajmërimeve në ueb faqen e saj, por dhe përmes mediave dhe përgatitjes së broshurave dhe afisheve në objektet publike që gjenden në lokacionet ku parashihet të mbahen dëgjimet. Përkundër këtyre aktiviteteve për përfshirje më të madhe të qytetarëve në dëgjimet publike, komuna nuk ka ndonjë mekanizëm të regjistrimit dhe publikimit të propozimeve që janë përkrahur apo hedhur poshtë. Komuna shfrytëzon komunikatat për media që të njoftojë për ndryshimet buxhetore.

Me përjashtim të buxhetit për vitin 2015, ku komuna ka publikuar vetëm raportin për tremujorin e parë të vitit, në vitet paraprake janë publikuar të dhëna të mjaftueshme për ndarjet dhe realizimin e buxhetit. Krahas raportit, komuna publikon edhe arsyetimet për shpenzimin e buxhetit.

Informatat e publikuara për praktikatat e menaxhimit të financave publike, janë të mjaftueshme për qytetarët që të kuptojnë më mirë se si po menaxhohen taksat e tyre. Publikimi i raporteve tremujore përmban edhe sqarimet për linjat buxhetore të pashpenzuara, pasqyrën e planifikimi vjetor, realizimin e të hyrave vetanake si dhe pasqyrën e arkëtimeve dhe shpenzimeve. Raportet e auditimit të jashtëm janë të publikuara dhe lehtë të qasshme në ueb faqen e Komunës. Gjetjet dhe rekomandimet e auditimit të jashtëm nuk zërthen në forma më të lehta për t'u kuptuar nga qytetarët.

Burimet e të ardhurave të komunës nuk janë të publikuara në një formë lehtësisht të qasshme dhe të kuptueshme. Burimet e të ardhurave të komunës mund të kuptohen vetëm nga raportet e auditimit të jashtëm, që janë të publikuara në ueb faqen e Komunës. Në këtë ueb faqe ekziston edhe një vegëz e veçantë për donatorët, iniciativë kjo e lënë në gjysmë pasi kjo vegëz nuk është funksionalizuar dhe nuk ofron asnjë informatë.

Informimi i saktë i qytetarëve për suficitin, deficitin dhe borxhin e Komunës është parakusht për të kuptuar mënyrën e menaxhimit të buxhetit. Në tremujorin e parë të vitit 2015, komuna ka bërë hapa pozitiv në këtë drejtim duke i pasqyruar në raportet financiare suficitin dhe deficitin buxhetor, por edhe arsyetimet dhe borxhin që qytetarët kanë ndaj komunës. Kjo praktikë e mirë që rritë transparencën financiare të komunës nuk është ndjekur edhe për periudhat



pasuese. Mangësi të tjera në raportet ekzistuese janë edhe mos publikimi i borxhit publik të Komunës, borxhet ndaj operatorëve ekonomik, koha mesatare për pagesën e detyrimeve, koha mesatare për grumbullimin e detyrimeve, kontestet gjyqësore dhe shuma e pretenduar, shuma e paguar/përfiturar për rastet e humbura/fituara në gjykata.

Organizatave të cilat ofrojnë shërbime për qytetarët dhe në të cilat komuna ka kompetenca, publikojnë në ueb faqet e tyre informata të mjaftueshme financiare. Informata për këto organizata nuk mund të gjenden edhe në ueb faqen e komunës, meqenëse komuna nuk është pronare e 100 për qind të aksioneve, përderisa komuna konsideron se obligimet për transparencë financiare janë vetëm në përgjegjësi të këtyre organizatave dhe jo të Komunës.<sup>9</sup>



### Nota: 3.1 (Neutral)

*Arsyetimi: Publiki është i informuar për përgatitjet e buxhetit dhe përfshihet në dëgjimet publike. Fillimisht raportet financiare kanë përmbajtur edhe suficitin dhe deficitin e komunës, praktikë kjo që nuk është vazhduar në periudhat pasuese. Informatat për organizatat që ofrojnë shërbimet për qytetarët e Prishtinës janë të qasshme vetëm në ueb faqet e tyre por jo edhe të komunës.*

## 7. Kontratave të prokurimit publik, furnizimit dhe granteve

*Marrëdhëniet kontraktuale me implikime financiare në mes të komunës dhe personave fizik dhe juridik duhet të zhvillohen në transparencë të plotë, për të siguruar menaxhimin e mirë të parasë publike dhe vlerën e duhur për shërbimet, punët apo furnizimet.*

Mungesa e transparencës gjatë hyrjes në marrëdhënie kontraktuale me palë të caktuara, natyrshëm ngritë dyshime për raste të keqpërdorimit, si mos respektim të procedurave të prokurimit, përshtatje të tenderëve apo favorizime tjera. Në të kundërtën, transparenca e plotë përveç që tregon përkushtim institucional për ta luftuar këto dukuri, mundëson që edhe palët e treta të mund të identifikojnë lëshimet e bëra. Në Komunën e Prishtinës, publiku është i informuar për mundësitë e kontratës, të publikuara janë manualet për proceset e konkurrimit, si dhe ofertat bëhen publike dhe ftohet edhe shoqëria civile për të përcjellë hapjen e ofertave. Vërejtje për komunën është mos vënia në dispozicion të dosjeve të tenderëve për organizatat që monitorojnë prokurimin publik. Përkundër kësaj, komuna nuk publikon procesverbalet për procesin e vlerësimit të ofertave, atyre të komisioneve vlerësuese apo raportet vlerësues për dhënie të kontratës. Mënyra e përzgjedhjes dhe përbërjet e komisioneve vlerësuese nuk janë publike, njëjtë siç nuk janë të ditura as arsyet për vendosjen e kritereve të caktuara.

Orientimi i vizitorëve në ueb faqen e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik


<sup>9</sup> Deklaratë e zyrtare për informim në Komunën e Prishtinës, Miranda Mullafazliu, në Fokus Grupin e organizuar nga EC Ma Ndryshe, me datë 24 shkurt, 2016.

(KRPP),<sup>10</sup> shërben si bazë për komunën që të informojë për mundësitë e dhënies së kontratave, për njoftimet për konkurset e projektimit dhe për anulimin e tyre. Ndërsa sa i përket njoftimeve për përmbyllje të projekteve, komuna shfrytëzon komunikatat për media dhe postimin në formë të lajmeve në ueb faqen e saj. Komuna nuk ka të publikuara apo të përgatitura raportet mbi performancën e kontraktorëve të bazuara në indikatorët e paracaktuar në kontratë.



### Nota: 2.5 (Neutral)

Arsyetime: Ofertat e kontraktorëve të komunës janë publike dhe shoqëria civile ftohet për të përcjellë hapjen e tyre. Përkundër njoftimeve për dhënien e kontratave,<sup>11</sup> kontratat e lidhura me operatorët ekonomik nuk janë publike. Nuk janë publike as performancat e kompanive të kontraktuara, por ka njoftime përmes mediave për përmbyllje të projekteve.



## III. Menaxhimi i resurseve njerëzore dhe resurseve tjera

### 8. Të punësuarit në administratën publike dhe organizatat/institucionet publike

*Menaxhimi i resurseve njerëzore duhet të bëhet në mënyrë transparente duke përfutur nga mbikëqyrja e vazhdueshme e publikut mbi performancën e administratës.*

Informatat për Komunën e Prishtinës si punëdhënës, janë lehtësisht të qasshme në platformën e veçantë të krijuar për rekrutime, në të cilën paraqiten të gjitha pozitat për vende të lira të punës.<sup>12</sup> Kjo platformë shfrytëzohet edhe si bazë e të dhënave që përmban listën e personave të punësuar në Komunë. Në formë tabelare janë të publikuara emrat dhe mbiemrat, data e lindjes, drejtoria ku veprojnë, pozitat e tyre dhe koeficientet e pagës. Informatat kontaktuese të shërbyesve civil në Komunë nuk janë të publikuara në këtë platformë. Struktura e të punësuarve paraqitet edhe në formë të diagramit interaktiv, ku përdoruesit mund të shohin numrin e të punësuarve nëpër secilën drejtori dhe raportin në mes drejtorive. Kjo platformë është e lidhur me ueb faqen kryesore të Komunës, nga ku përmes

<sup>10</sup> Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, shih: [https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=1&CtlID=SearchNotices&ind=1&PPRCMenu\\_OpenNode=63](https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=1&CtlID=SearchNotices&ind=1&PPRCMenu_OpenNode=63)

<sup>11</sup> Njoftimet për dhënien e kontratave. Komuna e Prishtinës, shih: <http://prishtinaonline.com/prokurimi/njoftim-per-dhenjen-e-kontrates>

<sup>12</sup> Portali i Punësimit, Komuna e Prishtinës. Shih, <http://erekrutimi.net/>

vegzave paraqiten përshkrimet e punës dhe funksionet e drejtorëve dhe drejtorive. Informatat për strukturën organizative të Komunës janë të prezantuara në faqe të ndryshme, që vështirëson qasjen për përdoruesit ngase duhet të kalojnë nga një faqe në tjetrën për të marrë informacionin e plotë.

Sigurimi i informatave për strukturën organizative të organizatave apo institucioneve të ndryshme komunale nuk është e mundur të bëhet nga ueb faqja e komunës, nga ku nuk mund të gjendet asnjë informatë e tillë. Ofrimi i informatave për funksionimin e këtyre institucioneve vitale të komunës, është parakusht që duhet plotësuar në mënyrë që publiku të jetë në dijeni për performancën e tyre.

Struktura organizative mirë e zhvilluar dhe që vije si rezultat i analizave të bërë në bazë të sektorëve dhe e aprovuar nga organet përkatëse, është e domosdoshme të jetë publike për të kryer vlerësime objektive për rekrutimet në komunë. Një strukturë e tillë për Komunën e Prishtinës nuk është publike, megjithëse në thirrjet për aplikim publikohen kritere të caktuara në bazë të kësaj strukture. Kanale të ndryshme të komunikimit përdoren për të shpërndarë njoftimet për aplikim, që ndër më të shpeshtat janë njoftimet në mediat e shkruara, ueb faqen e komunës, por nuk mungojnë as rrjetet sociale. Praktikë më e mirë zbatohet në rekrutimet në kuadër të Drejtorisë së Arsimit për punësimet e mësimdhënësve. Të gjitha fushat e vlerësimit dhe pikët e kandidatëve për secilën pozitë të shpallur janë publike. Përbërjet e bordeve të ndërmarrjeve publike nuk janë të ditura për publikun. Komuna nuk ofron informata për anëtarët e këtyre bordeve, kontaktet apo informata të tjera me rëndësi.

Komuna e Prishtinës nuk ka bërë përpjekje për të vetëdijësuar publikun me standardet të cilat pritet të përmbushen nga nëpunësit e saj, dhe sjelljet të cilat të njëjtit duhet t'i manifestojnë gjatë kohës sa janë në detyrë. Publikimi dhe zberthimi në dokumente më lehtë të kuptueshme i Kodit të Mirësjelljes për Nëpunësit Civil është një parakusht në këtë drejtim, mirëpo ky Kod nuk është i publikuar në ueb faqen e Komunës. Raportet vjetore të performancës individuale të punësuarve në komunë nuk janë publike, por të njëjtat kryhen rregullisht. Sa i përket konflikteve të mundshme të interesit të administratës së komunës, nuk janë publike rastet që identifikohen. Herë pas here, komuna njofton për konflikte të interesit përmes komunikatave për media por që nuk janë të mjaftueshme për të krijuar përshtypje se kjo dukuri luftohet në këtë institucion.



### Nota: 2.5 (Neutral)

*Ansytimi: Komuna ka publikuar listën e të gjithë të punësuarve dhe ka informata të mjaftueshme për strukturën e saj organizative. Nuk ka asnjë informatë për strukturën organizative të organizatave të ndryshme komunale. Komuna ka transparencë në kriteret e vlerësimit të kandidatëve për mësimdhënësë, por kjo praktikë e mirë nuk zbatohet edhe për rekrutimet tjera në komuna. Nuk ka informata rreth performancës së administratës.*

## 9. Pasuria kapitale dhe jokapitale

*Publiku duhet të ketë informata të përditësuara dhe të plota mbi menaxhimin e pasurisë publike nga ana e pushtetit komunal.*

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP), si pjesë të metodologjisë së auditimit vjetor të komunave ka përfshirë saktësinë e regjistrimit të patundshmërive. Ndër vite, ZAP ka konstatuar se kontrollet e dobëta dhe regjistrimi i mangët i pasurive të blera gjatë vitit ka rezultuar me vlerësime të pasakta të pasurive.<sup>13</sup> Komuna e Prishtinës nuk ka arritur të vendosë kontrole adekuate për regjistrim korrekt të pasurive të përfituara gjatë vitit aktual. Kjo ka ndodhur pasi që komuna nuk ka arritur ta zbatojë Rregullën Financiare 02/2013. Së fundi, komuna ka deklaruar se është në përpilim të listës së patundshmërive, dhe njëherit është duke bërë verifikimin e pronave.<sup>14</sup>

Mungesa e regjistrave të plotë të patundshmërive të komunës, ka bërë që të mos ketë vendime dhe arsyetime për të përdorur apo për të lëshuar me qira pronat komunale, lista të pronave të cilat janë transferuar nga komuna tek pronarë tjerë, apo arsyetimet për këto vendime.

Mos regjistrimi i të gjitha pasurive mund të rezultojë në nënvlerësim material të vlerave të këtyre pasurive. Në fund të çdo viti, komuna është e obliguar të kryej inventarizimin e tërësishëm për të konfirmuar ekzistencën e pasurive (në veçanti të pasurive të luajtshme) si dhe të funksionalizoj përdorimin e modulit E-pasuria për të konfirmuar saktësinë dhe plotësinë e pasurive. Përkundër që komuna ka një listë të inventarit të saj, e njëjta nuk është në dispozicion të publikut.




### Nota: 1 (Negativ)

*Arsyetimi: Lista e pasurive të komunës nuk është e saktë dhe publike, siç nuk janë publike as regjistrat e patundshmërive. Gjithashtu në ueb faqen e komunës nuk është publike lista e inventarit, arsye këto të mjaftueshme për vlerësim negativ të këtij indikator.*

13 Raporti i Auditimit për Pasqyrat Financiare të Komunës së Prishtinës për vitin e Përfunduar më 31 dhjetor 2014, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, faqe 31. Vegëza: [http://oag-rks.org/repository/docs/sq\\_Raporti\\_Final\\_Prishitina\\_349186.pdf](http://oag-rks.org/repository/docs/sq_Raporti_Final_Prishitina_349186.pdf)

14 Intervistë e Ec Ma Ndryshe me zyrtarën për informim në Komunën e Prishtinës, Miranda Mullafalzi, 2015.



## IV. Marrëdhëniet me qytetarët dhe shoqërinë

### 10. Informimi dhe shërbimi i qytetarëve

*Transparenca komunale duhet të jetë e avancuar duke i mundësuar publikut qasje të lehtë në informata, informim të saktë, të shpejtë dhe të detajuar rreth çështjeve që ndërlidhen me politikën, vendimet dhe shërbimet për qytetarët.*

Zyra për Marrëdhënie me Media në Komunën e Prishtinës është efi-kase në kryerjen e detyrave të saj. Ndonëse ka ankesa nga përfaqësues të shoqërisë civile se qasja e komunës ndaj mediave nganjëherë është selektive, kjo për shkak të keqpërdorimit të informatave zyrtare që kanë bërë portalet.<sup>15</sup> Së fundi, zyra ka rritur kapacitetet njerëzore dhe tani funksionon me tre zyrtarë, kontaktet e të cilëve/ave janë publike. Zyra është aktive edhe në rrjetet sociale, dhe mbanë statistika të detajuara për aktivitetet dhe shërbimet që kryen.

Avancimi i transparencës në nivel komunal nuk mund të bëhet pa një plan të detajuar të veprimit. Improvizimet dhe qasjet *ad-hoc* përveç që nuk janë të qëndrueshme në aspektin afatgjatë, ato nuk garantojnë publikimin e informatave të duhura në kohën e duhur. Për të shmangur veprimet e tilla, komuna ka ndër-marrë veprime në drejtim të hartimit të strategjisë për rritje të transparencës, por që ende nuk është përfunduar tërësisht.

Ueb faqja e komunës, si dritarja e parë e kontaktit të qytetarëve me institucionin, nuk është mirë e organizuar, që ka shtyrë komunën të krijoj dy faqet tjera ndihmëse (Prishtina Online dhe eRekrutimi), për të siguruar një lloj autonomie të administrimit për shkak të kufizimeve që ka faqja zyrtare që administrohet nga MAPL. Marrë parasysh edhe telashet teknike me ueb faqen standarde (zyrtare) kjo praktikë është inkurajuese për rritjen e transparencës. Ueb faqja zyrtare është e vjetruar në aspektin e teknologjisë së përdorur, e ngarkuar në aspektin vizual, aspak e lehtë për orientim dhe gjetje të informacioneve. Nuk ofrohen mundësi për forume të komunikimi të ndërsjellë, që në epokën digjitale është shumë më e lehtë dhe më efi-kase të komunikohet në këtë mënyrë, dhe krejt kjo me kosto shumë të ulët. Përkundër faktit se aspektet vizuale dhe kategorizimi i materialeve nuk janë në formën e duhur, ueb faqet e komunës janë mirë të populluara me materiale të ndryshme dhe mjaftë informuese.

Dhënia e mundësisë për qytetarët që në çdo kohë të mund të shprehin mendimet/sugjerimet e tyre për të përmirësuar transparencën komunale, do t'i ndih-monte komunës që t'i identifikoj më lehtë fushat në të cilat duhet intervenuar më me prioritet. Deri më tani, një mundësi e tillë jepet vetëm në dëgjimet publike të cilat organizohen me qytetarët për tema të ndryshme, e ku ndër të tjera mund të shprehën edhe mendimet për përmirësim të transparencës. Ueb faqja e komunës nuk ofron forma të dedikuara për të marrë mendimet e qytetarëve për fusha të caktuara, por as të përgjithshme. Një formë e tillë e kontaktit ekziston në ueb faqen ndihmëse të komunës “Prishtina Online”. Komuna nuk kryen hulumtime

<sup>15</sup> Fokus Grup i mbajtur në Prishtinë me datë 24 shkurt 2016.

te opinionit publik për të identifikuar nevojat e qytetarëve karshi transparencës, por kryesisht ato i mbledhë përmes ankesave që deponohen në kutitë e vendosura në objektet e komunës.

Komuna përdor vazhdimisht rrjetet sociale (si Twitter<sup>16</sup> dhe Facebook<sup>17</sup>) për shpërndarje të informatave dhe komunikim me qytetarët. Llogaritë e Komunës në këto rrjete sociale janë mirë të mirëmbajtura dhe rifreskohen në baza të rregullta. Komuna promovon përdorimin e këtyre llogarive duke vendosur banderola të veçantë në ueb faqen zyrtare. Megjithëkëtë, komuna nuk raporton për të dhënat statistikore rreth përdorimit dhe efikasitetit nga përdorimi i tyre. Për transmetim më të shpejtë të informatave dhe të dhënave statistikore për rezultatet e komunës, prodhohen infografika si dhe janë zhvilluar aplikacione për telefona të mençur siç është “Prishtina Digjitale”. Ky aplikacion, edhe pse nuk është tërësisht i zhvilluar, pasi që mungojnë të dhënat për shpenzimet e komunës, i ka aktivitetet e azhurnuara rregullisht.

Ueb faqja e komunës së Prishtinës është në dispozicion vetëm në gjuhën shqipe, dhe asnjë prej gjuhëve të tjera të cilat janë të listuara në ueb faqe nuk janë funksionale. Po ashtu, asnjë material tjetër, si vendime, rregullore apo prezantime nuk janë të përkthyer në gjuhë të tjera përjashtimisht thirrjeve për punësim që janë të përkthyer në gjuhën serbe dhe publikohen në mediat e shkruara.

Qasja në dokumentet publike është një nga anët më të forta të Komunës së Prishtinës në drejtim të avancimit të transparencës. Qytetarëve por edhe palët tjera të interesuara në dokumentet publike, komuna u përgjigjet pozitivisht dhe në mënyrë adekuat duket respektuar afatet ligjore. Numri i kërkesave është i madh, dhe për të gjitha komuna mbanë evidenca të sakta.

Aktivitetet dhe rezultatet e drejtorive të Komunës së Prishtinës të cilat ofrojnë shërbime për qytetarë, janë transparente për publikut dhe kualiteti i tyre është i kënaqshëm. Për më tepër, në formë të infografikave, vizualizohen statistikat e shërbimeve të kryera. Manuale të veçanta janë hartuar me qëllim të informimit dhe shpjegimit të mënyrave se si të merren shërbimet për qytetarë.



### Nota: 3.5 (Pozitive)

*Arsyetimi: Zyra për Marrëdhënie me Media dhe Publikun është efikase dhe aktive në kryerjen e detyrave të saj, përkundër vërejtjes për qasjes selektive ndaj portaleve të caktuara. Komuna ka ndërmarrë hapa për hartimin e strategjisë për transparencë. Ueb faqja e komunës përmban informacione të dobishme por është shumë keq e organizuar dhe nuk është funksionale në gjuhët tjera zyrtare. Efikasiteti për të dhënë qasja në dokumente publike është i kënaqshëm.*

<sup>16</sup> Profili i Komunës së Prishtinës në Twitter: <https://twitter.com/kprishtines>

<sup>17</sup> Profili i Komunës së Prishtinës në Facebook: <https://www.facebook.com/komunaprishtine>

## 11. Bashkëpunimi me shoqërinë civile

*Organet komunale duhet të jenë të hapura dhe të angazhohen për qeverisje transparente duke thelluar bashkëpunimin me shoqërinë civile.*

Organizatat e Shoqërisë Civile monitorojnë rregullisht punën e Komunës së Prishtinës, përfshirë Kuvendin dhe prokurimin. OShC-të ftohen në hapjen e ofertave për kontraktim të operatorëve ekonomikë. Mos shpërndarja e dokumenteve të cilat shqyrtohen nga Kuvendi është negative në këtë aspekt të bashkëpunimit. Vërejtje tjetër ndaj komunës mbeten procedurat e gjata dhe nganjëherë paksa burokratike sa i përket caktimit të takimeve me organizatat që kanë bashkëpunim të gjatë dhe për projekte të ndryshme.

Përfshirja e publikut në hartimin e politikave komunale ndikon drejtpërdrejtë në identifikimin e problemeve që mund të hasen në zbatimin e këtyre politikave publike, por edhe adresimin e nevojave në projektet e ardhshme zhvillimore. Organet komunale angazhohen për konsultime me qytetarët përmes organizimit të takimeve të rregullta. Takimet me qytetarë kanë për qëllim diskutimin e tematikave të ndryshme, nisur nga ato për buxhetin, për planet rregullative, por edhe për çështje të tjera me interes. Prania e drejtorëve të drejtorive përkatëse është e rregullt dhe bëhet në varësi të temës së diskutimit. Njoftimet për takimet, vendin e mbajtjes dhe kohën, publikohen paraprakisht në ueb faqen e komunës.


Konsultimet me qytetarë rreth dokumenteve të rëndësishme para se ato të shndërrohen në dokumente dhe akte të obliguara për zbatim, bëhet për një sërë të tilla, si planet rregulluese të lagjeve, miratimi i buxhetit por edhe për rregullore të rëndësishme. Për të siguruar që kërkesat e qytetarëve do të trajtohen në mënyrë sistematike, komuna ka krijuar edhe mekanizëm për regjistrim të kërkesave që shpërndahen nëpër drejtori dhe përmbajnë statusin se në cilën fazë të trajtimit gjenden. Sa i përket takimeve të Kryetarit të Komunës me qytetarët, nuk ka ndonjë ditë të caktuar por që Kryetari ka gatishmëri që të pret qytetarët në zyrën e tij në varësi të kërkesave të tyre. Kryesisht caktimet e takimeve me kryetarin bëhen përmes kërkesave në postën elektronike apo rrjetet sociale, ngase komuna nuk ka ndonjë formë të veçantë për këtë qëllim.



### Nota: 3.5 (Pozitive)

*Arsyetimi: Bashkëpunimi me shoqërinë civile është në nivele të kënaqshme, përkundër që ky bashkëpunim nuk është në forma mirë të strukturuar. Organet komunale angazhohen për konsultim të publikut përmes formave të ndryshme. Kryetari zhvillon takime me qytetarët, por nuk ka ndonjë orar të caktuar për këtë qëllim. Si përfundim vlerësimi për këtë indikator është pozitiv, por duke theksuar mungesën e caktimit të një orari të rregullt për takime të Kryetarit me qytetarët.*





## V. Planifikimi dhe zhvillimi urban

### 12. Planifikimi urban

*Publiku duhet të ketë qasje në informata të rëndësishme që ndërlidhen me planifikimin urban, pasi kjo përbën një nga parimet themelore të qeverisjes së mirë.*

Përdorimi i teknologjisë informative për të lehtësuar qasjen e qytetarëve në dokumentet publike, është duke gjetur zbatim gjithandej nëpër nivele të ndryshme të qeverisjes. Në këtë drejtim, Komuna e Prishtinës ka zbatuar projektin online në fushën e urbanizimit për aplikime për leje, që ka edhe mundësinë e kërkimit të fazës në të cilën ndodhet lënda. Të gjitha planet rregulluese janë publike në ueb faqe, me qëllim të informimit të qytetarëve me kriteret dhe mundësitë e marrjes së lejeve të ndërtimit. Në fushën e mbrojtjes së mjedisit, komuna ka të publikuar këshilla për dokumentet e nevojshme për leje mjedisore, si dha ka përgatitur udhëzues për kompletimin dhe dorëzimin e aplikacioneve për ndërtim.<sup>18</sup>

Vëzhgimi elementeve që ndërlidhen me planet urbane, si informatat mbi shërbimet komunale, resurset natyrore, planet për mbrojtjen e mjedisit emitimi i gazrave e të ngjashme, për të ndihmuar ndërtuesit në planifikimet e tyre më të sakta, nuk mund të bëhen duke u bazuar në informatat publike të komunës. Komuna ka filluar të ndërmarrë hapa në këtë aspekt, me nisjen e bisedimeve me “KUR Prishtina” për të siguruar informatat për cilësinë e ujit.

Ndër prioritetet e qeverisjes së re komunale ka qenë vendosja e rregullit në sektorin e ndërtimeve, që deri atëherë ishte në formën e saj më të keqe. Komuna ka arritur të ndalë ndërtimet pa leje, dhe tani të gjitha lejet ndërtimore të lëshuara janë publike<sup>19</sup>. Listat e lejeve ndërtimore të lëshuara përmbajnë informata të detajuara si ndërtuesit, projektuesit, sipërfaqen, pagesën, vendimet dhe situacionin.



#### Nota: 3.7 (Pozitive)

*Arsyetimi: Planet rregulluese janë publike, ndërsa mungojnë informatat për elementet që ndërlidhen me planet urbane. Si hap tejet pozitiv është publikimi i lejeve të ndërtimit, të shoqëruara me informata tjera të detajuara. Përcaktimi për vlerësim pozitiv ka të bëjë me vendosjen e rregullit në planifikimin urban, por që duhet theksuar mungesën e informatave për elementet ndërlidhëse, gjë që është në proces.*

<sup>18</sup> Udhëzues për Qytetarë. Komuna e Prishtinës. Qasur më 27 dhjetor 2015, shih: <https://kk.rks-gov.net/prishtina/getattachment/Municipality/Departments/Urbanizem,Ndertim-dhe-Mbr-Mjedisit/Udhezues-per-qytetare/Udhezues-per-qytetare.pdf.aspx>

<sup>19</sup> Lista e lejeve ndërtimore të lëshuara. Komuna e Prishtinës. Qasur më 27 dhjetor 2015, shih: <https://kk.rks-gov.net/prishtina/Municipality/Departments/Urbanizem,Ndertim-dhe-Mbr-Mjedisit/Lejet-e-leshuara.aspx>



### 13. Monitorimi i projekteve urbanistike

*Komuna duhet në vazhdimësi ta informojë publikun për rrjedhën e projekteve të cilat kanë ndikim në planifikimin dhe zhvillimin urban.*

Me qëllim të informimit të publikut me planifikimet e bërë për projektet urbanistike, komuna shfrytëzon një sërë kanalesh të komunikimit. Komunikatat për media dhe rrjetet sociale janë ndër format më të shpeshta, përderisa nuk mungojnë as dëgjimet publike si mundësi për të informuar për projektet e mëdha një audiencë të shënjestruar. Në raportet e punës pasqyrohen aktivitetet e shkuara të inspektorëve, kurse përmes komunikatave për media komuna informon publikun me aktivitetet e saja ditore, që njëkohësisht postohen edhe në ueb faqe në formë të lajmeve. Publiku është i përfshirë në monitorimin e planit urbanistik përmes ofrimit të katër numrave pa pagesë, ku mund të raportohen rastet e degradimeve urbanistike. Të gjitha rastet e raportuara, arkivohen dhe shpërndahen në drejtoritë përkatëse të cilat ndërmarrin veprimet e nevojshme.

Informatat për performancën e kompanive të kontraktuara nga komuna nuk janë lehtësisht të qasshme për publikun, megjithëse janë në dispozicion në KRPP dhe mund të sigurohen përmes kërkesës në departamentin e prokurimit të komunës. Mirëpo, komuna nuk ka bërë përpjktë për të lehtësuar qasjen në këto informata apo publikuar performancën e kompanive të kontraktuara.



#### Nota: 2.5 (Neutral)

*Ansytimi: Komuna informon publikun për planifikimin e projekteve urbanistike, si dhe të njëjtit përfshihen edhe në diskutime publike me tema specifike për urbanizmin. Strukturimi i këtyre diskutimeve publike do të rriste cilësinë dhe qytetarët do të ishin pjesëmarrës aktiv në dizajnimin e qytetit apo lagjes së tyre. Publiku ka mundësi të raportimit të lëshimeve në zbatim të këtyre projekteve por që nuk është direkt i përfshirë në komisionet vlerësuese. Informatat për performancën e kompanive të kontraktura nuk janë lehtësisht të qasshme.*

## VI. Notimi

	Pesha	%	Notimi	%
<b>Organizimi, përbërja, kompetencat, dokumentacioni dhe funksionimi</b>				
1. Kryetari, Drejtorët dhe Anëtarët e Kuvendit	3	5.56%	2.5	3%
2. Organizimi dhe funksionimi	2	3.70%	3	2%
3. Puna e organeve politikë-bërëse dhe vendim-marrëse	4	7.41%	2.2	3%
4. Luftimi i sjelljeve të pahijshme dhe keqpërdorimeve	3	5.56%	2	2%
5. Integrimi Evropian	2	3.70%	1	1%

### Menaxhimi ekonomik dhe financiar

6. Kontabiliteti dhe buxheti	5	9.26%	3.1	6%
7. Kontratat e prokurimit publik, furnizimit dhe granteve	5	9.26%	2.5	5%

### Menaxhimi i resurseve njerëzore dhe resurseve tjera

8. Të punësuarit në administratën publike dhe organizatat/institucionet publike	5	9.26%	2.5	5%
9. Pasuria kapitale dhe jokatipale	5	9.26%	1	2%

### Marrëdhëniet me qytetarët dhe shoqërinë

10. Informimi dhe shërbimi i qytetarëve	5	9.26%	3.5	6%
11. Bashkëpunimi me shoqërinë civile	5	9.26%	3.5	6%

### Planifikimi dhe zhvillimi urban

12. Planifikimi urban	5	9.26%	3.7	7%
13. Monitorimi i projekteve urbanistike	5	9.26%	2.5	5%

54

100%

53%

	Pesha	%	Notimi	%
<b>1. Kryetari, Drejtorët dhe Anëtarët e Kuvendit</b>				
1. Cili është kualiteti i informatave që përmbajnë resimet?	5	20%	2.5	10%
2. Sa janë të plota deklaratat e pasurisë?	5	20%	2.5	10%
3. Sa janë të kuptueshme, të plota dhe të qasshme informatat mbi interesat personale?	5	20%	1	4%
4. Sa efikase janë kanalet e komunikimit që përdoren nga personat e zgjedhur dhe emëruar politikisht?	5	20%	3	12%
5. Sa janë të përditësuara dhe të plota informatat mbi aktivitetet e Kryetarit, Kuvendit, dhe personave tjerë të zgjedhur dhe të emëruar?	5	20%	3	12%

25

100%

12

48%

	Pesha	%	Notimi	%
<b>2. Organizimi dhe funksionimi</b>				
6. Sa janë të plota dhe të lehtësisht të kuptueshme informatat mbi organizmin dhe kompetencat komunale?	5	20%	3	12%
7. A kanë qytetarët informata të mjaftueshme mbi mënyrat më efikase për ndikim në politikëbërje dhe vendimmarrje?	5	20%	2	8%
8. Sa janë të dobishme kanalet e komunikimit?	5	20%	3	12%
9. Cili është kualiteti i informatave për planet në të ardhmen?	5	20%	2	8%
10. A ka të dhëna mbi komunën?	5	20%	3	12%
	<b>25</b>	<b>100%</b>	<b>13</b>	<b>52%</b>

	Pesha	%	Notimi	%
<b>3. Puna e organeve politikë-bërëse dhe vendim-marrëse</b>				
11. Sa inkurajohet publiku të jetë vëzhgues aktiv i debateve dhe proceseve vendimmarrëse?	5	33.33%	3	20%
12. A është raportimi i Ekzekutivit i rregullt dhe i plotë në Kuvend?	5	33.33%	1.5	10%
13. Sa kanë mundësi qytetarët të informohen për punën e komunës, politikat dhe aktet normative?	5	33.33%	2	13%
	<b>15</b>	<b>100%</b>	<b>6.5</b>	<b>43.33%</b>

	Pesha	%	Notimi	%
<b>4. Luftimi i sjelljeve të pahijshme dhe keqpërdorimeve</b>				
14. A ka komuna mekanizma për të hetuar dhe gjykuar sjelljet e pahijshme dhe keqpërdorimet tjera?	5	33.33%	2.5	17%
15. A është komuna transparente në aktivitetet e saj në luftën kundër mashtrimeve/keqpërdorimeve?	5	33.33%	1	7%
16. Cili është niveli i informimit të publikut për mekanizmat e raportimit të keqpërdorimeve të mundshme?	5	33.33%	2	13%
	<b>15</b>	<b>100%</b>	<b>5.5</b>	<b>36.67%</b>

	Pesha	%	Notimi	%
<b>5. Integrimi Evropian</b>				
17. A ka publiku informata të mjaftueshme për obligimet e komunës në procesin e integritit në BE?	5	50%	1	10%
18. A ka publiku informata të mjaftueshme mbi ndikimet e mundshme të procesit të integritit në BE?	5	50%	1	10%
	<b>10</b>	<b>100%</b>	<b>2</b>	<b>20%</b>

	Pesha	%	Notimi	%
<b>6. Kontabiliteti dhe buxheti</b>				
19. A është publiku i informuar mirë rreth planifikimit buxhetor?	5	16.67%	4	13%
20. A publikohen të dhëna të mjaftueshme mbi ndarjet dhe realizimet buxhetore të komunës?	5	16.67%	3	10%
21. Sa është i informuar publiku për praktikën e mira dhe të metat e komunës në menaxhimin e financave publike?	5	16.67%	3	10%
22. A ka informata të mjaftueshme për të kuptuar burimet e të ardhurave të komunave?	5	16.67%	3	10%
23. Sa janë të informuar qytetarët për suficitin, deficitin dhe borxhin e komunës?	5	16.67%	3	10%
24. Sa transparente është funksionimi i organizatave të cilat ofrojnë shërbime për qytetarët ku komuna ka kompetenca (përfshi kompetenca të vogla)?	5	16.67%	2.5	8%
	<b>30</b>	<b>100%</b>	<b>18.5</b>	<b>61.67%</b>

	Pesha	%	Notimi	%
<b>7. Kontratat e prokurimit publik, furnizimit dhe granteve</b>				
25. Sa është transparent procesi përzgjedhjes dhe lidhjes së marrëdhënies kontraktuale, më saktësisht procesi i vlerësimit të përshtatshmërisë për hyrje në marrëdhënie kontraktuale me palën e caktuar?	5	50%	3	30%
26. A ka transparencë në menaxhimin e projekteve dhe kontratave?	5	50%	2	20%
	<b>10</b>	<b>100%</b>	<b>5</b>	<b>50%</b>

	Pesha	%	Notimi	%
<b>8. Të punësuarit në administratën publike dhe organizatat/institucionet publike</b>				
27. A është i qartë organizimi i administratës komunale dhe funksionet e personave kyc?	5	25%	4	20%
28. Sa janë të qarta strukturat organizative dhe informatat mbi funksionimin e organizatave/institucioneve të ndryshme komunale?	5	25%	1	5%
29. A zbatohen praktikën më të mira të rekrutimit/punësimit?	5	25%	3	15%
30. A ka informata publike rreth performancës së administratës në bazë të standardeve më të larta?	5	25%	1.5	8%
	<b>20</b>	<b>100%</b>	<b>9.5</b>	<b>47.5%</b>

	Pesha	%	Notimi	%
<b>9. Pasuria kapitale dhe jokapitale</b>				
31. A ka publikuar komuna listë të të gjitha patundshmërive?	5	25%	1	5%
32. A kemi informata dhe vendime të publikuara të cilat synojnë të arsyetojnë se përdorimi i tillë i tyre është në të mirë të sovranit?	5	25%	1	5%
33. A ka publikuar komuna listë të pasurive të ndryshme (inventar, automobila, piktura, pasuri tjetër me vlerë)?	5	25%	1	5%
34. A janë paraqitur aksionet dhe pronësia e komunës në kompani të ndryshme?	5	25%	1	5%
	<b>20</b>	<b>100%</b>	<b>4</b>	<b>20%</b>

	Pesha	%	Notimi	%
<b>10. Informimi dhe shërbimi i qytetarëve</b>				
35. Sa është efikase zyra për informim?	5	12.50%	3	8%
36. A ka Komuna plane apo strategji të veprimit për transparencën në komunë?	5	12.50%	2	5%
37. Sa është e dobishme ueb faqja e komunës?	5	12.50%	4	10%
38. A ofron komuna mundësi për të marrë mendimin e qytetarëve për përmirësim të transparencës?	5	12.50%	2	5%
39. Sa përdoren mjetet inovative për transparencë dhe komunikim me publikun?	5	12.50%	3.5	9%
40. A janë të dhënat të kuptueshme për qytetarët e komunës?	5	12.50%	3.5	9%
41. A mundësohet qasja në dokumente publike?	5	12.50%	4	10%
42. Cili është kualiteti i informatave rreth shërbimeve për qytetarët?	5	12.50%	4	10%
	<b>40</b>	<b>100%</b>	<b>26</b>	<b>65%</b>

	Pesha	%	Notimi	%
<b>11. Bashkëpunimi me shoqërinë civile</b>				
43. A janë krijuar forma të strukturuar të bashkëpunimit me shoqërinë civile?	5	33.33%	2.5	17%
44. A mbahen takime me publikun?	5	33.33%	4	27%
45. A konsultohen qytetarët rreth dokumenteve me interes para se ato të aprovohen?	5	33.33%	4	27%
	<b>15</b>	<b>100%</b>	<b>10.5</b>	<b>70%</b>

	Pesha	%	Notimi	%
<b>12. Planifikimi urban</b>				
46. Sa është publiku i informuar rreth akteve normative dhe dokumenteve strategjike në fushën e planifikimit urban?	5	33.33%	4	27%
47. A përdor komuna mjetet më të avancuara për t'iu mundësuar publikut të vëzhgojnë të gjithë elementet që ndërlidhen me planet urbane?	5	33.33%	2	13%
48. Sa është komuna transparente me lejet e ndërtimit dhe shfrytëzimit të hapësirave?	5	33.33%	5	33%
	<b>15</b>	<b>100%</b>	<b>11</b>	<b>73.33%</b>

	Pesha	%	Notimi	%
<b>13. Monitorimi i projekteve urbanistike</b>				
49. Sa është komuna efektive për të raportuar për aktivitetet e saja për monitorimin e zbatimit të planit urbanistik?	5	50%	3.5	35%
50. A ka publiku informata të mjaftueshme për performancën e kompanive të kontraktuara nga komuna për të zhvilluar projekte urbanistike?	5	50%	1.5	15%
	<b>10</b>	<b>100%</b>	<b>5</b>	<b>50%</b>








# Prizrenit

I. Organizimi, përbërja, kompetencat, dokumentacioni dhe funksionimi _____	156
1. Kryetari, Drejtorët dhe Anëtarët e Kuvendit _____	156
2. Organizimi dhe funksionimi _____	158
3. Puna e organeve politike-bërëse dhe vendim-marrëse _____	159
4. Luftimi i sjelljeve të pahijshme dhe keqpërdorimeve _____	160
5. Integrimi Evropian _____	161
II. Menaxhimi ekonomik dhe financiar _____	162
6. Kontabiliteti dhe buxheti _____	162
7. Kontratat e prokurimit publik, furnizimit dhe granteve _____	164
III. Menaxhimi i resurseve njerëzore dhe resurseve tjera _____	165
8. Të punësuarit në administratën publike dhe organizatat/ institucionet publike _____	165
9. Pasuria kapitale dhe jokapitale _____	167
IV. Marrëdhëniet me qytetarët dhe shoqërinë _____	168
10. Informimi dhe shërbimi i qytetarëve _____	168
11. Bashkëpunimi me shoqërinë civile _____	169
V. Planifikimi dhe zhvillimi urban _____	171
12. Planifikimi urban _____	171
13. Monitorimi i projekteve urbanistike _____	172
VI. Notimi _____	174



## I. Organizimi, përbërja, kompetencat, dokumentacioni dhe funksionimi

### 1. Kryetari, Drejtorët dhe Anëtarët e Kuvendit

*Volumi dhe kualiteti i informatave të publikuara rreth të zgjedhurve dhe emëruarve politik (në këtë kategori hyjnë Kryetari, Drejtorët, dhe Anëtarët e Kuvendeve Komunale), duhet të jenë të mjaftueshme për të vlerësuar kredibilitetin e tyre, mbikëqyrur angazhimin e tyre në vazhdimësi, dhe për të kontaktuar në mënyrën më të përshtatshme me personat që mbajnë këto pozita.*

Në komunën e Prizrenit, kryetari dhe të emëruarit politik, në përgjithësi i kanë të publikuara CV-të e shkurtra, ku figurojnë të dhënat mbi edukimin, përvojën e punës dhe angazhimin e deritanishëm. Përjashtim bën nënkryetari i parë i Komunës, për të cilin nuk ekziston asnjë informatë<sup>1</sup>. Ndërkohë te profili i anëtarëve të Kuvendit figuron vetëm emri, fotografia dhe subjekti politik që përfaqësojnë.

Deklaratat e pasurisë të zyrtarëve të lartë të pushtetit lokal në Prizren janë të publikuara në ueb faqen e Agjencisë Kundër Korrupsion, por të njëjtat nuk figurojnë edhe në uebin e Komunës. Bazuar në dispozitat e Statutit të Komunës së Prizrenit<sup>2</sup> me rastin e pranimit të funksionit, dhe për çdo ndryshim eventual që ndodh gjatë mandatit, çdo funksionar i lartë i Komunës, obligohet të bëjë deklaratë paraprake, me shënime të plota në regjistër për interesat e tyre financiare, derisa për regjistrat në fjalë për zyrtarët e lartë duhet të kujdeset kryetari i Komunës. Një regjistër i tillë nuk është vënë në dispozicion të publikut. Në rastin e kryetarit të Komunës së Prizrenit, AKK-ja sivjet si pasojë e lëshimeve teknike nuk e pat publikuar në fillim deklaratën e tij të pasurisë. Pas kësaj autoritetet komunale patën publikuar një lajm në ueb faqen zyrtare, duke bërë të ditur se Ramadan Muja ka dorëzuar formularin me kohë, duke publikuar dhe vërtetimin e pranuar nga AKK-ja për këtë<sup>3</sup>. Të ardhurat bazë dhe nga angazhimet tjera janë të pasqyruara në këto deklaratime. Por nuk ka të dhëna krahasuese ndër vite apo për ndryshimet në pasuri gjatë mandatit, pos ato për kryetarin e Komunës, që janë të publikuara në Platformën e krahasimit të pasurisë të Lëvizjes FOL<sup>4</sup>.

Informatat mbi konfliktet e interesit të zyrtarëve të lartë publik në Komunën e Prizrenit pothuajse janë inekzistente. Madje zyrtarët, si nënkryetari i parë, drejtori i Inspektorateve, ai i Administratës dhe drejtori i Turizmit, si dhe disa

<sup>1</sup> Ueb faqja e Komunës së Prizrenit, rubrika Nënkyetari, <https://kk.rks-gov.net/prizren/Municipality/Major%60s-profile.aspx>

<sup>2</sup> Statuti i Komunës së Prizrenit, [http://kk.rks-gov.net/prizren/getattachment/Home/satuti\\_komunes\\_tetor\\_2008\\_04\\_12.pdf.aspx](http://kk.rks-gov.net/prizren/getattachment/Home/satuti_komunes_tetor_2008_04_12.pdf.aspx)

<sup>3</sup> Ueb faqja e Komunës së Prizrenit, rubrika Lajmet, <https://kk.rks-gov.net/prizren/News/Kryetari-i-komunws-prof-dr-Ramadan-Muja,-ne-afat.aspx>

<sup>4</sup> Platforma e krahasimit të pasurisë, Lëvizja FOL <http://deklarimi.levizjafol.org/Zyrtaret/Pasuria/1468/Ramadan-Muja>

anëtarë të Kuvendit janë njoftuar nga AKK-ja mbi gjendjen e tyre të konfliktit të interesit<sup>5</sup>. Pas këtyre njoftimeve dhe këshillave nga AKK-ja, zyrtarët e lartë kanë ndërmarrë veprime për shmangien e gjendjeve të konflikteve të interesit<sup>6</sup>. Anëtar i KK-së nga LDK-ja Nexhat Bytyqi si pasojë e kërkesës së AKK-së ka dhënë dorëheqje dhe është zëvendësuar nga një anëtar tjetër. Por, Komuna nuk ka shpalosur ndonjë informatë mbi këto zhvillime.

Kanalet e komunikimit nuk janë dhe aq efikase. Informatat kontaktuese janë të publikuara për zyrtarët e Ekzekutivit, por jo edhe për anëtarët e Kuvendit. Këta të fundit kanë kërkuar zyra për takim me qytetarët, por deri më tani kjo nuk është realizuar<sup>7</sup>. Takimet individuale me qytetarët, sipas zyrtarëve komunal janë të mundshme dhe në baza ditore<sup>8</sup>. Mirëpo ata nuk kanë ofruar dëshmi për oraret dhe ato nuk janë të publikuara. Ndërkaq në kontakt me komunitetin janë hasur disa raste kur qytetarët nuk kanë mundur të realizojnë takim me kryetarin apo drejtorë të caktuar të qeverisë lokale, apo nuk kanë pasë informata e udhëzime se si mund ta realizojnë këtë<sup>9</sup>.

Njoftimet për seancat e Kuvendit në përputhje me ligjin publikohen në ueb dhe vende publike 7 ditë para takimit, me rendin e ditës. Materialet për diskutim në KK në gjysmën e dytë të vitit kanë filluar të dërgohen përmes e-mailit, të monitoruesit e shoqërisë civile dhe gazetarët. Nuk ka kalendar të publikuar me informata të plota mbi aktivitetet e kryetarit. Njoftimet paralajmëruese i dërgohen gazetarëve dhe shoqërisë civile. Një pjesë e tyre në formë lajmesh publikohen edhe në ueb faqe.



## Nota: 2 (Negative)

*Arsyetimi: Volumi dhe kualiteti i informatave të publikuara rreth të zgjedhurve dhe emëruarve politik është bazik. Deklaratat e pasurisë përmbushin vetëm obligimin ligjor, por jo edhe transparencën karshi publikut. Mosdeklarimi i konflikteve të interesit nga zyrtarët e lartë publik është një dukuri negative. Inkurajuese është vendosja e kontakteve, por pikëpyetje është efikasiteti i tyre. KK-ja aplikon disa praktika për informim.*

<sup>5</sup> Agjencia Kundër Korrupsion, Vendimet për konflikt interesi, <http://akk-ks.org/sq/vendimet>

<sup>6</sup> Po aty

<sup>7</sup> Naser Bresa, këshilltar i KK, mars 2015, diskutim në seancë të KK-së

<sup>8</sup> Ymer Berisha, Shef i Zyrës për Informim, gjatë intervistës me monitoruesit, nëntor 2015

<sup>9</sup> Takime në lagje me komunitetin, EC Ma Ndryshe

## 2. Organizimi dhe funksionimi

*Publiku duhet të ketë informata të mjaftueshme për të kuptuar organizimin, kompetencat, funksionimin, procesin e vendimmarrjes dhe të politikëbërjes të trupave të ndryshme komunale.*

Në Komunën e Prizrenit, informatat mbi organizimin dhe kompetencat komunale kryesisht janë të kopjuara nga legjislacioni. Nuk ka organogram të publikuar. Nuk ka informata mbi organet e decentralizuara e as ato në të cilat autoritetet komunale kanë kompetenca. Ka informata bazike mbi zyrtarët kryesorë, por detyrat dhe përgjegjësitë e sakta të tyre nuk janë të përshkruara në mënyrë të kuptueshme.

Mënyrat më efektive për ndikim në politikëbërje dhe vendimmarrja nuk janë të shpalosura në mënyrë të qartë për publikun. Qytetarët kanë njohuri të pakta mbi procesin e bërjes së politikave, strategjive, apo nxjerrjes së akteve normative, si dhe për mënyrën e vendimmarrjes në Ekzekutivin e Komunës dhe në Kuvend.

Kanalet e komunikimit zyrtar, ndonëse të publikuara, nuk janë të përhapura e as të promovuara. Komunikimi është më efikas në baza personale me zyrtarët komunal. Nuk ekziston një sistem që do të fuqizonte kanalet e komunikimit zyrtar, në mënyrë që ta bëjë më të përhapur dhe më të qëndrueshme këtë praktikë.

Cilësia e informatave për planet afatmesme e afatgjata është e dobët. Propozim buxheti 2016-2018 është i publikuar, por jo edhe versioni i miratuar në KK, ani pse sipas zyrtarëve kjo është politika më e rëndësishme publike e Komunës së Prizrenit. Strategjia komunale për Informim, Komunikim dhe Pjesëmarrje Qytetare 2015-2018 dhe Master Plani për Menaxhimin e Mbeturinave 2014-2023 janë të publikuara, sikurse edhe disa propozim rregullorë që janë vënë në diskutim publik. Mirëpo ka edhe politika tjera afatmesme që janë miratuar në KK, e përmbajtja e tyre nuk është bërë publike.

Të dhënat mbi komunën ekzistojnë, por nuk janë të strukturuar. Kjo pasi nuk ka të dhëna statistikore mbi popullsinë, pastaj për urbanizimin, sistemin e ujit e të kanalizimit, furnizimin me energji. Ekzistojnë të dhënat për gjeografinë, historinë, ekonominë, kulturën dhe trashëgiminë kulturore, që duhet të rifreskohen.



### Nota: 2 (Negative)

*Arsyetimi: Informatat aktuale të ofruara nga Komuna nuk i mundësojnë publikut të gjerë që të kuptojë lehtë organizimin, kompetencat, funksionimin, procesin e vendimmarrjes dhe të politikëbërjes të trupave të ndryshme komunale. Ato kryesisht mjaftojnë për përmbushjen e obligimeve minimale ligjore, por jo edhe për promovimin e një qasjeje proaktive për afrimin e publikut.*

### 3. Puna e organeve politikëbërëse dhe vendimmarrëse

*Publiku duhet të ketë informata të detajuara, përditësuara, dhe të mjaftueshme për të vlerësuar problematikat kryesore të debatuar dhe vendimet kryesore të marra nga organet politikëbërëse dhe vendimmarrëse të Komunës.*

Organet komunale të Prizrenit nuk është se kanë aplikuar praktika për shtytjen e qytetarëve që të jenë vëzhgues aktiv të debateve dhe proceseve vendimmarrëse. Informimi me kohë dhe i saktë, dhe me materiale ka ndodhur për takimet e Kuvendit dhe të Komitetit për Politikë e Financa. Kjo nuk vlen edhe për Komitetet dhe Komisionet tjera komunale që pothuajse në ‘fshehtësi’ i kanë mbajtur takimet e tyre. Madje ka raste kur neglizhohet edhe puna e këtyre komisioneve komunale, me mos mbajtje të rregullt të takimeve<sup>10</sup>. Rastet kur qytetarët kanë arritur që të fusin ndonjë çështje me interes në rendin e ditës janë të rralla. Pjesëmarrja e qytetarëve në takimet e Kuvendit është e ulët, e në Komitete e Komisione, pothuajse inekzistente. Hapësira fizike është e përshtatshme për pjesëmarrje të publikut. Seancat e KK-së transmetohen drejtpërdrejtë përmes mediave lokale.

Raportimi i Ekzekutivit në Kuvend përmbush vetëm kriteret minimale ligjore. Nuk ka llogaridhënie dhe transparencë të plotë të Ekzekutivit kundruall Kuvendit. Vetëm drejtorë të caktuar japin përgjigje në Kuvend për shqetësimet që paraqiten nga anëtarët e Kuvendit. Anëtarët e Kuvendit sidomos nga opozita, gati në secilën seancë, ankohen se nuk i marrin përgjigjet me shkrim nga drejtorët e Ekzekutivit. Sipas tyre ka raste kur përgjigjet vonohen edhe me muaj. Por ka dhe raste kur në pyetjen konkrete për temën e caktuar jepen përgjigje tërësisht të natyrës tjetër, jashtë kontekstit<sup>11</sup>. Gjithashtu përgjigjet e Ekzekutivit shumë rrallë herë përcillen me dokumente zyrtare, që do të mbështetnin validitetin e përgjigjeve të tyre. Ndërkohë as nismat si ajo e Forumit Transparenca (gazetarë dhe aktivistë) për ballafaqim me kryetarin e komunës, Ramadan Muja, nuk kanë dhënë rezultat, pasi që kryetari ka refuzuar përballjen direkte<sup>12</sup>. Kryetari nuk ka raportuar në Kuvend as për aktivitetin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, përkundër faktit se ligji e obligon në këtë drejtim<sup>13</sup>.

Mundësitë e qytetarëve për t’u informuar për punën e komunës, politikën dhe aktet normative janë të kufizuara. Statuti i Komunës është i publikuar dhe lehtë i qasshëm. Procesverbalet e mbledhjeve të Kuvendit dhe KPF-së publikohen, por me vonesa që shkojnë në disa muaj. Procesverbalet e Komiteteve dhe Komisioneve tjera nuk publikohen. Zërimet e mbledhjeve të KK-së nuk publikohen. Vendimet e KK-së publikohen, por pa arsytetime shtesë. Draft aktet janë të qasshme për qytetarët vetëm gjatë organizimit të diskutimeve publike për to dhe në të shumtën e rasteve nuk publikohen online. Propozimet legjislativë dhe nismat e rëndësishme legjislativë që janë në proces kryesisht publikohen. Projektet e propozuara nga anëtarët e Kuvendit nuk publikohen. Baza e të dhënave për

10 Intervistë, Skender Susuri, anëtar i KK-së, Bashkimi Demokratik

11 Intervistë, Skender Susuri, anëtar i KK-së, Bashkimi Demokratik, pyetjet e adresuara me shkrim për drejtorin e Turizmit dhe atë të Kulturës.

12 Diskutim në Fokus Grup, Valbona Musliu, gazetarë, më 22 janar 2016

13 Diskutim në Fokus Grup, Skender Susuri, anëtar i KK-së, Bashkimi Demokratik, më 22 janar 2016

rregulloret e shqyrtuara, aprovuara dhe sa vota kanë qenë për, sa kundër dhe sa abstenime gjendet në shërbimin teknik të KK-së, por nuk janë të publikuara. Këto të dhëna pasqyrohen brenda procesverbaleve.

Vendimet dhe aktivitetet e Ekzekutivit publikohen, por jo edhe marrëveshjet. Para prezantimit të draftit të Indeksit... për Prizren, raportet periodike në 2015-n i kanë pas të publikuara vetëm 4 drejtori, nga 13 sa i ka Ekzekutivi i Prizrenit. Kjo praktikë është përmirësuar pas Fokus Grupit, ku është diskutuar drafti i Indeksit dhe kështu drejtorja e Administratës ka publikuar raportin vjetor të punës me statistika, ajo e Financave pas raporteve periodike ka publikuar edhe raportin vjetor. Inspektorati ka publikuar një raport periodik dhe një raport vjetor. Shërbimet publike kanë publikuar raportin vjetor. Arsimi ka mbetur me një raport periodik, derisa Turizmi ka publikuar raportin vjetor të punës. Ndërsa Bujqësia pas një raporti periodik ka publikuar edhe raportin vjetor. Njëjtë buxheti komunal i vitit 2015 nuk ka qenë i publikuar, e as ai për vitin 2016. Pas diskutimeve në Fokus Grup, drejtorja e Financave ka publikuar Buxhetin e Kosovës për vitin 2016 si të tërë, me vërejtjen se faqet 306 deri në 317 i takojnë Prizrenit.



## Nota: 2 (Negative)

*Arsyetimi: Publiku nuk ka informata të detajuara, përditësuara, dhe të mjaftueshme për të vlerësuar problematikat kryesore të debatuar dhe vendimet kryesore të marra nga organet politike-bërëse dhe vendim-marrëse të Komunës, dhe duhen ende përpjekje për përmirësimin e transparencës në këtë drejtim. Inkurajuese është veprimi pas vërejtjeve, por megjithatë transparenca duhet të jetë vazhdimisht pjesë përbërëse e punës së organeve dhe zyrtarëve komunal.*

## 4. Luftimi i sjelljeve të pahijshme dhe keqpërdorimeve

*Komuna duhet të publikojë informata të rëndësishme nga të cilat lehtësisht mund të vlerësohet niveli i përkushtimit të saj në luftimin e sjelljeve të pahijshme dhe keqpërdorimeve.*

Në Komunën e Prizrenit, konfliktet e interesit të anëtarëve të Kuvendit, të kryetarit të Komunës, të nënkryetarëve, të drejtorëve të drejtorive të Komunës dhe të nëpunësve të administratës komunale përkufizohen në statutin e Komunës<sup>14</sup>. Për të gjitha rastet që nuk janë rregulluara me nenet e statutit zbatohen dispozitat e Ligjit për Procedurën Administrative. Zyrtarët e Komunës së Prizrenit thonë se kryetari i komunës ka emëruar një Komision disiplinor që merret me shkeljet eventuale ligjore nga punonjësit e Komunës. Njëkohësisht thirren në Kodin e Etikës për Shërbyesit Civil. Përbërja e Komisionit disiplinor e kompetencat që i ka ky trup nuk janë të publikuara. Përmbajtja e Kodit sipas drejtorit të Administratës ka qenë e publikuar në formë të tabelave. Monitoruesit nuk i kanë hasur në hapësirat e objekteve të komunës. Drejtori i Administratës ka theksuar se kanë qenë të vendosura dhe është zotuar t'i rivendosë ato nëse eventualisht janë hequr.

<sup>14</sup> Statuti i Komunës, Seksioni VIII, Konflikti i interesave, [http://kk.rks-gov.net/prizren/getattachment/Home/satuti\\_komunes\\_tetor\\_2008\\_04\\_12.pdf.aspx](http://kk.rks-gov.net/prizren/getattachment/Home/satuti_komunes_tetor_2008_04_12.pdf.aspx)

Komuna e Prizrenit nuk është transparente në aktivitetet e saja në luftën kundër keqpërdorimeve. Numri i aktiviteteteve të ndërmarra në këtë drejtim e as lloji i tyre nuk janë të publikuara. Nuk ka të dhëna për numrin e rasteve të hetuara. Sipas deklaratave të zyrtarëve komunal vendimet e ndërmarra përfshijnë suspendimin nga puna në kohë të caktuar, sikurse edhe largimin nga puna. Por, nuk ka të dhëna statistikore për këtë. Numri i personave të angazhuar në luftën kundër keqpërdorimeve dhe mashtrimeve sipas ZI arrinë në 28, të shpërndarë në të gjitha dikasteret<sup>15</sup>. Komuna nuk ka mekanizëm të përcjelljes për të gjitha dyshimet e ngritura.

Niveli i informimit të publikut për mekanizmat e raportimit të keqpërdorimeve të mundshme është tejet i ulët, pasi komuna nuk ofron informata të mjaftueshme për të shpjeguar me saktësi se çfarë përbën keqpërdorim dhe nuk ka ofruar asnjë mundësi për publikun që t'i komunikojë rastet e tilla.

Për më tepër, ka raste kur kryetari i komunës ka ndërmarrë veprime ndaj zyrtarëve të akuzuar nga organet e drejtësisë vetëm pas konsultave të zhvilluara në forumet e partisë së tij apo të partnerëve të koalicionit, të cilat më pas janë përcjellë me veprime të caktuara të organeve komunale.



### Nota: 1 (Negative)

*Arsyetimi: Në bazë të akteve në fuqi dhe praktikave të zbatuara del se Komuna e Prizrenit nuk ka treguar përkushtim pro-aktiv në luftimin e sjelljeve të pahijshme dhe keqpërdorimeve. Vetëm pas veprimeve të organeve të drejtësisë, në raste të caktuara janë ndërmarrë masa ndaj zyrtarëve të akuzuar.*

## 5. Integrimi Evropian

*Publikut duhet t'i ofrohet mundësia që të mësoj në mënyrë të saktë dhe të detajuar obligimet, arrijtet dhe sfidat që i ka komuna në procesin e integritit të Kosovës në BE.*

Në vitin 2015, Komuna e Prizrenit nuk ka publikuar asnjë informatë për obligimet që ka komuna në procesin e integritit të vendit në BE. Komuna posedon listën e obligimeve që ka në procesin e integritimeve evropiane, por ajo nuk është e publikuar.

Zyra për Integritime Evropiane ka shprehur qëndrimin se ka përmirësime në fushën e riatdhesimit, të drejtave të njeriut, barazisë gjinore, dhunës në familje, të drejtave të komuniteteve, përdorimit të gjuhëve, etj. Mirëpo të dhënat e kësaj natyre nuk janë të publikuara për opinionin. Opinioni, por as anëtarët e KK-së nuk kanë informata mbi rrjedhën e procesit për hartimin e Strategjisë komunale për Integritime Evropiane, ani pse kjo politikë publike ka qenë agjendë të punës së KK-së për vitin 2015<sup>16</sup>.

<sup>15</sup> Wintervistë me Shefin e Zyrës për Informim, Ymer Berisha, nëntor 2015

<sup>16</sup> Intervistë, Skender Susuri, anëtar i KK-së, Bashkimi Demokratik




Publiku gjithashtu nuk ka informata mbi ndikimin në integrimet evropiane lidhur me çështjet ekonomike, çështjet sociale, çështjet e administratës publike, dhe të tjera.



### Nota: 1 (Negative)

*Arsyetimi: Publikut nuk i është ofruar asnjë mundësi që të ketë informata për aktivitetet e Komunës në raport me procesin e integritit në BE. Si për ironi, në rubrikën Zyra për Integritet Evropian përmbajtja i ngjan më shumë një korrespondence elektronike sesa përshkrimin të përgjigjesive që ka kjo Zyre<sup>17</sup>.*



## II. Menaxhimi ekonomik dhe financiar

### 6. Kontabiliteti dhe buxheti

*Të dhënat dhe raportet e ndryshme dhe të përditësuara rreth të hyrave financiare, alokimeve buxhetore, shpenzimeve financiare, borxheve dhe kontesteve me pasojë financiare për komunën, duhet të jenë në dispozicion të publikut për të pasë pasqyrë të qartë mbi menaxhimin e parasë publike në nivel lokal.*

Komuna e Prizrenit ka ndërmarrë disa hapa drejt përfshirjes së publikut në planifikimin buxhetor, megjithëse informimi për këtë proces duhet të përmirësohet edhe më tutje. Autoritetet komunale gjatë vitit 2015 kanë organizuar 6 debate publike me qytetarët në zonat rurale dhe një tjetër në sallën e KK-së për buxhetin e vitit 2016 dhe KAB 2016-2018. Edhe KPF-ja ka organizuar dy debate publike, një në bashkëpunim me shoqërinë civile dhe tjetrën me OSBE-në, mbi këtë temë. Informimi ka qenë i saktë për këto takime. Nuk ka informata të publikuara nëse buxheti është diskutuar në Komitetin për Komunitete. As Komisionet tjera nuk janë aktivizuar në diskutimin e politikave buxhetore<sup>18</sup>. Draft-buxheti nuk është publikuar online, por janë shpërndarë kopjet e shtypura. Proseverbale të diskutimeve publike nuk janë publikuar, e as propozimet që janë pranuar nga qytetarët. Në bazë të deklaratave të zyrtarëve komunal, secili drejtor ka mbajtur shënime për kërkesat e qytetarëve dhe sipas tyre 80 deri në 90 për qind të propozimeve janë inkuorporuar në planifikimin buxhetor<sup>19</sup>. Por, komuna akoma nuk ka ndërtuar një mekanizëm për regjistrimin e propozimeve të qytetarëve, si dhe për publikimin e vendimeve në qoftë se këto propozime janë përkrahur apo hedhur poshtë.

<sup>17</sup> Ueb faqja e Komunës së Prizrenit, Zyra për Integritet Evropian, <http://kk.rks-gov.net/prizren/Municipality/Zyra-per-integritet-evropiane.aspx>, qasur më 29 dhjetor 2015 dhe 18 shkurt 2016.

<sup>18</sup> Intervistë, Skender Susuri, anëtar i KK-së, Bashkimi Demokratik

<sup>19</sup> Kujtim Gashi, kryesues i KK-së, debat i organizuar nga KDI dhe KPF për propozim-buxhetin, 11 shtator 2015.



Të dhënat mbi ndarjet dhe realizimet buxhetore publikohen online në kuadër të 'Buxhetometrit', platformë e Institutit GAP, që bashkëpunon me EC Ma Ndryshe, e që ka linkun edhe në ueb faqen e Komunës<sup>20</sup>. Të dhënat mbi ndarjet dhe realizimet buxhetore publikohen edhe në formë të raporteve, vjetore dhe tremujore. Në dokumentin e buxhetit figurojnë të dhënat mbi projektin, shumën e planifikuar për shpenzim dhe burimet nëse janë nga granti qeveritar apo të hyrat vetanake dhe viti kur do të realizohet projekti i caktuar. Nuk ka shpjegime mbi qëllimet e projekteve. Ato në të shumtën e rasteve pasqyrohen në propozimet që adresohen te kryetari për lejimin e shpalljes së tenderëve. Këto propozime janë të qasshme për gazetarët dhe shoqërinë civile<sup>21</sup>. Në Kornizën Afatmesme Buxhetore, figuron praktika e ngjashme sikurse në buxhetin vjetor, ku është edhe lista me projekte. Komuna nuk ka arritur që të zhvillojë një tabelë interaktive të buxhetit shumëvjeçar.

Komuna e Prizrenit këtë vit për herë të parë ka publikuar raportin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për pasqyrat financiare të vitit 2014. Bazuar mbi të dhënat e këtij raporti, në vitin 2015 ka pasuar edhe një hetim i AKK-së për projektin e ndërtimit të rrugës Shpenadi-Velezhë, për shkak të dyshimeve për parregullsi<sup>22</sup>. Projekti kishte nisur në vitin 2012, për të cilin pagesat ishin kryer edhe në vitin 2014. Lënda është dorëzuar te zyrarët e AKK-së për verifikim. Zyrarët komunal thonë se në këtë rast nuk ka pas parregullsi, pasi që pagesat janë vonuar për shkak të mungesës së mjeteve në buxhetin komunal.

Në përgjithësi mund të thuhet se ka informata të kënaqshme për të kuptuar burimet e të hyrave të Komunës, megjithëse duhet më shumë angazhim për t'i promovuar këto informata te publiku i gjerë.

Mirëpo, Komuna ofron pak informata për qytetarët mbi suficitin/deficitin buxhetor apo borxhet e saj, dhe llogaritë e arkëtueshme, apo detyrimet kontigjente. Publikimi i shumës së borxheve të komunës ndaj operatorëve të ndryshëm dhe llogarive të arkëtueshme, si dhe detyrimeve kontingjente ndodh zakonisht në kuadër të raportit vjetor të financave, pa sqarime, por vetëm në mënyrë të përmblendhur, që zakonisht nuk publikohet online.

Komuna nuk ofron informata mbi funksionimin e organizatave të cilat ofrojnë shërbime për qytetarët, ku komuna ka kompetenca, e aq më pak ndonjë të dhënë buxhetore të këtyre organizatave publike.



### Nota: 3 (Neutral)

*Arsyetimi: Gjatë vitit 2015, Komuna e Prizrenit ka aplikuar politika dhe praktika për përfshirjen e publikut në hartimin e buxhetit. Por ato duhet të avancohen edhe më tej në drejtim të arritjes së transparencës buxhetore, meqë raportet e realizimit, ato të shpenzimeve dhe sfidave duhet ta kenë edhe pjesën narrative, derisa duhet krijuar dhe një mekanizëm për njoftimin e qytetarëve mbi fatin e propozimeve të tyre.*

<sup>20</sup> Buxhetometri, Instituti GAP dhe EC Ma Ndryshe, <http://www.online-transparency.org/rpms/spendings/>

<sup>21</sup> Intervista me anëtarët e Forumit Transparenca, shtator, tetor dhe nëntor

<sup>22</sup> "Zvarritja e rrugës Shpenadi-Velezhë ngjall dyshime tek autoritetet shtetërore", <http://koha.net/?id=&l=90231>

## 7. Kontratat e prokurimit publik, furnizimit dhe granteve

*Marrëdhëniet kontraktuale me implikime financiare në mes të komunës dhe personave fizik dhe juridik duhet të zhvillohen në transparencë të plotë, për të siguruar menaxhimin e mirë të parasë publike dhe vlerën e duhur për shërbimet, punët apo furnizimet.*

Komuna e Prizrenit nuk është treguar transparente sa i përket shpalosjes së informatave të vlerësimit të përshtatshmërisë së operatorëve për hyrje në marrëdhënie kontraktuale me ta. Nuk ka informata të publikuara lidhur me mënyrën e përzgjedhjes dhe përbërjes së komisioneve vlerësuese, ani pse zyrtarët komunal pohojnë se këto komisione përbëhen nga zyrtarë të prokurimit, profesionistët dhe zyrtarë të caktuar të drejtorive përkatëse<sup>23</sup>. Njoftimet për kontrata nga Sektori i Prokurimit publikohen në Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP), e pjesërisht edhe në ueb faqen e Komunës. Nuk ka arsyetime për vendosjen e kriterëve. Procesverbalet e komisioneve vlerësuese ekzistojnë, por nuk publikohen<sup>24</sup>. Manuale për proceset e konkurrimit, parime dhe kod të mirësjelljes për procese kontraktuese nuk ka, por zbatohen dispozitat e LPP-së. Prej gjysmës së dytë të vitit aktivitetet e prokurimit me kuotim kanë nisur të publikohen në KRPP, që sipas zyrtarëve ka sjellë efekt pozitiv dhe konkurrencë të rritur. Nuk ka publikime mbi përgjegjshmërinë e kompanive të kontraktuara. Prokurimi i Prizrenit, sivjet për herë të parë ka ndërprerë tri kontrata me operatorët e papërgjegjshëm. Nuk ka informata që do të pasqyronin përputhshmërinë e projekteve aktuale me listën e projekteve të aprovuara nga KK-ja. Transparenca është tejet e ulët te aneks kontratat. Nuk ka raporte të publikuara të hulumtimit të tregut apo të tilla për mësimet e nxjerra nga kontratat në të kaluarën.

Transparenca në menaxhimin e projekteve dhe kontratave është në nivel të ulët. Ka raste kur shoqëria civile dhe komuniteti kanë kërkuar informata lidhur me rrjedhën e projekteve dhe kontratave të caktuara dhe nuk ju është lejuar qasja e plotë në dokumentet publike, por dikasteri i caktuar ka ofruar përgjigje të cunguar, apo krejt jashtë konteksti<sup>25</sup>. Sa i përket publikimit të kontratave komuna e Prizrenit nuk ka qenë transparente edhe sipas KDI-së pasi që nuk është përgjigjur në kërkesën e bërë nga kjo organizatë<sup>26</sup>.

Nuk ka raporte mbi performancën e kontraktorëve bazuar në indikatorët e paracaktuar në kontratë. Sipas Sektorit të Prokurimit, kjo është përgjegjësi e dikasterëve, që udhëheqin projektet.

Baza e të dhënave për kontratat e nënshkruara ekziston në komunë, por kontratat në përgjithësi nuk bëhen publike. Shumat e tyre, si dhe procedura e përdorur, e numri i konkurrentëve kryesisht figurojnë në njoftimet për dhënie të kontratës që publikohet në KRPP, dhe pjesërisht në ueb faqen e Komunës. Në këto njoft-

23 Isa Osmankaj, Shef i Zyrës së Prokurimit, debat "Prokurimi Publik në Komunën e Prizrenit" organizuar nga Lëvizja FOL, 18 dhjetor 2015

24 Isa Osmankaj, Shef i Zyrës së Prokurimit, debat "Prokurimi Publik në Komunën e Prizrenit" organizuar nga Lëvizja FOL, 18 dhjetor 2015

25 EC Ma Ndryshe dhe banorët e rrugës Liman Shala-Prizren, Kërkesë për qasje në dokumentet publike për projektin e shtrimit të rrjetit të kanalizimit

26 "Transparometri komunal", Janar-Gershor 2015, Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), korrik 2015

time figurojnë dhe të dhënat bazike për fituesin e tenderit. Statistikat ekzistojnë për aktivitetet e prokurimit, të ndara në shumë të mëdha, të mesme dhe me kuotim, si dhe për ato me Partneritet-publiko-privat, por nuk janë të publikuara<sup>27</sup>. Nuk ka as listë të publikuar të kontratave të nënshkruara me të dhëna specifike mbi palët që janë përzgjedhur si kontraktues, shumat dhe afatet, e realizimin e punëve sipas marrëveshjes.


Raportet e mbikëqyrjes së punimeve gjatë realizimit të projekteve kryesisht gjenden brenda drejtorive dhe nuk publikohen.

Ndëshkimet ndaj kompanive që nuk performojnë në bazë të kritereve dhe procedurave të dakorduara kanë filluar të aplikohen vetëm sivjet, me shkoputje të tri kontratave me operatorët e papërgjegjshëm<sup>28</sup>.



### Nota: 2 (Negative)

Arsyetimi: Vlerësimi për këtë indikator është negativ pasi që autoritetet komunale shpaleshin informata shumë të kufizuara mbi marrëdhëniet kontraktuale me implikime financiare, të cilat në parim duhet të zhvillohen në transparencë të plotë, për të bindur publikun se ka menaxhim të mirë të parasë publike.



## III. Menaxhimi i resurseve njerëzore dhe resurseve tjera

### 8. Të punësuarit në administratën publike dhe organizatat/institucionet publike

*Menaxhimi i resurseve njerëzore duhet të bëhet në mënyrë transparente duke përfutuar nga mbikëqyrja e vazhdueshme e publikut mbi performancën e administratës.*

Administrata komunale e Prizrenit organizohet në drejtori, si dhe Zyra. Secila drejtori e zyre komunale udhëhiqet nga drejtori përkatësisht shefi. Drejtorët emërohen dhe shkarkohen nga Kryetari i Komunës. Organizimi i brendshëm i drejtorive e zyrave dhe sistemimi i shërbyesve civilë në vende të punës, bëhet në bazë të Vendimit/Rregullores për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës në drejtoritë e Komunës së Prizrenit, i cili nuk është i publikuar<sup>29</sup>. Në përgjithësi, ka

<sup>27</sup> Isa Osmankaj, po aty

<sup>28</sup> Isa Osmankaj, po aty

<sup>29</sup> Ueb faqja e Komunës së Prizrenit, <http://kk.rks-gov.net/prizren/Municipality/Drejtoret.aspx>

përshkrim të detyrave dhe përgjegjësi të pozitive kryesore. Nuk ka raporte apo analiza të publikuara të sektorit të administratës publike, e as listë të gjithë personave të administratës. Informata kontaktuese të personave kryesorë ka, derisa pagat nuk bëhen publike, pos koeficientit që figuron në konkurset publike.

Informatat mbi funksionimin e organizatave/institucioneve të ndryshme komunale jo gjithëherë janë të qarta për publikun, dhe nuk ka organogram apo udhëzime të publikuara, që tregojnë lidhjen, përgjegjësitë dhe kompetencat.

Praktikat e rekrutimit/punësimit janë të bazuara në ndikimet politike partiake<sup>30</sup>. Struktura organizative nuk bazohet në analizat e sektorit dhe e njëjta nuk reflektohet në thirrjen për aplikim. Thirrjet për aplikim publikohen në ueb, media të shtypura e elektronike dhe në tabelat njoftuese të komunës. Punësimet sipas kriterëve të paracaktuara nuk janë transparente, ngase publikohen listat vetëm me poenat përfundimtarë, pa sqarime të hollësishme. Vendimet e mekanizmave të ankesës nuk publikohen.

Njoftimet për vende të lira dhe punësime në pozita publike në vende jashtë administratës bazë të komunës publikohen në ueb, media të shtypura e elektronike dhe në tabelat njoftuese të komunës. Nuk ka transparencë sa i përket emërimit të anëtarëve të Bordeve të ndërmarrjeve publike.

Nuk ka informata sa i përket performancës së administratës. Kodi i Etikës nuk është gjetur në tabela, por drejtori i Administratës ka theksuar se janë të publikuara<sup>31</sup>. Aktivitetet dhe vendimet e mekanizmave për vlerësim të performancës dhe sjelljes nuk janë publike. Nuk ka pas raportime të konfliktit të interesit, pos rasteve që të janë iniciuar e hetuar nga AKK-ja<sup>32</sup>. Raporti rreth vlerësimeve të performancës individuale në fundvit aplikohet, por nuk publikohet.



### Nota: 1.5 (Negative)

*Arsyetimi: Komuna e Prizrenit ka marrë vlerësim negativ sa i përket këtij indikator për faktin se nuk e ka qartësuar për publikun organizimin, strukturën dhe funksionimin e administratës së saj, derisa nuk aplikohen as praktikat më të mira gjatë rekrutimit dhe punësimit të personelit. Ndërkohë publiku nuk është i informuar për performancën e administratës.*

### Komentet e Komunës:

*Nuk ka të punësuar në Komunën e Prizrenit pa u shpallë konkursi publik në ueb-sajt të Komunës dhe në gazetë zyrtare dhe nuk ka konkurs të cilin e ka anulua Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës dhe që nuk janë respektua të gjitha kriteret e parapara në bazë të ligjit për shërbyes civil. Nuk ka konkurs që është mbajtur që nuk është intervistua, që nuk janë të incizuara intervistat dhe janë në formë të testit. Askush nuk është pranuar në punë që nuk i ka plotësuar kriteret e punës në bazë*

30 Intervistë anonime me zyrtarë të Komunës së Prizrenit, 18 nëntor 2015

31 Intervistë e autorit të raportit me drejtorin e Administratës, Ilir Baldedaj, shkurt 2015

32 Agjencia Kundër Korrupsion, Vendimet për konflikt interesi, <http://akk-ks.org/sq/vendimet>

të ligjit për shërbyes civil dhe në bazë të rekomandimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës. Asnjëri/a që nuk është punësuar në Komunë nuk bënë ankesë tek ne. Të gjitha ankesat shkojnë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës. Dy herë Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i ka anuluar konkurset dhe i kemi përsërit dhe të gjitha rekomandimet e Këshillit të Pavarur janë respektuar.

## 9. Pasuria kapitale dhe jokatitale

*Publiku duhet të ketë informata të përditësuara dhe të plota mbi menaxhimin e pasurisë publike nga ana e pushtetit komunal.*

Komuna nuk ka publikuar një listë të të gjitha patundshmërive. Komuna e Prizrenit ka publikuar regjistrin e pronës (ngastra kadastrale) dhe atë të lokaleve. Mungon regjistri i ndërtesave dhe banesave që ka në pronësi. Te regjistri i pronës figurojnë vetëm metrat katrorë, pa vlerë financiare, derisa te regjistri i lokaleve figuron edhe çmimi i qirasë<sup>33</sup>. Nuk ka harta interaktive që paraqesin saktësisht lokacionin e këtyre pronave, e as bazë të dhënave se për çfarë përdoren këto pasuri. Te regjistri i lokaleve figurojnë adresat, se ku ndodhen këto patundshmëri. Menaxhimi i pasurive në komunën e Prizrenit, sipas Auditorit të Përgjithshëm është shoqëruar me dobësi të vazhdueshme<sup>34</sup>.

Nuk ka informata apo vendime të publikuara me të cilat synohet që të arsyetohet se përdorimi i tillë i këtyre patundshmërive është në të mirë të sovranit. Nuk ka vendime dhe arsyetime të publikuara për përdorimin apo lëshimin me qira të këtyre pronave, as listë të publikuar të pronave që janë transferuar nga komuna te pronarët tjerë, me arsyetimet e duhura.

Komuna nuk ka publikuar listë të pasurive jo-kapitale, si inventar, automjete, etj.

Komuna nuk ka ofruar ndonjë të dhënë për aksionet apo pronësinë në kompani të ndryshme.




### Nota: 1 (Negative)

*Arsyetimi: Mungesa e theksuar e transparencës mbi menaxhimin e pasurisë publike nga ana e pushtetit komunal ka bërë që ky indikator të ketë vlerësim të dobët. As rekomandimet e vazhdueshme të Auditorit të Përgjithshëm nuk kanë arritur që të shtyjnë Ekzekutivin komunal që ta adresojë këtë çështje në mënyrë të duhur dhe brenda një afati optimal kohor.*

<sup>33</sup> Regjistri i Pronës dhe Regjistri i Lokaleve, <https://kk.rks-gov.net/prizren/Home.aspx>

<sup>34</sup> Raporti i Auditorit të Përgjithshëm për PVF-të e Komunës së Prizrenit, [http://oag-rks.org/repository/docs/sq\\_Raporti\\_Final\\_Prizren\\_327559.pdf](http://oag-rks.org/repository/docs/sq_Raporti_Final_Prizren_327559.pdf)



## IV. Marrëdhëniet me qytetarët dhe shoqërinë

### 10. Informimi dhe shërbimi i qytetarëve

*Transparenca komunale duhet të jetë e avancuar duke i mundësuar publikut qasje të lehtë në informata, informim të saktë, të shpejtë dhe të detajuar rreth çështjeve që ndërlidhen me politikat, vendimet dhe shërbimet për qytetarët.*

Në Komunën e Prizrenit, ekziston Zyra për Informim, që udhëhiqet nga Shefi, që është i vetmi i punësuar në këtë zyre. Kontakti me të mund të vendoset lehtë dhe mund të merret ndihmë për qasje në informata dhe dokumente publike. Zyra për informim në vitin 2015 ka ndërmarrë politika për ngritje të transparencës. Është efi-kase në kthimin e përgjigjeve. Por ekziston problemi në mundësimin e qasjes së plotë në dokumentet publike, gjë që varet nga dikasteret komunale. Nuk ka publikuar statistika rreth përdorimit të rrjeteve sociale, rreth përdorimit të mjeteve mobile, rreth shërbimeve përmes telefonit. Nuk ka statistika as rreth këshillimit të qytetarëve dhe shërbimeve të informatave.

Komuna ka miratuar Strategjinë komunale për Informim, Komunikim dhe Pjesëmarrje Qytetare 2015-2018, që përmban dhe Planin e Veprimit, derisa më parë ka miratuar Rregulloren për Transparencë.

Ueb faqja e Komunës së Prizrenit (<https://kk.rks-gov.net/prizren/>) është mesatarisht e dobishme. Përmbajtja e ueb faqes duhet të përmirësohet me sistemimin e të dhënave për të lehtësuar qasjen në to. Në të shumën e rasteve ato janë publikuara nëpër lidhje të ndryshme, vështirë për t'u identifikuar, që nganjëherë krijojnë huti te përdoruesi. Duhet të përmirësohet edhe ngarkimi i materialeve në baza ditore. Nuk ka infografika. Nuk ka as raporte rreth popullaritetit të ueb faqes. Nuk ka ndonjë masë promovuese për të rritur numrin e vizitorëve dhe përdoruesve të shërbimeve. Forumi i diskutimit në ueb faqen e komunës ekziston, por është jo funksional.

Në ueb faqe nuk ka mekanizëm për mbledhjen e sugjerimeve nga publiku për përmirësimin e saj, derisa rubrika letrat e qytetarëve është jashtë funksionit. Komuna nuk ka kryer hulumtime të opinionit publik rreth transparencës në komunë.

Pos ueb faqes, Komuna e Prizrenit përdor dhe rrjetin social Facebook për pasqyrimin e aktiviteteve të saj, që ka rreth dy mijë ndjekës<sup>35</sup>. Nuk ka publikuar raporte me statistika rreth përdorimit dhe efikasitetit të rrjetit social, e as nuk është vërejtur ndonjë fushatë promovuese për shtimin e ndjekësve, derisa krahasuar me numrin banorëve kjo komunë ka numër të vogël të pëlqimeve në Facebook dhe duhet ta promovoj më shumë këtë llogari<sup>36</sup>. Aty kryesisht postohen lajmet që publikohen dhe në ueb faqe, e nuk ka infografika, video apo animacione. Nuk ka aplikacione as për telefona të mençur me informata të ndryshme për komunën.

<sup>35</sup> <https://www.facebook.com/kkprizren/>

<sup>36</sup> "Transparometri komunal", Janar-Qershor 2015, Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), korrik 2015

Materialet përkthehen në të gjitha gjuhët zyrtare, por jo në kohë reale. Po ashtu nuk ka kujdes të veçantë që gjuha e përdorur dhe prezantimi i informatave të jetë në formë të kuptueshme për publikun e gjerë.

Qasja në dokumentet publike mundësohet, por jo me efikasitet të qind për qindtë, qysh raporton Zyra për Informim. Sipas ZI-së në periudhën janar-dhjetor janë dorëzuar 102 kërkesa për qasje në dokumente publike, dhe 102 janë aprovuar<sup>37</sup>. Mirëpo, përvoja e shoqërisë civile nxjerr në pah si problematike respektimin e afateve kohore të përshkruara në legjislacion. Ndërsa përvojat e EC Ma Ndryshe nxjerrin të dhëna tjera në krahasim me ato të ZI-së, pasi që ka kërkesa që janë dorëzuar gjatë vitit 2015 dhe ende nuk kanë marrë përgjigje.

Informatat rreth shërbimeve për qytetarët janë të mangëta. Statistika periodike dhe vjetore ka mbi Shërbimet Administrative. Por statistika nuk ka për shërbime si Mirëqenia Sociale dhe Familjare, Kulturë-Rini-Sport, Emergjencat Lokale, Furnizimi me ujë, Kanalizimi, etj. Por të dhëna ka në formë të raportit vjetor mbi grumbullimin e mbeturinave, deponimin e tyre. Të dhëna të precizuara nuk ka për çështjet që ndërlidhen me shëndetësinë, arsimin, sigurinë, kompanitë publike, hapësirat gjelbëruese, barërat nga lista esenciale, edukimin para universitar, harta interaktive, temat, kapaciteti, gjendja e trafikut, incidentet që ndërlidhen me shërbime komunale, informata të përditësuara mbi ndotjen e ajrit dhe zhurmës.



### Nota: 2.5 (Neutrale)

Ansytimi: Vlerësimi për Informimin dhe shërbimin e qytetarëve është në një kufi ndërmjet negatives dhe neutrales. Autori i raportit është përcaktuar që të jap vlerësimin neutral, për shkak të miratimit të Strategjinë komunale për Informim, Komunikim dhe Pjesëmarrje Qytetare 2015-2018. Megjithatë kjo është një politikë inkurajuese për shtimin e transparencës, e cila duhet të gjej zbatim praktik. Deri tani nuk ka informata publike se sa mjete buxhetore janë shpenzuar për zbatimin e saj në vitin 2015.

### Komentet e Komunës:

*Lidershipi komunal ka shprehur vullnetin për jetësimin e Qasjes në dokumente publike brenda afateve ligjore për të gjitha palët.*

## 11. Bashkëpunimi me shoqërinë civile

*Organet komunale duhet të jenë të hapura dhe të angazhohen për qeverisje transparente duke thelluar bashkëpunimin me shoqërinë civile.*

Komuna e Prizrenit shquhet për organizim të mirëfilltë të grupeve të ndryshme të interesit, të biznesit, të komuniteteve e të ngjashme. Mjaft aktive janë edhe

<sup>37</sup> Informatë nga ZI, Komuna Prizren, Raport për qasje në dokumente publike



organizatat e shoqërisë civile posaçërisht ato që merren me demokratizim dhe kulturë duke mos i anashkalluar as ato rinore, të grave, të personave me aftësi të kufizuara etj. Të gjitha këto mekanizma paraqesin një potencial të madh të cilin Komuna e Prizrenit duhet dhe do ta shfrytëzojë me qëllim të thellimit të partneritetit me qytetarët e saj... Megjithatë, mungon një qasje e gjithanshme dhe e strukturuar e Komunës së Prizrenit ndaj të gjitha këtyre organizatave<sup>38</sup>. Në periudhën e ardhshme do të tentohet institucionalizimi i bashkëpunimit të komunës me këto organizata dhe mekanizma të shoqërisë me përmes themelimit të mekanizmave konsultativ<sup>39</sup>. Komuna nuk ka të publikuar një udhëzues për pjesëmarrje qytetare. Ndërkohë ka memorandumë të bashkëpunimit me disa organizata të shoqërisë civile<sup>40</sup>.

Komuna mban dy tubime publike për të raportuar për punën e Ekzekutivit. Në takimin e mbajtur në dhjetor të këtij viti ka pas qytetarë që kanë shprehur mospajtime me raportin e paraqitur nga kryetari. Madje në një rast moderatori i tubimit ia ka ndërprerë fjalën një qytetari, meqë ai nuk pajtohet me të dhënat e paraqitura nga zyrtarët e lartë komunal<sup>41</sup>. Për buxhetim janë mbajtur 7 debate publike, në zonat rurale dhe urbane. Raportimi para qytetarëve kryesisht bëhet në mënyrë gojore. Në muajt e fundit të 2015-s është intensifikuar procesi i funksionalizimit të këshillave lokale.

Komuna e Prizrenit ka vështirësi në arritjen e vendosjes së një komunikimi të rregullt dhe të qëndrueshëm me qytetarët dhe grupe të interesit gjatë procesit të hartimit dhe miratimit të akteve komunale me theks të veçantë të rregulloreve dhe të dokumenteve tjera strategjike sikurse janë planet rregullative apo të ngjashme<sup>42</sup>. Gjatë vitit 2015, KK-ja e Prizrenit ka iniciuar hartimin e 5 rregulloreve, dhe secila është vënë në diskutim publik. Kryesisht organizohet nga një diskutim publik. Për buxhetin janë organizuar 7 debate publike nga Ekzekutivi dhe 2 nga KPF-ja. Regjistrimi i propozimeve të qytetarëve bëhet gjatë diskutimit publik ose përmes kontributit me shkrim, por nuk ka informata kthyesë nëse ato përfshihen ose jo në aktet e komunës. Zyrtarët thonë se Kryetari takon përditë qytetarët, por nuk kanë përmendur ndonjë ditë të caktuar të dedikuar për këso lloj takimesh.



## Nota: 2 (Negative)

*Arsyetimi: Komuna ka marrë vlerësim negativ pasi që ende nuk ka iniciuar ndonjë proces për themelimin e mekanizmave konsultativ, që do të shtonte bashkëpunimin me organizatat e shoqërisë civile. Gjithashtu në debatet publike nuk ka treguar gatishmëri për llogaridhënie para publikut, duke ju shmangur diskutimeve ku qytetarët kanë shprehur mospajtimet e tyre me qëndrimet e Ekzekutivit. Gjithashtu, ka paqartësi të theksuara nëse kryetari ka një orar preciz të dedikuar për takimin me qytetarët.*

38 Strategjia komunale për Informim, Komunikim dhe Pjesëmarrje Qytetare 2015-2018


39 Po aty

40 Sipas shefit të Zi-së, Ymer Berisha, Komuna ka memorandum me Caritasin Zvicëran, EC Ma Ndryshe, derisa edhe KDI-ja bën monitorimin e KK-së.

41 Monitorimi i tubimit publik të Kryetarit të Komunës me qytetarët, 23 dhjetor 2015

42 Strategjia komunale për Informim, Komunikim dhe Pjesëmarrje Qytetare 2015-2018





## V. Planifikimi dhe zhvillimi urban

### 12. Planifikimi urban

*Publiku duhet të ketë qasje në informata të rëndësishme që ndërlidhen me planifikimin urban, pasi kjo përbën një nga parimet themelore të qeverisjes së mirë.*

Publiku është pjesërisht i informuar sa i përket akteve normative dhe dokumenteve strategjike në fushën e planifikimit urban. Informatat janë të pakta mbi rregulloret ekzistuese për planifikim urban, planet, strategjitë, kriteret e kufizimet dhe procesin e marrjes së lejeve. Në ueb faqe figuron ende draft-rregullorja për trajtimin e ndërtimeve pa leje, që nga niveli qendror ishte vlerësuar se nuk mbështetet në bazë ligjore<sup>43</sup>. Në ueb figuron dhe rregullorja për tarifën, ngarkesat dhe gjobat nga shërbimet dhe veprimtaritë komunale, që ndërlidhet me shërbimet urbanistike. Në ueb faqe ka informata bazike mbi Planin Zhvillimor Komunal 2025, që është një dokument statutar që udhëheq zhvillimin e ardhshëm të komunës. Nuk ka informata për Hartën Zonale të Komunës, dhe disa Plane Rregulluese të Hollësishme. Në ueb faqe figurojnë Plani i Konservimit dhe Zhvillimit të Zonës Historike të Prizrenit, Plani rregullativ për zonën e veçantë “Parku i Biznesit” në Prizren, Plani rregullativ Dardania, ai Qendra e Re dhe Atmejdan. Qasja e publikut në Planet Rregulluese të Hollësishme mbetet sfiduese.

Komuna nuk përdor mjete të avancuara për t’i mundësuar publikut vëzhgimin e të gjitha elementeve që ndërlidhen me planet urbane. Leximi i tyre kërkon njohuri profesionale. Nuk ka harta interaktive me informata mbi shërbimet, aktivitetet dhe resurset në territor, planet për mbrojtje të mjedisit dhe menaxhimin e resurseve natyrore, kualitetin e ujit në hapësira të caktuara, emitimi i gazrave, informata të sakta të destinimit të tokës.

Komuna e Prizrenit nuk është transparente lidhur me lejet e ndërtimit dhe shfrytëzimin e hapësirave. Nuk publikohet lista me leje e ndërtimit të lëshuara, as vendimet dhe arsyetimet për lejet e ndërtimit të lëshuara. Procesverbalet e mbledhjeve të komisioneve që kanë aprovuar lejet e ndërtimeve nuk janë të qasshme për publikun. As nuk ofrohen informata mbi përputhshmërinë e lejeve të lëshuara me planet aktuale të komunës. Auditori ka “identifikuar që nga 784 kërkesa të bëra gjatë vitit (2014), vetëm 502 prej tyre ishin aprovuar, dokumentacioni i kërkuar nuk është plotësuar” dhe ka “vërejtur që edhe ata të cilët janë pajisur me leje ndërtimi, nuk i përmbahen kriterëve të përcaktuara nga urbanizmi”<sup>44</sup>. Për më shumë dispozitat e Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit obligojnë Drejtorinë për Urbanizëm që të përpilojë në baza javore listën e kërkesave të pranuar për projekte, e cila duhet të jetë publike dhe duhet t’u shpërndahet anëtarëve të Këshillit<sup>45</sup>. Po

43 “Rregullorja për trajtimin e ndërtimeve pa leje, kopje antiligjore”, Komunikatë, 23 nëntor 2013, EC Ma Ndryshe, [http://online-transparency.org/repository/docs/Komunikate\\_23\\_nentor\\_2012.pdf](http://online-transparency.org/repository/docs/Komunikate_23_nentor_2012.pdf)

44 Raporti i Auditorit për pasqyrat financiare të Komunës së Prizrenit 2014, [http://oag-rks.org/repository/docs/sq\\_Raporti\\_Final\\_Prizren\\_327559.pdf](http://oag-rks.org/repository/docs/sq_Raporti_Final_Prizren_327559.pdf)

45 Ligji për Qendrën Historike të Prizrenit, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2836>

ashtu sipas Ligjit, dosja e plotë e kërkesave për projekte mirëmbahet dhe vihet në dispozicion për publikun nga Drejtoria për Urbanizëm. Por një gjë e tillë nuk zbatohet në praktikë. I njëjti ligj obligon edhe Këshillin e Trashëgimisë Kulturore të Qendrës Historike të Prizrenit të publikoj punën e tij me informatë publike, gjë që ka ndodhur rrallë herë në 2015-n.



### Nota: 1 (Negative)

*Arsyetimi: Planifikimi urban ka ndikim të shumëfishtë në jetesën e qytetarëve. Komuna ka dëshmuar se ka mjaft dobësi sa i përket ofrimit të informatave për publikun, si dhe sigurimit të pjesëmarrjes së publikut në proceset vendimmarrëse në fushën e planifikimit urban dhe hapësinor.*

## 13. Monitorimi i projekteve urbanistike

*Komuna duhet në vazhdimësi ta informojë publikun për rrjedhën e projekteve të cilat kanë ndikim në planifikimin dhe zhvillimin urban.*

Komuna e Prizrenit nuk ka treguar efikasitet të duhur sa i përket raportimit të aktiviteteve të saja për monitorimin e zbatimit të planit urbanistik. Në raportin e Auditorit për vitin 2014, ceket qartë se Komuna nuk ka arritur të vendos kontrolle efektive dhe monitorim të duhur gjatë trajtimit të rasteve të ndërtimit<sup>46</sup>. Siç u tha edhe më lartë Auditori ka vërejtur “që edhe ata të cilët janë pajisur me leje ndërtimi, nuk i përmbahen kriterëve të përcaktuara nga urbanizmi. Për më tepër, Komuna nuk ka ndërmarrë masa adekuate për ndalimin e kësaj praktike”. Ndërsa përfaqësuesit e institucioneve që janë pjesë e Task Forcës për Qendrën Historike të Prizrenit, zonë kjo e mbrojtur me legjislacion të veçantë, sivjet kanë konfirmuar degradimin urbanistik në këtë hapësirë. Sipas tyre pothuajse në pjesën dërmuese të ndërtimeve apo intervenimeve në Qendrën Historike ka tejkalime të llojeve të ndryshme të lejeve urbanistike. Përfaqësuesi i QRTK-së ka theksuar se në 90 për qind të rasteve ka tejkalime nga lejet e DUPH-së, pavarësisht nëse bëhet fjalë për shkelje të vogla apo të mëdha<sup>47</sup>. EC Ma Ndryshe përmes kërkesave për qasje në dokumente publike ka kërkuar nga Drejtoria e Inspektorateve listën e objekteve apo ndërtimeve pa leje që duhen ekzekutuar (rënuar) brenda kësaj zone dhe territorit të komunës së Prizrenit, por kjo listë asnjëherë nuk është ofruar. Drejtoria e Inspektorateve ka publikuar raportin e punës janar-qershor 2015, ku thuhet se Inspektorët e ndërtimtarisë kanë kryer inspektime dhe mbikëqyrje të vazhdueshme, me ç’rast kanë formuar 170 lëndë, janë përpiluar 221 kontrolle me procesverbal, janë lëshuar 104 aktvendime për ndalim punimesh, 29 aktvendime për rrënim vullnetar, 19 pëlqime ndërtimtare, 6 konkluzione për ekzekutim të dhunshëm, 4 kallëzime penale, dhe janë shqiptuar dënime mandatore në shumë

46 Raporti i Auditorit për pasqyrat financiare të Komunës së Prizrenit 2014, [http://oag-rks.org/repository/docs/sq\\_Raporti\\_Final\\_Prizren\\_327559.pdf](http://oag-rks.org/repository/docs/sq_Raporti_Final_Prizren_327559.pdf)

47 Institucionet konfirmojnë degradimin urbanistik në Qendrën Historike të Prizrenit, <http://ecmandryshe.org/?page=1,17,352#.VoZcck-znNU>

12,750 euro, dënime nga gjykatat kanë arritur vlerën në 3,500 euro<sup>48</sup>. Drejtoria e Inspektorateve ka publikuar edhe raportin e punës janar-dhjetor 2015 ku thuhet se në periudhën raportuese janë përpiluar 456 kontrolle me procesverbal, janë lëshuar 156 aktvendime për ndalim punimesh, 81 aktvendime për rrënim vullnetar, 60 pranim punësh hekuri para betonimit të pllakes, 14 pëlqime për pranim të kushteve ndërtimore për ordinaanca dhe të tjera, 17 konkluzione per ekzekutim të dhunshëm, 20 procesverbale për ekzekutim të dhunshëm, 10 inicime procedurash për kundërvajtje, 4 kallëzime penale, dhe janë shqiptuar dënime mandatore në shumë 18 mijë e 400 euro, derisa dënimet nga gjykatat kanë arritur vlerën në 9 mijë e 300 euro<sup>49</sup>. Rastet mund të raportohen nga publiku në DI, por nuk ka informata kthyesë në lidhje me rezultatet e ndërmarra.

Publiku nuk ka informata të mjaftueshme për performancën e kompanive të kontraktuara nga komuna për të zhvilluar projekte urbanistike. Nuk ka të dhëna specifike me emrat e kompanive që kanë kryer projektet kryesore të zhvillimit urban. Monitorimi dhe përcjellja e punëve që janë duke u zhvilluar kryhet nga dikasteret që janë bartës të projekteve. Informatat mbi projektet kryesore infrastrukturore që janë duke u zhvilluar, qëllimi i projektit dhe përfaqësuesit komunal që e kanë për detyrë; kontraktorë; buxheti; periudha e zbatimit, figurojnë vetëm në tabelat informuese në vendpunime. Nuk ka ndonjë listë specifike që i prezantohet online publikut.



### Nota: 1.5 (Negative)

*Arsyetimi: Transparenca e Komunës së Prizrenit lidhur me monitorimin e projekteve urbanistike ka marrë notim negativ, meqë publikut nuk i ofrohen informata relevante në këtë drejtim. Ndërsa gjendjen reale kryesisht e përshkruajnë raportet e institucioneve tjera shtetërore dhe monitoruesit e shoqërisë civile.*

48 Raporti i Punës janar – qershor 2015, Drejtoria e Inspektorateve, <https://kk.rks-gov.net/prizren/getattachment/5f25deb3-bdb0-4066-8a5a-3b61d4198eeb/Raporti-i-punes-janar-qershor-2015.aspx>

49 Raporti i Punës janar – dhjetor 2015, Drejtoria e Inspektorateve <http://kk.rks-gov.net/prizren/getattachment/a8e1ed44-b8e8-4160-af7d-8ee64121b449/Raporti-i-punes-janar-dhjetor-2015.aspx>

## VI. Notimi

	Pesha	%	Notimi	%
<b>Organizimi, përbërja, kompetencat, dokumentacioni dhe funksionimi</b>				
1. Kryetari, Drejtorët dhe Anëtarët e Kuvendit	3	5.56%	2	2%
2. Organizimi dhe funksionimi	2	3.70%	2	1%
3. Puna e organeve politikë-bërëse dhe vendim-marrëse	4	7.41%	2	3%
4. Luftimi i sjelljeve të pahijshme dhe keqpërdorimeve	3	5.56%	1	1%
5. Integrimi Evropian	2	3.70%	1	1%

### Menaxhimi ekonomik dhe financiar

6. Kontabiliteti dhe buxheti	5	9.26%	3	6%
7. Kontratat e prokurimit publik, furnizimit dhe granteve	5	9.26%	2	4%

### Menaxhimi i resurseve njerëzore dhe resurseve tjera

8. Të punësuarit në administratën publike dhe organizatat/institucionet publike	5	9.26%	1.5	3%
9. Pasuria kapitale dhe jokatitale	5	9.26%	1	2%

### Marrëdhëniet me qytetarët dhe shoqërinë

10. Informimi dhe shërbimi i qytetarëve	5	9.26%	2.5	5%
11. Bashkëpunimi me shoqërinë civile	5	9.26%	2	4%

### Planifikimi dhe zhvillimi urban

12. Planifikimi urban	5	9.26%	1	2%
13. Monitorimi i projekteve urbanistike	5	9.26%	1.5	3%

54

100%

37%

	Pesha	%	Notimi	%
<b>1. Kryetari, Drejtorët dhe Anëtarët e Kuvendit</b>				
1. Cili është kualiteti i informatave që përmbajnë resimet?	5	20%	2	8%
2. Sa janë të plota deklaratat e pasurisë?	5	20%	1	4%
3. Sa janë të kuptueshme, të plota dhe të qasshme informatat mbi interesat personale?	5	20%	1	4%
4. Sa efikase janë kanalet e komunikimit që përdoren nga personat e zgjedhur dhe emëruar politikisht?	5	20%	2	8%
5. Sa janë të përditësuara dhe të plota informatat mbi aktivitetet e Kryetarit, Kuvendit, dhe personave tjerë të zgjedhur dhe të emëruar?	5	20%	3	12%

25

100%

9

36%

	Pesha	%	Notimi	%
<b>2. Organizimi dhe funksionimi</b>				
6. Sa janë të plota dhe të lehtësisht të kuptueshme informatat mbi organizmin dhe kompetencat komunale?	5	20%	2	8%
7. A kanë qytetarët informata të mjaftueshme mbi mënyrat më efikase për ndikim në politikëbërje dhe vendimmarrje?	5	20%	1	4%
8. Sa janë të dobishme kanalet e komunikimit?	5	20%	2	8%
9. Cili është kualiteti i informatave për planet në të ardhmen?	5	20%	2	8%
10. A ka të dhëna mbi komunën?	5	20%	2	8%
	<b>25</b>	<b>100%</b>	<b>9</b>	<b>36%</b>

	Pesha	%	Notimi	%
<b>3. Puna e organeve politikë-bërëse dhe vendim-marrëse</b>				
11. Sa inkurajohet publiku të jetë vëzhgues aktiv i debateve dhe proceseve vendimmarrëse?	5	33.33%	2	13%
12. A është raportimi i Ekzekutivit i rregullt dhe i plotë në Kuvend?	5	33.33%	1	7%
13. Sa kanë mundësi qytetarët të informohen për punën e komunës, politikat dhe aktet normative?	5	33.33%	3	20%
	<b>15</b>	<b>100%</b>	<b>6</b>	<b>40%</b>

	Pesha	%	Notimi	%
<b>4. Luftimi i sjelljeve të pahijshme dhe keqpërdorimeve</b>				
14. A ka komuna mekanizma për të hetuar dhe gjykuar sjelljet e pahijshme dhe keqpërdorimet tjera?	5	33.33%	2	13%
15. A është komuna transparente në aktivitetet e saj në luftën kundër mashtrimeve/keqpërdorimeve?	5	33.33%	1	7%
16. Cili është niveli i informimit të publikut për mekanizmat e raportimit të keqpërdorimeve të mundshme?	5	33.33%	1	7%
	<b>15</b>	<b>100%</b>	<b>4</b>	<b>26.67%</b>

	Pesha	%	Notimi	%
<b>5. Integrimi Evropian</b>				
17. A ka publiku informata të mjaftueshme për obligimet e komunës në procesin e integritit në BE?	5	50%	1	10%
18. A ka publiku informata të mjaftueshme mbi ndikimet e mundshme të procesit të integritit në BE?	5	50%	1	10%
	<b>10</b>	<b>100%</b>	<b>2</b>	<b>20%</b>

	Pesha	%	Notimi	%
<b>6. Kontabiliteti dhe buxheti</b>				
19. A është publiku i informuar mirë rreth planifikimit buxhetor?	5	16.67%	3	10%
20. A publikohen të dhëna të mjaftueshme mbi ndarjet dhe realizimet buxhetore të komunës?	5	16.67%	3	10%
21. Sa është i informuar publiku për praktikën e mira dhe të metat e komunës në menaxhimin e financave publike?	5	16.67%	3	10%
22. A ka informata të mjaftueshme për të kuptuar burimet e të ardhurave të komunave?	5	16.67%	3	10%
23. Sa janë të informuar qytetarët për suficitin, deficitin dhe borxhin e komunës?	5	16.67%	2	7%
24. Sa transparente është funksionimi i organizatave të cilat ofrojnë shërbime për qytetarët ku komuna ka kompetenca (përfshi kompetenca të vogla)?	5	16.67%	1	3%

<b>30</b>	<b>100%</b>	<b>15</b>	<b>50%</b>
-----------	-------------	-----------	------------

	Pesha	%	Notimi	%
<b>7. Kontratat e prokurimit publik, furnizimit dhe granteve</b>				
25. Sa është transparent procesi përzgjedhjes dhe lidhjes së marrëdhënies kontraktuale, më saktësisht procesi i vlerësimit të përshtatshmërisë për hyrje në marrëdhënie kontraktuale me palën e caktuar?	5	50%	2	20%
26. A ka transparencë në menaxhimin e projekteve dhe kontratave?	5	50%	2	20%

<b>10</b>	<b>100%</b>	<b>4</b>	<b>40%</b>
-----------	-------------	----------	------------

	Pesha	%	Notimi	%
<b>8. Të punësuarit në administratën publike dhe organizatat/institucionet publike</b>				
27. A është i qartë organizimi i administratës komunale dhe funksionet e personave kyc?	5	25%	2	10%
28. Sa janë të qarta strukturat organizative dhe informatat mbi funksionimin e organizatave/institucioneve të ndryshme komunale?	5	25%	1	5%
29. A zbatohen praktikën më të mira të rekrutimit/punësimit?	5	25%	2	10%
30. A ka informata publike rreth performancës së administratës në bazë të standardeve më të larta?	5	25%	1	5%

<b>20</b>	<b>100%</b>	<b>6</b>	<b>30%</b>
-----------	-------------	----------	------------

	Pesha	%	Notimi	%
<b>9. Pasuria kapitale dhe jokapitale</b>				
31. A ka publikuar komuna listë të të gjitha patundshmërive?	5	25%	2	10%
32. A kemi informata dhe vendime të publikuara të cilat synojnë të arsyetojnë se përdorimi i tillë i tyre është në të mirë të sovranit?	5	25%	1	5%
33. A ka publikuar komuna listë të pasurive të ndryshme (inventar, automobila, piktura, pasuri tjetër me vlerë)?	5	25%	1	5%
34. A janë paraqitur aksionet dhe pronësia e komunës në kompani të ndryshme?	5	25%	1	5%
	<b>20</b>	<b>100%</b>	<b>5</b>	<b>25%</b>

	Pesha	%	Notimi	%
<b>10. Informimi dhe shërbimi i qytetarëve</b>				
35. Sa është efikase zyra për informim?	5	12.50%	3	8%
36. A ka Komuna plane apo strategji të veprimit për transparencën në komunë?	5	12.50%	4	10%
37. Sa është e dobishme ueb faqja e komunës?	5	12.50%	3	8%
38. A ofron komuna mundësi për të marrë mendimin e qytetarëve për përmirësim të transparencës?	5	12.50%	1	3%
39. Sa përdoren mjetet inovative për transparencë dhe komunikim me publikun?	5	12.50%	2	5%
40. A janë të dhënat të kuptueshme për qytetarët e komunës?	5	12.50%	3	8%
41. A mundësohet qasja në dokumente publike?	5	12.50%	3	8%
42. Cili është kualiteti i informatave rreth shërbimeve për qytetarët?	5	12.50%	2	5%
	<b>40</b>	<b>100%</b>	<b>21</b>	<b>52.50%</b>

	Pesha	%	Notimi	%
<b>11. Bashkëpunimi me shoqërinë civile</b>				
43. A janë krijuar forma të strukturuar të bashkëpunimit me shoqërinë civile?	5	33.33%	3	20%
44. A mbahen takime me publikun?	5	33.33%	2	13%
45. A konsultohen qytetarët rreth dokumenteve me interes para se ato të aprovohen?	5	33.33%	2	13%
	<b>15</b>	<b>100%</b>	<b>7</b>	<b>46.67%</b>

	Pesha	%	Notimi	%
<b>12. Planifikimi urban</b>				
46. Sa është publiku i informuar rreth akteve normative dhe dokumenteve strategjike në fushën e planifikimit urban?	5	33.33%	2	13%
47. A përdor komuna mjetet më të avancuara për t'iu mundësuar publikut të vëzhgojnë të gjithë elementet që ndërlidhen me planet urbane?	5	33.33%	1	7%
48. Sa është komuna transparente me lejet e ndërtimit dhe shfrytëzimit të hapësirave?	5	33.33%	1	7%
	<b>15</b>	<b>100%</b>	<b>4</b>	<b>26.67%</b>

	Pesha	%	Notimi	%
<b>13. Monitorimi i projekteve urbanistike</b>				
49. Sa është komuna efikase për të raportuar për aktivitetet e saja për monitorimin e zbatimit të planit urbanistik?	5	50%	2	20%
50. A ka publiku informata të mjaftueshme për performancën e kompanive të kontraktuara nga komuna për të zhvilluar projekte urbanistike?	5	50%	1	10%
	<b>10</b>	<b>100%</b>	<b>3</b>	<b>30%</b>





# Referencat

Raporte dhe analiza _____	182
Raporte dhe dokumente të institucioneve publike _____	182
Legjislacion dhe politika _____	183
Ueb-faqet dhe profilet në rrjete sociale të institucioneve publike _____	184
Media _____	188
Intervista _____	188
Fokus grupe _____	191

## Raporte dhe analiza

Buxhetometri për Komunën e Prizrenit, Instituti GAP dhe EC Ma Ndryshe

EC Ma Ndryshe, Institucionet konfirmojnë degradimin urbanistik në Qendrën Historike të Prizrenit, 2015

Instituti Demokratik i Kosovës, Transparometri komunal Janar-Qershor 2015, korrik 2015

Instituti GAP, Praktikrat e Buxhetimit në Gjashtë Komuna të Kosovës, 2014

Instituti GAP, Si i shpenzon shteti paret tona?

Lëvizja FOL, Platforma e krahasimit të pasurisë

Qendra Kosovare për Bashkëpunim Ndërkombëtar, Përfshirja e publikut në vendimmarrje në Komunën e Gjilanit, dhjetor 2015

SIGMA, Legjislacioni mbi shërbimin civil: listë për verifikimin e legjislacionit dytësor, 1997

## Raporte dhe dokumente të institucioneve publike

Komuna e Ferizajit, Plani strategjik i komunës për trajtimin dhe parandalimin e korrupsionit, 2016

Komuna e Mitrovicës, Raport i punës i Drejtorisë për Integritet Europian dhe Mirëqenie Sociale, 2015

Komuna e Mitrovicës, Raport lidhur me kërkesat për qasje në dokumentet publike, 2016

Komuna e Mitrovicës, Raporti vjetor për performansën e arritur në shërbimet administrative për vitin 2015, 2016

Komuna e Pejës, Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2014-2016

Komuna e Pejës, Raportet e Punës të Kryetarit të komunës, 2015

Komuna e Prizrenit, Drejtoria e Inspektorateve, Raporti i Punës janar – qershor 2015, 2015

Komuna e Prizrenit, Drejtoria e Inspektorateve, Raporti i Punës janar – dhjetor 2015, 2016

Zyra e Auditorët të Përgjithshëm, Raporti i auditimit për pasqyrat financiare të komunës së Prizrenit për vitin 2014, 2015

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, Raportet e komunave, 2015

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, Raporti i Auditimit për Komunën e Mitrovicës për vitin 2014, 2015

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, Raporti i Auditimit për Pasqyrat Financiare të Komunës së Prishtinës për vitin 2014, 2015

## Legjislacion dhe politika

Gazeta Zyrtare e Kosovës Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, 2008

Gazeta Zyrtare e Kosovës, Ligji për Deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, 2011

Gazeta Zyrtare e Kosovës, Ligji për qasje në dokumente publike, 2010

Gazeta Zyrtare e Kosovës, Ligji për Qendrën Historike të Prizrenit, 2012,

Komuna e Ferizajit, Rregullorja për transparence, 2014

Komuna e Ferizajit, Statuti i Komunës së Ferizajit, 2008

Komuna e Gjakovës, Statuti i Komunës së Gjakovës, 2008

Komuna e Gjilanit, Statuti i Komunës së Gjilanit, 2014

Komuna e Mitrovicës, Planet rregulluese të miratuara nga Kuvendi i Komunës 2010 – 2015

Komuna e Mitrovicës, Rregullorja për Mbrojtjen e Mjedisit, 2010

Komuna e Mitrovicës, Statuti i Komunës së Mitrovicës, 2011

Komuna e Pejës, Statuti i Komunës së Pejës, 2008

Komuna e Prishtinës, Statuti i Komunës së Prishtinës, 2010

Komuna e Prizrenit, Statuti i Komunës së Prizrenit, 2008

Komuna e Prizrenit, Strategjia komunale për Informim, Komunikim dhe Pjesëmarrje Qytetare 2015-2018, 2015

Ministria e Administratës Publike, Rregullore për Kodin e Mirësjelljes në shërbimin civil të Republikës së Kosovës, 2015

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Udhëzim Administrativ për procedure e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme në komunë, 2014

## Ueb-faqet dhe profilet në rrjete sociale të institucioneve publike

Agjencia Kundër Korrupsionit, Deklarimi e pasurisë, [http://www.akk-ks.org/sq/deklarimet?path=declaration\\_assets%2F2015%2FKomunat%2FKomuna\\_e\\_Gjakoves#indexmain](http://www.akk-ks.org/sq/deklarimet?path=declaration_assets%2F2015%2FKomunat%2FKomuna_e_Gjakoves#indexmain)

Agjencia Kundër Korrupsionit, Deklarimi i Pasurusi për Komunën e Pejës, [http://akk-ks.org/sq/deklarimet?path=declaration\\_assets%2F2015%2FKomunat%2FKomuna\\_e\\_Pejes#indexmain](http://akk-ks.org/sq/deklarimet?path=declaration_assets%2F2015%2FKomunat%2FKomuna_e_Pejes#indexmain)

Agjencia Kundër Korrupsionit, Regjistër për deklarimin e pasurisë, [http://www.akk-ks.org/declaration/2015/Komunat/Komuna\\_e\\_Gjilanit/Nazim\\_Gagica.pdf](http://www.akk-ks.org/declaration/2015/Komunat/Komuna_e_Gjilanit/Nazim_Gagica.pdf)

Agjencia Kundër Korrupsionit, Vendimet, <http://akk-ks.org/sq/vendimet>

Agjencia Kundër Korrupsionit, Deklarimet e pasurisë së zyrtarëve të Komunës së Mitrovicës, [http://akk-ks.org/sq/deklarimet?path=declaration\\_assets%2F2015%2FKomunat%2FKomuna\\_e\\_Mitrovices\\_Jugore](http://akk-ks.org/sq/deklarimet?path=declaration_assets%2F2015%2FKomunat%2FKomuna_e_Mitrovices_Jugore)

Gazmend Muhaxheri, profili zyrtar në Facebook, <https://www.facebook.com/gazmuaxheri/?fref=ts>

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, <https://krpp.rks-gov.net/>

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, Kontratat, [https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=SearchNotices&ind=1&PPRCMenu\\_OpenNode=63](https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=SearchNotices&ind=1&PPRCMenu_OpenNode=63)

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, Njoftimet për Komunën e Mitrovicës, [https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=SearchNotices&ind=1&PPRCMenu\\_OpenNode=63](https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=SearchNotices&ind=1&PPRCMenu_OpenNode=63)

Komuna e Ferizajit, Emrat e anëtarëve të Kuvendit të Komunës, <https://kk.rks-gov.net/ferizaj/getattachment/Municipality/Assembly/Asambleistet/Emrat-e-anetareve-te-KK-se-Lista-e-re-e-zgjedhjeve-2013.pdf.aspx>

Komuna e Ferizajit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, <https://kk.rks-gov.net/gjakove/Kuvendi/Kryesuesi-i-Kuvendit.aspx>

Komuna e Ferizajit, Lajmet, <https://kk.rks-gov.net/ferizaj/News/Shkarkimet-e-fundit---ne-funksion-te-ngritjes-se-e.aspx>

Komuna e Ferizajit, Organogrami <https://kk.rks-gov.net/ferizaj/getattachment/Temat/Organogrami-i-Komunes/Organogrami-i-Komunes-se-Ferizaj.pdf.aspx>

Komuna e Ferizajit, Profilet e Këshilltarëve, <https://kk.rks-gov.net/ferizaj/Municipality/Assembly/Profilet-e-keshilltarve.aspx>

Komuna e Ferizajit, profili zyrtar në Facebook, <https://www.facebook.com/KomunaFerizajFaqjaZyrtare/?fref=ts>

Komuna e Ferizajit, Rregulloret, <https://kk.rks-gov.net/ferizaj/Municipality/Assembly/Regulations.aspx>

Komuna e Ferizajit, Shërbimet Publike, <https://kk.rks-gov.net/ferizaj/Services/Sherbimet-Publike.aspx>

Komuna e Ferizajit, Udhërrëfytyesi i Ferizajit për vizitorë, <https://kk.rks-gov.net/ferizaj/getattachment/Home/Udherrefyfyesi-i-Ferizajit111.pdf.aspx>

Komuna e Gjakovës, Njoftimet për kontratë, <https://kk.rks-gov.net/gjakove/Prokurimi/Njoftim-per-kontrate.aspx>

Komuna e Gjakovës, profili zyrtar në Facebook, <https://www.facebook.com/KuvendiKomunalGjakove>

Komuna e Gjakovës, Vendim për të gjeturat e auditorit, <https://kk.rks-gov.net/gjakove/getattachment/c7920c8a-9add-4095-b9c2-91ad7136d962/Vendim-per-te-gjeturat-e-auditorit-dt--24-07-2015.aspx>

Komuna e Gjilanit, Departamenti i Prokurimit, <http://kk.rks-gov.net/gjilan/Zyret/Departamenti-i-Prokurimit.aspx>

Komuna e Gjilanit, Kabineti i kryetarit të komunës, <http://kk.rks-gov.net/gjilan/Municipality/Kabineti/Major%60s-profile.aspx>

Komuna e Gjilanit, Kontaktet, <http://kk.rks-gov.net/gjilan/Important-Phone.aspx>

Komuna e Gjilanit, Kryetari i komunës, <http://kk.rks-gov.net/gjilan/Municipality/President/President-profile.aspx>

Komuna e Gjilanit, Lajmet, <http://kk.rks-gov.net/gjilan/News/Gjilani-mban-takimin-publik-me-qytetaret,-i-10-ti-.aspx>

Komuna e Gjilanit, profili zyrtar në Facebook, <https://www.facebook.com/Komuna-e-Gjilanit-Faqja-Zyrtare-1410141205896819/>

Komuna e Gjilanit, Regjistrimi i procedurave administrative, <https://rpa.rks-gov.net/sq/>

Komuna e Gjilanit, Takimet publike me qytetarët, <http://kk.rks-gov.net/gjilan/Takimet-Publike-me-Qytetare/Procesverbalet.aspx>

Komuna e Gjilanit, Zyra për Integritet Europiane, <http://kk.rks-gov.net/gjilan/Municipality/Zyret/Zyra-per-Integritet-Evropiane.aspx>

Komuna e Mitrovicës, Drejtoria për Integritet Europiane dhe Mirëqenie Sociale, <https://kk.rks-gov.net/mitrovice/Municipality/Departments/Integriteteve-Evropiane-dhe-Mireqenies-Sociale.aspx>

Komuna e Mitrovicës, Fletëpalosje e Drejtorisë për Planifikim dhe Urbanizëm, <https://kk.rks-gov.net/mitrovice/getattachment/Municipality/Departments/Urban-Planning,-Cadastre-and-Environmental-Protect/Drejtoria-per-Planifikim-dhe-Urbanizem.pdf.aspx>

Komuna e Mitrovicës, Forumi, <https://kk.rks-gov.net/mitrovice/Forums.aspx>

Komuna e Mitrovicës, kanali zyrtar në Youtube: <https://www.youtube.com/user/MBNz96p6c7gF3Wf7ODPY>

Komuna e Mitrovicës, Kryetari i komunës, <https://kk.rks-gov.net/mitrovice/Municipality/President/President-profile.aspx>

Komuna e Mitrovicës, Lista e anëtarëve të Kuvendit të Komunës <https://kk.rks-gov.net/mitrovice/Municipality/Assembly/Major-s-deputies.aspx>

Komuna e Mitrovicës, Mbledhjet e Kuvendit, audio incizimet, <https://kk.rks-gov.net/mitrovice/Municipality/Seances/Mbledhjet-e-Kuvendit-2014--Audio.aspx>

Komuna e Mitrovicës, Platforma “Cakto takim online me zyrtarët komunal”, <http://www.komunamitrovices-takimet.com/>

Komuna e Mitrovicës, profili zyrtar në Facebook, <https://www.facebook.com/komuna.mitrovices>

Komuna e Mitrovicës, Skema Organizative e Komunës, <https://kk.rks-gov.net/mitrovice/Municipality/Organogrami-i-Komunes-se-Mitrovices.aspx>

Komuna e Mitrovicës, Zyra për Informim, <https://kk.rks-gov.net/mitrovice/Municipality/Zyret-Njesite/Zyra-per-Informim.aspx>

Komuna e Pejës, profili zyrtar në Facebook, <https://www.facebook.com/komuna.peje>

Komuna e Pejës, Transmetimi Live i seancave të Kuvendit të Komunës, [https://kk.rks-gov.net/peje/Assembly-\(1\)/Transmetim-live.aspx](https://kk.rks-gov.net/peje/Assembly-(1)/Transmetim-live.aspx)

Komuna e Prishtinës, Lista e lejeve ndërtimore të leshura, <https://kk.rks-gov.net/prishtina/Municipality/Departments/Urbanizem,Ndertim-dhe-Mbr-Mjedisit/Lejet-e-leshuara.aspx>

Komuna e Prishtinës, Njoftimet për dhënien e kontratave, <http://prishtinaonline.com/prokurimi/njoftim-per-dhenjen-e-kontrates>



Komuna e Prishtinës, Portali i Punësimit, <http://erekrutimi.net/>

Komuna e Prishtinës, profili zyrtar në Facebook: <https://www.facebook.com/komunaprishtine>

Komuna e Prishtinës, profili zyrtar në Twitter, <https://twitter.com/kprishtines>

Komuna e Prishtinës, Rezymetë e anëtarëve të Kuvendit të Komunës, <https://kk.rks-gov.net/prishtina/Municipality/Assembly/Asamblastet.aspx>

Komuna e Prishtinës, Drejtoria për Urbanizëm, Ndërtim dhe Mbrojtje të Mjedisit, Udhëzues për Qytetarë, <https://kk.rks-gov.net/prishtina/getattachment/Municipality/Departments/Urbanizem,Ndertim-dhe-Mbr-Mjedisit/Udhezues-per-qytetare/Udhezues-per-qytetare.pdf.aspx>

Komuna e Prizrenit, Drejtorët, <http://kk.rks-gov.net/prizren/Municipality/Drejtoret.aspx>

Komuna e Prizrenit, Lajmet, <https://kk.rks-gov.net/prizren/News/Kryetari-i-komunws-prof-dr-Ramadan-Muja,-ne-afat-.aspx>

Komuna e Prizrenit, Nënkyetari, <https://kk.rks-gov.net/prizren/Municipality/Major%60s-profile.aspx>

Komuna e Prizrenit, profili zyrtar në Facebook, <https://www.facebook.com/kkprizren/>

Komuna e Prizrenit, Regjistri i Pronës dhe Regjistri i Lokaleve, <https://kk.rks-gov.net/prizren/Home.aspx>

Komuna e Prizrenit, Zyra për Integritim Evropian, <http://kk.rks-gov.net/prizren/Municipality/Zyra-per-integrime-evropiane.aspx>

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Departamenti për Integritim Evropian dhe Koordinim të Politikave <https://mapl.rks-gov.net/Main-menu/Departamentet/Departamenti-per-Integrime-Evropiane.aspx>

Projekti “Open Data Kosovo”, <http://opendatakosovo.org/>

Shpend Ahmeti, profili zyrtar në Facebook, <https://www.facebook.com/shpend.ahmeti>

Televizioni Syri Vision, <http://www.syri-vision.tv/tv/live.html>

Ueb faqja personale e Lutfi Hazirit, <http://lutfihaziri.com/>

## Media

Gazeta Express, Komuna e Gjakovës e konfirmon dorëheqjen e Hoxhës

KOHA Net, AVONET: Kryetari i Ferizajt punëson të vetët

KOHA Net, Opozita e akuzon kryetarin Haziri për mashtrim

KOHA Net, Zvarritja e rrugës Shpenadi-Velezhë ngjall dyshime tek autoritetet shtetërore

## Intervista

Abdurrahman Uruqi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit, Komuna e Ferizajit, intervistuar më 21 tetor 2015, Ferizaj

Abetare Domi, Armend Vokshi, Mimoza Kusari (intervistë në grup), Komuna e Gjakovës, intervistuar më 2 dhjetor 2015, Gjakovë

Afërdita Sylejmani, Aktiviste e organizatës CBM, intervistuar më 29 tetor 2015 dhe 31 tetor 2015, Mitrovicë

Agim Zuzaku, Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik, Komuna e Gjilanit, intervistuar më 5 tetor 2015, Gjilan

Ajet Musliu, Koordinator i Drejtorisë së Urbanizmit, Komuna e Ferizajit, intervistuar më 23 tetor 2015, Ferizaj

Ali Tafarshiku, Kabineti i Kryetares, Komuna e Gjakovës, intervistuar më 16 tetor 2015, Gjakovë

Abetare Domi, Zyrtare për informim, Komuna e Gjakovës, intervistuar më 16 tetor 2015, Gjakovë

Alidin Damati, Gazetar në Agjencinë e Lajmeve KosovaPress (korrespondent nga Mitrovica), intervistuar më 2 tetor 2015, Mitrovicë

Arben Shala, Zyrtar juridik në Drejtorinë e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, Komuna e Prizrenit, intervistuar më 20 nëntor 2015, Prizren

Arbër Kadriu, Drejtor ekzekutiv i Iniciativa për Progres (INPO), intervistuar më 29 tetor 2015, Prishtinë

- Arbreshë Fazliu, Gazetare në Klan Kosova, intervistuar më 10 nëntor 2015, Prishtinë
- Ariana Lukaj, Kabineti i Kryetarit, Zyra informimit, intervistuar më 23 tetor 2015, Pejë
- Ariana Lukaj, Zyrtare për informim, Komuna e Pejës, intervistuar më 9 tetor 2015, Pejë
- Armend Vokshi, Drejtorja e Administratës, Komuna e Gjakovës, intervistuar më 15 tetor 2015, Gjakovë
- Fatos Axhemi, aktivist i shoqërisë civile, intervistuar më 15 dhjetor 2015, Gjakovë
- Artiana Matoshi, Gazetare në Koha Ditore, intervistuar më 5 nëntor 2015, Prishtinë
- Bekim Salihu, Hulumtues në Institutin GAP, intervistuar më 30 tetor 2015, Prishtinë
- Burim Elezi, Zyrtar për Integritet Europian, Komuna e Gjilanit, intervistuar më 6 tetor 2015, Gjilan
- Drin Veselaj, Anëtar i Kuvendit të Komunës së Pejës, intervistuar më 30 janar 2016, Pejë
- Durim Sheremeti, Kabineti i Kryetarit, Komuna e Pejës, intervistuar më 23 tetor 2015, Pejë
- Elenora Fetollari, Koordinatorja e Zyrës për Integritet Europian, Komuna e Prizrenit, intervistuar më 29 nëntor 2015, Prizren
- Erzen Vraniqi, Zyrtar për informim, Komuna e Prishtinës, intervistuar më 20 tetor 2015, Prishtinë
- Fahil Hoxha, Koordinator i Inspektoriatit, Komuna e Prizrenit, intervistuar më 21 tetor 2015, Prizren
- Faik Grainca, Drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit dhe Mjedisit, Komuna e Ferizajit, intervistuar më 13 tetor 2015, Ferizaj
- Faruk Guri, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Ferizajit, intervistuar më 18 shtator 2015, Ferizaj
- Faruk Hyseni, Drejtor i Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme, Komuna e Ferizajit, intervistuar më 4 shtator 2015, Ferizaj
- Fatmir Beka, Monitorues i komunës së Mitrovicës nga organizata Mundësia, intervistuar më 11 shtator 2015, Mitrovicë
- Flamur Shala, Anëtar i Kuvendit të Komunës nga LDK, Komuna e Prishtinës, intervistuar më 25 tetor 2015, Prishtinë
- Ganimet Klaiqi, Gazetar Koha Ditore, intervistuar më 29 tetor 2015, Prishtinë

Hatixhe Përzhella, Koordinator e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Komuna e Prizrenit, intervistuar më 19 nëntor 2015, Prizren

Haxhi Gashi, Zyrtar i Prokurimit, Komuna e Pejës, intervistuar më 9 tetor 2015, Pejë

Hilmi Mustafa, Zyrtar për integritet Europian, Komuna e Ferizajit, intervistuar më 7 tetor 2015, Ferizaj

Hysni Sylja, Zyrtar për informim, Komuna e Mitrovicës, intervistuar më 2 tetor 2015, Mitrovicë

Ilir Baldedaj, Drejtor i Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme, Komuna e Prizrenit, intervistuar më 3 shkurt 2016, Prizren

Isa Gashi, Shef i Zyrës së Personelit, Komuna e Prizrenit, intervistuar më 19 nëntor 2015, Prizren

Isë Osmanaj, Menaxher i Zyrës së Prokurimit, Komuna e Prizrenit, intervistuar më 13 nëntor 2015, Prizren

Islam Husaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Pejës, intervistuar më 3 shkurt 2016, Pejë

Jeton Abazi, Drejtor i Financave, Komuna e Pejës, intervistuar më 8 tetor 2015, Pejë

Kujtim Gashi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Prizrenit, intervistuar më 26 nëntor 2015, Prizren

Lirak Çelaj, Anëtar i Kuvendit të Komunës nga PDK, Komuna e Prishtinës, intervistuar më 25 tetor 2015, Prishtinë

Lirije Sylja, Drejtore e Drejtorisë së Financave, Komuna e Ferizajit, intervistuar më 21 tetor 2015, Ferizaj

Mailinda Ibrahim, gazetare në TV Mitrovica, intervistuar më 9 nëntor 2015, Mitrovicë

Mentor Buzhala, Gazetar në Zëri, intervistuar më 5 nëntor 2015, Prishtinë

Miranda Mullafazliu, Zyrtare për informim, Komuna e Prishtinës, intervistuar më 14 tetor 2015, Prishtinë

Muhamet Kelmendi, Zyrtar i Personelit, Komuna e Pejës, intervistuar më 8 tetor 2015, Pejë

Muhamet Pajaziti, Zyrtar për informim dhe qasje në dokumente publike, Komuna e Gjilanit, intervistuar më 6 tetor 2015, Gjilan

Naim Cahani, Koordinator projektsh në Institutin Demokratik të Kosovës, intervistuar më 13 janar 2016, Prizren

Naser Musa, Zyrtar i Pasurisë, Komuna e Ferizajit, intervistuar më 16 shtator 2015, Ferizaj

Nazim Gagica, Drejtor i Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme, Komuna e Gjilanit, intervistuar më 5 tetor 2015, Gjilan

Rajmonda Zhdrella, Gazetare në Koha Vizion (Emisioni 038), intervistuar më 9 nëntor 2015, Prishtinë

Suzana Muriqi, Zyrtare në Drejtorinë e Integritit dhe Diaspores, Komuna e Pejës, intervistuar më 9 tetor 2015, Pejë

Skënder Susuri, Anëtar i Kuvendit të Komunës së Prizrenit nga Bashkimi Demokratik, intervistuar më 20 nëntor 2015, Prizren

Shkodran Nikqi, Gazetar i BINR (Kallxo.com), intervistuar më 24 tetor 2015, Pejë

Shyhrete Topalli, Zyrtare për informim, Komuna e Ferizajit, intervistuar më 19 gusht 2015, Ferizaj

Vehbi Geci, Zyrtar juridik në Departamentin e Prokurimit, Komuna e Gjilanit, intervistuar më 6 tetor 2015, Gjilan

Visar Islamaj, Zyrtar në Zyrën e Shërbimit Profesional të Kuvendit të Komunës së Prizrenit, intervistuar më 9 dhjetor 2015, Prizren

Ymer Berisha, Shef i Zyrës për Informim, Komuna e Prizrenit, intervistuar më 18 janar 2016 dhe 3 shkurt 2016, Prizren

Zijadin Maliqi, Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Komuna e Gjilanit, intervistuar më 5 tetor 2015, Gjilan

Zyrtar i Drejtorisë së Urbanizmit, Komuna e Prishtinës, intervistuar më 22 tetor 2015, Prishtinë

## Fokus grupe

Ferizaj, 12 shkurt 2016, Restaurant Orchide, Moderator: Afrim Demiri

Gjakovë, 9 shkurt 2016, Çarshia e Jupave, Moderator: Kreshnik Basha

Gjilan, 5 shkurt 2016, Hotel Kristal, Moderator: Muhamet Halili

Mitrovicë, 16 shkurt 2016, Vila Lux, Moderator: Besnik Leka

Pejë, 29 janar 2016, Hotel Dukagjini, Moderatore: Rozafa Imami

Prishtinë, 24 shkurt 2016, Salla e Konferencave Orion, Moderator: Visar Sutaj

Prizren, 22 janar 2016, Villa 100, Moderator: Kreshnik Basha

# EC MANDR

EC është organizatë e komunitetit, e themeluar në vitin 2006, që angazhohet për avansimin e demokracisë në nivel lokal në Kosovë. Organizata punon me një numër të konsiderueshëm grupesh të komunitetit, si dhe mirëmban një presion të përhershëm ndaj qeverive lokale për qeverisje gjithëpërfshirëse, transparente dhe llogaridhënëse. EC angazhohet për qytetari aktive në formësimin e ambientit jetësor duke nxitur organizim të mirëfilltë të komunitetit, demokratizim të institucioneve dhe pasurim të jetës kulturore në qendrat kryesore të Kosovës, me fokus në Prizren dhe Prishtinë. Nga janari i vitit 2015, EC funksionon me këto tri programe: Qyteti Gjithëpërfshirës (mobilizim i komunitetit), Qeverisja e mirë (monitorim dhe avokim), Hulumtimi (prodhim i dijes).

Tiparet dalluese të EC janë: një, fokusi gjeografik, dhe dy, qasja ndaj çështjeve të interesit. E bazuar në Prizren dhe Prishtinë, organizata përdor qasje antropologjike në hulumtimin dhe zhvillimin e politikave. Si rezultat, produktet e hulumtimit të organizatës ofrojnë përmbajtje të besueshme, pasi që merren me thelbin e problemit në vend se me simptomat. Për më tepër, EC mbulon fusha të veçanta sikur planifikimi urban, politikat kulturore, menaxhimi i hapësirës publike dhe të ngjashme, të cilat janë përgjithësisht të nëntrajtuara në Kosovë. Aktiviteti hulumtues dhe aktivizmi grassrootsi organizatës janë metoda pune të kombinuara mirë dhe të ndërvarura. Përmes aktivizmit, EC angazhohet në mënyrë të përhershme në punë me grupet e komunitetit për t'i identifikuar nevojat e tyre, të cilat janë burime që e ushqejnë komponentën e hulumtimeve. Kjo metodologji mundëson ndikim më të madh tek agjenda e politikëbërjes, pasi që idetë vijnë nga poshtë, ndërsa paralelisht krijohen mundësi për përfshirjen e politikëbërësve në një debat konstruktiv dhe të mirëinformuar.

Projektet kryesore të organizatës gjatë viteve të fundit: Prizreni, qytet pa pengesa (2016–2017), Qyteti Gjithëpërfshirës, lagje aktive për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren (2016–2020), Shkolla për Planifikim dhe Zhvillim Urban (2015–2016), EC për qytete transparente dhe gjithëpërfshirëse (2015–2016), Indeksi i Reformës së Transparencës Komunale (2015–2016), Urbanizmi i Prizrenit nën vëzhgim të përhershëm (2013–2016), Aktivizmi kulturor dhe urban në Prizren (2014–2015), Qyteti Gjithëpërfshirës, planifikim me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren (2013–2015), Lidhja e komunitetit me shërbyesit e drejtësisë (2014–2016), Zhvillimi rajonal përmes turizmit kulturor (2014–2015), Pjesëmarrja qytetare përmes medias sociale (2013–2015),

# RYSHE

Trashëgimia kulturore, shtyllë qendrore e zhvillimit lokal dhe rajonal në Prizren (2013–2015), Pjesëmarrja publike në hartimin e politikave kulturore në Prizren (2012–2013), Transparenca Online e komunave të Prizrenit, Mamushës dhe Prishtinës (2012–2015), Një tregim ballkanik (2011–2012), Aktivizmi qytetar për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore (2009–2010).

Publikimet e fundit të organizatës: Trashëgimia kulturore, një histori e patreguar (2016), Milionat e shpenzuara për monumentet e mbyllura (2016), Një qytet për komunitetin (2015), Katalogu i Rajonit Jug “Bukur dhe Gjellbër” (2015), Zhdukja e Gjurmëve – Qendrat historike të Kosovës (2015), Mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore (kontribut për raportin e Progresit) (2015), (Pa)drejtësia në urbanizmin e Prizrenit (2015), Grupet e komunitetit dhe planifikimi urban në Prizren (2015), Katalogu i Rajonit të Prizrenit (2015), Planifikim urban për qytetarët (2014), Qendra Historike e Prishtinës numëron ditët e fundit (2014), Ku është kalldrëmi i Prizrenit? (2014), Paraja publike si “paret e babës” (2014), Udhëzues për transparencën në komuna (2014), Ligjet nuk po e mbrojnë Qendrën Historike të Prizrenit (2014), Urbanizmi si lexim i qytetit (2014).